



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR**  
**MBI**  
**“AUDITIMIN FINANCIAR DHE**  
**PËRPUTHSHMËRISË”**  
**NË BASHKINË KORÇË**

**TIRANË, QERSHOR 2021**

| <b>Nr.</b> | <b>Përmbatja</b>  | <b>Faqe</b> |
|------------|---|-------------|
| <b>I</b>   | <b>HYRJA</b>  | 4           |
| 1          | Titulli   | 4           |
| 2          | Marrësi   | 4           |
| 3          | Objektivat dhe qëllimi  | 4           |
| 4          | Identifikimi i çështjes   | 4           |
| 5          | Përgjegjësitë e strukturave drejtuese   | 5           |
| 6          | Përgjegjësitë e audituesve  | 5           |
| 7          | Kriteret e vlerësimit   | 6           |
| 8          | Standardet e auditimit  | 6           |
| 9          | Metodat e auditimit   | 7           |
| 10         | Dokumentimi i auditimit   | 8           |
| <b>II.</b> | <b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>   | 9           |
| 1.         | Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim  | 9           |
| 2.         | Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit  | 10 - 197    |
| 2.1        | Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2018, 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.                     | 10- 18      |
| 2.2        | Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2018-2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi   | 19 - 61     |
| 2.3        | Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”. | 62 - 156    |
| 2.4        | Të tjera (procedura e dhënies së lejeve të ndërtimit).  | 156 - 169   |
| <b>III</b> | <b>KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT</b>  | 170-173     |
| <b>IV</b>  | <b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>   | 173 - 197   |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

**SHKURTIME**

|                |  |
|----------------|--|
| <b>KLSH</b>    | Kontrolli i Lartë i Shtetit  |
| <b>SNA</b>     | Standartet ndërkombëtare të auditimit  |
| <b>MFK</b>     | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli  |
| <b>NA</b>      | Nëpunës Autorizues   |
| <b>NZ</b>      | Nëpunës Zbatues  |
| <b>GSM</b>     | Grupi i Menaxhimit Strategjik  |
| <b>NJAB</b>    | Njësia e Auditimit të Brendshëm  |
| <b>AB</b>      | Auditi i Brendshëm   |
| <b>MAB</b>     | Manuali i Auditimit të Brendshëm   |
| <b>FZHR</b>    | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve   |
| <b>AQT</b>     | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara  |
| <b>UMF</b>     | Udhëzim i Ministrisë së Financave  |
| <b>VKM</b>     | Vendim i Këshillit të Ministrave   |
| <b>VKB</b>     | Vendim i Këshillit Bashkiak  |
| <b>ISSAI</b>   | Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit                      |
| <b>INTOSAI</b> | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit                       |
| <b>ISA</b>     | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit  |
| <b>IFAC</b>    | Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve  |
| <b>IPSAS</b>   | Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik                       |
| <b>ALUIZNI</b> | Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale |
| <b>IT</b>      | Teknologjia e Informacionit  |
| <b>NJA</b>     | Njësi Administrative   |
| <b>SHA</b>     | Shoqëri Anonimë  |
| <b>BOE</b>     | Bashkim i Operatorëve Ekonomikë  |
| <b>OE</b>      | Operator Ekonomik  |

## **I. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 260/11, datë 10.09.2020 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 14.09.2020 deri më datë 06.11.2020, në subjektin Bashkia Korçë, për periudhën e veprimtarisë së subjektit, nga data 01.01.2018 deri në 30.06.2020, u krye ri auditimi “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- L.B, Kryeauditues, Përgjegjës Grupi.
- S.M, Auditues.
- E.C, Auditues.
- B.Z, Kryeauditues.

**1. Titullin.** Auditim Financiar dhe Përputhshmërie

**2. Marrësi.** Bashkia Korçë

**3. Objektivat dhe qëllimi.**

- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, për të arritur objektivin e këtij auditimit që është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2018, 2019 dhe 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

- Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrin ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt, me synim dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbime e investimeve.

Ky projekt auditimi do të shtrihet për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2018 deri në datë 30.06.2020, si dhe do të ketë si fushëveprimi, buxhetimin për 6 mujorin e parë të viotit 2020, auditimin e pasqyrave dhe transaksioneve financiare, procedurat e prokurimit me fonde publike të zhvilluara gjatë periudhës së veprimtarisë nën auditim si dhe procedurat e dhënies së lejeve të ndërtimit.

**4. Identifikimi i çështjes.** Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit si dhe ai i aplikuar gjatë fazës së auditimit në terren, vijon të mbetet i vlefshëm, si dhe nuk ka rishikim të tij.

Sa më sipër, fushat me risk të lartë u përcaktuan drejtimet e auditimit të miratuara sipas Programit të Ri -Auditimit, nr.260/11, datë 10.09.2020, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në Bashkinë Korçë”, si më poshtë:

- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", ligjet vjetore "Për buxhetin e shtetit" të vitit 2018, 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

- 2. Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2018-2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

- 3. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

- Të ndryshme të dala gjatë auditimit (lejet e ndërtimit)

**5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.** Strukturat drejtuese të Bashkisë Korçë, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

#### **6. Përgjegjësitë e audituesve.**

##### Për auditimin financiar:

▪ Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

▪ Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

##### Për auditimin e përputhshmërisë:

▪ Përgjegjësitë e audituesit, lidhen me faktin e marrjes së sigurisë së arsyeshme, në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara si: rregullat, ligjet, politikën, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

ISSAI 4000 përcakton se, audituesit publikë duhet të përgatisin raportin e auditimit bazuar në parimet e plotësisë, objektivitetit, afatit, saktësisë dhe kundërshtimit. Më konkretisht:

*Parimi i Plotësisë*, kërkon që audituesi të marrë parasysh të gjitha dëshmitë e provat përkatëse të auditimit si dhe të trajtojë të gjithë informatat dhe evidencat e duhura e të mjaftueshme para se të lëshojë raportin e angazhimit;

*Parimi i Objektivitetit*, kërkon që audituesi të zbatojë gjykimin dhe skepticizmin profesional për t'u siguruar që raporti është faktikisht i saktë, dhe se gjetjet e konkluzionet janë të paraqitura në mënyrën e duhur, të drejtë dhe të ekuilibruar;

*Parimi i Afatit* nënkupton përgatitjen e raportit në kohën e duhur, pasi vetëm në këtë mënyrë ai është i rëndësishëm për përdoruesit e synuar;

*Parimi i Kundërshtimit ose Kontradiksionit*, nënkupton përfshirjen e komenteve nga subjekti përgjegjës në formën e përshtatshme, duke u përgjigjur dhe vlerësuar për këto reagime dhe komente.

## **7. Kriteret e vlerësimit.**

### **▪ Standardet e Auditimit:**

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit; (SNA)
- SNA mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Manuali i Auditimit Financiar, dhe Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

### **▪ Akte ligjore:**

- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me ndryshime;
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Ligji Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” etj.

### **▪ Akte nënligjore**

- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar;
- VKM nr. 545, datë 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit , Institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe Administratën e Prefektit", i ndryshuar;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, etj.

### **▪ Udhëzime, Urdhra dhe Rregullore**

- UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;
- UMF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njëjësive të vetëqeverisjes vendore”;
- UMF nr.10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, etj.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ KLSH<sup>së</sup>”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH<sup>së</sup> nr.85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH<sup>së</sup> e ndryshuar;
- Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Korçë, etj.

**8. Standardet e auditimit të aplikuar në kryerjen e punës.** Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 200-299 “Parimet bazë të auditimit financiar”, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”.

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

**ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”:** Gjatë auditimit, ka funksionuar sistemi i mbikëqyrjes dhe sigurimit të cilësisë, për të marrë siguri të arsyeshme, për dhënien e opinionit, nëse grupi i auditimit:

- ka vepruar në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore;
- në mënyrë individuale dhe kolektive ka patur kompetencën e nevojshme profesionale për të kryer auditimin;
- është mbikëqyrur nga Përgjegjësi i Grupit, Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit, për t’u siguruar që auditimi është kryer në përputhje me standardet përkatëse profesionale.

**ISSA 130 “Kodin Etik” :** Grupi i auditimit, gjatë punës audituese në terren vepruar në përputhje me Kodin Etik, duke reflektuar: Integritet; Pavarësi, objektivitet, paanshmëri. Ruajtjen e sekretit profesional; Kompetencat dhe kujdesin e duhur; Sjelljen profesionale.

**ISSAI 1315 “Risku”** Gjatë fazës së planifikimit dhe auditimit në terren, është kryer vlerësimi i riskut, si dhe u identifikuan fushat më risk më të lartë, mbi të cilat u fokusua auditimi. Nga Grupi i auditimit u vlerësua RA ( $RA=RB \cdot RKB \cdot RMZ$ ), ku u vlerësua:

- Kuptimi i subjektit dhe mjedisit i tij;
- U identifikua dhe vlerësua risku i brendshëm;
- U vlerësua funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm;
- U përcaktua e rreziku i mos zbulimit;
- U aplikua Modeli i sigurisë, (Më hollësisht të trajtuara në Letrat e punës).

**ISSAI 1320-1450 “Materialiteti”:** Nga Grupi i auditimit është përcaktuar sipas zonave të llogarisë niveli i materialitetit, i cili ka rezultuar si sasior, po ashtu edhe cilësor (kryesisht në auditimin e përputhshmërisë);

**ISSAI 1500 “Dokumentimi”:** Nga Grupi i auditimit është siguruar dokumentimi i gjetjeve të auditimit, duke u bazuar kryesisht në një evidencë të plotë, të saktë, të besuar, të mjaftueshme, duke marrë në konsideratë kriteret e: Mjaftueshmërinë e evidencës së auditimit; Rëndësia e evidencës së auditimit; Burimet e evidencës së auditimit; Llojet e evidencës së auditimit, etj.

**9. Metodatat e auditimit:** Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit.

Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer intervista me shkrim dhe verbale, ka kryer teste kontrolli, të cilat në mënyrë analitike janë të përshkuara në Letrat e punës.

Për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë (përputhshmërisë) nga ana e subjektit të audituar në lidhje me zhvillimin e procedurave të prokurimit publik (zona e llogarisë 23), u gjykua që të kryhen teste thelbësore (të detajeve) për të gjitha procedurat e auditimit të kryera nga subjekti në periudhën objekt auditimi.

Përzgjedhja e metodës u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit.

- Për të ardhurat, janë përdorur teste thelbësore (substanciale), duke u nisur nga vlerësimi paraprak që ka treguar se kontrollet dhe sistemet e kontroleve të brendshme të subjektit janë të dobëta dhe nuk funksionojnë (trajtuar më hollësisht te letrat e punës).

Testet e Kontrollit, të cilat janë përdorur nga Grupi i Auditimit, janë të mbështetura tek niveli i materialitetit dhe vlerësimin të riskut, shkalla e sigurisë që përfitohet nga kryerja e testeve të kontrollit, tekNT e kampionimit dhe zgjedhjes rastësore.

Testet e detajeve, të cilat janë përdorur nga Grupi i Auditimit, për të marrë evidencë auditimi për pohimet (ekzistenca e një ngjarje ekonomike, ligjshmëria dhe vlerësimi i saj).

- Për pasqyrat nën gjykimin profesional të audituesit, është përcaktuar pragu i materialitetit, sipër të cilit janë testuar llogaritë kontabël, si dhe është përcaktuar materialiteti sasior, bazuar në Manualin e auditimit financiar, me metodën e përqindjes mbi shpenzimet korente dhe kapitale, në vlerën 38,555,720 lekë (trajtuar në aneks 0 bashkëlidhur projekt raportit) Përsa i përket, rregullshmërisë dhe ligjshmërisë së shpenzimeve dhe transaksioneve të kryera, bazuar në analizën e RA, i cili është konsideruar i lartë, për zonën e llogarive 23, është kryer auditim i plotë, për shkak të vlerës së lartë dhe transaksioneve të kufizuara. Ndërkohë u audituan me zgjedhje, veprimtaritë dhe ngjarjet e tjera ekonomike, të cilat sipas gjykimit profesional të audituesit rezultojnë me risk më të ulët.

**10. Dokumentimi i auditimit,** është mbështetur në kërkesat e manualeve të auditimit, në Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e ezauruara (planifikim dhe auditim në terren). Nga Grupi i auditimit janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit, si dhe është lënë gjurmë auditimi për të gjitha procedurat e kryera nga Grupi i auditimit.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

## II. PËSHKRIMI AUDITIMIT

### 1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Bashkia Korçë, është Njësi e Vetëqeverisjes Vendore, e cila ka në përbërje të saj 7 Njësi Administrative: Qendër Bulgarec, Voskop, Voskopoje, Lekas, Vithkuq, Mollaj, Drenovë, ku secila mbart karakteristika territoriale, problematika, dhe vlera të veçanta nga njëra-tjetra, që kryesisht janë zona bujqësore fushore, malore ose të përziera, me pak zhvillim urban. Popullsia e qytetit të Korçës numëron 130 531 banorë. Pas viteve '90 qyteti pati një lëvizje të ndjeshme të popullsisë prej migrimit brenda vendit si edhe emigrimit jashtë shtetit. Përveç kombësisë shqiptare popullsia në qytet dhe rreth tij është e përzier me vllahë, sllavë dhe rumunë.



#### Njësitë administrative, qytetet dhe fshatrat

| Qarku   | Qendra e Bashkisë   | Njësitë administrative sipas RAT | Qytetet dhe fshatrat nën juridiksion të bashkisë   | Popullsia sipas Census 2011 | Popullsia sipas Regjistrimit Civil | Sipërfaqja KM <sup>2</sup> |
|---------|---|----------------------------------|--|-----------------------------|------------------------------------|----------------------------|
| Korçë   | Qyteti Korçë  | Korçë                            | Qyteti Korçë   | 75,994                      | 129,065                            | 805.99                     |
|         |   | Qëndër Bulgarec                  | Fshatrat; Bulgarec, Lumalas, Biranj, Melcan, Porodinë, Dishnicë, Shamoll, Belorta, Kuç i Zi, Barç, Çiflig, Malavec, Neviçisht  |                             |                                    |                            |
|         |   | Voskop                           | Fshatrat; Voskop, Dërsnik, Polen, Vinçan, Goskovë Iart, Goskovë poshtë, Damjanec   |                             |                                    |                            |
|         |   | Voskopoje                        | Fshatrat; Voskopoje, Shpskë, Krushovë, Gjonomadh, Lavdar   |                             |                                    |                            |
|         |   | Lekas                            | Fshatrat; Lekas, Marjan, Gjonbabas, Gurmujas, Shkozan, Xerje, Tudas, Gjergjevicë, Lavdar Brozdovec, Mazrek, Poponivë           |                             |                                    |                            |
|         |   | Vithkuq                          | Fshatrat; Vithkuq, Leshnje, Gjanc, Lubonjë, Rehovë, Roshanj, Trebickë, Grabockë, Treskë, Stratobërdh, Panarit, Shtyllë, Cemicë |                             |                                    |                            |
|         |   | Mollaj                           | Fshatrat; Mollaj, Floq, Pulahë, Ujë Bardhë, Kamenicë   |                             |                                    |                            |
| Drenovë | Fshatrat; Drenovë, Mborje, Boboshticë, Moravë, Qatrom, Ravonik, Turan, Dardhë |                                  |  |                             |                                    |                            |

Veprimtaria e saj bazohet në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, etj. Vendimet merren nga Këshilli Bashkiak. Drejtimi i Bashkisë kryhet nga Kryetari i Bashkisë. Njësitë Administrative drejtohen nga Administratorët e Njësive Administrative; **Detyrat dhe kompetencat e Bashkisë Korçë fokusohen kryesisht në:** Shërbimin publik; Shërbimin social; Shërbimin kulturor dhe sportet; Biznesin.

**Misioni për njësinë që auditohet është:** Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin). **Objektivat** burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

## **2. REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:**

**2/1 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit**, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2018, 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

- 1.1.** Programimi i PBA 2018-2020 dhe programimi i buxhetit vjetor 2018 dhe 2020.
- 1.2.** Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontroll i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.
- 1.3.** Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;
- 1.4.** Burimi krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre.
- 1.5.** Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.
- 1.6.** Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizimit të të ardhurave;
- 1.7.** Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

### **Për 6 mujorin e parë të vitit 2020.**

Në zbatim të pikës 1, të programit të auditimit nr. **260/1, datë 02.03.2020**, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Vendimet e Këshillit Bashkiak;
- 2- PBA
- 3- Raportet e monitorimit

### **Nga ana e Këshillit Bashkiak janë marrë vendimet sa më poshtë vijon:**

1. VKB nr. 172 datë 26.12.2019 “Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe të buxhetit vjetor 2021”.
2. VKB nr. 173 datë 26.12.2019 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2020 të Bashkisë Korçë”
3. VKB nr. 1 datë 30.1.2020 “Për një ndryshim në VKB nr. 173 datë 26.12.2019” Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2020 të Bashkisë Korçë.
4. VKB nr. 20 datë 27.2.2020 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2019 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2020.
5. VKB nr. 32 datë 30.3.2020 “Për miratimin e fondit për blerje pako ushqimore në ndihmë të familjeve në nevojë për përbalimin e fatkeqësisë natyrore të shkaktuara nga Covid-19”.
6. VKB nr. 40 datë 21.4.2020 “Për miratimin e rritjes së planit të buxhetit si dhe kalimin e fondit prej 3,000,000 lekësh të akorduara nga Këshilli i Qarkut për projektin “Qendra ditore për moshën e tretë”.
7. VKB nr. 41 datë 21.4.2020 “Për miratimin e rritjes së planit të të ardhurave dhe shpenzimeve për projektin “Doktor Shuster”, të financuar nga Ballkani Perëndimor Faza e II”.
8. Situacioni i shpenzimeve për vitet janar -qershor i rakorduar me Degën e Thesarit.
9. Urdhri i Kryetarit të Bashkisë nr. 20 datë 15.1.2020 për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik (GMS).

### **2.1. Programimi i PBA 2021-2023 dhe programimi i buxhetit vjetor 2020.**

#### **PBA 2021-2023**

Në zbatim të aktit normativ nr. 17, datë 22.4.2020, “Për përjashtimin e zbatimit të procedurave dhe afateve për përgatitjen e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm për vitin 2020”, Njësitë e Qeverisjes Vendore, përjashtimisht për vitin 2020, si pasojë e situatës epidemike të shkaktuar nga Covid-19, përjashtohen nga zbatimi i



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

procedurave dhe afatet për përgatitjen e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm.

Gjatë vitit 2020 me VKB nr. 13, datë 30.1.2020, janë miratuar vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave në zbatim të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Për vitin 2020 buxheti i Bashkisë Korçë paraqitet si më poshtë sipas burimeve të financimit dhe llogarive ekonomike.

000/lekë

| Nr. | Emërtimi  | VITI 2020        |                  |
|-----|---|------------------|------------------|
|     |   | Të ardhurat      | Shpenzimet       |
| 1   | Të ardhura të trashëguara viti 2019             | 154,039          |                  |
| 2   | Transfertë e pakushtëzuar viti 2020             | 449,034          |                  |
| 3   | Transfertë e pakushtëzuar sektoriale 2020       | 307,780          |                  |
| 4   | Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore 2020 | 1,062,931        |                  |
| 5   | Të ardhurat nga Institucionet e tjera           | 28,183           |                  |
| 6   | Projektet IPA                                   | 20,000           |                  |
| 7   | Të ardhura të tjera dhe sponsorizime            | 5,817            |                  |
| 1   | Paga + Sigurime Shoqërore (600+601)             |                  | 654,542          |
| 2   | Shpenzime korrente (602-609)                    |                  | 929,349          |
| 3   | Pagesa për principalin dhe interesin (166+651)  |                  | 54,300           |
| 4   | Investime (230 +231)                            |                  | 389,592          |
|     | <b>Totali i buxhetit</b>                        | <b>2,027,783</b> | <b>2,027,783</b> |

*Burimi i të dhënave – Bashkia Korçë.*

**Raportet e monitorimit 2020**

Për periudhën janar-qershor 2020 Bashkia Korçë ka përgatitur në zbatim të udhëzimit nr. 22 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisve të Vetëqeverisjes vendore”, raportet e monitorimit të cilat janë paraqitur në Këshillin Bashkiak dhe janë depozituar pranë MFE si më poshtë:

-Raporti i monitorimit janar-dhjetor 2019 i paraqitur në KB më datë 27.2.2020 dhe është dërguar në MFE me shkresën me nr. 1707 prot., datë 25.2.2020.

-Raporti i monitorimit janar-prill 2020 2019 i paraqitur në KB më datë 28.5.2020 dhe është dërguar në MFE me shkresën me nr. 3523 prot., datë 27.5.2020.

Gjithashtu me VKB nr. 70 datë 26.6.2020 është miratuar Raporti i konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë Korçë për vitin 2019 si dhe është dërguar në MFE me shkresën nr. 4717, datë 2.7.2020, në zbatim të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 51.

**2.2. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.**

Detajimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën janar-qershor 2020 sipas llogarive ekonomike jepet si më poshtë:

000/lekë

| Llogaria ekonomike                          | Buxheti Vjetor           |                       | Fakti janar-qershor 2020 | % e realizimit |
|---|--------------------------|-----------------------|--------------------------|----------------|
|   | plan Fillestar viti 2020 | i ndryshuar viti 2020 |                          |                |
| (600+601) Shpenzime per paga dhe sigurime   | 654,207                  | 654,542               | 299,869                  | 46             |
| (602-609) Shpenzime korrente                | 810,956                  | 929,349               | 246,953                  | 26             |
| (230+231) Shpenzime kapitale                | 210,472                  | 389,592               | 39,703                   | 11             |
| (166+651) Shpenzime principali dhe interesi | 54,300                   | 54,300                | 20,791                   | 38             |
| <b>Total</b>                                | <b>1,729,935</b>         | <b>2,027,783</b>      | <b>607,316</b>           | <b>30</b>      |

*Burimi i të dhënave – Bashkia Korçë.*

## Detajimi i buxhetit sipas programeve dhe realizimi 6- mujor.

Buxheti i Bashkisë Korçë, për vitin 2020 është miratuar me VKB nr. 173, datë 26.12.2019 dhe është konfirmuar nga institucioni i Prefektit me shkresën nr. Prot., 1652/1, datë 08.01.2020. Buxheti është depozituar në MFE me shkresën nr. 287 prot., datë 14.01.2020. Ky buxhet ka 27 programe buxhetore.

Detajimi i buxhetit sipas programeve dhe realizimi 6- mujor është sa vij:

|                      |   | Buxheti Vjetor   |                  | Fakti          | % e        |
|----------------------|---|------------------|------------------|----------------|------------|
| Programet/ viti 2020 |   | Plan fillestar   | I ndryshuar      | janar-qershor  | realizimit |
| 01110                | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                               | 150,431          | 156,822          | 45,503         | 29         |
| 01120                | Çështje financiare dhe fiskale  | 53,956           | 54,460           | 22,002         | 40         |
| 01170                | Gjendja civile  |                  | 162              | 17             | 10         |
| 01710                | Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm                           | 54,300           | 54,300           | 20,791         | 38         |
| 03140                | Shërbimet e Policisë Vendore  | 11,805           | 11,864           | 3,817          | 32         |
| 03280                | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile                               | 58,142           | 66,572           | 14,260         | 21         |
| 04130                | Mbështetje për zhvillimin ekonomik                                    | 22,992           | 24,493           | 573            | 2          |
| 04220                | Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve | 4,241            | 4,241            | 1,217          | 29         |
| 04240                | Menaxhimi i infrastrukturës i ujitjes dhe kullimit                    | 43,178           | 55,812           | 24,570         | 44         |
| 04260                | Administrimi i pyjeve dhe kullotave                                   | 26,457           | 86,894           | 6,973          | 8          |
| 04520                | Rrjeti rrugor rural   | 88,121           | 109,201          | 23,435         | 21         |
| 04570                | Transporti publik   | 13,255           | 13,256           | 3,099          | 23         |
| 04760                | Zhvillimi i turizmit  | 32,969           | 35,528           | 1,309          | 4          |
| 04910                | Fondi rezerve   | 2,000            | 2,000            |                | 0          |
| 04940                | Fondi i kontigjences  | 1,000            | 1,000            |                | 0          |
| 05100                | Menaxhimi i mbetjeve  | 124,807          | 135,720          | 46,632         | 34         |
| 05630                | Ndërgjegjësimi mjedisor   | 2,621            | 2,621            | 1,154          | 44         |
| 06140                | Planifikimi Urban Vendor  | 33,091           | 47,204           | 5,196          | 11         |
| 06260                | Shërbime publike vendore  | 289,261          | 335,054          | 122,444        | 37         |
| 06440                | Ndriçim rrugësh   | 66,510           | 61,110           | 25,989         | 43         |
| 08130                | Sport dhe argëtim   | 100,142          | 112,936          | 26,576         | 24         |
| 08220                | Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore                | 89,205           | 152,336          | 35,367         | 23         |
| 09120                | Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor                            | 331,137          | 360,922          | 125,318        | 35         |
| 09230                | Arsimi i mesëm i përgjithshëm   | 46,463           | 51,194           | 20,940         | 41         |
| 09230                | Arsimi profesional  | 22,272           | 23,939           | 9,884          | 41         |
| 10140                | Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara       | 16,434           | 16,484           | 5,585          | 34         |
| 10220                | Sigurimi shoqëror   | 4,600            | 7,690            | 1,404          | 18         |
| 10430                | Kujdesi social për familjet dhe fëmijët                               | 34,061           | 36,755           | 11,304         | 31         |
| 10661                | Strehimi social   | 6,484            | 7,213            | 1,957          | 27         |
| <b>Total</b>         |   | <b>1,729,935</b> | <b>2,027,783</b> | <b>607,316</b> | <b>30</b>  |

*Burimi i të dhënave – Bashkia Korçë.*

Buxheti fillestar ka qenë në vlerën 1,729,935 mijë lekë dhe pas ndryshimeve të bëra sipas VKB<sup>ve</sup> të sipërpërmendura është në shumën 2,027,783 mijë lekë. Realizimi për periudhën janar-qershor 2020 është 607,316 mijë lekë ose realizuar në masën 30%.

Likuidimi i shpenzimeve në këtë periudhë është kryer në zbatim të UMFE nr. 14, datë 24.3.2020 "Për procedurat e menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore" si dhe shkresës së MFE nr. 6466 prot. datë 09.04.2020, sipas listës së prioriteteve të shpenzimeve.

Buxhetet për vitin 2020, janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Institucionet e Varësisë si dhe nga Drejtoritë në Bashki, (7 institucione varësie).



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

Detajimi i buxhetit dhe realizimi 6-mujor 2020 sipas Institucioneve është sa më poshtë vijon:

| Institucioni – viti 2020                                  | Buxheti Vjetor   |                  | Fakti janar-qershor 2020 | % e realizimit |
|---|------------------|------------------|--------------------------|----------------|
|   | Plan Fillestar   | I ndryshuar      |                          |                |
| Bashkia   | 807,779          | 1,026,751        | 232,917                  | 23             |
| Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (NSHP)                    | 400,440          | 447,354          | 168,678                  | 38             |
| Ndërmarrja Mbështetëse e Arsimit dhe Çerdhes (NSHMAC)     | 385,834          | 408,684          | 164,367                  | 40             |
| Qendra e Artit dhe Kulturës (QAK)                         | 89,205           | 97,848           | 27,251                   | 28             |
| Klubi Shumë sportësh (KLSH)                               | 34,673           | 34,673           | 11,825                   | 34             |
| Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social (NJMBQS) | 2,644            | 2,735            | 1,305                    | 48             |
| Shtëpia e Foshnjës  | 5,245            | 5,572            | 973                      | 17             |
| Qendra Rezidenciale e Zhvillimit (QRZH)                   | 3,565            | 3,589            |                          | 0              |
| Qendra Ditore (QD)  | 550              | 577              |                          | 0              |
| <b>Total</b>  | <b>1,729,935</b> | <b>2,027,783</b> | <b>607,316</b>           | <b>30</b>      |

*Burimi i të dhënave – Bashkia Korçë.*

Për periudhën janar-qershor 2020 Bashkia ka realizuar 23% të shpenzimeve kundrejt planit vjetor të ndryshuar, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike 38%, Ndërmarrja Mbështetëse e Arsimit dhe Çerdhes 40%, Qendra e Artit dhe Kulturës 28%, Klubi Shumë sportësh 34%, Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social 48% dhe Shtëpia e Foshnjës 17%.

**Analizë për investimet. Analiza e detajuar e investimeve të planifikuara në vitin 2020 dhe realizimi i tyre për periudhën janar-qershor 2020 paraqitet si më poshtë:**

| Nr | Përshkrimi i investimit / viti 2020            | Plan                  | Fakt janar-qershor   | Dif Plan-Fakt         | % e realizimit |
|----|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|----------------|
| 1  | QAK  | 1,644,000.00          | 144,000.00           | 1,500,000.00          | 9              |
| 2  | NSHMAC   | 17,430,120.00         | 2,957,880.00         | 14,472,240.00         | 17             |
| 3  | NSHP   | 14,766,492.00         | 382,477.00           | 14,384,015.00         | 3              |
| 4  | NJMBQS   | 60,000.00             | 0.00                 | 60,000.00             | 0              |
| 5  | Shtëpia e Foshnjës                             | 511,200.00            | 0.00                 | 511,200.00            | 0              |
| 6  | QRZH   | 1,700,000.00          | 0.00                 | 1,700,000.00          | 0              |
| 7  | Bashkia  | 314,179,877.22        | 36,218,579.95        | 277,840,800.47        | 12             |
|    | <b>Shuma 231</b>                               | <b>350,291,689.22</b> | <b>39,702,936.95</b> | <b>310,468,255.47</b> | <b>11</b>      |
| 8  | Oponencat teknike + plane të detajuara vendore |                       |                      |                       |                |
|    | <b>Shuma 230</b>                               | <b>39,300,000.00</b>  | <b>0.00</b>          | <b>39,300,000.00</b>  | <b>0</b>       |
|    | <b>Shuma 230+231</b>                           | <b>389,591,689.22</b> | <b>39,702,936.95</b> | <b>349,768,255.47</b> | <b>11</b>      |

*Burimi i të dhënave – Bashkia Korçë.*

Në mënyrë analitike investimet paraqiten në aneksin 2/1 bashkëlidhur projekt raportit.

**Detyrimet e prapambetura ,janar-qershor 2020.**

Sipas raportimit të bërë në MFE me shkresën nr.4856 prot., datë 07.07.2020 për periudhën janar-qershor 2020 janë në vlerën 87,750,562 lekë të detajuara si më poshtë:

Pasqyra e detyrimeve të pa likujduara sipas financimit buxhetor gjëndje 30.06.2020.

| Pjesa që i përket Grandit Qeveritar | Investime të ardhurave | Detyrimi total për investimet | Kategoritë          |                           | Vendime gjyqësore Detyrimi total | Investi me nga FZHR | Totali I detyrimeve më 30.06.2020 |
|-------------------------------------|------------------------|-------------------------------|---------------------|---------------------------|----------------------------------|---------------------|-----------------------------------|
|                                     |                        |                               | Mallra dhe shërbime | Detyrimi total për mallra |                                  |                     |                                   |
|                                     |                        | 50,031,965                    |                     | 29,596,054                | 8,122,543                        |                     | <b>87,750,562</b>                 |

*Burimi i të dhënave – Bashkia Korçë.*

**Në mënyrë analitike** Detajimi i fondit 50,031,965 lekë jepet **në Aneks 2/2** bashkëlidhur projekt raportit.

**Mbi vendimet gjyqësore.** Detyrimet qe rrjedhin nga vendimet gjyqësore për vitin 2020, paraqiten sipas tabelës sa më poshtë vijon:

*Në lekë*

| Nr | Kreditore                           | Gjendja ne<br>31.12.2019 | Shtesa gjatë<br>vitit | Vlera e<br>vendimit | Shpenzime<br>gjyqësore | Tarifa<br>përmbartimore | Shuma e<br>paguar gjatë<br>6 mujorit | Gjendja<br>6m I 2020 |
|----|-------------------------------------|--------------------------|-----------------------|---------------------|------------------------|-------------------------|--------------------------------------|----------------------|
| 1  | Refat Tuke<br>(P.O.Sh Pf.)          |                          | 2,361,871             | 2,315,560           |                        | 46,311                  | 500,000                              | 1,861,871            |
| 2  | Ll.Q (P. O.Sh Pf.)                  | 309,174                  | 0                     |                     |                        |                         | 0                                    | 309,174              |
| 3  | S.Xh                                | 134,924                  | 0                     |                     |                        |                         | 0                                    | 134,924              |
| 4  | Shoqëria "AV"<br>shpk               |                          | 1,502,723             | 1,168,132           | 169,121                | 165,470                 | 0                                    | 1,502,723            |
| 5  | S.Q dhe<br>Bashkërronarët<br>Komuna | 4,066,591                | 0                     |                     |                        |                         | 0                                    | 4,066,591            |
| 6  | Voskopoje                           |                          | 244,500               | 220,000             | 24,500                 |                         | 244,500                              | 0                    |
| 7  | K.B                                 |                          | 51,000                |                     | 33,000                 | 18,000                  | 51,000                               | 0                    |
| 8  | R.Sh                                |                          | 256,181               | 195,360             | 25,500                 | 26,400                  | 0                                    | 256,181              |
|    | <b>Shuma</b>                        | <b>4,510,689</b>         | <b>4,407,354</b>      | <b>3,899,052</b>    | <b>252,121</b>         | <b>256,181</b>          | <b>795,500</b>                       | <b>8,122,543</b>     |

|                        |  |
|------------------------|--|
| <b>Titulli gjetjes</b> | Mbi pagesat e shpenzimeve përmbartimore.   |
| <b>Situata</b>         | Në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, gjatë periudhës objekt auditimi, u konstatua se edhe pse këto vendime gjyqësore kanë qenë të formës së prerë, të gjitha pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga Bashkia Korçë, por janë kryer nga përmbartuesit privat duke rënduar buxhetin e shtetit për tarifat përmbartimore me kosto shtesë në shumën prej <b>256,181 lekë</b> .  |
| <b>Kriteri</b>         | Vendimet e gjykatës administrative të apelit   |
| <b>Ndikimi/efekti</b>  | Pagesë e shpenzimeve përmbartimore.  |
| <b>Shkaku</b>          | Moszbatimi i vendimeve të formës së prerë  |
| <b>Rendesia</b>        | E lartë  |
| <b>Rekomandimi</b>     | - Drejtoria Juridike, për të eliminuar shpenzimet përmbartimore në dëm të buxhetit, per cdo vendim të formes se prere i cili është kthyer ne titull ekzekutiv dhe është leshuar urdher ekzekutimi nga gjykata të informoje Sektorin e Financës, për të planifikuar buxhetin që në fazat e PBA-së, me qëllim që ekzekutimi i tyre të bëhet vullnetarisht.<br>- Nga institucioni duhet të krijohen provizionet për detyrimet e shpenzime gjyqësore. Këto provizione duhet të njihen në kontabilitet dhe të pasqyrohen në pasqyrat financiare vjetore të njësisë. |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

**1.4 -1.5 Burimi krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.**

| Titulli i gjetjes | Gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa në datë 30.06.2020   |
|-------------------|--|
| Situata           | <p>Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 30.06.2020, vlera e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore për subjektet e biznesit dhe familjarët në shkallë bashkie, për Bashkinë Korçë janë në vlerën 294,161,594 lekë analizuar si më poshtë;</p> <p>-Biznesi i madh dhe i vogël janë në vlerën 183,615,110 lekë ose përbëjnë 62% të vlerës totale të borxhit</p> <p>- Taksat dhe tarifave e familjes janë në vlerën 110,546,484 lekë ose përbëjnë 38% të vlerës totale të borxhit. Sektori i Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Korçë, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, ka zbatuar vetëm procedurën e bllokimit të llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe nuk ka vazhduar me procedurat e tjera.</p>   |
| Kriteri           | Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara”, të neneve 89 dhe neni 93 .   |
| Ndikimi/efekti    | Veprime që çojnë në mungesë të ardhurash në Buxhetin e Bashkisë Korçë  |
| Shkaku            | Mos zbatimi i kuadrin ligjor në arkëtimin e detyrimeve nga debitorët   |
| Rendesia          | <b>I lartë</b>   |
| Rekomandimi       | <p>Nga Drejtoria e Taksave të Bashkisë Korçë, të merren masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/ juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për <b>3962</b> subjekte biznesi i madh dhe i vogël për vlerën <b>183,615,110 lekë</b> dhe <b>31,677</b> familje për vlerën gjithsej <b>110,546,484 lekë</b>, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:</p> <p>a. T`u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime ne llogarit bankare,.</p> <p>b. T`i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit kërkesa për vendosje barrë siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);</p> <p>c. Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave e Tarifa, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</p> <p>d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite Sektori Taksa e Tarifa dhe Sektori Juridik të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</p> |

**3. Punonjësit e Drejtorisë së Taksave dhe njësisive administrative si që kanë detyrë funksionale kontrollin dhe mbledhjes e të ardhurave**

|                   |  |
|-------------------|--|
| Titulli i gjetjes | Mos aplikimi i saktë i tarifave vendore mbi subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në prokurimet e fondeve |
|-------------------|--|

**publike**

**Situata**

Nga ana e Bashkisë Korçë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, VKB nr. 124, datë 30.11.2017, (Paketa Fiskale 2018), VKB nr. 133 datë 14.11.2018, (Paketa Fiskale 2019). Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.160 datë 25.11.2019, (Paketa Fiskale 2020) të Bashkisë Korçë, përsa i përket realizimit të të ardhurave nga arkëtimi i tarifave vendore të subjekteve të ndërtimit që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në prokurimet e fondeve publike nga Bashkia Korçë. Referuar zbatim të nenit 43, pika 1/1 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kontraktori përpara fillimit të punimeve duhet të aplikojë në QKB për hapjen e vendit të ushtrimit të veprimtarisë të ndryshëm nga selia (sipas vendndodhjes të objektit të kontratës). Një kopje të aplikimit duhet të dorëzojë në Drejtorinë e Menaxhimit të Kontratave përpara fillimit të punimeve.

Por nga auditimi i dokumentacionit ku u kryqëzuan të dhënat e marra nga Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave në lidhje me subjektet që kishin lidhur kontratë për punë publike me Bashkinë, dhe të dhënave të marra nga Drejtoria e Taksave për pagimin e tarifave në lidhje me pagesën e tarifave përkatëse të këtyre subjekteve, u konstatuan dy fenomene;

1- Operatorë ekonomikë të cilët e kishin mbyllur NIPTI<sup>n</sup> sekondar përpara mbarimit të kontratës duke mos ju llogaritur në këtë mënyrë edhe tarifa e pastrim, gjelbërim dhe ndriçimit për kantierin e ndërtimit. Pasi u llogarit pjesa e kontratës e cila vazhdonte edhe pas mbylljes së NIPTI<sup>t</sup> sekondar, rezultoi vlera e papaguar si më poshtë;

*Per tu llogaritur Tarifa e pastrim Gjelberim Ndricimit, per pjesen e kontrates qe tejkalon daten e mbylljes se NIPT-it te operatorit ekonomik* Llogaritja e Tarifave

| nr             | Emertimi i objektit  | Data e kontrates sipas Andreas | Afati i Kontrates | Vlera e kontrates me TVSH | Data e amendamenti | Afati   | Data e amendamenti te dyte | Afati   | Data e perfundimit te kontrates dhe amendamentit | Sipermarësi | Vlera e kontrates | NUIS       | Data/hapje adrese dytesore | Data/mbyllje adrese dytesore | Tarif Pastrimi | Tarif Ndricimi | Tarif Gjelberimi |
|----------------|--|--------------------------------|-------------------|---------------------------|--------------------|---------|----------------------------|---------|--|-------------|-------------------|------------|----------------------------|------------------------------|----------------|----------------|------------------|
| 1              | Rikonstrukcion i shkolles 9-vjecare "Nuçi Naçi" 3 kate shites per palester | 29.07.2019                     | 6 maj             | 30.125.449                | kontrate d         | 73 dite | kontrate d                 | 15 dite | 5/6/2020   | NIKA        | 25.104.541        | J76705047U | 28.08.2019                 | 03.02.2020                   | 27,500         | 1,500          | 2,500            |
| 17             | Rehabilitim urban i rrugeve ne lagjet e qyteit                             | 12.06.2019                     | 3 maj             | 21.872.503                | kontrate d         | 45 dite | -                          | -       | 12/9/2019  | A.L.ASFA    | 21.872.503        | K81511508A | 04.09.2019                 | 08.11.2019                   | 18,333         | 1,000          | 1,667            |
| <b>Total 1</b> |  |                                |                   |                           |                    |         |                            |         |  |             |                   |            |                            |                              | <b>45,833</b>  | <b>2,500</b>   | <b>4,167</b>     |

2- Operatorë ekonomikë të cilët kanë lidhur kontrata gjatë vitit 2020 dhe nuk kanë hapur NIPTI sekondar, duke mos ju llogaritur në këtë mënyrë edhe tarifa e pastrim, gjelbërim dhe ndriçimit për kantierin e ndërtimit. Pasi u llogarit pjesa e kontratës e cila është ekzekutuar pa NIPTI sekondar, rezultoi vlera e papaguar si më poshtë

*Operatorët ekonomike qe nuk kane paguar tarifat sepse nuk kane hapur NIPTI sekondar* Llogaritja e Tarifave

| nr             | Emertimi i objektit  | Data e kontrates sipas Andreas | Afati i Kontrates | Vlera e kontrates me TVSH | Data e amendamenti                | Afati   | Data e amendamenti te dyte        | Afati   | Data e perfundimit te kontrates dhe amendamentit | Sipermarësi | Vlera e kontrates | NUIS       | Data/hapje adrese dytesore | Data/mbyllje adrese dytesore | Tarif Pastrimi 2020 | Tarif Ndricimi 2020 | Tarif Gjelberimi 2020 |
|----------------|--|--------------------------------|-------------------|---------------------------|-----------------------------------|---------|-----------------------------------|---------|--|-------------|-------------------|------------|----------------------------|------------------------------|---------------------|---------------------|-----------------------|
| 4              | Investime ne infrastrukturen e ujitjes dhe kullimit" Loti I- Rikonstrukcion I veprave ujitese ( Ura Polene ) | 23.01.2020                     | 30 dite           | 859.559                   | Amendament kontrate dt.30.04.2020 | 99 dite | Amendament kontrate dt.15.06.2020 | 45 dite | -  | NIKA        | 859.559           | J76705047U | -                          | -                            | 25,000.00           | 2,500.00            | 2,500.00              |
| 5              | Riorganizim I sheshit te hyrjes se Qendres Multifunksionale Kulturme dhe Sportive ( Muzeu I Fenijeve)        | 05.03.2020                     | 14 dite           | 879,600                   | -                                 | -       | -                                 | -       | -  | ASH-2A CO   | 879,600           | K5302402C  | -                          | -                            | 4,166.67            | 416.67              | 416.67                |
| 19             | Rikonstrukcion rrugeshe ne njesite administrative (Faza I) Bashkia Korçë                                     | 31.05.2019                     | 3 maj             | 30,560,315                | -                                 | -       | -                                 | -       | -  | Gllavenica  | 30,560,315        | K17710805A | -                          | -                            | 12,500.00           | 1,250.00            | 1,250.00              |
| <b>Total 2</b> |  |                                |                   |                           |                                   |         |                                   |         |  |             |                   |            |                            |                              | <b>41,666.67</b>    | <b>4,166.67</b>     | <b>4,166.67</b>       |

**Kriteri**

- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35 ku citohet “1. Çdo pagesë tjetër në buxhetin e





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                       |  |
|-----------------------|--|
|                       | <p><i>bashkisë, të komunës ose të qarkut klasifikohet si tarifë kur: a) përkon me përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; b) nuk është taksë bashkiake ose komunale, si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligji. 2. Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, përcaktojnë nëse tarifat do të mbledhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent”, ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1 “Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia” si dhe vendimet e këshillit bashkiak për vitet 2018, 2019 dhe 2020 pikat 1, 6 dhe 9 ku përcaktohen tarifat e pastrim gjelbërim dhe ndriçimit për bizneset e mëdha dhe të vogla.</i></p> |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Veprime që çojnë në mungesë të ardhurash në Buxhetin e Bashkisë Korçë  |
| <b>Shkaku</b>         | Mos zbatimi i kuadrit ligjor në arkëtimin e tarifave vendore nga subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në prokurimet e fondeve publike  |
| <b>Rendesia</b>       | <b>I lartë</b>   |
| <b>Rekomandimi</b>    | Bashkia Korçë të marrë masa për arkëtimin e shumës prej <b>102,500 lekë</b> si rezultat i mos aplikimit të tarifave vendore për pastrim, gjelbërim dhe ndriçim për 4 subjektet që kanë kryer investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Korçë.  |

***Për veprimet dhe mosveprimet në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore ngarkohen me përgjegjësi:***

***1.Z. L.GJ, Drejtori i Menaxhimit të Kontratave***

|                          |   |
|--------------------------|---|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mos realizimi i të ardhurave mbledhja e taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.</b>  |
| <b>Situata</b>           | Nga auditimi në Bashkinë Korçë për vitet 2018, 2019 dhe 6 muhori i parë i 2020, për vjeljen dhe grumbullimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë bazuar në ligjin Nr.9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 23 dhe sipas pikës 2 të nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar dhe VKM nr.860 datë 10.12.2014, janë pajisur me leje legalizimi nga zyra e ALUIZN-it dhe janë debitorë të mbetur familjarë dhe subjekte në vlerën <b>21,717,084</b> lekë. Nga ana e këtij institucioni nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZN-it |

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | (ASHK)  |
| <b>Kriteri</b>        | - Ligji nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014, neni 23, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim”   |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Veprime që çojnë në mungesë të ardhurash në Buxhetin e Bashkisë Korçë   |
| <b>Shkaku</b>         | Mos zbatimi i kuadrit ligjor në arkëtimin e detyrimeve nga subjektet e pajisur me leje legalizimi   |
| <b>Rendesia</b>       | <b>I lartë</b>  |
| <b>Rekomandimi</b>    | Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Korçë, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar të marrë masat për arkëtimin e tarifës për TNI nga subjektet në proces legalizimi duke bërë njoftim vlerësimet tatimore për subjektet sipas aneksit nr.1/1, bashkëlidhur projekt raportit në vlerën totale të pa arkëtuar prej <b>21,717,084</b> lekë, e ardhur e munguar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore të legalizuara. |

*Për veprimet dhe mosveprimet në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore ngarkohen me përgjegjësi:*

*1.Z.S.F, Kryetar i Bashkisë Korçë.*

*2.Z. S.P, Drejtori i Drejtorisë së Taksave.*

*3. Punonjësit e Drejtorisë së Taksave dhe njësive administrative si që kanë detyrë funksionale kontrollin dhe mbledhjen e të ardhurave*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

**2.2 Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2018-2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë,** bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i shfuqizuar (për pasqyrat financiare të vitit 2018), ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (për pasqyrat financiare të vitit 2019), si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”.

- Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.
- Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nënjësisë.
- Opinioni mbi pasqyrat financiare.

#### **A. Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2019 u konstatua se:**

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara për vitin 2019 janë hartuar dhe depozituar me shkresën nr. 344, datë 05.05.2020 kur duhej të depozitoheshin brenda muajit prill 2020 si afat ligjor.

- Nga Sektori i Financës, Bashkia Korçë, janë hartuar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara për vitin ushtrimor 2019, ku përveç pasqyrave financiare të njësisë Bashkia Korçë përfshiheshin edhe pasqyrat financiare të 8 (tetë) njësitë vartëse e përkatësisht, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes, Qendra e Artit dhe Kulturës, Klubi Shumësportësh Skënderbeu, Njësia e Menaxhimit të Banesave me Kosto të Ulët, Qendra Ditore e Zhvillimit, Qendra Rezidenciale e Zhvillimit, Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla”.

Hartimi i informacionit kontabël të konsoliduar në njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështetet në parimet dhe rregullat e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit dhe të përgatitjes e paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore individuale të njësisve, për nivelet përkatëse të qeverisjes në të cilat bëhet konsolidimi i informacionit.

Ky konsolidim është shumë i rëndësishëm në mënyrë që të prodhohet një informacion i dobishëm, i kuptueshëm dhe i besueshëm, në shërbim të vendimmarrjeve të qeverisjes së përgjithshme, në nivele qendrore dhe lokale.

Hartimi i Pasqyrave financiare përmbledhëse të konsoliduara ka si qëllim të përgjithshëm dhënien e informacionit të besueshëm tek organet përkatëse vendimmarrëse, nëpërmjet: **Sigurimit të informacionit rreth burimeve financiare dhe alokimin e tyre; Sigurimit të informacionit për mënyrën e financimit të aktiviteteve të njësisve dhe realizimin e kërkesave mbi mjetet monetare; Sigurimit të informacionit që lidhet me aftësinë e njësisë për të financuar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet; si dhe Sigurimit të informacionit për vlerësimin e performancës së njësisve raportuese.**

- Hartimi i pasqyrave financiare përmbledhëse të konsoliduara brenda muajit prill të vitit 2020 mundëson grupimin e informacioni, duke bërë eliminimet dhe duke mënjanuar dublimet, për njësitë e organeve të vetëqeverisjes vendore, me të gjitha njësitë e varësisë dhe është në përputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes,

paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli IV “Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara” pika 98, 99,100,101 germa “b” .

**Pasqyrat financiare të konsoliduara kanë të plotësuar;** Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar (bilanci); Pasqyra e konsoliduar e performancës financiare; Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në aktivet/fondet neto; Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve të flukseve monetare; Pasqyra e konsoliduar për pasqyrat statistikore, që shoqërojnë pasqyrat financiare; si dhe Dhënia e shënimeve shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të konsoliduara.

**Auditimi i aktiveve afatgjata:**

**a. Objektivat e auditimit** të aktiveve afatgjata, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve afatgjata; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.

Nëse aktivet afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike (vlerën fillestare), duke evidentuar veçmas amortizimin e tyre. Lidhur me këto aktive, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nëse kanë analizuar e rakorduar investimet e tyre eventuale që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e ndërmarrjeve të tjera (publike ose jopublike). Për këtë qëllim, nga njësia a janë saktësuar regjistrimet kontabël në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar.

**b. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:**

Për auditimin e aktiveve afatgjata, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve afatgjata në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet afatgjata;

U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.

**c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata:**

1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostonë së tyre të prodhimit.

- Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

(UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;

- Përdor referencat ose tekNt më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

- *Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.*  
Nga verifikimi i pasqyrave financiare (*bilancit*) të vitit 2019 rezultoi:

**Në analizë aktivet:**

**a.** Në formatin nr. 1 “*Pasqyra e pozicionit financiar*”, “*Aktivet afatgjata jo materiale*” paraqitet në vlerën 58,334,242 lekë (*me kosto historike*). Kjo vlerë është në ulje krahasuar me 31.12.2018, që do të thotë se për vitin 2019 ka pakësim të aktiveve në një vlerë prej 18,424,736 lekë.

Vlera prej 58,334,242 lekë i përket llogarisë 202 “*Studime, projektme*” për të cilën nuk është llogaritur amortizimi..

**b.** Në formatin nr. 1 “*Pasqyra e pozicionit financiar*”, “*Aktivet afatgjata materiale*” në vlerën 8,099,624,788 lekë janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë:

*lekë*

| Nr.       | Nr. llog.          | EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT       | Ushtrimi i Mbyllur   | Ushtrimi i Paraardhës |
|-----------|--------------------|---------------------------------------|----------------------|-----------------------|
| <b>47</b> | <b>21,23,24,28</b> | <b>2. Aktivet afatgjata materiale</b> | <b>8,099,624,788</b> | <b>7,581,629,647</b>  |
| 48        | 210                | Toka,troje,terrene                    | 342,774,958          | 342,148,638           |
| 49        | 211                | Pyje, plantacione                     | 81,985,919           | 72,835,500            |
| 50        | 212                | Ndërtesa e konstruksione              | 2,965,359,684        | 2,950,025,205         |
| 51        | 213                | Rrugë,rrjete,vepra ujore              | 4,398,665,861        | 3,880,201,385         |
| 52        | 214                | Instalime teknike, makineri e pajisje | 123,817,404          | 114,194,900           |
| 53        | 215                | Mjete transporti                      | 48,473,289           | 53,807,682            |
| 54        | 216                | Rezerva shtetërore                    |                      |                       |
| 55        | 217                | Kafshë pune e prodhimi                |                      |                       |
| 56        | 218                | Inventar ekonomik                     | 138,547,673          | 168,416,336           |
| 57        | 24                 | Aktive afatgjatat ë dëmtuara          |                      |                       |
| 58        | 28                 | Caktime të aktiveve afatgjata         |                      |                       |
| <b>59</b> | <b>25-26</b>       | <b>3. Aktive afatgjata financiare</b> |                      |                       |
| 60        | 25                 | Huadhënie e nën huadhënie             |                      |                       |
| 61        | 26                 | Pjesëmarrje në kapitalin e vet        |                      |                       |

Zëri “*Toka, troje, terrene*” (llog. 210) për vlerën 342,775 mijë lekë në mënyrë analitike sipas pasqyrave financiare individuale. Krahasuar me vitin 2018 nuk ka lëvizje në vlerë.

Zëri “*Pyje, Plantacione*” (llog. 211) për vlerën 81,986 mijë lekë në mënyrë analitike sipas pasqyrave financiare individuale. Krahasuar me vitin 2018 ka lëvizje në vlerë.

Zëri “*Ndërtime e konstruksione*” (llog. 212) për vlerën 2,965,359 mijë lekë në mënyrë analitike sipas pasqyrave financiare individuale. Krahasuar me vitin 2018 ka lëvizje në vlerë.

Zëri “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” (llog. 213) për vlerën 4,398,665,861 mijë lekë në mënyrë analitike sipas pasqyrave financiare individuale. Krahasuar me vitin 2018 ka lëvizje në vlerë.

Zëri “*instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune*” (llog. 214) për vlerën 123,817 mijë lekë (*me kosto historike*) në mënyrë analitike sipas pasqyrave financiare individuale. Krahasuar me vitin 2018 ka lëvizje në vlerë.

Zëri “*Mjete transporti*” (llog. 215) për vlerën 48,473 mijë lekë (*me kosto historike*) në mënyrë analitike sipas pasqyrave financiare individuale. Krahasuar me vitin 2018 ka lëvizje në vlerë.

Zëri “*Inventar ekonomik*” (llog. 218) për vlerën 138,547 mijë lekë në mënyrë analitike sipas pasqyrave financiare individuale. Krahasuar me vitin 2018 ka lëvizje në vlerë.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 20) në formatin nr. 7/a “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike*” kolona 11 “*Gjendja në mbyllje të*

ushtrimit” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), kolona 8 “Kosto historike” 58,334,242 lekë. Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28) në formatin nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike” kolona 11 “Gjendja në mbyllje të ushtrimit” është në vlerën 9,448,732,403 lekë kurse vlera e pasqyruara në formatin nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kolona 8 “Kosto historike” është 9,448,066,403 lekë (Me një diferencë prej 666,000 lekë). Ky ndryshim vjen nga zëri Mjete transporti 164,138,726 – 163,472,726 = 666,000 lekë.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 20) në formatin nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” kolona 10 “Teprica neto” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 1, “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Ushtrimi i mbyllur” llogaria 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 58,334,242 lekë.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28) në formatin nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” kolona 10 “Teprica neto” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 1, “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Ushtrimi i mbyllur” llogaria 21 “Aktive afatgjata materiale”, 8,099,624,788 lekë.

Pasqyra krahasuese e pozicionit financiar me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata:

Në lekë

| Llog. | Emërtimi                                    | Ushtrimi paraardhës  | Ushtrimi mbyllur     | Formati 7/b, (Gjendja dhe ndryshimet) | Diferenca (4-5) |
|-------|---|----------------------|----------------------|---------------------------------------|-----------------|
| 1     | 2   | 3                    | 4                    | 5                                     | 6               |
| 201   | Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave | 0                    | 0                    | 0                                     |                 |
| 202   | Studime dhe kërkime                         | 76,756,976           | 58,334,242           | 58,334,242                            |                 |
| 203   | Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme  |                      |                      |                                       |                 |
| 210   | Toka, Troje, Terrene                        | 342,148,638          | 342,774,958          | 342,774,958                           |                 |
| 211   | Pyje, Plantacione                           | 72,835,500           | 81,985,919           | 81,985,919                            |                 |
| 212   | Ndërtesa e Konstruksione                    | 2,950,025,205        | 2,965,359,684        | 2,965,359,684                         |                 |
| 213   | Rrugë, rrjete, vepra ujore                  | 3,880,201,385        | 4,398,665,861        | 4,398,665,861                         |                 |
| 214   | Instalime teknike, makineri e pajisje       | 114,194,900          | 123,817,404          | 123,817,403                           | + 1             |
| 215   | Mjete Transporti                            | 53,807,682           | 48,473,289           | 48,473,289                            |                 |
| 216   | Rezerva Shtetërore                          |                      |                      |                                       |                 |
| 217   | Kafshë pune e prodhimi                      |                      |                      |                                       |                 |
| 218   | Inventar ekonomik                           | 168,416,336          | 138,547,673          | 138,547,675                           | -2              |
| 24    | Aktive afatgjata të dëmtuara                |                      |                      |                                       |                 |
| 28    | Caktime të Aktiveve Afatgjata               |                      |                      |                                       |                 |
|       | <b>TOTALI</b>                               | <b>7,658,386,623</b> | <b>8,157,959,030</b> | <b>8,157,959,031</b>                  | <b>-1</b>       |

“Amortizimi i aktiveve afatgjata” sipas pasqyrave financiare formati 7/b në fund të vitit 2019 paraqitet në vlerën 1,348,441,615 leke. Krahasuar me vitin 2018 “Amortizimi i aktiveve afatgjata” paraqitet me shtese prej 338,786,204 lekë, shtesë e cila ka ardhur si rezultat i llogaritjes së amortizimit vjetor për aktivet afatgjata materiale për të gjithë vlerën por nuk është llogaritur amortizimi i aktiveve afatgjata jo materiale studime e kërkime bazuar në UMF nr.8, datë 09.03.2018 si dhe amortizimin e akumuluar.

| Aktivet Afatgjata                      | TOTALI AM.           | Shtesa             | Am.Vjetor | Pakësim           | Gjendja me 31.12.019 |
|--|----------------------|--------------------|-----------|-------------------|----------------------|
|  | Çelja me 1.01.019    | Amortizimi 2019    | 2019      | 2019              |                      |
| <b>Shuma</b>                           | <b>1,009,655,205</b> | <b>394,889,431</b> |           | <b>56,103,227</b> | <b>1,348,441,615</b> |
| Studime e kërkime                      |                      |                    |           |                   |                      |
| Toke troje terrene                     |                      |                    |           |                   |                      |
| Ndërtime e Konstruksione               | 303,478,992          | 154,128,702        |           | 44,084,319        | 413,523,375          |
| Rruge, rrjete, vepra ujore             | 287,197,761          | 198,125,423        |           | 3,773,591         | 481,549,593          |
| Instalteknike, mak, paisje, vegla pune | 170,369,450          | 12,442,403         |           | 3,234,184         | 179,577,669          |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                   |             |            |  |           |             |
|-------------------|-------------|------------|--|-----------|-------------|
| Mjete transporti  | 102,591,501 | 12,540,930 |  | 133,200   | 114,999,437 |
| Inventar ekonomik | 146,017,501 | 17,651,973 |  | 4,877,933 | 158,791,541 |

Në llog. (467) **“Kreditorë të ndryshëm”** me vlerën 214,118,194 lekë në total, vlera e detyrimeve të prapambetura llogaria (486) **“Shpenzime të periudhave të ardhshme”** për vitin 2019 është 191,211,054 lekë.

Pasqyra:

| Nr. | Njësiti e pasqyrave të konsoliduara (llogaria 467)       | Lekë               |
|-----|--|--------------------|
| 1   | Bashkia Korçë  | 146,797,326        |
| 2   | Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes | 17,417,575         |
| 3   | Qendra e Artit dhe Kulturës                              | 8,496,323          |
| 4   | Klubi Shumësportësh Skënderbeu                           | 922,230            |
| 5   | Shtëpia e Foshnjës <b>“Lulet e Vogla”</b> .              | 155,988            |
| 6   | Ndërmarrja e Shërbimeve Publike                          | 40,098,632         |
| 7   | Qendra Rezidenciale e Zhvillimit                         | 49,769             |
| 8   | Qendra Rezidenciale e Zhvillimit                         | 180,351            |
|     | <b>Shuma</b>   | <b>214,118,194</b> |

Vlera e detyrimeve të prapambetura të regjistruara në llogarisë 486 **“Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, është 191,211,054 lekë ku në listat analitike me vlerat e detyrimeve të prapambetura janë edhe vlerat e detyrimeve të cilat janë brenda 30 ditëve të datës së specifikuar për likuidim (Dhjetor 2019). Mbështetur në listat analitike sipas njësive llogaria e konsoliduar 486 **“Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, duhej të ishte në vlerën 136,165,039 lekë.

Pasqyra:

| Nr. | Llogaria 486 e konsoliduar <b>“Shpenzime të periudhave të ardhshme”</b> . | Sipas pasqyrave financiare (lekë) | Fatura    | Në fakt (Lekë)     |
|-----|---|-----------------------------------|-----------|--------------------|
| 1   | Bashkia Korçë   | 124,905,126                       | 21        | 90,999,528         |
| 2   | Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes                  | 17,417,575                        | 18        | 13,255,452         |
| 3   | Qendra e Artit dhe Kulturës   | 8,496,323                         | 15        | 4,940,131          |
| 4   | Njësia e mirëmbajtjes Banesave me Qellim Social                           | 91,232                            | 0         | 0                  |
| 5   | Shtëpia e Foshnjës <b>“Lulet e Vogla”</b> .                               | 202,166                           | 3         | 73,184             |
| 6   | Ndërmarrja e Shërbimeve Publike   | 40,098,632                        | 23        | 26,896,744         |
|     | <b>Shuma</b>  | <b>191,211,054</b>                | <b>80</b> | <b>136,165,039</b> |

Si mbas VKM nr. 50, datë 5.2.2014 **“Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimt”**

7. Për qëllimet e Strategjisë së Parandalimit dhe Shlyerjes së Detyrimeve të Prapambetura (SPSD), detyrimet e prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara nga një ligj/kontratë/marrëveshje /vendim gjykatë i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësiti e qeverisjes qendrore, pushtetit vendor (kontratat e financuara nga qeveria qendrore) dhe fondeve speciale të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Balanca e verifikuar e pashlyer në datën 31 dhjetor 2013 (si dhe e papaguar gjatë muajit janar 2014) do të përdoret për qëllimin e strategjisë. Sipas UMF nr. 8, datë 09.03.2018, pika 42 **“Të gjitha njësiti e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486, **“Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, në varësi të natyrës së tyre:**

Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura të bëhen si më poshtë:

Debitohet llogaria përkatëse 486, “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura”; dhe Kreditohet llogaria përkatëse 467, “Kreditorë të ndryshëm”.

**Në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, D. “Fondi i konsoliduar”** nuk është pasqyruar llog. 12 “Rezultatet e mbartura” në vlerën 164,242,781 lekë po kështu edhe në Formatin 6 “pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit”, nuk është pasqyruar vlera e llog. 12 “Rezultatet e mbartura” në vlerën 164,242,781 lekë dhe vlera e llog. 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” duhej të pasqyrohej për vlerën (- 34,508,474) lekë.

Sipas UMF nr. 8, datë 09.03.2018, pika 43 “Këto njësi, në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësojnë pozicionin e çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe të realizojnë transaksionin e transferimit të tepricës së llogarisë 85, “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12, “Rezultat i mbartur”. Pika 52 “Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, llogaria 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” përfaqëson, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës. Ndërsa, si tepricë debitore, kjo llogari përfaqëson rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese.

**Funksionimi i llogarisë 12, “Rezultati i mbartur”.** Kjo llogari është e përdorshme dhe funksionale sidomos për njësitë e vetëqeverisjes vendore që, në kuadrin e decentralizimit të tyre, trashëgojnë në vitet e mëpasshme grantet buxhetore dhe të ardhurat e papërdorura të vitit ushtrimor. Rezultati i mbartur vjen nga rezultati i viteve respektive dhe mbetet i papërdorur, me të drejtë të paparashkrueshme për ta përdorur në vijim. Ky rezultat duhet të jetë i argumentuar me të ardhurat në likuiditete në llogaritë financiare e të disponibiliteteve, si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuar në periudhat përkatëse ushtrimore.

Në pasqyrën e pozicionit financiar C. “aktivet neto” janë të barabarta me D. “fondin e konsoliduar” në vlerën 8,694,821,818 lekë, e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së aktivitetit 9,705,085,077 mijë lekë dhe B “detyrimet” të pasivit në vlerën 1,010,263,259 mijë lekë.

**Formati 4** “pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto”, totali i fondeve korrespondon me totalin e fondeve në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” në vlerën 8,694,821,819 lekë.

Gjithashtu në Formatin 6 “Investimet dhe burimet e financimit” llogaria 16 “Huamarrje e brendshme” në vlerën 137,695,969 lekë, llogaria 105 “Grante të brendshme kapitale” në vlerën 133,596,147 lekë, llogaria nr. 115, “Fonde të vetat për investime” në vlerën 85,850,250 lekë, llogaria nr. 231 “shpenzime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 190,259,693 lekë, janë të njëjta me vlerën e kësaj llogarie në Formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”

**Llog. 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”** zënë shumën 53,421,313 lekë e cila në pasiv, në analizë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra, llogari të pagueshme, të cilat trashëgohen në vitin 2020 në vlerën 53,525,014 lekë (e cila nuk rakordon në shumën 103,701 lekë) si “Detyrime ndaj personelit” (llog. 421-423) për 38,830,081 lekë, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” (llog. 431) për 1,975,245 lekë, për “Sigurime shoqërore” (llog. 435) në vlerën 11,182,369, “Sigurime shëndetësore” (llog. 436) në vlerën 1,537,319 lekë.

**Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”** është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.

**Në Formatin nr. 2, “pasqyra e performancës financiare”, A “Të ardhurat” janë pasqyruar: “Të ardhurat nga Taksat e tatimet” në vlerën 357,652,046 lekë, “Të ardhurat jo tatimore” në vlerën 251,242,469 lekë, “Grante Korrente” në vlerën 1,312,869,713 lekë;**

*Në lekë*

| Nr.   | Nr.        |  | VITI          | VITI          |
|-------|------------|--|---------------|---------------|
| rresh | Llogarije  | P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE                           | USHTRIMOR     | I MEPARSHEM   |
| a     | b          | c  | 1             | 2             |
| 1     | <b>A</b>   | <b>TE ARDHURAT</b>   | 2,900,987,105 | 2,483,154,631 |
| 2     | <b>70</b>  | <b>I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</b>                    | 357,652,046   | 346,800,453   |
| 3     | <b>700</b> | <b>1.Tatimi mbi te Ardhurat</b>                              | 21,071,430    | 13,055,476    |
| 4     | 7000       | Tatim mbi te ardhurat personale                              | 1,014,705     | 550,396       |
| 5     | 7001       | Tatim mbi Fitimin  | 15,515,582    | 7,864,515     |
| 6     | 7002       | Tatim mbi Biznesin e vogël                                   | 4,541,143     | 4,640,565     |
| 7     | 7009       | <i>Te tjera Tatime mbi te ardhurat</i>                       | 0             | 0             |
| 8     | <b>702</b> | <b>2.Tatimi mbi Pasurinë</b>                                 | 123,243,010   | 135,201,077   |
| 9     | 7020       | Tatim mbi Pasurinë e paluajtshme                             | 114,081,200   | 125,610,344   |
| 10    | 7021       | Tatim mbi shitjen e pasurisë se paluajtshme                  | 0             | 0             |
| 11    | 7029       | Te tjera tatime mbi Pasurinë                                 | 9,161,810     | 9,590,732     |
| 12    | <b>703</b> | <b>3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit</b>        | 213,337,606   | 198,543,900   |
| 13    | 7030       | Tatim mbi vlerën e shtuar(TVSH)                              | 0             | 0             |
| 14    | 7031       | Akciza   | 0             | 0             |
| 15    | 7032       | Takse mbi shërbimet specifike                                | 0             | 0             |
| 16    | 7033       | Takse mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie        | 0             | 0             |
| 17    | 7035       | Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie  | 213,337,606   | 198,543,900   |
| 18    | <b>704</b> | <b>4.Takse mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare</b>  | 0             | 0             |
| 19    | 7040       | Takse doganore për mallrat e importit                        | 0             | 0             |
| 20    | 7041       | Takse doganore për mallrat e eksportit                       | 0             | 0             |
| 21    | 7042       | Tarife shërbimi doganor e koliposte                          | 0             | 0             |
| 22    | 7049       | Te tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare    | 0             | 0             |
| 23    | <b>705</b> | <b>5.Takse e rrugës</b>                                      | 0             | 0             |
| 24    | <b>708</b> | <b>6.Te tjera Tatime e Taksa kombëtare</b>                   | 0             | 0             |
| 25    | <b>709</b> | <b>7.Gjoha e Kamat vonesa</b>                                | 0             | 0             |
| 26    | <b>75</b>  | <b>II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQ E SHENDETES</b>               | 0             | 0             |
| 27    | 750        | Nga te punësuarit  | 0             | 0             |
| 28    | 751        | Nga punëdhënësi  | 0             | 0             |
| 29    | 752        | Nga te vet punësuarit  | 0             | 0             |
| 30    | 753        | Nga fermerët   | 0             | 0             |
| 31    | 754        | Nga sigurimet vullnetare                                     | 0             | 0             |
| 32    | 755        | Kontribute nga buxheti për sigurime shoqërore                | 0             | 0             |
| 33    | 756        | Kontribute nga buxheti për sigurime shëndetësore             | 0             | 0             |
| 34    | <b>71</b>  | <b>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</b>                            | 266,783,603   | 251,519,280   |
| 35    | <b>710</b> | <b>1.Nga ndërmarrjet dhe pronësia</b>                        | 29,996,731    | 27,602,278    |
| 36    | 7100       | Nga Ndërmarrjet publike jo financiare                        | 0             | 0             |
| 37    | 7101       | Nga Ndërmarrjet publike financiare                           | 0             | 0             |
| 38    | 7109       | Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia                        | 29,996,731    | 27,602,278    |
| 39    | <b>711</b> | <b>2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare</b>   | 236,786,873   | 223,917,002   |
| 40    | 7110       | Tarifa administrative dhe rregullatore                       | 177,750,253   | 169,540,712   |
| 41    | 7111       | Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh                     | 29,098,118    | 30,359,928    |
| 42    | 7112       | Takse për veprime gjyqësore e noteriale                      | 0             | 0             |
| 43    | 7113       | Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve                | 16,258,990    | 5,280,466     |
| 44    | 7114       | Te ardhura nga biletat                                       | 3,508,200     | 5,420,200     |
| 45    | 7115       | Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdëmtime                  | 10,171,312    | 13,315,696    |
| 46    | 7116       | Te ardhura nga transferipronës,Legalizimi i ndërtime pa leje | 0             | 0             |
| 47    | <b>719</b> | <b>3.Te tjera te ardhura jo tatimore</b>                     | 0             | 0             |
| 48    | <b>76</b>  | <b>IV.TE ARDHURA FINANCIARE</b>                              | 0             | 0             |
| 49    | 760        | Nga interesat e huadhënies se brendshme                      | 0             | 0             |
| 50    | 761        | Nga interesat e huadhënies se Huaj                           | 0             | 0             |

|    |            |  |               |               |
|----|------------|--|---------------|---------------|
| 51 | 765        | Nga interesat e depozitave                                 | 0             | 0             |
| 52 | 766        | Nga këmbimet valutore                                      | 0             | 0             |
| 53 | <b>72</b>  | <b>V.GRANTE KORENTE</b>                                    | 2,116,757,694 | 1,765,498,019 |
| 54 | <b>720</b> | <b>1.Grant korent iBrendshëm</b>                           | 2,105,655,454 | 1,765,498,019 |
| 55 | 7200       | Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)                             | 305,676,446   | 261,245,295   |
| 56 | 7201       | Nga Buxheti për NJQP(Vendore)                              | 1,388,777,318 | 1,154,431,124 |
| 57 | 7202       | Nga Buxheti për pagesa te posaçme te ISSH                  | 0             | 0             |
| 58 | 7203       | Nga Buxheti për mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)              | 0             | 0             |
| 59 | 7204       | Pjesëmarrje e institucioneve ne tatime nacionale           | 0             | 0             |
| 60 | 7205       | Financim shtese për te ardhurat e krijuara brenda sistemit | 321,644,217   | 254,038,720   |
| 61 | 7206       | Financim ipritshëm nga buxheti                             | 53,421,313    | 65,193,143    |
| 62 | 7207       | Sponsorizime te brendshme( nga te trete)                   | 1,229,021     | 591,200       |
| 63 | 7209       | Të tjera grantekorente të brendshme                        | 34,907,139    | 29,998,537    |
| 64 | <b>721</b> | <b>2.Grant korrenti Huaaj</b>                              | 11,102,240    | 0             |
| 65 |            | Nga Qeveri te Huaaja                                       | 11,014,240    | 0             |
| 66 |            | Nga Organizata Ndërkombëtare                               | 88,000        | 0             |
| 67 |            | <b>VI.TE ARDHURA TE TJERA</b>                              | 159,793,761   | 119,336,879   |
| 68 | 781        | Te ardhura nga investimet ne ekonomi                       | 0             | 0             |
| 69 | 782        | Rimarrje Shumash te parashikuara për aktive afatshkurtra   | 0             | 0             |
| 70 | 783        | Rimarrje Shumash te parashikuara për aktive afatgjata      | 0             | 0             |
| 71 | 784        | Rimarrje Shumash për shpenzime te viteve ardhshme          | 0             | 0             |
| 72 | 787        | Tërheqje nga seksioni i investimeve                        | 159,793,761   | 119,336,879   |
| 73 | <b>73</b>  | <b>VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARI TE PROD</b>       |               |               |

Në Formati nr. 2, “pasqyra e performancës financiare” B. “Shpenzimet” janë pasqyruar shpenzimet korrente të konstatuara në vlerën 2,527,609 mijë lekë si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit të ndara sipas zërave si;

Llog. (600) “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në vlerën 551,992 mijë lekë ose 21.8% të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur shpenzimet për pagat e personelit të përhershëm, për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor 2019.

llog. (601) “Kontribute të sigurimeve” për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 91,518 mijë lekë ose 3.6% të totalit të shpenzimeve.

llog. (602) “Blerje mallra e shërbime” në vlerën 492,413 mijë lekë ose 19.4% të totalit të shpenzimeve,

Llog (603) “Subvensione për diferencë çmimi” në vlerën 43,712 mijë lekë ose 1.7%.

Llog (604) “Transferime korente të brendshme” në vlerën 850,191 mijë lekë ose 33.6%.

Llog (606) “Transferime për Buxhetet familjare e Individë” në vlerën 529,948 mijë lekë ose 20.9%.

Llog. (63) “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” në vlerën – 4217 mijë lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët.

Vlerat e shpenzimeve paraqitura në pasqyrat financiare F2 “Pasqyrën e performancës financiare” paraqiten në vlerën 2,527,609 mijë lekë si më poshtë:

lekë

| Nr.      | Nr. llog.  | PERSHKRIMI I OPERACIONEVE                  | Viti Ushtrimor | Viti i mëparshëm |
|----------|------------|--|----------------|------------------|
| <i>a</i> | <i>b</i>   | <i>c</i>                                   | <i>1</i>       | <i>2</i>         |
| 74       | <b>B</b>   | <b>SHPENZIMET</b>                          | 2,527,609,155  | 2,114,174,244    |
| 75       | <b>600</b> | <b>I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE</b> | 551,992,747    | 529,617,041      |
| 76       | 6001       | Paga, personel i përhershëm                | 547,929,320    | 528,974,744      |
| 77       | 6002       | Paga personel i Përkohshëm                 | 513,298        | 642,297          |
| 78       | 6003       | Shpërblime                                 | 0              | 0                |
| 79       | 6009       | Shpenzime të tjera për personelin          | 3,550,129      | 0                |
| 80       | <b>601</b> | <b>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>         | 91,518,020     | 88,229,819       |
| 81       | 6010       | Kontributi I Sigurimeve Shoqërore          | 82,182,294     | 79,236,525       |
| 82       | 6011       | Kontributi I Sigurimeve Shëndetësore       | 9,335,726      | 8,993,294        |
| 83       | <b>602</b> | <b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>        | 492,413,172    | 409,649,108      |
| 84       | 602        | Mallra dhe shërbime te tjera               | 0              | 0                |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|     |            |   |               |               |
|-----|------------|---|---------------|---------------|
| 85  | 6020       | Materiale zyre e te përgjithshme                            | 42,511,535    | 20,916,299    |
| 86  | 6021       | Materiale dhe shërbime speciale                             | 41,091,100    | 34,853,910    |
| 87  | 6022       | Shërbime nga te trete                                       | 205,714,310   | 177,882,397   |
| 88  | 6023       | Shpenzime transporti  | 44,015,114    | 40,724,528    |
| 89  | 6024       | Shpenzime udhëtimi  | 13,298,884    | 12,776,600    |
| 90  | 6025       | Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme                      | 88,076,028    | 78,647,143    |
| 91  | 6026       | Shpenzime për qiramarrje                                    | 6,230,128     | 3,930,794     |
| 92  | 6027       | Shpenzime për detyrime për kompensime legale                | 7,763,857     | 2,489,826     |
| 93  | 6028       | Shpenzime te lidhura me huamarrjen për hua                  | 0             | 0             |
| 94  | 6029       | Shpenzime te tjera operative                                | 43,712,216    | 37,427,611    |
| 95  | <b>603</b> | <b>IV.SUBVECIONE</b>  | 9,998,550     | 8,552,345     |
| 96  | 6030       | Subvencione për diference çmimi                             | 9,998,550     | 8,552,345     |
| 97  | 6031       | Subvencione për te nxitur punësimin                         | 0             | 0             |
| 98  | 6032       | Subvencione për te mbuluar humbjet                          | 0             | 0             |
| 99  | 6033       | Subvencione për sipërmarrjet individuale                    | 0             | 0             |
| 100 | 6039       | Subvencione te tjera  | 0             | 0             |
| 101 |            | <b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>                                | 1,380,139,684 | 1,085,599,629 |
| 102 | <b>604</b> | <b>1.Transferime korente të brendshme</b>                   | 850,191,371   | 519,333,014   |
| 103 | 6040       | Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise            | 35,094,141    | 20,801,214    |
| 104 | 6041       | Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme | 772,851,796   | 463,194,799   |
| 105 | 6042       | Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore  | 0             | 0             |
| 106 | 6044       | Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurëse         | 42,245,435    | 35,337,001    |
| 107 | <b>605</b> | <b>2.Transferime korente me jashtë</b>                      | 0             | 0             |
| 108 | 6051       | Transferime Për Organizatat Ndërkombëtare                   | 0             | 0             |
| 109 | 6052       | Transferime Për Qeveritë e Huaja                            | 0             | 0             |
| 110 | 6053       | Transferime Për institucionet jo fitimprurëse te huaja      | 0             | 0             |
| 111 | 6059       | Transferime Te tjera korrente me jashtë shtetit             | 0             | 0             |
| 112 | <b>606</b> | <b>3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë</b>      | 529,948,313   | 566,266,615   |
| 113 | 6060       | Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH                      | 56,519        | 1,290,000     |
| 114 | 6061       | Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor        | 529,891,794   | 564,976,615   |
| 115 |            | <b>VI.SHPENZIME FINANCIARE</b>                              | 5,764,493     | 8,820,400     |
| 116 | <b>65</b>  | <b>1.Shpenzime Financiare te brendshme</b>                  | 5,764,493     | 8,820,400     |
| 117 | 650        | Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte                | 0             | 0             |
| 118 | 651        | Interesa për huamarrje te tj. Brendshme                     | 5,764,493     | 8,820,400     |
| 119 | 652        | Interesa Letra tjera vlere Qeverise                         | 0             | 0             |
| 120 | 656        | Shpenz .nga këmbimet valutore                               | 0             | 0             |
| 121 | <b>66</b>  | <b>2. Shpenzime Financiare te jashtme</b>                   | 0             | 0             |
| 122 | 660        | Interesa për huamarrje nga Qeveritë e Huaja                 | 0             | 0             |
| 123 | 661        | Interesa për financime nga Institucionet nderkomb           | 0             | 0             |
| 124 | 662        | Interesa për huamarrje te tjera jashtme                     | 0             | 0             |
| 125 |            | <b>VII. KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASH</b>            | 0             | 0             |
| 126 | 681        | Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytëzimit               | 0             | 0             |
| 127 | 682        | Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashtë përdo e te shitura | 0             | 0             |
| 128 | 683        | Shuma te parashikuara te shfrytëzimit                       | 0             | 0             |
| 129 | 686        | Shuma te parashikuara për aktivet financiare                | 0             | 0             |
| 130 | <b>63</b>  | <b>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>              | -4,217,511    | -16,294,098   |

- Në “Pasqyrën e performancës financiare” rezulton se “Të Ardhurat” janë të barabarta me Shpenzimet + Rezultatin e vitit Ushtrimor (2,527,609,155 + 337,377,950 = 2,900,987,105 lekë)

- Në “Pasqyrën e performancës financiare” rezulton se Llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 373,377,950 lekë nuk është e barabartë me Llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” me vlerën 129,733,547 në Pasqyrën F1 “Pasqyra e pozicionit financiar”.

57. Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, sipas procedurës së mësipërme, llogaria 85,

“Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” përfaqëson, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës. Ndërsa, si

tepricë debitore, kjo llogari përfaqëson rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese.

70. Rubrika C e pasqyrës së performancës financiare përfaqëson tepricën apo deficitin e periudhës (*rezultatit e veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur*) dhe është e barabartë me diferencën algjebrike midis totalit të të ardhurave dhe totalit të shpenzimeve.

71. Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur, i paraqitur në rubrikën C të pasqyrës së performancës financiare, duhet të jetë detyrimisht i barabartë me zërin rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85), që evidentohet në rubrikën C, të aktiveve neto/fondeve neto në pasqyrën e pozicionit financiar.

Rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85) përfaqëson diferencën absolute midis totalit të operacioneve të të ardhurave (të ardhura të funksionimit + operacione të korigjimit) me totalin e operacioneve të shpenzimeve (shpenzimet e funksionimit + operacionet e korigjimit).

- **Llog. 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** për vlerën – 4,217,511 lekë në Pasqyrën F2 “*Pasqyrën e performancës financiare*” është e barabartë me Ndryshimin e Gjendjeve të Klasës 3 në Pasqyrën F1 “*Pasqyra e pozicionit financiar*” (170,842,157 - 191,765,134 = - 4,217,511 lekë).

**Pasqyra statistikore formati nr. 6 “Investimet dhe burimet e financimit”** zëri “*Burimet për investime*”, llogaria nr. 105 “Grante të brendshme kapitale” në vlerën 377,180,547 lekë, llog. 1050 “Grante kapitale nga buxheti” e plotësuar për shumën 7,910,000 lekë, llogaria nr. 1051 “Grante kapitale nga nivele të tjera” në vlerën 301,478,696 lekë (në total 686,569,443 lekë) në analizë nuk rakordon me vlerën 904,561,097 lekë në pasqyrën “*gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)*” kolona e dytë “*Blerjet e krijuara me pagesë*” formati 7/a.

Gjithashtu teprica në fund e llogarive për shpenzimet për investime dhe burimet për investime në Formatin 6, llog. 105 në vlerën 133,596,147 lekë janë të barabarta me llogaritë përkatëse në Pasqyrën F1 “*Pasqyra e pozicionit financiar*” e cila është në të njëjtën vlerë.

Gjithashtu teprica në fund e llogarive për shpenzimet për investime dhe burimet për investime në Formatin 6, llog. 115 në vlerën 85,850,250 lekë janë të barabarta me llogaritë përkatëse në Pasqyrën F1 “*Pasqyra e pozicionit financiar*” e cila është në të njëjtën vlerë.

Gjithashtu teprica në fund e llogarive për shpenzimet për investime dhe burimet për investime në Formatin 6, llog. 16, 17 “Huamarrje” në vlerën 137,695,969 lekë janë të barabarta me llogaritë përkatëse në Pasqyrën F1 “*Pasqyra e pozicionit financiar*” e cila është në të njëjtën vlerë.

*Formati nr.6:*

| Nr.      | Nr. llog. | EMERTIMI                                    | Teprica<br>Fillim viti | Transaksionet e vitit |                    | Teprica<br>në Fund |
|----------|-----------|---|------------------------|-----------------------|--------------------|--------------------|
|          |           |   |                        | Debi                  | Kredi              |                    |
| <i>a</i> |           | <i>b</i>                                    | <i>c</i>               | <i>d</i>              | <i>e</i>           | <i>f</i>           |
| 1        | I.        | SHPENZIMET PER INVESTIME                    | 611,837,681            | 231,625,085           | 654,431,251        | 189,031,515        |
| 2        | 230       | Shpenzime për Aktive Afatgjata jo materiale | 0                      | 397,472               | 397,472            | 0                  |
| 3        | 231       | Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale    | 613,075,859            | 231,227,613           | 654,033,779        | 190,269,693        |
| 4        | 25,26     | Shpenzime për Aktive Afatgjata Financiare   | 0                      | 0                     | 0                  | 0                  |
| 5        | 25        | Huadhënie dhe nenhuadhënie                  | 0                      | 0                     | 0                  | 0                  |
| 6        | 26        | Pjesëmarrje ne kapitalin e vet              | 0                      | 0                     | 0                  | 0                  |
| 7        | II.       | BURIMET PER INVESTIME                       | 1,378,090,730          | 1,942,359,736         | 822,495,822        | 133,611,307        |
| 8        | 105       | I.Grante te brendshme kapitale              | 693,528,104            | 937,112,504           | <b>377,180,547</b> | 133,596,147        |
| 9        | 1050      | Grante kapitale nga Buxheti                 | 11,141,985             | 15,965,896            | <b>7,910,000</b>   | 3,086,089          |
| 10       | 1051      | Grante kapitale nga nivele te tjera         | 681,147,941            | 853,354,757           | <b>301,478,696</b> | 129,271,880        |
| 11       | 1052      | Kontribute te tetreteve për investime       | 0                      | 0                     | 0                  | 0                  |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|    |       |   |                    |                      |                    |                    |
|----|-------|---|--------------------|----------------------|--------------------|--------------------|
| 12 | 1059  | Grante te brendshme kapitale ne natyre                | 0                  | 203,718,430          | 203,718,430        | 0                  |
| 13 | 106   | 2.Grante te huaja Kapitale                            | 0                  | 0                    | 0                  | 0                  |
| 14 | 1060  | Nga qeveri te huaja                                   | 0                  | 0                    | 0                  | 0                  |
| 15 | 1061  | Nga institucione ndërkombëtare                        | 0                  | 0                    | 0                  | 0                  |
| 16 | 1069  | Grante te huaja ne natyre                             | 0                  | 0                    | 0                  | 0                  |
| 17 | 14    | 3.Grante kapitale për investime për te trete          | 0                  | 0                    | 0                  | 0                  |
| 18 | 145   | Grantebrend. kapitale perpjesm. ne invest. te trete   | 0                  | 0                    | 0                  | 0                  |
| 19 | 146   | Grante te huaja kapitale perpje. ne inves ne te trete | 0                  | 0                    | 0                  | 0                  |
| 20 | 11    | 4.Fonde te tjera te veta.                             | 63,949,781         | 136,151,028          | 158,051,497        | 85,850,250         |
| 21 | 111   | Fonde rezerve   | 0                  | 0                    | 0                  | 0                  |
| 22 | 115   | Caktim fondi per investime nga rezultati I vitit      | 63,949,781         | 136,083,381          | 157,983,850        | 85,850,250         |
| 23 | 116   | Te ardhura nga shitja e aktiveve te qëndrueshme       | 0                  | 67,647               | 67,647             | 0                  |
| 24 | 12    | 5.Rezultati I Mbartur                                 | 0                  | 0                    | 0                  | 0                  |
| 25 | 16,17 | 6.Huamarrje   | 170,842,157        | 33,146,188           | 0                  | 137,695,969        |
| 26 | 16    | Huamarrje e Brendshme                                 | 170,842,157        | 33,146,188           | 0                  | 137,695,969        |
| 27 | 17    | Huamarrje e Huaj                                      | 0                  | 0                    | 0                  | 0                  |
| 29 | III.  | BALANCA (II-I)  | <b>766,253,049</b> | <b>1,710,734,651</b> | <b>168,064,571</b> | <b>-55,420,208</b> |

**Formati 5** “Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore” për pasqyrat e konsoliduara nuk është plotësuar relacioni shpjegues ku janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

Mbyllja e bilancit për vitin 2019 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe plotësimi i tij është bërë në formatin elektronik duke rakorduar llogaritë dhe shumat përkatëse, veprimet janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur.

**Titulli i gjetjes**

Mosparaqitja e pasqyrave financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara me vlerën e drejtë të Llogarive nr. 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”, Llogaria nr. 12 “Rezultatet e mbartura”, llog. 85 “Rezultati i vitit ushtrimor”, dhe llogarisë nr. 486, “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe pjesërisht nuk paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje.

**Situata 1:**

Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara, gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28) në formatin nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” kolona 11 “Gjendja në mbyllje të ushtrimit” është në vlerën 9,448,732,403 lekë kurse vlera e pasqyruara në formatin nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kolona 8 “Kosto historike” është 9,448,066,403 lekë (Me një diferencë prej 666,000 lekë). Ky ndryshim vjen nga zëri Mjete transporti 164,138,726 – 163,472,726 = **666,000** lekë.

**Situata 2:**

Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara formati 7/b “Amortizimi i aktiveve afatgjata” në fund të vitit 2019 paraqitet në vlerën 1,348,441,615 lekë. Krahasuar me vitin 2018 “Amortizimi i aktiveve afatgjata” paraqitet me shtesë prej 338,786,204 lekë, e cila ka ardhur si rezultat i llogaritjes së amortizimit vjetor për aktivet afatgjata materiale për të gjithë vlerën por nuk është llogaritur amortizimi i aktiveve afatgjata jo materiale “studime e kërkime” bazuar në UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe

**Situata 3:**

*raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, pika 36, si dhe amortizimin e akumuluar.

Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara formati nr. 1 “*Pasqyra e pozicionit financiar*”, D. “*Fondi i konsoliduar*” nuk është pasqyruar llog. 12 “*Rezultatet e mbartura*” në vlerën 164,242,781 lekë po kështu edhe në Formatin 6 “*Pasqyra e investimeve dhe burimet e financimit*”, nuk është pasqyruar vlera e llog. 12 “*Rezultatet e mbartura*” në vlerën 164,242,781 lekë dhe llog. 85 “*Rezultati i vitit ushtrimor*” duhej të pasqyrohej për vlerën (- 34,508,474) lekë. Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara Formati 2 “*Pasqyra e performancës financiare*” rezulton se Llog. 85 “*Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor*” me vlerën 373,377,950 lekë nuk është e barabartë me Llog. 85 “*Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor*” me vlerën 129,733,547 lekë në pasqyrën Formati 1 “*Pasqyra e pozicionit financiar*” me një diferencë në vlerën 243,644,403 lekë. Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur, i paraqitur në rubrikën C të pasqyrës së performancës financiare, duhet të jetë detyrimisht i barabartë me zërin rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85), që evidentohet në rubrikën C, të aktiveve neto/fondeve neto në pasqyrën e pozicionit financiar.

Kjo llogari në pozicionin financiar dhe atë të performancës financiare nuk përfaqëson saktë, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten, për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës. Ndërsa edhe si tepricë debitore, kjo llogari nuk përfaqëson saktë rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin nuk jepen sqarime në shënimet shpjeguese. Sa më lart nuk është në përputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, pika 57, 71.

Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara vlera e detyrimeve të prapambetura të regjistruara në llogarisë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*”, është 191,211,054 lekë ku në listat analitike sipas njësive të vartësisë me vlerat e detyrimeve të prapambetura janë edhe vlerat e detyrimeve të cilat janë brenda 30 ditëve të datës së specifikuar për likuidim (Dhjetor 2019). Mbështetur në listat analitike sipas njësive llogaria e konsoliduar 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*”, duhej të ishte në vlerën 136,165,039 lekë.

Sipas VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “*Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimi*”, për qëllimet e Strategjisë së Parandalimit dhe Shlyerjes së Detyrimeve të Prapambetura (SPSD), detyrimet e prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara nga një ligj/kontratë/marrëveshje /vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e qeverisjes qendrore, pushtetit vendor (kontratat e financuara nga qeveria qendrore) dhe fondeve speciale të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Balanca e verifikuar e pashlyer në datën 31 dhjetor 2013 (si dhe e papaguar gjatë muajit janar 2014) do të përdoret për qëllimin



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

|                   |  |
|-------------------|--|
| <b>Situata 4:</b> | <p>e strategjisë.</p> <p>Sipas UMF nr. 8, datë 09.03.2018, pika 42 “Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486, “<i>Shpenzime të periudhave të ardhshme</i>”, në varësi të natyrës së tyre: Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura të bëhen si më poshtë: Debitohet llogaria përkatëse 486, “<i>Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura</i>”; dhe Kreditohet llogaria përkatëse 467, “<i>Kreditorë të ndryshëm</i>”.</p>  |
| <b>Situata 5:</b> | <p>Pasqyra statistikore formati nr. 6 “<i>Investimet dhe burimet e financimit</i>” zëri “<i>Burimet për investime</i>”, llogaria nr. 105 “<i>Grante të brendshme kapitale</i>” në vlerën 377,180,547 lekë, llog. 1050 “<i>Grante kapitale nga buxheti</i>” e plotësuar për shumën 7,910,000 lekë, llogaria nr. 1051 “<i>Grante kapitale nga nivele të tjera</i>” në vlerën 301,478,696 lekë (në total 686,569,443 lekë) në analizë nuk rakordon me vlerën 904,561,097 lekë në pasqyrën “<i>gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)</i>” kolona e dytë “<i>Blerjet e krijuara me pagesë</i>” formati 7/a.</p> <p>Llog. 4342 “<i>Operacione me shtetin (të drejta)</i>” zënë shumën 53,421,313 lekë e cila në pasiv, në analizë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra, llogari të pagueshme, të cilat trashëgohen në vitin 2020 në vlerën 53,525,014 lekë (e cila nuk rakordon në shumën 103,701 lekë) si “<i>Detyrime ndaj personelit</i>” (llog. 421-423) për 38,830,081 lekë, “<i>Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa</i>” (llog. 431) për 1,975,245 lekë, për “<i>Sigurime shoqërore</i>” (llog. 435) në vlerën 11,182,369, “<i>Sigurime shëndetësore</i>” (llog. 436) në vlerën 1,537,319 lekë.</p> |
| <b>Situata 6:</b> | <p>Llogaria 4342, “<i>Operacione me shtetin (të drejta)</i>” në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe duhet të përfaqësojë detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (<i>grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit</i>). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (<i>por jo vetëm</i>) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Sa më lart është në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “<i>Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme</i>”, “<i>Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin</i>”.</p>  |
| <b>Situata 7:</b> | <p>Formati 5 “<i>Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore</i>” për pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara nuk është plotësuar relacioni shpjegues ku të jenë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen duke mbajtur parasysh dhënien e shënimeve shpjeguese të bëra nga hartuesit e pasqyrave financiare vjetore individuale, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë në kundërshtim me UMF nr.</p>   |

|                       |  |
|-----------------------|--|
|                       | <p>8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 110, 111.</p>   |
| <b>Kriteri:</b>       | <p>Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.</p>  |
| <b>Ndikimi/Efekti</b> | <p>Pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara nuk sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe pjesërisht nuk paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje.</p>   |
| <b>Rëndësia</b>       | <p>I mesëm</p> <p>Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Korçë, për vitin 2020 me qëllim <u>sigurimin e informacionit</u> rreth burimeve financiare dhe alokimit të tyre, për mënyrën e financimit të aktiviteteve të njësisë dhe realizimin e kërkesave mbi mjetet monetare, me aftësinë e njësisë për të financuar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet, si dhe për vlerësimin e performancës së njësisë raportuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nga Bashkia Korçë, Sektori i Financës të merren masat për të saktësuar gjendjen në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28 Mjete transporti) pasqyruar në formatin nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe formatin nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”.</li> <li>- Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, sipas procedurës kontabile, llogaria 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” si tepriçë debitore, duhet të përfaqësojë rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese.</li> <li>- Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” nga viti i mëparshëm në llogarinë 12 “Rezultate të mbartura”, e cila është e përdorshme dhe funksionale për njësitë e vetëqeverisjes vendore që, në kuadrin e decentralizimit të tyre, trashëgojnë në vitet e mëpasshme grantet buxhetore dhe të ardhurat e papërdorura të vitit ushtrimor. Rezultati i mbartur duhet të vijë nga rezultati i viteve respektive dhe mbetet i papërdorur, me të drejtë të pa parashkrueshme për ta përdorur në vijim. Ky rezultat duhet të jetë i argumentuar me të ardhurat në likuiditete në llogaritë financiare e të disponibiliteteve, si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuar në periudhat përkatëse ushtrimore.</li> <li>- Bashkia Korçë, Sektori i Financës të marrë masat për të saktësuar vlerën e llogarisë 486, “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura”, kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara vlerën e drejtë të aktiveve afat shkurtra; njëkohësisht duke përcaktuar rregullat që forcojnë kontrollet e brendshme lidhur me rakordimin dhe raportimin e detyrimeve për faturat e papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë rigoroze mbi baza mujore e vjetore, sipas përkatësisë së vitit buxhetor kur ato krijohen dhe likuidohen.</li> </ul> |
| <b>Rekomandime</b>    |  |





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

- Drejtuesit e Bashkisë Korçë, sektori i financës në miratimin e pasqyrave financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara, duhet të pasqyrojnë rakordimet e bëra nga hartuesit e pasqyrave financiare vjetore individuale me të tretët me informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër me qëllim, rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohet se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohet nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.
- Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara për vitin 2020 të Bashkisë Korçë, për llogaritë e arkëtueshme 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” dhe llogaritë e tjera aktive afatshkurtra 486, “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura”.

#### **B. Auditimi i Pasqyrave financiare individuale viti 2019 të Bashkisë Korçë.**

Në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, D. “Fondi i konsoliduar” nuk është pasqyruar llog. 12 “Rezultatet e mbartura” në vlerën 132,696,192 lekë po kështu edhe në Formatin 4 “pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto”, nuk është pasqyruar vlera e llog. 12 “Rezultatet e mbartura” në vlerën 132,969,192 lekë dhe vlera e llog. 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” duhej të pasqyrohej për vlerën (- 31,442,819) lekë.

Sipas UMF nr. 8, datë 09.03.2018, pika 43 “Këto njësi, në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësojnë pozicionin e çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe të realizojnë transaksionin e transferimit të tepricës së llogarisë 85, “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12, “Rezultat i mbartur”. Pika 52 “Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, , llogaria 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” përfaqëson, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës. Ndërsa, si tepricë debitorë, kjo llogari përfaqëson rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese.

**Funksionimi i llogarisë 12, “Rezultati i mbartur”.** Kjo llogari është e përdorshme dhe funksionale sidomos për njësitë e vetëqeverisjes vendore që, në kuadrin e decentralizimit të tyre, trashëgojnë në vitet e mëpasshme grantet buxhetore dhe të ardhurat e papërdorura të vitit ushtrimor. Rezultati i mbartur vjen nga rezultati i viteve respektive dhe mbetet i papërdorur, me të drejtë të pa parashkrueshme për ta përdorur në vijim. Ky rezultat duhet të jetë i argumentuar me të ardhurat në likuiditete në llogaritë financiare e të disponibiliteteve, si dhe me të drejta të konstatuara por të paarkëtuara në periudhat përkatëse ushtrimore.

- Në “Pasqyrën e performancës financiare” rezulton se Llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 101,253,373 lekë nuk është e barabartë me Llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” me vlerën 293,548,399 në Pasqyrën F1 “Pasqyra e pozicionit financiar” me një diferencë në vlerën 192,295,026 lekë.

Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, llogaria 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” duhet të përfaqësojë, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës. Ndërsa, si tepricë

debitore, kjo llogari përfaqëson rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese. Rubrika C e pasqyrës së performancës financiare përfaqëson tepricën apo deficitin e periudhës (*rezultatin e veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur*) dhe është e barabartë me diferencën algjebrike midis totalit të të ardhurave dhe totalit të shpenzimeve.

Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur, i paraqitur në rubrikën C të pasqyrës së performancës financiare, duhet të jetë detyrimisht i barabartë me zërin rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85), që evidentohet në rubrikën C, të aktiveve neto/fondeve neto në pasqyrën e pozicionit financiar.

Rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85) përfaqëson diferencën absolute midis totalit të operacioneve të të ardhurave (të ardhura të funksionimit + operacione të korigjimit) me totalin e operacioneve të shpenzimeve (shpenzimet e funksionimit + operacionet e korigjimit).

Në pasqyrën e pozicionit financiar C. "*aktivet neto*" janë të barabarta me D. "*fondin e konsoliduar*" në vlerën 6,563,515,306 lekë, e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së aktivitetit 7,451,749,323 mijë lekë dhe B "*detyrimet*" të pasivit në vlerën 888,234,017 mijë lekë.

Formati 4 "*pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto*", totali i fondeve korrespondon me totalin e fondeve në formatin nr. 1 "*Pasqyra e pozicionit financiar*" në vlerën 6,563,515,306 lekë.

Konstatohet se faturat e pa likuiduara brenda një viti buxhetor, edhe pse kanë qenë të mbuluara me vlerën e të ardhurave të trashëguara për vitin pasues buxhetor, këto fatura nuk janë likuiduar të gjitha në vitin e ardhshëm, pasi disponibilitetet në thesar në fund të vitit buxhetor, nuk janë përdorur të gjitha në funksion të likuidimit të faturave të prapambetura vjetore, por një pjesë e tyre janë përdorur për buxhetin e ri vjetor.

**Në llog. (467) "Kreditorë të ndryshëm"** me vlerën 146,797,326 lekë në total, vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Korçë për vitin 2019 është 90,999,528 lekë.

Pasqyra:

| Subjekti    | Përshkrimi i kontratës   | Nr. faturës | Data e faturës | Gjendja më 31.12.2019 |
|-------------|--|-------------|----------------|-----------------------|
| P.P sh.p.k. | Materiale promocionale   | 284         | 27.12.2017     | 56,400                |
| I.C sh.p.k. | "Çajupi" Kolaudime   | Kontrata    | 01.12.2015     | 1,782,000             |
| V. sh.p.k.  | Investime Vithkuq Lubonjë  | 75          | 04.11.2013     | 5,872,711             |
| N. sh.p.k.  | Rikonstrukcion Shkolla Lekas   | 7           | 28.08.2014     | 1,588,153             |
| LI.Q        | Vendim gjyqësor nr. 3780140  |             | 27.01.2014     | 309,174               |
| E. - G      | Mbikëqyrje: Rikualifikimi urban i zonës përreth qytezës së fëmijëve.                                 | 12          | 28.03.2018     | 3,888,000             |
| E. - G      | Mbikëqyrje: Rikonstrukcion i qendrës infrastrukturore rrugore dhe monumenteve të kulturës Voskopojë. | 13          | 28.03.2018     | 2,217,600             |
| K.          | Mbetje të përziera gusht   | 30          | 31.08.2019     | 2,425,123             |
| K.          | Mbetje të përziera shtator   | 36          | 30.09.2019     | 2,215,813             |
| K.          | Mbetje të përziera tetor   | 41          | 31.10.2019     | 2,255,843             |
| S. sh.p.k.  | Sistemim asfaltim lagjet 4,5,6,8,13 dhe 18   | 766         | 08.08.2019     | 3,465,828             |
| G.          | Rikonstrukcion rrugësh NJ. A Faza I  | 112         | 09.09.2019     | 20,117,059            |
| S. sh.p.k.  | Sistemim asfaltim L. 5 dhe 13  | 785         | 16.11.2019     | 1,690,818             |
| GBC E.      | Mbikëqyrje: Rikonstrukcion rrugësh në njësitë administrative (Faza I)                                | 30          | 01.10.2019     | 431,053               |
| T.sh.p.k.   | Mbikëqyrje: "Ndërtimi i parkut Japonez"  | 313         | 13.06.2019     | 691,116               |
| P.S         | Kolaudim: "Rip,dhe mermet. i stacioneve te pyjeve Voskopojë"   | 64          | 14.10.2019     | 2,500                 |
| S.Xh        | Sofron Xhengo-Vend.Nr.234 datë17.02.2000; Vend. Nr.195 datë24.05.2000                                |             |                | 134,924               |
| S.Q         | Sokrat Qirjako dhe Bashkëpronarët-Vend.Nr.2854 datë31.10.2019  |             |                | 4,066,591             |



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

|           |  |  |  |                   |
|-----------|--|--|--|-------------------|
| J. sh.p.k | Pagese 5% e garancisë së punimeve "Qendra Polifunkionale dhe e Shërbimeve"                           |  |  | 18,641,542        |
| K.93      | Pagese 5% garanci objekti "Rik.i shkollës A.Asabella"  |  |  | 1,015,321         |
| K.93      | Pagese 5% garanci objekti "Rik.i qendrës dhe infrastr.rrugore dhe monumenteve të kulturës Voskopojë" |  |  | 18,131,959        |
|           | <b>SHUMA</b>   |  |  | <b>90,999,528</b> |

Vlera e detyrimeve të prapambetura të regjistruara në llogarisë. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, është 124,905,128 lekë ku në listën me vlerat e detyrimeve të prapambetura janë edhe vlerat e detyrimeve të cilat janë brenda 30 ditëve të datës së specifikuar për likuidim (Dhjetor 2019). Mbështetur në listën e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” kjo vlerë është **90,999,528** lekë.

VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”

7. Për qëllimet e Strategjisë së Parandalimit dhe Shlyerjes së Detyrimeve të Prapambetura (SPSD), detyrimet e prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara nga një ligj/kontratë/marrëveshje /vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e qeverisjes qendrore, pushtetit vendor (kontratat e financuara nga qeveria qendrore) dhe fondeve speciale të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Balanca e verifikuar e pashlyer në datën 31 dhjetor 2013 (si dhe e papaguar gjatë muajit janar 2014) do të përdoret për qëllimin e strategjisë. Sipas UMF nr. 8, datë 09.03.2018, pika 42 “Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486, “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në varësi të natyrës së tyre:

Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura të bëhen si më poshtë:

Debitohet llogaria përkatëse 486, “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura”; dhe Kreditohet llogaria përkatëse 467, “Kreditorë të ndryshëm”.

Në pasqyrën e pozicionit financiar Pasivet, në llogarinë 16 e 17: “Hua afatgjatë” është paraqitur vlera 137,695,969 lekë e cila përfaqëson vlerën e mbetur të pa shlyer të kredive të mara kryesisht nga bankat: Intesa San Paolobank në vlerën 200,000,000 lekë dhe Procredit Bank në vlerën 92,600,000 lekë.

Gjatë vitit 2019 janë likuiduar për dy kreditë e mësipërme në vlerën 33,146,188 lekë si vlerë principiali. e cila pasqyrohet në situacionin vjetor duke debituar llogarinë 16 dhe kredituar llogarinë 520 për këtë vlerë.

Në pasqyrën e performancës financiare në llogarinë 651 “Interesa për huamarrje të brendshme” është regjistruar vlera prej 5,764,493 lekë interesa të likuiduara për kreditë e mara.

Gjithashtu Bashkia duke u bazuar në marrëveshjen e nënhuasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave (huadhënësi) dhe Bashkia Korçë (huamarrësi), për projektin “Ndërtimi i Banesave me Qëllim Social”, paguan principalin sipas disbursimeve të kryera:

Transh I = 340.214 € 2014 – 2023

Transh II = 640.000 € 2016 – 2025

Transh III = 110.000 € 2017 – 2026

Transh IV = 101.386 € 2018 – 2027

**1.191.600 €**

Për vitin 2019 Bashkia ka paguar principalin në vlerën 14.848.452,82 lekë duke debituar llogarinë 16 dhe kredituar llogarinë 467, në ditarin e bankës debitohe llogaria 467 dhe kreditohet llogaria 520 dhe në ditarin e veprimeve të ndryshme debitohe llogaria 831 dhe kreditohet llogaria 166 dhe në fund llogaria 831 mbyllet me llogarinë 85.

Sipas UMF nr. 8, datë 09.03.2018, aktualisht, huamarrja nuk vepron direkt nga institucionet apo përfituesit. Huaja si rregull merret nga qeveria shqiptare dhe për shlyerjen e saj përgjigjet qeveria shqiptare, sipas kontratave të lidhura.

Në përputhje me hapësirat ligjore në vazhdim, veçanërisht për organet e vetëqeverisjes vendore mund të krijohen premisa për huamarrjen e huadhënien direkte, pa ndërmjetësinë e qeverisë shqiptare, pra direkte me sistemin bankar.

Grupi i llogarive 16 e 17, nga pikëpamja kontabël funksionon si më poshtë:

a) Për nënshkrimin dhe marrjen e huas, veprimet:

Kreditohe llogaritë 16 dhe 17 (për nënshkrimin dhe marrjen e huas);

Debitohen llogaritë e klasës 4 (për konstatimin e huas); dhe

Debitohen llogaritë e klasës 5 (marrjen efektive të huas).

b) Për shlyerjen ose pagimin e principialit, veprimet:

Debitohen llogaritë 16 dhe 17; dhe

Kreditohe llogaritë e klasës 4 ose klasës 5.

c) Për konstatimin ose pagimin e interesave, veprimet:

Debitohet klasa 6 (për shpenzimet financiare);

Kreditohe llogaritë e klasës 4 (për konstatimin e interesave); dhe

Kreditohe llogaritë e klasës 5 (për pagimin e interesave).

Formati 4 “*pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto*”, totali i fondeve korrespondon me totalin e fondeve në formatin nr. 1 “*Pasqyra e pozicionit financiar*” në vlerën 6,563,515,306 lekë.

Gjithashtu në Formatin 6 “*Investimet dhe burimet e financimit*” llogaria 16 “*Huamarrje e brendshme*” në vlerën 137,695,969 lekë është e njëjtë me vlerën e kësaj llogarie në Formatin nr. 11 “*Pasqyra e pozicionit financiar*”.

Nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve për vitin 2019 sipas procesverbalit të vlerësimit dhe atë të asgjësimit të aktiveve të miratuar nga kryetari i Bashkisë. Llogaria 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” në vlerën 468,000 lekë, llogaria 214 “*Instalime teknike makineri dhe pajisje*” në vlerën 554,400 lekë llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” në vlerën 2,170,931 lekë.

Llog. 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*” zënë shumën 14,470,877 e cila në pasiv në analizë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra, llogari të pagueshme, të cilat trashëgohen në vitin 2020 në vlerën 14,762,317 lekë (e cila nuk rakordon në shumën 291,500 lekë) si “*Detyrime ndaj personelit*” (llog. 421-423) për 10,549,391lekë, “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*” (llog. 431) për 668,834 lekë, për “*Sigurime shoqërore*” (llog. 435) në vlerën 3,122,406, “*Sigurime shëndetësore*” (llog. 436) në vlerën 421,748 lekë.

Llogaria 4342, “*Operacione me shtetin (të drejta)*” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

#### Titulli i gjetjes

Mosparaqitja në pasqyrat financiare individuale me vlerën e drejtë të Llogarive nr. 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”, Llogaria nr. 12 “Rezultatet e mbartura”, llog. 85 “Rezultati i vitit ushtrimor”, dhe llogarisë nr. 486, “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe pjesërisht nuk paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje.

Në pasqyrat financiare individuale Bashkia Korçë formati nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, D. “Fondi i konsoliduar” nuk është pasqyruar llog. 12 “Rezultatet e mbartura” në vlerën 132,696,192 lekë po kështu edhe në Formatin 6 “Pasqyra e investimeve dhe burimet e financimit”, nuk është pasqyruar vlera e llog. 12 “Rezultatet e mbartura” në vlerën 132,696,192 lekë dhe llog. 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” duhej të pasqyrohej për vlerën (-31,442,819) lekë. Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara Formatin 2 “Pasqyra e performancës financiare” rezulton se Llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” me vlerën 293,548,389 lekë nuk është e barabartë me Llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” me vlerën 101,253,373 lekë në pasqyrën Formatin 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” me një diferencë në vlerën **192,295,026** lekë. Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur, i paraqitur në rubrikën C të pasqyrës së performancës financiare, duhet të jetë detyrimisht i barabartë me zërin rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85), që evidentohet në rubrikën C, të aktiveve neto/fondeve neto në pasqyrën e pozicionit financiar.

#### Situata 1:

Kjo llogari në pozicionin financiar dhe atë të performancës financiare nuk përfaqëson saktë, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten, për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës. Ndërsa edhe si tepricë debitore, kjo llogari nuk përfaqëson saktë rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese. Sa më lart nuk është në përputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 57, 71.

Vlera e detyrimeve të prapambetura të regjistruara në llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, është 124,905,128 lekë ku në listën me vlerat e detyrimeve të prapambetura janë edhe vlerat e detyrimeve të cilat janë brenda 30 ditëve të datës së specifikuar për likuidim (Dhjetor 2019). Mbështetur në listën e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” kjo vlerë është **90,999,528** lekë.

VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”

#### Situata 2:

7. Për qëllimet e Strategjisë së Parandalimit dhe Shlyerjes së Detyrimeve të Prapambetura (SPSD), detyrimet e prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara nga një ligj/kontratë/marrëveshje /vendim gjykatë i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e qeverisjes qendrore, pushtetit vendor (kontratat e financuara nga

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | <p>qeveria qendrore) dhe fondeve speciale të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Balanca e verifikuar e pashlyer në datën 31 dhjetor 2013 (si dhe e papaguar gjatë muajit janar 2014) do të përdoret për qëllimin e strategjisë.</p> <p>Sipas UMF nr. 8, datë 09.03.2018, pika 42 “Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486, “<i>Shpenzime të periudhave të ardhshme</i>”, në varësi të natyrës së tyre: Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura të bëhen si më poshtë:</p> <p>Debitohet llogaria përkatëse 486, “<i>Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura</i>”; dhe Kreditohet llogaria përkatëse 467, “<i>Kreditorë të ndryshëm</i>”.</p> <p>Konstatohet se faturat e pa likuiduara brenda një viti buxhetor, edhe pse kanë qenë të mbuluara me vlerën e të ardhurave të trashëguara për vitin pasues buxhetor, këto fatura nuk janë likuiduar të gjitha në vitin e ardhshëm, pasi disponibilitetet në thesar në fund të vitit buxhetor, nuk janë përdorur të gjitha në funksion të likuidimit të faturave të prapambetura vjetore, por një pjesë e tyre janë përdorur për buxhetin e ri vjetor.</p> <p>Llog. 4342 “<i>Operacione me shtetin (të drejta)</i>” zënë shumën 14,470,877 lekë e cila në pasiv, në analizë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra, llogari të pagueshme, të cilat trashëgohen në vitin 2020 në vlerën 14,762,317 lekë (e cila nuk rakordon në shumën <b>291,500 lekë</b>) si “<i>Detyrime ndaj personelit</i>” (llog. 421- 423) për 10,549,391 lekë, “<i>Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa</i>” (llog. 431) për 668,834 lekë, për “<i>Sigurime shoqërore</i>” (llog. 435) në vlerën 3,122,406, “<i>Sigurime shëndetësore</i>” (llog. 436) në vlerën 421,748 lekë.</p> <p>Llogaria 4342, “<i>Operacione me shtetin (të drejta)</i>” në pasqyrat financiare individuale të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe duhet të përfaqësojë detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (<i>grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit</i>). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (<i>por jo vetëm</i>) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Sa më lart është në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “<i>Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme</i>”, “<i>Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin</i>”.</p> |
| <b>Situata 4:</b>     | <p>Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “<i>Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme</i>”.</p>  |
| <b>Kriteri:</b>       | <p>Pasqyrat financiare nuk sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe pjesërisht nuk paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje.</p>   |
| <b>Ndikimi/Efekti</b> |   |



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

#### Rëndësia:

I mesëm

Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare individuale të Bashkisë Korçë, për vitin 2020 me qëllim *sigurimin e informacionit* rreth burimeve financiare dhe alokimin e tyre, për mënyrën e financimit të aktiviteteve të njëjësive dhe realizimin e kërkesave mbi mjetet monetare, me aftësinë e njësisë për të financuar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet, si dhe për vlerësimin e performancës së njëjësive raportuese:

- Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, sipas procedurës kontabile, llogaria 85, “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*” si tepricë debitore, duhet të përfaqësojë dhe pasqyrojë rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese.

- Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*” nga viti i mëparshëm në llogarinë 12 “*Rezultate të mbartura*”, e cila është e përdorshme dhe funksionale për njësitë e vetëqeverisjes vendore që, në kuadrin e decentralizimit të tyre, trashëgojnë në vitet e mëpasshme grantet buxhetore dhe të ardhurat e papërdorura të vitit ushtrimor. Rezultati i mbartur duhet të vijë nga rezultati i viteve respektive dhe mbetet i papërdorur, me të drejtë të pa parashkrueshme për ta përdorur në vijim. Ky rezultat duhet të jetë i argumentuar me të ardhurat në likuiditete në llogaritë financiare e të disponibiliteteve, si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuar në periudhat përkatëse ushtrimore.

- Bashkia Korçë, Sektori i Financës të marrë masat për të saktësuar vlerën e llogarisë 486, “*Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura*”, kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare individuale të Bashkisë Korçë vlerën e drejtë të aktiveve afat shkurtër; njëkohësisht duke përcaktuar rregullat që forcojnë kontrollet e brendshme lidhur me rakordimin dhe raportimin e detyrimeve për faturat e papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë rigorozë mbi baza mujore e vjetore, sipas përkatësisë së vitit buxhetor kur ato krijohen dhe likuidohen.

- Drejtuesit e Bashkisë Korçë, sektori i financës në miratimin e pasqyrave financiare, duhet të konfirmojnë (Rakordojnë) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër me qëllim, rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohet se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohet nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

- Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare individuale për vitin 2020 të Bashkisë Korçë, për llogaritë e arkëtueshme 4342 “*Operacione me shtetin (Të drejta)*” dhe llogaritë e tjera aktive afatshkurtra 486, “*Shpenzime të periudhave të ardhshme për*

#### Rekomandime:

**Mbi hartimin dhe zbatimimin e kontratave të karburantit për vitin 2018, 2019,2020.**

**a. Amendament kontrate ekzistuese e datës 05.05.2017:**

- për nevojat e fillimvitit 2018 me datë 19.01.2018 për furnizimin me karburant “benzinë” për nevojat e Bashkisë lidhur me subjektin “J.D” sh.p.k. në vlerën 89,000 lekë me marzh fitimi 7%.

- për nevojat e fillimvitit 2018 me datë 19.01.2018 për furnizimin me karburant “gazoil” për nevojat e Bashkisë lidhur me subjektin “J.D” sh.p.k. në vlerën 1,482,428 lekë me marzh fitimi 5.5%.

1- Me Urdhër shpenzimin nr. 79, datë 09.02.2018 është likuiduar vlera prej 1,049,057 lekë me tvsh

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 12, datë 22.01.2018 për 9139 litra gazoil me vlerën 1,482,345 lekë me tvsh, dhe benzinë 546 litra me vlerën prej 88,888 lekë, lëshuar nga subjekti “J.D” sh.p.k.. fletë hyrjen nr. 1, datë 22.01.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori dhe Bashkia e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriat Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar datë 31.03.2017.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 16.01.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 31.03.2017 sipas raportit të analizave.

Gazoil (Çmimi  $476+30=506\$/\text{ton} \times 0.8439 = (426.9 \times 127.34)/1000 = 54.36$  lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (5.5%) 6.6 lekë/litri çmimi del 127.96 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (25.59 lekë) në total çmimi del 153.55 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 31 mars 2017 si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar sipas faturës tatimore prej 1,482,345 lekë për sasinë e gazoilit prej 9139 litra gazoil është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 153.55 lekë/litri që është 1,403,293 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej 79,052 lekë.

Benzina (Çmimi  $545+30=575\$/\text{ton} \times 0.7349 = (422.5 \times 127.34)/1000 = 53.8$  lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (7%) 8.26 lekë/litri çmimi del 126.56 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (25.31 lekë) në total çmimi del 151.87 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 31 mars 2017 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar sipas faturës tatimore prej 88,888 lekë për sasinë e benzinës prej 546 litra benzinë është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 151.87 lekë/litri që është 82,921 lekë duke sjellë një pagesë tepër për benzinën prej 5,967 lekë.

Kjo vlerë në total prej **85.019** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “J.D” sh.p.k.. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes,





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

*mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”.*

#### **b. Amendament kontrate nr 2589/1, datës 08.05.2018 karburant naftë për 2,603,110 lekë me marzh fitimi 5% me afat 30 ditë nga lidhja e kontratës.**

1- Me Urdhër shpenzimit nr. 473, datë 28.05.2018 është likuiduar vlera prej 2,603,005 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 147, datë 09.05.2018 për 15843 litra gazoil me vlerën 2,603,005 lekë me tvsh, lëshuar nga subjekti “J.D” sh.p.k.. fletë hyrjen nr. 31, datë 09.05.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori dhe Bashkia e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar datë 23.04.2018.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 27.04.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 23.04.2018 sipas raportit të analizave.

Gazoil (Çmimi  $658+30=688$ \$/ton  $\times 0.8375 = (576.2 \times 105.42)/1000 = 60.74$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (5%) 6.38 lek/litri çmimi del 134.12 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (26.82 lekë) në total çmimi del 160.94 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 23 prill 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar sipas faturës tatimore prej 2,603,005 lekë për sasinë e gazoilit prej 15843 litra gazoil është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 160.94 lekë/litri që është 2,549,772 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej 53,233 lekë.

Kjo vlerë në total prej **53,233** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “J.D” sh.p.k.. pasi është përfitur në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

#### **c. Amendament i datës 19.01.2018 i kontratës ekzistuese e datës 12.04.2017:**

- për nevojat e fillimvitit 2018 me datë 19.01.2018 për furnizimin me karburant “gazoil” për nevojat e Bashkisë lidhur me subjektin “J.D” sh.p.k. në vlerën 2,977,469 lekë me marzh fitimi 6.5%.

1- Me Urdhër shpenzimit nr. 204, datë 20.03.2018 është likuiduar vlera prej 1,977,405 lekë me tvsh. (Amendimi i kontratës së mëparshme datë 12.04.2017 me kontratën datë 19.01.2018 për vlerën 2,977,469 lekë me marzh fitimi 6.5%).

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 13, datë 22.01.2018 për 12050 litra gazoil me vlerën 1,977,405 lekë me tvsh, lëshuar nga subjekti “J.D” sh.p.k.. fletë hyrjen nr. 2, datë 22.01.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori dhe Bashkia e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar datë 31.03.2017.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 16.01.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 31.03.2017 sipas raportit të analizave.

Gazoil (Çmimi  $476+30=506$ \$/ton  $\times 0.8439 = (426.9 \times 127.34)/1000 = 54.36$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (5.5%) 6.67 lek/litri çmimi del 128.03 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (25.60 lekë) në total çmimi del 153.63 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 31 mars 2017 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar sipas faturës

tatimore prej 1,977,405 lekë për sasinë e gazoilit prej 12050 litra gazoil është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 153.63 lekë/litri që është 1,851,241 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **126,164** lekë.

Kjo vlerë në total prej 126,164 lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “J.D” sh.p.k.. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

2- Me Urdhër shpenzimin nr. 348, datë 26.04.2018 është likuiduar vlera prej 999,972 lekë me tvsh. (Amendimi i kontratës së mëparshme datë 12.04.2017 me kontratën datë 19.01.2018 për vlerën 2,977,469 lekë me marzh fitimi 6.5%).

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 86, datë 26.03.2018 për 6345 litra gazoil me vlerën 999,972 lekë me tvsh, lëshuar nga subjekti “J.D” sh.p.k.. fletë hyrjen nr. 18, datë 26.03.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori dhe Bashkia e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar datë 01.12.2017.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 20.03.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 01.12.2017 sipas raportit të analizave.

Gazoil (Çmimi  $574+30=604$  \$/ton  $\times 0.8437 = (509 \times 112.36)/1000 = 56.84$  lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (5.5%) 6.8 lekë/litri çmimi del 130.64 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (26.12 lekë) në total çmimi del 156.76 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 01 dhjetor 2017 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar sipas faturës tatimore prej 999,972 lekë për sasinë e gazoilit prej 6345 litra gazoil është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 156.76 lekë/litri që është 994,642 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej 5,330 lekë.

Kjo vlerë në total prej **5,330** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “J.D” sh.p.k.. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

#### **d. Amendament kontrate ekzistuese e datës 03.10.2017:**

- për nevojat e fillimvitit 2018 me datë 19.01.2018 për furnizimin me karburant “gazoil” për nevojat e Bashkisë lidhur me subjektin “A.C” sh.p.k. në vlerën 1,972,344 lekë me marzh fitimi 5.1%.

1- Me Urdhër shpenzimin nr. 80, datë 09.02.2018 është likuiduar vlera prej 1,972,344 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 62, datë 29.01.2018 për 12300 litra gazoil me vlerën 1,972,344 lekë me tvsh, lëshuar nga subjekti “A.C” sh.p.k. fletë hyrjen nr. 5, datë 29.01.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori dhe Bashkia, e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të datës 08.09.2017.

Llogaritja e çmimit të gazoilit nga subjekti është bërë për datën 23.01.2018 referuar buletinit të APP.

Çmimit i furniturës së datës 08.09.2017 referuar buletinit të APP, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri është llogaritur si më poshtë:

Gazoil (Çmimi  $527+30=557$  \$/ton  $\times 0.8386 = (467.1 \times 110.67)/1000 = 51.69$  lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (5.1%) 6.05 lekë/litri çmimi del 124.74 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (24.94 lekë) në total çmimi del 149.68 lekë/litri.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 8 shtator 2017 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar prej 1,972,344 lekë për sasinë e gazoilit prej 12300 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 149.68 lekë/litri që është 1,841,064 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **131,280** lekë.

Kjo vlerë në total prej 131,280 lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti "A.C" sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5.

#### **e. Amendament kontrate ekzistuese e datës 19.04.2017:**

- për nevojat e fillimvitet 2018 me datë 24.01.2018 për furnizimin me karburant "benzinë" për nevojat e Bashkisë lidhur me subjektin "A&T" sh.a. në vlerën 263,200 lekë me marzh fitimi 7.69%.

1- Me Urdhër shpenzimit nr. 205, datë 21.03.2018 është likuiduar vlera prej 263,004 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 522, datë 16.02.2018 për benzinë 1680 litra me vlerën prej 263,004 lekë, lëshuar nga subjekti "A&T" sh.a. fletë hyrjen nr. 9, datë 16.02.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të datë 02.06.2017.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 05.02.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 02.06.2017 sipas raportit të analizave.

Benzina (Çmimi  $519+30=549$ \$/ton  $\times 0.7451 = (409 \times 119.49)/1000 = 48.87$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (7.69%) 8.79 lek/litri çmimi del 123.16 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (24.63 lekë) në total çmimi del 147.79 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 2 qershor 2017 sipas kushtit CIF-Shqipëri gjithashtu si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar sipas faturës tatimore prej 263,004 lekë për sasinë e benzinës prej 1680 litra benzinë është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 147.79 lekë/litri që është 248,287 lekë duke sjellë një pagesë tepër për benzinën prej 14.717 lekë.

Kjo vlerë në total prej **14,717** lekë si pagesë e tepërt për benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti "A&T" sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5.

#### **f. Kontrata nr. 1194/2, datë 15.03.2018 për furnizimin me karburant "benzinë" për nevojat e Bashkisë 2018. Lidhur me subjektin "O." sh.p.k. në vlerën 2,456,300 lekë me marzh fitimi 8.8%, me afat deri 31.12.2018.**

1- Me Urdhër shpenzimit nr. 615, datë 05.07.2018 është likuiduar vlera prej 74,448 lekë me tvsh. (Kontrata 1194/2 datë 15.03.2018)

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 50, datë 26.04.2018 për benzinë 470.82 litra me vlerën prej 74,448 lekë, lëshuar nga subjekti "O." sh.p.k. fletë hyrjen nr. 27, datë 26.04.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të datë 19.01.2018.

Llogaritja e çmimit të benzinës është bërë për datën 10.04.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 19.01.2018 sipas raportit të analizave.

Benzina (Çmimi  $654+30=684$ \$/ton  $\times 0.7498 = (512.8 \times 109.11)/1000 = 55.95$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (8.8%) 8.79 lekë/litri çmimi del 132.13 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (26.42 lekë) në total çmimi del 158.55 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 19 janar 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri gjithashtu si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

**2-** Me Urdhër shpenzimin nr. 727, datë 01.08.2018 është likuiduar vlera prej 165,388 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 36, datë 28.05.2018 për benzinë 969.77 litra me vlerën prej 165.388 lekë, lëshuar nga subjekti “O.” sh.p.k. fletë hyrjen nr. 35, datë 28.05.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të datë 19.01.2018.

Llogaritja e çmimit të benzinës është bërë për datën 22.05.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 19.01.2018 sipas raportit të analizave.

Benzina (Çmimi  $654+30=684\$/\text{ton} \times 0.7498 = (512.8 \times 109.11)/1000 = 55.95$  lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (8.8%) 8.79 lekë/litri çmimi del 132.13 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (26.42 lekë) në total çmimi del 158.55 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 19 janar 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri gjithashtu si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar sipas faturës tatimore prej 165,388 lekë për sasinë e benzinës prej 1969.77 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 158.55 lekë/litri që është 153,757 lekë duke sjellë një pagesë tepër për benzinën prej **11,631** lekë.

Kjo vlerë në total prej 11,631 lekë si pagesë e tepërt për benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “O.” sh.p.k.. pasi është përfitur në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

**3-** Me Urdhër shpenzimin nr. 733, datë 02.08.2018 është likuiduar vlera prej 192,919 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 25, datë 06.06.2018 për benzinë 1167 litra me vlerën prej 192,919 lekë, lëshuar nga subjekti “O.” sh.p.k. fletë hyrjen nr. 40, datë 06.06.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të datë 19.01.2018.

Llogaritja e çmimit të benzinës është bërë për datën 22.05.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 19.01.2018 sipas raportit të analizave.

Benzina (Çmimi  $654+30=684\$/\text{ton} \times 0.7498 = (512.8 \times 109.11)/1000 = 55.95$  lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (8.8%) 8.79 lekë/litri çmimi del 132.13 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (26.42 lekë) në total çmimi del 158.55 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 19 janar 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar sipas faturës tatimore prej 192,919 lekë për sasinë e benzinës prej 1167 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 158.55 lekë/litri që është 185,027 lekë duke sjellë një pagesë tepër për benzinën prej 7,892 lekë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

Kjo vlerë në total prej **7,892** lekë si pagesë e tepërt për benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti "O." sh.p.k.. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 77, pika 5.

**4-** Me Urdhër shpenzimin nr. 745, datë 03.08.2018 është likuiduar vlera prej 272,919 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 25, datë 04.07.2018 për benzinë 1666.54 litra me vlerën prej 272,919 lekë, lëshuar nga subjekti "O." sh.p.k. fletë hyrjen nr. 55, datë 04.07.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori.

Llogaritja e çmimit të benzinës është bërë për datën 22.05.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 19.01.2018 sipas raportit të analizave të datës 19.01.2018.

Benzina (Çmimi  $654+30=684$ \$/ton  $\times 0.7498 = (512.8 \times 109.11)/1000 = 55.95$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (8.8%) 8.79 lek/litri çmimi del 132.13 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (26.42 lekë) në total çmimi del 158.55 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 19 janar 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar sipas faturës tatimore prej 272,919 lekë për sasinë e benzinës prej 1666.54 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 158.55 lekë/litri që është 264,229 lekë duke sjellë një pagesë tepër për benzinën prej **8,690** lekë.

Kjo vlerë në total prej **8,690** lekë si pagesë e tepërt për benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti "O." sh.p.k.. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 77, pika 5.

**5-** Me Urdhër shpenzimin nr. 980, datë 04.10.2018 është likuiduar vlera prej 272,765 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 01, datë 02.08.2018 për benzinë 1650 litra me vlerën prej 272,765 lekë, lëshuar nga subjekti "O." sh.p.k. fletë hyrjen nr. 66, datë 02.08.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori.

Llogaritja e çmimit të benzinës është bërë për datën 24.07.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24.07.2018 sipas raportit të analizave të datës 25.07.2018.

Benzina (Çmimi  $725+30=755$ \$/ton  $\times 0.7543 = (569.4 \times 107.55)/1000 = 63.23$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (8.8%) 11.32 lek/litri çmimi del 140.05 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (28.01 lekë) në total çmimi del 168.06 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24 korrik 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 77, pika 5.

**6-** Me Urdhër shpenzimin nr. 981, datë 04.10.2018 është likuiduar vlera prej 272,937 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 14, datë 14.09.2018 për benzinë 1666.54 litra me vlerën prej 272,937 lekë, lëshuar nga subjekti "O." sh.p.k. fletë hyrjen nr. 75, datë 14.09.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori.

Llogaritja e çmimit të benzinës është bërë për datën 31.08.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24.07.2018 sipas raportit të analizave të datës 24.07.2018.

Benzina (Çmimi  $725+30=755$ \$/ton  $\times 0.7543 = (569.4 \times 107.55)/1000 = 63.23$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (8.8%) 11.32 lekë/litri çmimi del 140.05 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (28.01 lekë) në total çmimi del 168.06 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24 korrik 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

**7-** Me Urdhër shpenzimin nr. 1019, datë 16.10.2018 është likuiduar vlera prej 385,466 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 39, datë 26.09.2018 për benzinë 2350 litra me vlerën prej 385,465 lekë, lëshuar nga subjekti “O.” sh.p.k. fletë hyrjen nr. 81, datë 26.09.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori.

Llogaritja e çmimit të benzinës është bërë për datën 10.09.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24.07.2018 sipas raportit të analizave të datës 24.07.2018.

Benzina (Çmimi  $725+30=755$ \$/ton  $\times 0.7543 = (569.4 \times 107.55)/1000 = 63.23$  lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (8.8%) 11.32 lekë/litri çmimi del 140.05 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (28.01 lekë) në total çmimi del 168.06 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24 korrik 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

**8-** Me Urdhër shpenzimin nr. 1274, datë 27.12.2018 është likuiduar vlera prej 272,883 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 3261596365, datë 01.11.2018 për benzinë 1678 litra me vlerën prej 272,883 lekë, lëshuar nga subjekti “O.” sh.p.k. fletë hyrjen nr. 106, datë 01.11.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori.

Llogaritja e çmimit të benzinës është bërë për datën 23.10.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24.07.2018 sipas raportit të analizave të datës 24.07.2018.

Benzina (Çmimi  $725+30=755$ \$/ton  $\times 0.7543 = (569.4 \times 107.55)/1000 = 63.23$  lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (8.8%) 11.32 lekë/litri çmimi del 140.05 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (28.01 lekë) në total çmimi del 168.06 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24 korrik 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

**9-** Me Urdhër shpenzimin nr. 1275, datë 27.12.2018 është likuiduar vlera prej 272,786 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 23, datë 09.10.2018 për benzinë 1589 litra me vlerën prej 272,786 lekë, lëshuar nga subjekti “O.” sh.p.k. fletë hyrjen nr. 92, datë 09.10.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori.

Llogaritja e çmimit të benzinës është bërë për datën 03.10.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24.07.2018 sipas raportit të analizave të datës 24.07.2018.

Benzina (Çmimi  $725+30=755$ \$/ton  $\times 0.7543 = (569.4 \times 107.55)/1000 = 63.23$  lekë/litri.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (8.8%) 11.32 lekë/litri çmimi del 140.05 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (28.01 lekë) në total çmimi del 168.06 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24 korrik 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar sipas faturës tatimore prej 272,786 lekë për sasinë e benzinës prej 1589 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 168.06 lekë/litri që është 267,047 lekë duke sjellë një pagesë tepër për benzinën prej **5,739** lekë.

Kjo vlerë në total prej 5,739 lekë si pagesë e tepërt për benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti "O." sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5.

**10-** Me Urdhër shpenzimin nr. 116, datë 07.02.2019 është likuiduar vlera prej 272,923 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 291596398, datë 26.11.2018 për gazoil 82332 litra me vlerën prej 13,259,733 lekë, benzinë për 1816 litra në vlerën 272,923, lekë lëshuar nga subjekti "O." sh.p.k. fletë hyrjen nr. 122, datë 26.11.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit.

Llogaritja e çmimit të benzinës nga subjekti është bërë për datën 20.11.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit është kryer mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS.

benzina (Çmimi  $556+30=586$ \$/ton  $\times 0.7447 = (436.3 \times 108.92)/1000 = 47.52$  lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (8.8%) 9.9 lekë/litri çmimi del 122.92 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (24.58 lekë) në total çmimi del 147.40 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 20 nëntor 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 272,923 lekë për sasinë e gazoilit prej benzinës 1816 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 147.40 lekë/litri që është 267,678 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej 5,245 lekë.

Kjo vlerë në total prej **5,245** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti "O." sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5.

**g. Kontrata nr. 3415/1, datë 04.06.2018 për furnizimin me karburant "gazoil" 10 ppm për nevojat e Bashkisë 2018. Lidhur me subjektin "O." sh.p.k. në vlerën 33,558,963 lekë me marzh fitimi 5.7%, me afat deri 31.12.2018**

**1-** Me Urdhër shpenzimin nr. 734, datë 02.08.2018 është likuiduar vlera prej 5,835,608 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 25, datë 06.06.2018 për gazoil 35178 litra me vlerën prej 5,835,608 lekë, lëshuar nga subjekti "O." sh.p.k. fletë hyrjen nr. 40, datë 06.06.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të datë 21.03.2018.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 25.05.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 21.03.2018 sipas raportit të analizave.

Gazoili (Çmimi  $617+30=647$ \$/ton  $\times 0.8346 = (539.9 \times 105.05)/1000 = 56.71$  lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (5.7%) 7 lek/litri çmimi del 130.71 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (26.14 lekë) në total çmimi del 156.85 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 21 mars 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar sipas faturës tatimore prej 5,835,608 lekë për sasinë e gazoilit prej 135178 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 156.85 lekë/litri që është 5,517,669 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej 317,669 lekë.

Kjo vlerë në total prej **317,669** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti "O." sh.p.k.. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 77, pika 5.

**2-** Me Urdhër shpenzimin nr. 1018, datë 16.10.2018 është likuiduar vlera prej 5,557,869 lekë me tvsh. (diferenca e vlerës 277,627 lekë është likuiduar me Urdhër shpenzimin nr. 1273, datë 27.12.2018)

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 1, datë 02.08.2018 për gazoil 35475 litra me vlerën prej 5,835,496 lekë, lëshuar nga subjekti "O." sh.p.k. fletë hyrjen nr. 66, datë 02.08.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të datë 24.07.2018.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 24.07.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24.07.2018 sipas raportit të analizave.

Gazoili (Çmimi  $667+30=697$ \$/ton  $\times 0.8431 = (587.6 \times 107.55)/1000 = 63.19$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (5.7%) 7.42 lek/litri çmimi del 137.61 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (27.52 lekë) në total çmimi del 165.13 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24 korrik 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 77, pika 5.

**3-** Me Urdhër shpenzimin nr. 1276, datë 27.12.2018 është likuiduar vlera prej 5,878,076 lekë me tvsh. (diferenca e vlerës 2,750,000 lekë është likuiduar me USHP 115 datë 07.02.2019 për 2,750,000)

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 23, datë 09.10.2018 për gazoil 49002 litra me vlerën prej 8,628,076 lekë, lëshuar nga subjekti "O." sh.p.k. fletë hyrjen nr. 92, datë 09.10.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të datë 24.07.2018.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 24.07.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24.07.2018 sipas raportit të analizave.

Gazoili (Çmimi  $667+30=697$ \$/ton  $\times 0.8431 = (587.6 \times 107.55)/1000 = 63.19$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (5.7%) 7.42 lek/litri çmimi del 137.61 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (27.52 lekë) në total çmimi del 165.13 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24 korrik 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 8,628,075 lekë për sasinë e gazoilit prej 49002 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 165.13 lekë/litri që është 8,091,700 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej 536,376 lekë.





## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

Kjo vlerë në total prej **536,376** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti "O." sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5.

**4-** Me Urdhër shpenzimit nr. 117, datë 07.02.2019 është likuiduar vlera prej 13,259,733 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 291596398, datë 26.11.2018 për gazoil 82332 litra me vlerën prej 13,259,733 lekë, benzinë për 1816 litra në vlerën 272,923, lekë lëshuar nga subjekti "O." sh.p.k. fletë hyrjen nr. 122, datë 26.11.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit.

Llogaritja e çmimit të gazoilit nga subjekti është bërë për datën 20.11.2018 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit është kryer mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS.

Gazoili (Çmimi  $626+30=656$ \$/ton  $\times 0.8339 = (547 \times 108.92)/1000 = 59.57$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (5.7%) 7.21 lek/litri çmimi del 133.78 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (26.75 lekë) në total çmimi del 160.53 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 20 nëntor 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 13,259,733 lekë për sasinë e gazoilit prej 82332 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 160.53 lekë/litri që është 13,216,756 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **42,977** lekë. Kjo vlerë në total prej 42,977 lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti "O." sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5.

#### **h. Kontrata nr. 1873/2, datë 12.03.2019 për furnizimin me karburant "benzinë" me marzh fitimi 5% dhe "naftë" me marzh fitimi 2.5% për nevojat e Bashkisë deri 31.08.2019. Lidhur me subjektin "A.C" sh.p.k.**

**1-** Me Urdhër shpenzimit nr. 455, datë 23.04.2019 është likuiduar vlera prej 882,300 lekë me tvsh. Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 127, datë 15.03.2019 për gazoil 2770 litra me vlerën prej 436,800 lekë, lëshuar nga subjekti "A.C" sh.p.k. fletë hyrjen nr. 14, datë 15.03.2019 dhe faturën tatimore nr. 128, datë 15.03.2019 për benzinë 3043 litra me vlerën prej 445,500 lekë, fletë hyrjen nr. 15, datë 15.03.2019 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të datë 11.12.2018.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 28.02.2019 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06.12.2018 sipas raportit të analizave.

Gazoili (Çmimi  $555+30=588$ \$/ton  $\times 0.8304 = (488.27 \times 109.37)/1000 = 53.40$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (2.5%) 3.01 lek/litri çmimi del 123.41 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (24.68 lekë) në total çmimi del 148.09 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06 dhjetor 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 436,800 lekë për sasinë e gazoilit prej 2770 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 148.09 lekë/litri që është 410,209 lekë duke sjellë një pagesë tepër për

gazoilin prej **26,591** lekë. Kjo vlerë në total prej 26,591 lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti "A.C" sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5.

Llogaritja e çmimit të benzinës është bërë për datën 28.02.2019 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06.12.2018 sipas raportit të analizave.

Benzina (Çmimi  $509+30=539$ \$/ton  $\times 0.7422 = (400 \times 109.37)/1000 = 43.74$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (5%) 5.51 lek/litri çmimi del 115.75 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (22.55 lekë) në total çmimi del 138.3 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06 dhjetor 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri gjithashtu si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefata e likuiduar sipas faturës tatimore prej 445,500 lekë për sasinë e benzinës prej 3043 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 138.30 lekë/litri që është 420,846 lekë duke sjellë një pagesë tepër për benzinën prej 24,654 lekë.

Kjo vlerë në total prej **24,654** lekë si pagesë e tepërt për benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti "A.C" sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5.

**2-** Me Urdhër shpenzimin nr. 788, datë 01.07.2019 është likuiduar vlera prej 723,105 lekë me tvsh. Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 366, datë 01.06.2019 për gazoil 4500 litra me vlerën prej 723,105 lekë, lëshuar nga subjekti "A.C" sh.p.k. fletë hyrjen nr. 38, datë 03.06.2019 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e pa shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 16.05.2019 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06.12.2018 sipas raportit të analizave.

Gazoili (Çmimi  $555+30=588$ \$/ton  $\times 0.8304 = (488.27 \times 109.37)/1000 = 53.40$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (2.5%) 3.01 lek/litri çmimi del 123.41 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (24.68 lekë) në total çmimi del 148.09 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06 dhjetor 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 723,105 lekë për sasinë e gazoilit prej 4500 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 148.09 lekë/litri që është 666,405 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej 56,700 lekë. Kjo vlerë në total prej **56,700** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti "A.C" sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5.

**3-** Me Urdhër shpenzimin nr. 931, datë 08.08.2019 është likuiduar vlera prej 685,098 lekë me tvsh. Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 485, datë 12.07.2019 për gazoil 4500 litra me vlerën prej 685,098 lekë, lëshuar nga subjekti "A.C" sh.p.k. fletë hyrjen nr. 52, datë 12.07.2019 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e pa shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 28.06.2019 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06.12.2018 sipas raportit të analizave.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

Gazoili (Çmimi  $555+30=588$ \$/ton  $\times 0.8304 = (488.27 \times 109.37)/1000 = 53.40$  lekë/litri. Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (2.5%) 3.01 lekë/litri çmimi del 123.41 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (24.68 lekë) në total çmimi del 148.09 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06 dhjetor 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefte e sipas faturës tatimore prej 685,098 lekë për sasinë e gazoilit prej 4500 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 148.09 lekë/litri që është 666,405 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **18,693** lekë. Kjo vlerë në total prej 18,693 lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti "A.C" sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 77, pika 5.

**4-** Me Urdhër shpenzimin nr. 1068, datë 12.09.2019 është likuiduar vlera prej 685,044 lekë me tvsh. Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 579, datë 13.08.2019 për gazoil 4500 litra me vlerën prej 685,044 lekë, lëshuar nga subjekti "A.C" sh.p.k. fletë hyrjen nr. 60, datë 13.08.2019 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori *e pa shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit.*

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 01.08.2019 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06.12.2018 sipas raportit të analizave.

Gazoili (Çmimi  $555+30=588$ \$/ton  $\times 0.8304 = (488.27 \times 109.37)/1000 = 53.40$  lekë/litri. Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (2.5%) 3.01 lekë/litri çmimi del 123.41 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (24.68 lekë) në total çmimi del 148.09 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06 dhjetor 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefte e sipas faturës tatimore prej 685,044 lekë për sasinë e gazoilit prej 4500 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 148.09 lekë/litri që është 666,405 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej 18,639 lekë. Kjo vlerë në total prej **18,639** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti "A.C" sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 77, pika 5.

**5-** Me Urdhër shpenzimin nr. 1209, datë 15.10.2019 është likuiduar vlera prej 693,684 lekë me tvsh. Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 643, datë 19.09.2019 për gazoil 4500 litra me vlerën prej 693,684 lekë, lëshuar nga subjekti "A.C" sh.p.k. fletë hyrjen nr. 71, datë 19.09.2019 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori *e pa shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit.*

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 10.09.2019 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06.12.2018 sipas raportit të analizave.

Gazoili (Çmimi  $555+30=588$ \$/ton  $\times 0.8304 = (488.27 \times 109.37)/1000 = 53.40$  lekë/litri. Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (2.5%) 3.01 lekë/litri çmimi del 123.41 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (24.68 lekë) në total çmimi del 148.09 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06 dhjetor 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefte e sipas faturës tatimore

prej 693,684 lekë për sasinë e gazoilit prej 4500 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 148.09 lekë/litri që është 666,405 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **27,279 lekë**. Kjo vlerë në total prej 27,279 lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti "A.C" sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5.

**6-** Me Urdhër shpenzimin nr. 1423, datë 25.11.2019 është likuiduar vlera prej 573,069 lekë me tvsh. Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 711, datë 22.10.2019 për gazoil 3705 litra me vlerën prej 573,069 lekë, lëshuar nga subjekti "A.C" sh.p.k. fletë hyrjen nr. 77, datë 22.10.2019 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit datën 06.12.2018.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 11.10.2019 referuar buletinit të APP. Përlllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06.12.2018 sipas raportit të analizave.

Gazoili (Çmimi  $555+30=588\$/\text{ton} \times 0.8304 = (488.27 \times 109.37)/1000 = 53.40$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (2.5%) 3.01 lek/litri çmimi del 123.41 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (24.68 lekë) në total çmimi del 148.09 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06 dhjetor 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 573,069 lekë për sasinë e gazoilit prej 3705 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 148.09 lekë/litri që është 548,673 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej 24,396 lekë. Kjo vlerë në total prej **24,396** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti "A.C" sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5.

**7-** Me Urdhër shpenzimin nr. 1424, datë 25.11.2019 është likuiduar vlera prej 73,495 lekë me tvsh. Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 712, datë 22.10.2019 për benzinë 500 litra me vlerën prej 73,495 lekë, lëshuar nga subjekti "A.C" sh.p.k. fletë hyrjen nr. 78, datë 22.10.2019 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit datën 06.12.2018.

Llogaritja e çmimit të benzinës është bërë për datën 11.10.2019 referuar buletinit të APP. Përlllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06.12.2018 sipas raportit të analizave.

Benzina (Çmimi  $509+30=539\$/\text{ton} \times 0.7422 = (400 \times 109.37)/1000 = 43.74$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (5%) 5.46 lek/litri çmimi del 114.70 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (22.94 lekë) në total çmimi del 137.64 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 06 dhjetor 2018 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 73,495 lekë për sasinë e benzinës prej 500 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 137.64 lekë/litri që është 68,820 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **4,675 lekë**. Kjo vlerë në total prej 4,675 lekë si pagesë e tepërt për benzinën e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti "A.C" sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77, pika 5.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

8- Me Urdhër shpenzimin nr. 1519, datë 12.12.2019 është likuiduar vlera prej 67,212 lekë me tvsh. Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 772, datë 14.11.2019 për benzinë 450 litra me vlerën prej 67,212 lekë, lëshuar nga subjekti “A.C” sh.p.k. fletë hyrjen nr. 82, datë 14.11.2019 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit datën 20.02.2019.

Llogaritja e çmimit të benzinës është bërë për datën 04.11.2019 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 20.02.2019 sipas raportit të analizave.

Benzina (Çmimi  $581+30=611$ \$/ton  $\times 0.7365 = (450 \times 109.71)/1000 = 49.36$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (5%) 5.74 lek/litri çmimi del 120.60 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (24.12 lekë) në total çmimi del 144.72 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 20 shkurt 2019 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 67,212 lekë për sasinë e benzinës prej 450 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 144.72 lekë/litri që është 65,124 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej 2,088lekë.

Kjo vlerë në total prej **2,088** lekë si pagesë e tepërt për benzinën e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti “A.C” sh.p.k. pasi është përfitur në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

**i. Kontrata nr. 1054/2, datë 07.11.2019 për furnizimin me karburant “gazoil” me marzh fitimi 2.5% për nevojat e Bashkisë 2019. Lidhur me subjektin “A.C” sh.p.k. në vlerën 2,480.520 lekë me afat deri 31.12.2019.**

1- Me Urdhër shpenzimin nr. 1520, datë 22.12.2019 është likuiduar vlera prej 893,160 lekë me tvsh. Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 773, datë 14.11.2019 për gazoil 5790 litra me vlerën prej 893,160 lekë, lëshuar nga subjekti “A.C” sh.p.k. fletë hyrjen nr. 85, datë 14.11.2019 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit datën 08.11.2018.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 10.12.2019 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 08.11.2019 sipas raportit të analizave.

Gazoili (Çmimi  $582+30=612$ \$/ton  $\times 0.8302 = (508 \times 111.42)/1000 = 56.60$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (2.5%) 3.09 lek/litri çmimi del 126.69 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (25.33 lekë) në total çmimi del 152.02 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 08 nëntor 2019 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 893,160 lekë për sasinë e gazoilit prej 5790 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 152.02 lekë/litri që është 880,195 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej 12,965 lekë.

Kjo vlerë në total prej **12,965** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti “A.C” sh.p.k. pasi është përfitur në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

**j. Kontrata nr. 10354/2, datë 07.11.2019 për furnizimin me karburant “naftë” me marzh fitimi 2.5% për nevojat e Bashkisë 2019. Lidhur me subjektin “A.C” sh.p.k. me afat deri 31.12.2019.**

1- Me Urdhër shpenzimin nr. 1586, datë 24.12.2019 është likuiduar vlera prej 893,160 lekë me tvsh. Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 844, datë 12.12.2019 për gazoil 5792 litra me vlerën prej 893,160 lekë, lëshuar nga subjekti “A.C” sh.p.k. fletë hyrjen nr. 105, datë 12.12.2019 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit datën 08.11.2018.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 14.11.2019 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 08.11.2019 sipas raportit të analizave.

Gazoili (Çmimi  $582+30=612\$/\text{ton} \times 0.8302 = (508 \times 111.42)/1000 = 56.60$  lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (2.5%) 3.09 lekë/litri çmimi del 126.69 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (25.33 lekë) në total çmimi del 152.02 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 08 nëntor 2019 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 893,160 lekë për sasinë e gazoilit prej 5792 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 152.02 lekë/litri që është 880,499 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **12,661** lekë. Kjo vlerë në total prej 12,661 lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti “A.C” sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

**k. Kontrata nr. 9178/2, datë 10.10.2019 për furnizimin me karburant “benzinë” me marzh fitimi 5% për nevojat e Bashkisë 2019. Lidhur me subjektin “A.C” sh.p.k. me afat deri 31.12.2019.**

1- Me Urdhër shpenzimin nr. 1585, datë 24.12.2019 është likuiduar vlera prej 98,543 lekë me tvsh. Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 843, datë 12.12.2019 për benzinë 651 litra me vlerën prej 98,543 lekë, lëshuar nga subjekti “A.C” sh.p.k. fletë hyrjen nr. 104, datë 12.12.2019 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit datën 08.11.2019.

Llogaritja e çmimit të benzines është bërë për datën 26.11.2019 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 08.11.2019 sipas raportit të analizave.

Benzina (Çmimi  $602+30=632\$/\text{ton} \times 0.7527 = (475.7 \times 111.42)/1000 = 53$  lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (5%) 5.9 lekë/litri çmimi del 124.4 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (24.88 lekë) në total çmimi del 149.28 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 08 nëntor 2019 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 98,543 lekë për sasinë e benzines prej 651 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 149.28 lekë/litri që është 97,181 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **1,362** lekë. Kjo vlerë në total prej 1,362 lekë si pagesë e tepërt për benzinën e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti “A.C” sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

**l. Kontrata nr. 750/2, datë 28.01.2020 për furnizimin me karburant “benzinë” me marzh fitimi 5% dhe naftë me marzh fitimi 2.5% për nevojat e Bashkisë 2020. Lidhur me subjektin “A.C” sh.p.k. me afat deri 28.01.2020.**

1- Me Urdhër shpenzimit nr. 165, datë 20.02.2020 është likuiduar vlera prej 1,655,697 lekë me tvsh. Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 49, datë 05.02.2010 për benzinë 1719 litra me vlerën prej 255,704 lekë, lëshuar nga subjekti “A.C” sh.p.k. fletë hyrjen nr. 04, datë 05.02.2020 me faturën tatimore nr. 48, datë 05.02.2010 për gazoil 9305 litra me vlerën prej 1,399,993 lekë, lëshuar nga subjekti “A.C” sh.p.k. fletë hyrjen nr. 03, datë 05.02.2020 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit datën 08.11.2019.

Llogaritja e çmimit të benzinës është bërë për datën 21.01.2020 referuar buletinit të APP. Përllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 08.11.2019 sipas raportit të analizave.

Benzina (Çmimi  $602+30=632\$/\text{ton} \times 0.7527 = (475.7 \times 111.42)/1000 = 53$  lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (5%) 5.9 lekë/litri çmimi del 124.4 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (24.88 lekë) në total çmimi del 149.28 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 08 nëntor 2019 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 255,704 lekë për sasinë e benzinës prej 1719 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 149.28 lekë/litri që është 256,612 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **908** lekë. Kjo vlerë në total prej 908 lekë si pagesë e tepërt për benzinën e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti “A.C” sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 21.01.2020 referuar buletinit të APP.

Gazoili (Çmimi  $575+30=605\$/\text{ton} \times 0.8302 = (502.27 \times 109.96)/1000 = 55.22$  lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (2.5%) 3 lekë/litri çmimi del 125.22 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (25.26 lekë) në total çmimi del 150.26 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 21 janar 2020 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 1,399,993 lekë për sasinë e gazoilit prej 9305 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 150.26 lekë/litri që është 1,398,169 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **1,824** lekë.

Kjo vlerë në total prej 1,824 lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti “A.C” sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

**m. Kontrata 2282/3 dt 11.03.2020 për vlerën 8,512,00 lekë “M.O” sh.p.k. me marzhin e fitimit 2.35%.**

1- Me Urdhër shpenzimit nr. 714, datë 08.07.2020 është likuiduar vlera prej 1,723,184 lekë me tvsh. Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 218, datë 19.03.2020 për gazoil 12141 litra me vlerën prej 1,723,184 lekë, lëshuar nga subjekti “M.O” sh.p.k. fletë hyrjen nr. 12, datë 19.03.2020 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit datën 09.03.2020.

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 04.03.2020 referuar buletinit të APP. Përlllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 09.03.2020 sipas raportit të analizave.

Gazoili (Çmimi  $364+30=394$ /ton  $\times 0.8440 = (332.53 \times 107.73)/1000 = 35.82$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (2.35%) 2.34 lek/litri çmimi del 102.16 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (20.49 lekë) në total çmimi del 122.59 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 09 mars 2020 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 1,723,184 lekë për sasinë e gazoilit prej 12141 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 122.59 lekë/litri që është 1,488,365 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej 234,819 lekë. Kjo vlerë në total prej **234,819** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti “M.O” sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

2- Me Urdhër shpenzimin nr. 1005, datë 14.09.2020 është likuiduar vlera prej 1,990,530 lekë me tvsh. Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 374, datë 13.07.2020 për gazoil 15300 litra me vlerën prej 1,990,530 lekë, lëshuar nga subjekti “M.O” sh.p.k. fletë hyrjen nr. 38, datë 14.07.2020 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit datën 09.03.2020.

Llogaritja e çmimit të benzinës është bërë për datën 06.07.2020 referuar buletinit të APP. Përlllogaritja e çmimit duhet të kryhet mbështetur çmimit referuar bursës REUTERS për datën 09.03.2020 sipas raportit të analizave.

Gazoili (Çmimi  $364+30=394$ /ton  $\times 0.8440 = (332.53 \times 107.73)/1000 = 35.82$  lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit (2.35%) 2.34 lek/litri çmimi del 102.16 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (20.49 lekë) në total çmimi del 122.59 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 09 mars 2020 sipas kushtit CIF-Shqipëri si rrjedhojë edhe vlefata e sipas faturës tatimore prej 1,990,530 lekë për sasinë e gazoilit prej 15300 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 122.59 lekë/litri që është 1,875,627 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej 114,903 lekë. Kjo vlerë në total prej **114,903** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin e faturuar duhet të arkëtohet nga subjekti “M.O” sh.p.k. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

Në zbatim të kontratave janë kryer pagesa të tepërta për gazoilin dhe benzinën e likuiduar në vlerën **1,935,119** lekë me tvsh e cila duhet të arkëtohet nga subjektet “J.D” sh.p.k.. në vlerën 269,746 lekë, “A.C” sh.p.k. në vlerën 131,280 lekë, “A&T” sh.a.. në vlerën 14,717 lekë, “O.” sh.p.k. në vlerën 233,435 lekë, “M.O”sh.p.k. në vlerën 349,722 lekë pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5. Përlllogaritja e çmimit të benzinës dhe gazoilit është bërë jo në përputhje me ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat Kombëtare”, të ndryshuar, pasi është shtuar dhe taksa e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës sipas VKM nr. 498, datë 30.05.2013.

Sa më lart kontratat janë hartuar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 31 “Kriteret për vlerësimin e ofertës”;





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

3. Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në:

a) çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletinin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

b) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;

c) marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje.

- Autoriteti kontraktor Bashkia Korçë në procedurat e prokurimit me objekt “Blerje karburanti” pavarësisht faktit se ky objekt prokurimi përfshin disa tipe primare karburantesh, si benzinë, diezel, etj. rezulton që autoriteti kontraktor zhvillon vetëm një procedurë prokurimi për të dy llojet e karburantit.

Në këto kushte konstatohet se operatorët ekonomik kanë ofertuar me marzhe fitimi të ndryshme për secilin prej tipeve të karburantit duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 63 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se “operatori ekonomik duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve ku kërkohet oferta alternative”.

Në këto raste autoriteti kontraktor për prokurimin me objekt “Blerje karburanti” të zhvillojnë një procedurë prokurimi të ndarë në lote dhe në këtë mënyrë operatorët ekonomikë do të kenë mundësi të ofertojnë për lotin përkatës, ku janë të interesuar të marrin pjesë. (Rekomandim APP nr. 5332, datë 17.05.2018)

- Gjithashtu sipas ekstraktit të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjekteve të mësipërme “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” objekti i aktivitetit të tyre është . tregti me pakicë të karburanteve . transport karburanti e mallrash etj

Kur objekti i aktivitetit duhej të ishte “ . import-eksport dhe tregti me shumicë e naftës, gazit, nënprodukteve të tyre, vajrave lubrifikantë, transporti kombëtar e ndërkombëtar i tyre...” të cilën e kanë vetëm shoqëritë aksionere .

Sipas VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto” pika 1. “Veprimtaria e tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj bëhet vetëm nga shoqëritë tregtare, të themeluara në formën e shoqërive aksionare, .....”

-Konstatohet se për zbatimin e kontratave me subjektet nga autoriteti kontraktor janë ngritur komisioni për marrjen në dorëzim dhe ka procesverbal të “marrjes e materialeve në dorëzim të mallit sipas kontratës” ku komisioni nuk shprehen për cilësinë dhe plotësimin e specifikimeve teknike të shoqëruara me raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Gjithashtu është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42 “Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqëruar”, pika 54 “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka bashkëlidhur dokumentacioni justifikues që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës .”.

#### Titulli i gjetjes:

Autoriteti kontraktor për llogaritjen e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletinet e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.

#### Situata1:

- Autoriteti kontraktor Bashkia Korçë në procedurat e prokurimit me objekt “Blerje karburanti” pavarësisht faktit se ky objekt prokurimi përfshin disa tipe

primare karburantesh, si benzinë, diezel, etj. rezulton që autoriteti kontraktor zhvillon vetëm një procedurë prokurimi për të dy llojet e karburantit.

Në këto kushte konstatohet se operatorët ekonomikë kanë ofertuar me marzhe fitimi të ndryshme për secilin prej tipeve të karburantit duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 63 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se “operatori ekonomik duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve ku kërkohet oferta alternative”*.

- Kontratat për blerjen e karburantit janë hartuar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, Neni 31 *“Kriteret për vlerësimin e ofertës”*; 3. Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në:

a) çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletinin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

b) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;

c) marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje.

#### Situata 2:

- Gjithashtu sipas ekstraktit të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjekteve kontraktuese *“shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”* objekti i aktivitetit të tyre është . tregti me pakicë të karburanteve . transport karburanti e mallrash etj, kur objekti i aktivitetit duhej të ishte *“ . import-eksport dhe tregti me shumicë e naftës, gazit, nënprodukteve të tyre, vajrave lubrifikantë, transporti kombëtar e ndërkombëtar i tyre...”* të cilën e kanë vetëm shoqëritë aksionere. Sipas VKM nr. 970, datë 02.12.2015 *“Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto”* pika 1. *“Veprimtaria e tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj bëhet vetëm nga shoqëritë tregtare, të themeluara në formën e shoqërive aksionare.”*

Autoriteti kontraktor për llogaritjen e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletinet e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment, sipas raporteve të analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e importuar, gjithashtu janë shtuar elementë fiskalë si *“taksa e markimit”* jo në përputhje me ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, *“Për taksat Kombëtare”*, të ndryshuar, pasi është shtuar dhe taksa e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës sipas VKM nr. 498, datë 30.05.2013 dhe në kundërshtime me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, neni 77, pika 5, *“Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”*. Pika 6 *“Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në*

#### Situata 3:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

|                        |   |
|------------------------|---|
| <b>Situata 4:</b>      | <p><i>momentin e shitjes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”.</i></p> <p>Nga auditimi i zbatimit të kontratave të blerjes së karburantit rezultoi se në likuidimin e sasisë së karburantit gazoil dhe benzol nga Bashkia Korçë, nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën e furniturës <i>lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment</i>, gjithashtu si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit, si rrjedhojë janë kryer pagesa të tepërta për gazoilin dhe benzolin e likuiduar në vlerën <b>1,935,119</b> lekë me tvsh cila duhet të arkëtohet nga subjektet “J.D” sh.p.k.. në vlerën 269,746 lekë, “A.C” sh.p.k. në vlerën 364,715 lekë, “A&amp;T” sh.a.. në vlerën 14,717 lekë, “O.” sh.p.k. në vlerën 936,219 lekë, “M.O”sh.p.k. në vlerën 349,722 lekë me t.v.sh. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “<i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i>”, neni 77, pika 5.</p> <p>-Konstatohet se për zbatimin e kontratave me subjektet nga autoriteti kontraktor janë ngritur komisionet për marrjen në dorëzim dhe ka procesverbal të “<i>marrjes e materialeve në dorëzim të mallit sipas kontratës</i>” por komisionet nuk shprehen për cilësinë dhe plotësimin e specifikimeve teknike të shoqëruara me raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial duke vepruar në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “<i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i>”, pika 42 “<i>Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësimin e tyre dhe të dokumentacionit shoqëruar</i>”, pika 54 “<i>Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka bashkëlidhur dokumentacioni justifikues që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës .”.</i></p> |
| <b>Situata 5:</b>      |   |
| <b>Kriteri:</b>        | <p>VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “<i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i>”, dhe Dokumentet Standarde të Tenderit, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “<i>Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto</i>” ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “<i>Për taksat Kombëtare</i>”, të ndryshuar, pasi është shtuar dhe taksa e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës sipas VKM nr. 498, datë 30.05.2013.</p>  |
| <b>Ndikimi/Efekti:</b> | <p>Si rezultat i mos respektimit të çmimi të miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën e furniturës <i>lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment</i>, dhe përfshirja si element i çmimit markimi i karburantit kanë sjellë kryerjen e pagesave të tepërta për gazoilin dhe benzolin e likuiduar në vlerën <b>1,935,119</b> lekë me tvsh.</p>  |
| <b>Shkaku:</b>         | <p>Mos respektimi i çmimit të miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën e furniturës <i>lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment</i>, dhe përfshirja si element i çmimit markimi i karburantit.</p>  |
| <b>Rëndësia:</b>       | <p>I lartë.</p> <p>- Autoriteti Kontraktor Bashkia Korçë, në hartimin e kontratave të furnizimit me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje të marrin parasysh kriteret për vlerësimin e furniturës, si çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF Shqipëri, elementeve fiskalë, etje, referuar rregullave të prokurimit publik dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit.</p>  |
| <b>Rekomandime:</b>    |   |

- Urdhër shpenzimet për vlerat e likuiduara nga autoriteti kontraktor për karburante, të shoqërohen me faturat tatimore, raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar për të vërtetuar cilësinë dhe standardet e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri dhe kushteve të kontratës.
- Autoriteti kontraktor, në llogaritjen e çmimit të karburanteve, duhet të mbështetet në buletinet e APP, me çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës, sipas *sipas kushtit CIF-Shqipëri*, raporteve të analizave sipas datës respektive të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar, referuar elementëve fiskalë të përcaktuara me ligj.
- Nga Bashkia Korçë, sektori i financës të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, për arkëtimin e vlerës prej **1,935,119** lekë me tvsh e cila duhet të arkëtohet nga subjektet “J.D” sh.p.k.. në vlerën 269,746 lekë, “A.C” sh.p.k. në vlerën 364,715 lekë, “A&T” sh.a.. në vlerën 14,717 lekë, “O.” sh.p.k. në vlerën 936,219 lekë, “M.O”sh.p.k. në vlerën 349,722 lekë me t.v.sh. përfituar padrejtësisht si rezultat i mos respektimit të çmimit të miratuar sipas kontratave për furniturat bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datat përkatëse të furniturave, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën 6684/4, datë 01.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot.,260/18 datë 03.06.2021 “Shkresë përcjellëse”, nga *Kryetari i Bashkisë S.F.*, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se komenti juaj në lidhje me ndarjen në lote, ju sqarojmë se komenti juaj merret në konsideratë, ndërsa në lidhje me kontratat për afatet e pagesës komenti juaj nuk merret në konsideratë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

**2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 24.04.2017, “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.**

#### ***2.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.***

Nga auditimi ka rezultuar se, është hartuar Regjistri i parashikimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe Regjistri i realizimit të prokurimeve për vitet 2018 dhe 2019.

**Viti 2018:** Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresën nr. 273, datë 19.01.2018, është dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitin 2018 mbështetur në VKB nr. 135, datë 21.12.2017 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Korçë" dhe në Urdhrin nr. 2, datë 05.01.2018, "Për detajimin e shpenzimeve operative" dhe Urdhrin nr. 3, datë 05.01.2018, "Për detajimin e investimeve për vitin 2018".

Me shkresën nr. 1057 prot., datë 05.03.2018, është dërguar regjistri shtesë. Në këtë regjistër janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB nr. 21, datë 09.02.2018, “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2017 të Bashkisë, Institucioneve të varësisë dhe Funksioneve të reja në buxhetin e vitit 2018”, Urdhrit të Kryetarit nr. 80, datë 14.02.2018, "Për detajimin e investimeve të vitit 2018, sipas VKB nr. 21, datë 09.02.2018", Urdhrit të Kryetarit nr. 81, datë 14.02.2018, "Për detajimin e shpenzimeve operative të vitit 2018 sipas VKB nr. 21, datë 09.02.2018" dhe Urdhrit të Kryetarit nr. 132, datë 01.03.2018 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 2, datë 05.01.2018, sipas VKB nr. 21, datë 09.02.2018, i ndryshuar”.

-Përveç zërit nr. 2, i cili është shtuar bazuar në nenin 2, pika 2.1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, Qendra e Artit dhe e Kulturës, ka kërkuar me shkresën nr. 20 prot., datë 27.02.2018, t'i delegojë Bashkisë Korçë të drejtën për të zhvilluar procedurën e prokurimit, kërkesë e cila i është miratuar nga Bashkia Korçë.

**Viti 2019:** Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresën nr. 437 datë 18.01.2019 është dërguar në Degën e Thesarit regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitin 2019 mbështetur në VKB nr. 152, datë 27.12.2018, "Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2019 të Bashkisë Korçë" dhe në Urdhrin nr. 6, datë 08.01.2019, "Për detajimin e shpenzimeve operative" dhe Urdhrin Nr. 7 datë 08.01.2019 "Per detajimin shpenzimeve korrente për vitin 2019".

**Viti 2020:** Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresën nr. 826, datë 28.01.2020, është dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitin 2020 mbështetur në VKB nr. 173, datë 26.12.2019, "Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2020 të Bashkisë Korçë" dhe Urdhrin e Kryetarit nr. 18, datë 14.01.2020, "Për detajimin e shpenzimeve kapitale për vitin 2020, të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë", Urdhrin e Kryetarit nr. 19, datë 14.01.2020, "Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2020 të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë", Urdhrin e Kryetarit nr. 45, datë 24.01.2020, për një ndryshim në Urdhrin nr. 19, datë 14.01.2020”.

NJP dhe NZ, kanë vepruar në përputhje me VKM, nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, pika 1, ku cilësohet: “Në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime, autoriteti kontraktor është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së”.

Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 914, neni 4, pika 3, ku cilësohet: “Organet e pushtetit vendor, ndërmarrjet

shtetërore apo çdo autoritet kontraktor tjetër jo buxhetor përgatitin regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, jo më vonë se 10 ditë pas miratimit të buxhetit apo planit të blerjeve nga këshillat vendorë ose nga organet drejtuese përkatëse”. Nga auditimi ka rezultuar se gjatë vitit ka patur ndryshim të regjistrin të parashikimeve, për të cilat është bërë buxheti i tyre. Të gjitha ndryshimet janë hedhur në SPE, referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 4, pika 4 ku cilësohet: “Autoriteti kontraktor ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste të justifikuara. Çdo ndryshim i regjistrin të parashikimeve bëhet nga vetë autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem...”

**Më hollësisht ndryshimet e regjistrave janë paraqitur në Aneksi 3- 3/1 bashkëlidhur projekt raportit.**

### **2.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.**

Për kryerjen e auditimit mbi disponimin e fondeve dhe angazhimin e tyre për kryerjen e procedurave të prokurimit për investime publike për periudhën objekt auditimi, nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Programi buxhetor Afatmesëm 2016-2018; 2017-2019 dhe 2018-2020;
- Plani Buxhetit;
- Fakti i buxhetit;
- Regjistri i Parashikimeve;
- Regjistri i Realizimeve.

Nga vlera totale e fondit limit të prokuruar 83% e tyre është me burim financimi nga buxheti i Bashkisë Korcë, në mënyrë të përmbledhur sipas tabelës:

**Tabela nr. 3.2 “Projektet dhe burimi i financimit”**

| Fondi limit | Fondi limit i detajuar nga buxheti: |            |
|-------------|-------------------------------------|------------|
|             | Bashkisë                            | Shtetit    |
| 533,054,012 | 444,191,471                         | 88,862,541 |

*Më hollësisht shpenzimet e programuara me nivelin e fondeve buxhetore janë paraqitur në Aneksi 3- 3/2 bashkëlidhur projekt raportit.*

**Konkluzion:** Fillimi (nxjerrja e urdhër prokurimeve) dhe kryerja e procedurave të prokurimit publik, është realizuar pas miratimit dhe angazhimit të fondeve publike, për financimin e projekteve për punë publike, të zhvilluara gjatë vitit 2018 dhe 2019, me burim financimi nga buxheti i shtetit apo nga të ardhurat e Bashkisë Korcë.

### **2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).**

**2.4.** Auditim mbi zbatimin e kushteve në kontratave të lidhura me operatorë ekonomik të shpallur fitues për mallra dhe shërbime, si dhe marrja në dorëzim e tyre sipas specifikimeve teknike.(Aneks 3-3/4, likuidimi i kontratave, bashkëlidhur projekt raportit).

#### **Për auditimin e kësaj nën çështjeje u verifikuan:**

- Dosjet e procedurave
- Përcaktimi i kritereve të vlerësimit;
- Hartimi i DT;

#### **Administrimi i dosjeve të prokurimit:**

- Urdhrat e Titullarit të AK;
- Procesverbalet e mbajtura nga NJP dhe KVO, etj;



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

- Raporti përfundimtar;
- Korrespondenca me OE;
- Dokumentacioni që plotësohet nga AK;
- Korrespondenca me APP dhe KPP;
- Dokumentacioni mbi angazhimin e fondeve buxhetore.

**Mbi administrimin e dosjeve nga NJP:**

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua i gjithë dokumentacioni i ndodhur në Dosjen e prokurimit për të gjitha procedurat e audituara, nga ku rezultoi se:

**Konkluzion:** Në përgjithësi nga NJP, janë zbatuar të gjitha detyrat e përcaktuara, si: përgatitja e regjistrave të prokurimit; përzgjedhja e llojit të procedurës, hartimi Urdhrit të prokurimit; përgatitja e DT, plotësimi i gjithë dokumenteve standarde për t'u plotësuar nga AK, ka administruar të gjitha procesverbalet e mbajtura gjatë zhvillimit të procedurës; ka respektuar afatet e procedurës, ka administruar dokumentacionin e OE fitues, ka shqyrtuar dhe ka reflektuar të gjitha rekomandimet e APP-së, mbi kriteret kualifikuese, sipas vërejtjeve të saj gjatë monitorimit të procedurave, etj.

Nga ana e Juristit të NJP janë administruar dhe inventarizuar të gjitha dosjet e prokurimit. Pjesë e dosjeve ishte i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas akteve ligjore, nënligjore dhe DST.

Sa më sipër, juristi i NJP ka vepruar në përputhje me VKM nenin 57, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 3.

**- Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik:**


Nga ana e grupit të auditimit janë audituar sipas viteve objekt auditimi sa vijon:

| Viti                  | Procedura audituara | Fondi limit        | Vlera e fituar     | Diferenca nga fondi limit | Në %         | Statusi i OE pjesëmarrës ne procedurë |             |                |
|-----------------------|---------------------|--------------------|--------------------|---------------------------|--------------|---------------------------------------|-------------|----------------|
|                       |                     |                    |                    |                           |              | Marrin pjesë                          | Kualifikuar | S' kualifikuar |
| 2018                  | 2                   | 97,086,725         | 93,761,457         | 3,325,268                 | 3.43         | 20                                    | 12          | 8              |
| 2019                  | 8                   | 73,723,707         | 44,061,416         | 29,662,291                | 40.23        | 63                                    | 13          | 50             |
| <b>Riudituar 2019</b> | 6                   | 186,709,885        | 105,059,381        | 81,650,504                | 43.73        | 72                                    | 25          | 47             |
| Shuma 2019            |                     | 260,433,592        | 149,120,797        | 111,312,795               | 42.74        | 135                                   | 38          | 97             |
| 2020                  | 5                   | 53,995,161         | 52,674,457         | 1,320,704                 | 2.45         | 25                                    | 8           | 17             |
| <b>Total</b>          | <b>21</b>           | <b>411,515,478</b> | <b>295,556,711</b> | <b>115,958,767</b>        | <b>28.18</b> | <b>180</b>                            | <b>58</b>   | <b>122</b>     |


Në mënyrë analitike nominale procedurat e audituara janë në **aneks 3.3.0**, bashkëlidhur projekt raportit.

**Nga auditimi rezultoi se:**


Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik ka rezultuar se, ofertat fituese pothuajse në të gjitha rastet e audituara janë anomalisht të ulëta nga 47.9% deri në 7.98%, paraqitur grafikisht sa vijon:



Ndërkohë që për periudhën objekt auditimi nga procedurat e audituara ka rezultuar një pjesëmarrje 180 OE prej së cilëve janë s'kualifikuar 122 prej tyre ose 68% e tyre.



Gjithashtu nga auditimi i zbatimit të 14 kontratave për punë civile me vlerë kontrate 326,914,222 lekë me tvsh dhe 272,428,518 lekë pa tvsh (të cilat në përgjithësi kanë qenë oferta anomalisht të ulëta), është konstatuar se në zbatimin e punimeve në terren, janë kryer me cilësi të dobët, në disa raste devijime nga projekti i zbatimit duke cënuar qëndrueshmërinë e objektit si dhe sigurinë e tij, nisur nga ana funksionale me akses publik e shoqëruar dhe me dëme ekonomike në shumën 8,053,606 lekë ose 3% e vlerës së likuiduar pa tvsh., konkretisht sipas grafikut sa më poshtë vijon:







**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

Nga auditimi KLSH konstatoi se në Bashkinë Korçë janë shpallur fitues së procedurës së prokurimit dhe janë përfituar kontrata nga **një subjekti të vetëm, në të njëjtën periudhë kohore në vende të ndryshme të zbatimit.**

| <b>Titulli gjetjes</b> | <b>i</b><br><b>Mbi auditimin e dhënies dhe përfitimit të procedurave të prokurimit një subjekti të vetëm, në të njëjtën periudhë kohore në vende të ndryshme të zbatimit.</b>   |
|------------------------|---|
| <b>Situata</b>         | <p>Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik rezultoi se në 9 raste me fond limit 215,085,079 lekë , ka rezultuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- OE “G” shpk, ka kontraktuar 2 kontrata të lidhura më datë 31.05.2019;</li><li>- OE “N” shpk, ka kontraktuar tre kontrata 2 më datë 29.07.19 dhe datë 27.09.19;</li><li>- OE A.K 2002 shpk, ka kontraktuar 4 kontrata me datat 18.06.2019, 12.06.2019, 20.05.2019 dhe 16.07.2019.</li></ul> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit sipas procedurave të prokurimit (DST) dhe në SPE, rezulton se:</p> <p style="text-align: center;"><b>A- Për OE “G” shpk:</b></p> <p><b>1-</b> Në lidhje me numrin e punonjësve të kërkuar:<br/><u>Procedurat e prokurimit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"><li>a- Sistemime malore, në DST kërkojnë 56 punonjës.</li><li>b- “Rikonstruksion rrugësh në njësitë administrative (faza I )” 39 punonjës.</li></ul> <p>Për të marrë pjesë dhe për të përmbushur kriterin e DST ky OE duhet të disponojë <math>56 + 39 = 95</math> punonjës.</p> <p>Në fakt sipas shkresa nr.T00998108, datë 20.04.2019, të paraqitur në të dy procedurat ka për muajin janar 58, për muajin shkurt 57 dhe për muajin mars 58 punonjës ose mesatarisht 57.7 punonjës.</p> <p><b>Pra më pak 37 punonjës.</b></p> <p><b>2-</b> Në lidhje me stafin, ku drejtuesi teknik në objektin “Rikonstruksion rrugësh në njësitë administrative (faza )”, me <b>vlerë mbi 30 milion lekë</b>, është deklaruar edhe inxhinier në objektin “Sistemime malore”, në kundërshtim me Udhëzimin nr.2, të KM, datë 13.5.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 2.1, në të cilën është përcaktuar se:</p> <p><i>“2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.</i></p> <p><i>Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.</i></p> <p><b>3-</b> Në lidhje me makineritë ka deklaruar të njëjtët ekskavatorë.</p> <p>Sa u trajtua duhet të merren në konsideratë edhe deklaratimet e 4 kontratave në proces, bashkëlidhur tabelës nr.1 dhe të deklaruara në sistem.</p> <p style="text-align: center;"><b>B- Për OE “N” shpk:</b></p> <p><b>1-</b> Në lidhje me numrin e punonjësve të kërkuar:<br/><u>Procedurat e prokurimit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"><li>a- “Për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pa favorizuara, Bashkia Korçë”, kërkojnë 36 punonjës,</li></ul> |

**b-** “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare, “N.N” 3 kate shtesë për palestër”, me fond limit **41,666,666 lekë**, kërkojnë 39 punonjës.

**c-** “Rikonstruksion i pjesshëm i degës Ventrok”, me fond limit **34,133,298 lekë**, kërkojnë 38 punonjës.

Për të marrë pjesë dhe për të përmbushur kriterin e DST ky OE duhet të disponojë  $36 + 39 + 38 = 113$  punonjës.

Në fakt sipas shkresës Nr. T01089405, datë 22.05.2019, të paraqitur në të tre procedurat ka për muajin Shkurt 60 punonjës, Mars 63 punonjës, Prill 62 punonjës ose **mesatarisht 61.7 punonjës**.

Duke mos plotësuar kriterin me **-51 punonjës**.

**2-** Në lidhje me stafin, ku drejtuesi teknik në objektin “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare, “N.N” 3 kate shtesë për palestër”, me fond limit **41,666,666 lekë**, është i njëjti me atë të “Rikonstruksion i pjesshëm i degës Ventrok”, me fond limit **34,133,298** si dhe është deklaruar inxhinier ndërtimi në objektin “Për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pa favorizuara”, në kundërshtim me Udhëzimin nr.2, të KM, datë 13.5.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 2.1, në të cilën është përcaktuar se: *“Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.*

*Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.*

Gjithashtu në të tre objektet stafi i deklaruar është i njëjtë.

**3-** Në lidhje me makineritë ka deklaruar të njëjtët mjete sipas tabelës numër 2, bashkëlidhur (me bold).

Sa u trajtua duhet të merren në konsideratë edhe deklaratimet e **14 kontratave në proces**, bashkëlidhur tabelës nr.2 dhe të deklaruara në sistem.

#### **C- Për OE “A.K 2002” shpk:**

**1-** Në lidhje me numrin e punonjësve të kërkuar:

Procedurat e prokurimit:

**a-** “Skemat ujitëse”, kërkojnë **68 punonjës** (pjesëmarrja 90% dhe “Alasfalt” shpk 10%), ku OE “A.K 2002” shpk duhet të ketë  $68 * 90\% = 61.2$  punonjës

**b-** “Rehabilitimi urban i rrugëve të lagjeve të qytetit”, kërkojnë **38 punonjës** (pjesëmarrja 49% dhe “Alasfalt” shpk 51%) ku OE “A.K 2002” shpk duhet të ketë  $68 * 49\% = 33$  punonjës.

**c-** “Rikonstruksion i veprave ujitëse”, kërkojnë **38 punonjës**;

**d-** “Rikonstruksion në bllokun informal rruga “QANI QYTEZA”, kërkojnë **15 punonjës**.

**1-** Për të marrë pjesë dhe për të përmbushur kriterin e DST ky OE duhet të disponojë  $61 + 33 + 38 + 15 = 147$  punonjës.

Në fakt sipas shkresa T....., datë 20.04.2019, dhe Nr. T....., datë, 24.05.2019 të paraqitur në të 4 procedurat ka për muajin janar 61, shkurt 67, mars 68 dhe prill 64 ose **mesatarisht 65 punonjës**.

Duke mos plotësuar kriterin me **- 82 punonjës**.

**2-** Në lidhje me stafin, është i njëjtë në të katër procedurat e prokurimit dhe aq më tepër drejtuesi teknik i deklaruar për objektin “Rehabilitimi urban i rrugëve të lagjeve të qytetit” me fond limit 36,395,655 lekë, është njëkohësisht inxhinier në objektet e tjera, në kundërshtim me Udhëzimin nr.2,



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                 |  |
|-----------------|--|
|                 | <p>të KM, datë 13.5.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 2.1, në të cilën është përcaktuar se: <i>“Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.</i></p> <p><b>3-</b> Në lidhje me makineritë ka deklaruar të njëjtët mjete sipas tabelës numër 3, bashkëlidhur (me bold)</p> <p>Sa u trajtua duhet të merren <b>në konsideratë edhe deklaratimet e 5 kontratave në proces, bashkëlidhur tabelës nr.3 dhe të deklaruara në sistem.</b></p> <p><b>Rezultoni se për</b> procedurat e poshtë shënuara kryetari i KVO ka qenë i njëjtë si dhe disa anëtar të KVO kanë qenë të njëjtë dhe kanë dijeni për shpalljen fitues të OE/BOE në kushtet kur nuk i plotësojnë kriteret për kualifikim në disa procedura prokurimi</p>  |
| <b>Kriteri:</b> | <p><b>a- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- <b>Neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, ku është përcaktuar se:</b> “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, <b>pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese:...</b>”.</li><li>- <b>Neni 47, “S`kualifikimi i ofertuesve”, ku është përcaktuar se:</b> “Autoriteti kontraktor s`kualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme, <b>për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në fazën e shpalljes së kontratës fituese.</b> Autoriteti kontraktor për çdo s`kualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13 pika 3 të këtij ligji.</li><li>- <b>Neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, ku është përcaktuar se:</b> “1. Autoriteti kontraktor, <b>kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave.</b> Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”.</li><li>- <b>Neni 58, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 1, ku është përcaktuar se:</b> “1. <b>Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit, që ka paraqitur ofertën më të mirë, në përputhje me nenin 55 të këtij ligji”.</b></li></ul> <p><b>b- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- <b>Neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, ku është përcaktuar se:</b> “1. Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave <b>verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.</b></li></ul> <p>Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave <b>kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.</b></p> |

|                       |  |
|-----------------------|--|
|                       | <p>- Neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, ku është përcaktuar se: “<b>Në bazë të ofertave të pranuara, komisioni i vlerësimit të ofertave</b> harton klasifikimin përfundimtar, <b>i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla</b>”.</p> <p>- Neni 69, “Njoftimi i fituesit”, ku është përcaktuar se: “Pas miratimit të raportit përmbledhës, autoriteti kontraktor dërgon për publikim në faqen e internetit të APP-së dhe Buletin e Njoftimeve Publike njoftimin e fituesit në përputhje me nenin 58 të LPP”.</p> <p>- Neni 70 “Lidhja e kontratës”, ku është përcaktuar se: “Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor”.</p> |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Pa mundësia e realizimit të punimeve objekt i kontratës.   |
| <b>Shkaku</b>         | Shpallje e gabuar e OE fitues të procedurës së prokurimit.   |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë.   |
| <b>Rekomandimi</b>    | Autoriteti Kontraktor të marrë masa për shpalljen e fituesit, duke pasur në konsideratë rrethanant e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me qëllim që OE/kontraktori të plotësojë kriteret për realizimin e objektit të prokurimit pasardhës.  |

**Sa më sipër mban përgjegjësi KVO, për kualifikimin dhe shpalljen fitues në këto kushte të OE/BOE.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** B.Th, E.V, E.Dh, E.M, H.N, K.J, M.B, K.P, O.P, O.L..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën 6684/4, datë 01.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot.,260/18 datë 03.06.2021 “Shkresë përcjellëse”, nga *Kryetari i Bashkisë S.F*, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

***Në lidhje me konstatimin se janë kualifikuar pa të drejtë të njëjtit operatorë ekonomikë për disa procedura prokurimi të zhvilluara afërsisht brenda të njëjtës periudhë kohore ju sqarohet se:***

**I.**Të gjitha procedurat e cituara në aktkonstatimin Nr.4 janë procedura të shpallura dhe të zhvilluara nga autoriteti kontraktor në mënyrë të pavarur nga njëra -tjetra.

**II.**Për secilën nga procedurat janë hartuar dokumentat e tenderit dhe është ngritur KVO përkatëse.

**III.** Procedurat nuk janë të organizuara me lote në mënyrë që të aplikoheshin kriteret kumulative për ofertuesit e njëjtë.

**IV.**Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

**V.**Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

**VI.** Në dokumentet e tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DATË Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”..

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit të procedurës të cilën po e vlerëson.

**VII.** Nuk ka asnjë bazë ligjore që KVO të vlerësojë një procedurë prokurimi duke marrë për baze shumatoren e kriterëve të të gjitha procedurave ku ka marrë pjesë një operator . KVO nuk mund të zgjedhë në mënyrë subjektive dhe pa baze ligjore se në cilën procedurë ta kualifikojë dhe në cilën ta skualifikojë operatorin.

**VIII.** Të njëtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP në shqyrtimin e rasteve të ngjashme (shiko Vendimin 717/2018 bashkëlidhur) . Si rrjedhim edhe sikur KVO të skualifikonte ofertuesit sipas konstatimeve tuaja, KPP do të rrezonte vendimin.

**IX.** Gjithashtu ju sqarojmë se bazuar në nenin 56 të VKM 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" , "Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla.

**X.** Në përfundim, qëllimi primar i ligjit dhe i Bashkisë Korçë gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit ka qënë **mirëpërdorimi i fondeve publike** referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore **të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale**”.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se komentit juaj

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se ashtu sikurse është konstatuar në Akt Konstatim, OE të shpallur fitues dhe lidhur kontratë dy ose më shumë herë në të njëtin kohë për objekte të ndryshëm për punë civile, nuk përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit për procedurën pasardhëse, kjo e sqaruar më hollësisht në tabelat bashkëlidhur akt konstatimit.

Sa më sipër kjo nuk siguron mirëpërdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, ashtu sikurse ju pretendoni, pasi jemi në kushtet kur OE/kontraktori nuk plotëson kriteret për realizimin e objektit të prokurimit pasardhës.

Në lidhje me komentit tuaj se: “Si rrjedhim edhe sikur KVO të skualifikonte ofertuesit sipas konstatimeve tuaja, KPP do të rrezonte vendimin.”, ju sqarojmë se të dhënat për OE ju dispononi si AK, gjithashtu keni të dhënat edhe për kontratat në proces të deklaruara nga OE pjesmarrës në procedurën e prokurimit.

**Në 6 raste të zbatimit të kontratave për punë publike rezultoi moszbatimi i kriterëve të veçanta për kualifikim gjatë zbatimit të kontratës për punë publike**

|                  |   |
|------------------|---|
| <b>Titulli i</b> | <b>Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik, në 6 raste janë shkëlur kushtet e kontratës të të cilat duhet të ishin sipas kërkesave të</b> |
|------------------|---|

**gjetjes      përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi.**

|                |   |   |                           |
|----------------|---|---|---------------------------|
| <b>Situata</b> | <b>“Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi lagjet 5 dhe 13”</b> |   |                           |
|                | Datë kontrate<br>27.02.2019   | Kontraktori "S" shpk & "A" shpk                   | Drejtuesi teknik L.V      |
|                | Nr. kontrate nr. 900/2<br>prot.   | Amendament kontrate datë<br>02.09.2019            | Mbikëqyrësi R.N           |
|                | Vlera e kontratës<br>26,311,191 lekë  | Qëllimi i amendamentit – shtyrje<br>afati 56 ditë | Numër licence<br>MK1506/8 |

Nga auditimi i ditarit të punimeve të firmosur nga Drejtuesi teknik L.V dhe mbikëqyrësi i punimeve R.N me numër licence MK1506/8, rezulton se në kantier kanë qenë:

Inxhinierë 3, specialistë 5, punëtor 5 dhe shoferë 2, pra 15 gjithsej, në një kohë që në DT kërkohen: “4.1.Një punësim mesatar i të paktën 22 personash, për Gusht 2018-Tetor 2018 dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës se sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe listë pagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”.

➤ **Nga auditimi i mjeteve që janë në kantier sipas ditarit të punimeve, në zbatim të pikës 5 të kriterëve të veçanta është kërkuar “Disponimi i mjeteve të mëposhtme:**

| Sipas DST          |            |               |
|--------------------|------------|---------------|
| Lloji i makinerive | Sasia copë | Sipas ditarit |
| Ekskavator         | 2          | 2             |
| Kamion             | 3          | 3             |
| Grejder            | 2          | S`ka          |
| Autobot            | 1          | 1             |
| Auto betonierë     | 1          | S`ka          |
| Betoniere          | 2          | S`ka          |
| Asfalto shtruese   | 1          | 1             |
| Rul                | 1          | 2             |
| Fadroma            | S`ka       | 1             |

|   |  |                                |
|---|--|--------------------------------|
| <b>“Rikonstruksion i veprave ujitëse”</b> |  |                                |
| Datë kontrate 20.05.2019                  | Kontraktori A.K<br>2002shpk                  | Drejtuesi teknik<br><b>A.H</b> |
| Nr. kontrate nr. 3961/2 prot.             | Mbikëqyrësi i punimeve <b>A” shpk</b>        |                                |
| Vlera e kontratës 3,117,240 lekë          | Numër licence MK.1666/3<br>administrator L.T |                                |

Nga auditimi i ditarit të objektit të firmosur nga drejtuesi teknik A.H dhe mbikëqyrësi i punimeve “A” shpk, me numër licence MK.1666/3, (L.T) rezulton së në kundërshtim me kërkesat për kualifikim (kriteret e veçanta teknike për kualifikim, sa vijon:

*“4.1.Një punësim mesatar i të paktën 38 (tridhjetë e tete) personash, për periudhën Dhjetor 2018 - Shkurt 2019 dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës se sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe listë pagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi .*

**1.2      Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të përfshirë ne listë pagesa për periudhën Dhjetor 2018 – Shkurt 2019**

*Inxhinier Ndërtimi 1*

*Inxhinier Topograf 1*

*Inxhinier Hidroteknik 1*

**5.Disponimi i mjeteve të mëposhtme:**

|                           |              |
|---------------------------|--------------|
| <b>Lloji i Makinerive</b> | <b>Sasia</b> |
|---------------------------|--------------|



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                        |               |
|------------------------|---------------|
| <i>Kamion</i>          | <i>Cope 2</i> |
| <i>Betoniere</i>       | <i>Cope 3</i> |
| <i>Vibrator betoni</i> | <i>Cope 3</i> |
| <i>Motosaldatriçe</i>  | <i>Cope 1</i> |

Në fakt janë: Nga **38 punonjës të kërkuar gjithsej janë 12**, sa vijon: teknik ndërtimi 1, topograf 1, specialistë 6 dhe punëtorë 4.

Nuk ka inxhinier hidroteknik.

Në lidhje me mjetet:

| Sipas DST<br>Makineria | Sasia | Sipas ditarit<br>të kantierit | Diferenca |
|------------------------|-------|-------------------------------|-----------|
| Kamion                 | 2     | 2                             | 0         |
| Betoniere              | 3     | 2                             | -1        |
| Vibrator betoni        | 3     | S`ka                          | -3        |
| Motosaldatriçe         | 1     | S`ka                          | -1        |
| Fadromë                | S`ka  | 1                             | +1        |

| <b>“Rikonstrukcion i rrugëve rurale dhe informale “Rikonstrukcion rruge fshati Barç”</b> |   |   |
|--|---|---|
| Datë kontrate 27.05.2019   | Kontraktori “V” shpk                      | Drejtuesi teknik G.A                            |
| Nr. kontrate nr. 4333/2 prot.  | Amendament kontrate s`ka                  | Mbikëqyrësi i punimeve Studio Servis “K.S” shpk |
| Vlera e kontratës 11,689,253 lekë  | Numër licence MK 2992/6 administrator K.S |   |

Nga auditimi i ditarit të objektit të firmosur nga drejtuesi teknik G.A dhe mbikëqyrësi shoqëria S. S. “K.S” shpk me numër licence MK 2992/6 me administrator K.S, si dhe nisur nga kërkesat e veçanta për kualifikim pjesë e DST ku kërkohet sa vijon:

*“4.Deshmi për fuqinë mesatare punëtore te operatorit ekonomik:*

*“4.1.Një punësim mesatar i të paktën 28) personash, për periudhën Janar 2019 - Mars 2019 dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe listë pagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi.*

**1.3** *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të përfshirë në liste pagesa për periudhën Janar 2019 - Mars 2019*

*Inxhinier Ndërtimi 1*

*Inxhinier Topograf 1*

*Inxhinier Hidroteknik 1*

*Inxhinier Elektrik 1*

**5.Disponimi i mjeteve të mëposhtme:**

| Lloji i Makinerive | Sasia  |
|--------------------|--------|
| Kamion             | Cope 2 |
| Ekskavator         | Cope 1 |
| Grejder            | Cope 1 |
| Autobot            | Cope 1 |
| Betoniere          | Cope 2 |
| Tokmak             | Cope 2 |
| Autovinç           | Cope 1 |
| Auto bitumatrice   | Cope 1 |
| Asfalto shtruese   | Cope 1 |
| Rul                | Cope 1 |

**Rezultoni se nuk ka.**

- Inxhinier Hidroteknik dhe Inxhinier Elektrik në objekt sipas ditarit:
- Gjithsej janë 830 ditë pune njerëz/ 58 ditë sipas ditarit = 14.3 +2 staf inxhinierik = 16.3 nga 28 të kërkuar ose 13.7 punonjës më pak.

- Bazuar në kërkesat e veçanta të procedurës nuk janë paraqitur asnjëherë sipas ditarit të objektit autobot, autovinç, auto bitumatrice
- Në objekt janë paraqitur sipas ditarit një fadromë dhe një kamionçinë.

| "Rikonstrukcion i pjesshëm i Degës Ventrok" |                          |                                   |
|---|--------------------------|-----------------------------------|
| Datë kontrate 29.07.2019                    | Kontraktori "N" shpk     | Drejtuesi teknik G.M              |
| Nr. kontrate nr. 6149/2 prot.               | Amendament kontrate s`ka | Mbikëqyrësi i punimeve "M.S" shpk |
| Vlera e kontratës 22,918,633 lekë           |                          | Numër licence MK1811/7 T.S        |

Nga auditimi i ditarit të objektit të firmosur nga drejtuesi teknik G.M ("N" shpk) dhe mbikëqyrësi i punimeve "M.S" shpk, me numër licence MK1811/7 përfaqësuar nga T.S, rezulton se në zbatim të kërkesës së procedurës së prokurimit sa vijon:

#### "4.Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik:

**4.1.**Një punësim mesatar i të paktën **38 personash**, për periudhën **Shkurt 2019 – Prill 2019** dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe listë pagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi.

**1.4** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të përfshirë në listë pagesa për periudhën **Shkurt 2019 - Prill 2019**

Inxhinier Ndërtimi 1

Inxhinier Topograf 1

Inxhinier Hidroteknik 1

#### 5.Disponimi i mjeteve të mëposhtme:

| Lloji i Makinerive | Sasia/ copë |
|--------------------|-------------|
| Kamion             | 4           |
| Ekskavator         | 2           |
| Betoniere          | 6           |
| Vibrator betoni    | 6           |
| Motosaldatrice     | 1           |

Rezulton se në kantier **asnjëherë nuk ka qenë inxhinieri hidroteknik, nuk ka vibrator betoni, nuk ka moto saldatrice, si dhe betoniera.**

Në lidhje me numrin e punonjësve të kërkuar 38 -3 staf teknik = **35 punonjës**, rezulton se në objekt kanë qenë mesatarisht 263 ditë njerëz/ 101 ditë sipas kontratës = **2.6 punonjës**.

| "Skemat ujitëse"                  |  |                                   |
|-----------------------------------|--|-----------------------------------|
| Datë kontrate 18.06.2019          | Kontraktori "A.K 2002" & "A.A" shpk    | Drejtuesi teknik G.M              |
| Nr. kontrate nr. 4841/2 prot.     | Amendament kontrate s`ka               | Mbikëqyrësi i punimeve "MCE" shpk |
| Vlera e kontratës 11,776,426 lekë | Numër licence MK319/2administrator P.M |                                   |

Nga auditimi i dokumentacionit të ditarit të objektit të firmosur nga drejtuesi teknik A.M dhe mbikëqyrësi i punimeve "MCE" shpk, me numër licence MK319/2, P.M, rezulton se në kundërshtim me kërkesën për kualifikim sa vijon:

**4.1.**Një punësim mesatar i të paktën **68** për periudhën **Janar 2019 - Mars 2019** dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe listë pagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi .

**1.5** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të përfshire në listë pagesa për periudhën **Janar 2019 - Mars 2019**

Inxhinier Ndërtimi 1

Inxhinier Topograf 1

Inxhinier Hidroteknik 1

#### 5.Disponimi i mjeteve të mëposhtme:





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

| Lloji i Makinerive | Sasia |
|--------------------|-------|
| Kamion             | 2     |
| Betoniere          | 5     |
| Vibrator betoni    | 5     |
| Motosaldatriçe     | 1     |

Janë paraqitur gjithsej ditë njerëz 1403 : 91 ditë të kontraktuara = 15.25 punonjës nga 68 të kërkuar – 3 staf teknik = ose - 52.75 punonjës më pak.

Nuk figuron në asnjë ditë inxhinieri hidroteknik;

Nuk janë 2 betoniera;

Nuk ka moto saldatriçe;

Nuk ka vibrator betoni, copë 5.

| "Rikonstruksion i Shkollës 9 vjeçare "Nuci Naçi"- 3 kate shtesë për palestër" |   |                                     |
|---|---|-------------------------------------|
| Datë kontrate 29.07.2019  | Kontraktori " N " shpk                  | Drejtuuesi teknik G.M               |
| Nr. kontrate nr. 6026/2 prot.   | Amendament kontrate s`ka                | Mbikëqyrësi i punimeve "S.S.K" shpk |
| Vlera kontratës 30,125,449 lekë   | Numër licence MK319/2 administrator K.S |                                     |

Nga auditimi i dosjes së dokumentacionit teknik të objektit, ditarit të objektit, të firmosur nga drejtuesi teknik G.M dhe mbikëqyrësi shoqëria "S.S.K" shpk, me numër licence MK 2992/6 me administrator K.S, rezulton se në kundërshtim me kërkesat e veçanta për kualifikim dhe deklaratimet e OE të shpallur fitues në lidhje me kriteret sa vijon:

"4.Deshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik:

**4.1.**Një punësim mesatar i të paktën **39 personash**, për periudhën **Shkurt 2019 - Prill 2019** dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe listë pagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi.

**1.6** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të përfshirë në listë pagesa për periudhën **Shkurt 2019 - Prill 2019**

Inxhinier Ndërtimi 1

Inxhinier Topograf 1

Inxhinier Hidroteknik 1

Inxhinier Elektrik 1

Inxhinier Mekanik 1

**5.Disponimi i mjeteve të mëposhtme:**

| Lloji i Makinerive              | Sasia /copë |
|---------------------------------|-------------|
| Kamion 1                        | 3           |
| Ekskavator me goma              | 1           |
| Grejder                         | 1           |
| Betoniere                       | 1           |
| Auto betonierë                  | 1           |
| Vibrator                        | 1           |
| Tokmak elektrik                 | 1           |
| Autobot                         | 1           |
| Autovinç                        | 1           |
| Pompe Suvatimi                  | 1           |
| Asfalto shtruese                | 1           |
| Rul                             | 1           |
| Nyje thyerje materialesh inerte | 1           |
| Fabrike asfalto betoni          | 1           |

**Rezulton se:**

- Numri i punonjësve të kërkuar në DST është 39, nga ditari i objektit rezulton 1315 ditë njerëz/ 136 ditë të kontraktuara dhe për të cilat është mbajtur ditar

objekti = 9.7 + 3 staf teknik I deklaruar = 12.7, punonjës gjithsej ose **26.3 punonjës më pak se ai i kërkuar në DST.**

- Nga auditimi i stafit teknik të kërkuar rezulton se **nuk figurojnë në ditarin e objektit:**

Inxhinier Hidroteknik 1

Inxhinier Elektrik 1

Inxhinier Mekanik 1

- Në lidhje me mjetet rezulton se nuk figurojnë në objekt sipas ditarit sa vijon:

| Kërkuar në DST     |        | Paraqitur në objekt | Diferenca |
|--------------------|--------|---------------------|-----------|
| Lloji i Makinerive | Sasia  |                     |           |
| Kamion 1           | Cope 3 | 2                   | -1        |
| Ekskavator me goma | Cope 1 | 0                   | -1        |
| Grejder            | Cope 1 | 1                   | 0         |
| Betoniere          | Cope 1 | 0                   | -1        |
| Auto betonierë     | Cope 1 | 1                   | 0         |
| Vibrator           | Cope 1 | 1                   | 0         |
| Tokmak elektrik    | Cope 1 | 0                   | -1        |
| Autobot            | Cope 1 | 0                   | -1        |
| Autovinç           | Cope 1 | 0                   | -1        |
| Pompe Suvatimi     | Cope 1 | 0                   | -1        |
| Asfalto shtruese   | Cope 1 | 1                   | 0         |
| Rul                | Cope 1 | 0                   | -1        |

Por figurojnë 2 automjete, pa përcaktuar llojin dhe 1 fadromë.

#### Kriteri

- **Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006**, “Për prokurimin publik”, ndryshuar, neni 60, “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1, ku është përcaktuar se “1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, **nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese**”.

- **VKM nr. 914, datë 29.12.2014** “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu IX, “Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, **Neni 77, “Mbikëqyrja e kontratës”, pikat 1, 2, 3 dhe 4**, ku është përcaktuar se:

1. “Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore, të autorizuara me ligj, (nëse është rasti) mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara **në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi**”.

2. Mos përmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për **përfundimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përfundimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë.**

3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor **duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë.** “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

4. “Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe **në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së.**

Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin”.

- **Ligjin nr.8402, datë 10.9.1998**, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” **Neni 7, ku është përcaktuar se:** “Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi i punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë.

Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM, nr.3, datë 15.2.2001**, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pjesa I, “Mbi mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit”.

- Gjithashtu dhe me “**Rregulloren për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë së Korçës**”, pika 37. Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës, nën-pika 37.1 “Detyra të përgjithshme”, ku janë përcaktuar:

○ **“Monitoron dhe ndjek nga afër dhe në detaje kryerjen e punimeve në teren nga firmat sipërmarrëse duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi për punimet e ndërtimit.**

○ **Përgatit informacionin për investitorin mbi ecurinë e procedurave dhe të punimeve në këto kontrata dhe problemet që dalin gjatë zbatimit të tyre.**

○ **Evidenton problemet që dalin gjatë zbatimit të punimeve, përgatit relacione dhe dokumentacionin e nevojshëm për institucionet që do të marrin pjesë në zgjidhjen e tyre.**

○ **Kontrollon dokumentet e nevojshme për fillim e punës në kontratat e punimeve (projekti, preventivi, kontrata, garancitë, etj. )**

○ **Kontrollon dokumentacionin teknik pas fillimit të punës për kontratat e punimeve dhe për supervizionin, si: librezat e masave, ditari i objektit, punimet e maskuara, ndryshime dhe shtesa në punime, korrespondenca me kontraktorët dhe supervisorët etj.**

*Krijon kontakte dhe mban korrespondenca me donatorë të ndryshëm si dhe me firma sipërmarrëse dhe supervisorët e kontratave për ndjekjen dhe kontrollin e mbajtjes së dokumentacionit teknik»*

|                        |  |
|------------------------|--|
| <b>Ndiki mi/efekti</b> | Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori  |
| <b>Shkaku</b>          | Moszbatim i kushteve të procedurës së prokurimit, e cila është pjesë përbërëse e kontratës.  |
| <b>Rendësia</b>        | <b>E lartë.</b>  |
| <b>Rekomandimi</b>     | Autoriteti Kontraktor të marrë masa që gjatë zbatimit të kontratës së punëve publike të mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi për tu siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, duke monitoruar zbatimin e kontratës dhe në rast të |

shkeljes së kushteve të kërkuara të zbatojë penalitetet e parashikuara në kontratë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. L.Gj, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës.
2. Mbikëqyrësi i punimeve "S.S.K" shpk, administrator K.S
3. Mbikëqyrësi i punimeve "MCE" shpk, P.M
4. Mbikëqyrësi i punimeve "M.S" shpk, administrator T.S
5. Mbikëqyrësi i punimeve R.N
6. Mbikëqyrësi i punimeve "A" shpk, administrator L.T

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën 6684/4, datë 01.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot.,260/18 datë 03.06.2021 "Shkresë përcjellëse", nga *Kryetari i Bashkisë S.F*, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me konstatimin e mospërmbushjes të detyrimit nga personi përgjegjës i prokurimeve ju sqarojmë se:

-Bazuar në nenin 57 të VKM Nr 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" detyrat e personit përgjegjës për prokurimin janë si më poshtë:

*3. Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme:*

*-Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;*

*- Përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti) kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme;*

*- Hartimin e urdhrat të prokurimit;*

*- Përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre;*

*- Hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;*

*- Hartimin dhe dërgimin e ftesave për pjesëmarrje kandidatëve të ftuar në një procedurë prokurimi, duke argumentuar përzgjedhjen e tyre;*

*- Administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;*

*- Llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti;*

*- Në kuadër të hartimit të dokumenteve të tenderit, bashkërendimin e punës me APP-në, me qëllim realizimin e kësaj detyre me efikasitetit dhe në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi;*

*- Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor;*

*- Administrimin e sigurimit të kontratës përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor;*

*- Përcjelljen pranë APP-së të raportimeve mbi ecurinë e zbatimit të kontratës, në rastet kur kërkohet, si dhe të raportimit përfundimtar të ekzekutimit të kontratës.*

*-Gjithashtu lidhur me raportimin që duhet të bëjë personi përgjegjës për ekzekutimin e kontratës në nenin 77, pika 4. të VKM 914 datë 29.12.2014 është përcaktuar detyrimi si më poshtë:*

*"Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së.*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

*Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin."*

Në zbatim të detyrimeve ligjore si më sipër, personi përgjegjës për prokurimet ka kërkuar informacion në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave dhe Drejtoria e Finances lidhur me zbatimin e kontratave dhe likuidimin e tyre.

Mbas marrjes të informacionit ka dërguar në APP formularin për zbatimin e kontratës.

Për sa më sipër nga ana e personit përgjegjës të prokurimeve janë kryer të gjitha detyrimet që i ngarkon legjislacioni i prokurimeve.

Bashkëlidhur do të gjeni dokumentacionin provues për veprimet e kryera nga personi përgjegjës për prokurimet për kontratat e cituara nga ana juaj në këtë akt konstatimi.

Përsa i përket kontrollit të përditshëm të ditareve të punës nga Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave ju sqarojmë se është e pamundur që të kryhet ky kontroll, për arsye sepse objektet janë të shumta dhe të shtrira si në qytet dhe në fshatra dhe në stafin e drejtorisë ka mungese personeli (është vetëm një ing. ndërtimi).

#### Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

Në lidhje me komentet për detyrimin nga personi përgjegjës i prokurimeve për përcjelljen pranë APP-së të raportimeve mbi ecurinë e zbatimit të kontratës, në rastet kur kërkohet, si dhe të raportimit përfundimtar të ekzekutimit të kontratës, ju keni paraqitur dokumente dhe fakte per ecurinë e zbatimit të kontratës dhe komenti merret në konsideratë.

Në lidhje me mbikëqyrjen e kontratave nga Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës, nuk është argument mungesa e stafit, organ duhet të ishte e plotë në funksion të "Rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë së Korçës", pika 37, "Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës", nën pika 37.1 "Detyra të përgjithshme". Është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e punimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë, sidomos në kushtet kur ofertat janë anomalisht të ulëta. Sa më sipër komenti për këtë çështje nuk merret parasysh dhe do të trajtohet në Projekt Raportin e Auditimit.

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Janë kontraktuar pa marrë më parë miratimin për leje zhvillimi (ndërtimi) ose pa deklaratë të fillimit të punimeve të ndërtimit, të miratuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Kryetari i Bashkisë</b>  |
| <b>Situata</b>           | Nga auditimi i dosjeve të procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi, marrë nga sektori i Njësisë së Prokurimeve Bashkia Korçë, konstatohet se 16 objekte të prokuruar gjatë periudhës objekt auditimi me fond limit 241,901,203 lekë, <b>janë kontraktuar pa marrë më parë miratimin për leje zhvillimi (ndërtimi) ose pa deklaratë të fillimit të punimeve të ndërtimit, të miratuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Kryetari i Bashkisë.</b> |
| <b>Kriteri</b>           | Ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 13, 22, 29, 38, 39 pika 1, 41 pika 1, 2, 3, neni 43, 51 dhe neni 52.<br>VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit. Mos referimi në dispozitat ligjore të sipërcituara ka bërë që të mos gjej zbatim duke mos u aplikuar neni 52 "Kundërvajtjet administrative", pika  |

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | “e”.  |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Mungesë të plotësimi të kushteve që kërkohen për paisjen me leje si edhe zhvillim të punimeve pa leje.  |
| <b>Shkaku</b>         | Moszbatimi i ligjit nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, ndryshuar  |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë   |
| <b>Rekomandimi</b>    | Bashkia Korçë për të gjitha punimet, për të cilat është detyrim paisja me leje ndërtimi (zhvillimi) të aplikojë për leje para se të nisë procedurën e prokurimit të punimeve. |

| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mbi detyrën e projektimit.</b>  |
|--------------------------|--|
| <b>Situata</b>           | Në asnjë rast nuk ka Urdhër të Kryetarit të Bashkisë drejtuar Drejtorisë së planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit (e cila është marrë me projektimet dhe preventivat duke i hartuar vetë) <b>për hartimin e detyrës së projektimit dhe miratimin e saj.</b> Nga auditimi në bilanc i llogarisë 202 “Studime dhe projekte”, vihet re se studimi dhe projektimi”, për sa trajtuar më sipër, janë në vlerën zero lekë.<br>Nga auditimi rezultoi se nuk ka urdhër nga Titullari i Njesisë Vendore, <b>për ngritjen e grupit të punës me specialistë të fushave</b> sipas zërave të punimeve parashikuar në preventivin e punimeve për kontrollin dhe marrjen në dorëzim të projekt preventivave të punimeve.”. |
| <b>Kriteri</b>           | Mos nxjerrja e urdhrave është në kundërshtim me pikën 35.a dhe 36 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nenin 6, germa (e) dalë në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.<br>Pika 42 e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nenin 6, germa (e) të ligjit nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.   |
| <b>Ndikimi/efekti</b>    | Mungesë e rishikimit dhe konfirmimit të dokumentacionit.   |
| <b>Shkaku</b>            | Moszbatim i akteve ligjore.  |
| <b>Rendesia</b>          | E lartë.   |
| <b>Rekomandimi</b>       | Autoriteti Kontraktor të marrë masa për hartimin e detyrës së projektimit dhe miratimin e saj si dhe për kontrollin dhe marrjen në dorëzim të projekt preventivave të punimeve.  |

| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Projektet nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse.</b>  |
|--------------------------|---|
| <b>Situata</b>           | Nga auditimi rezulton se projektet nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Grupi i projektimit duhet jetë i përberë minimumi nga: inxhinieri gjeodet për plan rilevimin dhe azhurnimin topografik, projektuesi arkitekt, projektuesi konstruktor, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi i instalimeve hidro sanitare, projektuesi i instalimeve ngrohje ftohje ventilim, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri, inxhinieri sizmolog, inxhinieri gjeolog, eksperti mjedisor<br>Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohen me përgjegjësi Drejtoresha e Planifikimit |



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | <p>Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Korçë, Zh.L, dhe inxhinierët: B.M , E.T, I.Th , P.P , S.D dhe Ujësjellës Kanalizime Korçë, për hartim të projektit në kundërshtim me përcaktimet ligjore, në tejkalim të kompetencave dhe në mungesë të licencave përkatëse.</p> <p>Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashki, bazuar në Rregulloren Brendshme neni 36, pikat 36.1 “Misioni”, 36.2 “Objektivat e drejtorisë”, 36.3 “Detyra të përgjithshme”, 36.4 “Drejtori i drejtorisë”, 36.5 “Sektori për Planifikimin e Territorit dhe Projektimin – Përgjegjësi”, ka të përcaktuara detyrat bazuar në nenin 14 “<b>Kontributet profesionale në planifikim</b>”, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ndërsa në pikën 36.6 “Detyrat dhe Përgjegjësitë”, në kundërshtim me misionin e kësaj drejtorie bazuar në ligjin nr. 107/2014, janë përcaktuar: “Organizon punën <b>për realizimin e projekt-ideve të kërkuara dhe projekteve të zbatimit</b> në kohën e duhur me cilësinë e kërkuar dhe duke plotësuar dokumentacionin e nevojshëm teknik dhe ekonomik”.</p> <p><b>Në një kohë që kjo Drejtori nuk është e licencuar për hartimin e projekteve të zbatimit.</b></p> |
| <b>Kriteri</b>        | <ul style="list-style-type: none"><li>- Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 5.</li><li>- VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, e cila ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, neni 16 “Licenca – kategoritë e punimeve”, pika 1. Projekte të hartuar nga punonjës të pa licencuar janë sipas <b>Aneks 3-3/4,01</b> bashkëlidhur projekt raportit.</li></ul>  |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Hartimi i projekteve nga persona të palicensuar.  |
| <b>Shkaku</b>         | Moszbatim i kriterëve të akteve ligjore e nënligjore.   |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë.  |
| <b>Rekomandimi</b>    | Bashkia Korçë të marrë masa për të operuar vetëm me projekte të zbatimit të hartuara nga projektues, të pajisur me licencat përkatëse.  |

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Zh.L, Drejtor i Drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit. (DPKZHT)
2. B.M, me detyrë specialist preventivues (DPKZHT)
3. E.T, me detyrë ish specialiste në DPKZHT
4. I.Th , me detyrë përgjegjës sektori për mbrojtjen e mjedisit (DPKZHT)
5. P.P , me detyrë inxhinier në NSHP
6. S.D, privat.
7. S.F, me detyrë Kryetar i Bashkisë.

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mbi përbërjen e Njesisë së hartimit të dokumenteve të procedurave të prokurimit publik.</b>   |
| <b>Situata</b>           | Në njësinë e prokurimit është anëtare M.B me profesion Ing. Agroushqimore, profesioni i të cilës nuk ka lidhje me objektet e prokurimit ku ka marrë pjesë. |
| <b>Kriteri</b>           | Në kundërshtim me VKM nr. 914, datë, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave  |

|                       |  |
|-----------------------|--|
|                       | të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 57, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 1, ku është përcaktuar se: “Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit kontraktor krijon njësinë e prokurimit, në përbërje të së cilës është personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit dhe të paktën një specialist fushe në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit. Në raste të tjera, titullari i autoritetit kontraktor cakton në përbërjen e njësisë së prokurimit, përveç personit përgjegjës për prokurimin, një ose disa persona të tjerë, me arsim të lartë. Në rast mungese personeli, autoriteti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm. Përveç sa më sipër, autoriteti kontraktor mund të krijojë një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete kontraktore”. |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Moskrijim i kushteve për menaxhimin e saktë të procedurës së prokurimit sipas specifikave përkatëse.   |
| <b>Shkaku</b>         | Autoriteti kontraktor nuk ka mundur të kërkojë staf të specializuar nga autoritete të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm. Përveç sa më sipër, autoriteti kontraktor mund të krijojë një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete kontraktore”.  |
| <b>Rendesia</b>       | I lartë  |
| <b>Rekomandimi</b>    | Bashkia Korçë të marrë masa që në NJHDT të vendosë punonjës në varësi të specifikës së objektit të prokurimit.   |

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën 6684/4, datë 01.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot.,260/18 datë 03.06.2021 “Shkresë përcjellëse”, nga *Kryetari i Bashkisë S.F.*, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

**Pretendimi i subjektit:**

Lidhur me sa më sipër ju sqarojmë se në të gjitha procedurat e mallrave dhe shërbimeve janë ngritur strukturat përkatëse për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit. Ndërsa në procedurat e punëve gjithmonë ka qënë pjesë përbërëse e njësisë të prokurimit specialisti i fushës me profesion Ing.Ndërtimi.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: Ky koment konfirmon faktin që punonjësi nuk ka lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara nga AK në varësi të specifikës së objektit të prokurimit dhe si i tillë nuk merret në konsideratë.

|                        |   |
|------------------------|---|
| <b>Titulli gjetjes</b> | <b>Mbi mosrespektimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK).</b>  |
| <b>Situata</b>         | <p><b>Në të gjitha kontratat e lidhura, neni i kushteve të përgjithshme të kontratës (KPK), “Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve”, është vendosur sa vijon:</b></p> <p>“Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.</li> </ul> <p>Si dhe është shtuar:</p> <p>pika 27.2. Investitori do të zbrësë dëmshpërblimin për vonesat nga pagesa e</p> |





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                       |  |
|-----------------------|--|
|                       | fundit e Sipërmarrësit.  |
| <b>Kriteri</b>        | Ky përcaktim është në kundërshtim me KPK, të DST, të miratuara, <b>Neni 34, “Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve”, pika 34.1, “Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:</b><br>a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.<br>b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.<br>c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”. |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Në përlllogaritjen jo të saktë të kamat vonesave në rastet e shtyrjes së afatit mbi 6 muaj.  |
| <b>Shkaku</b>         | Moszbatim i KPK  |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë.   |
| <b>Rekomandimi</b>    | AK të marrë masa për hartimin e kushteve të kontratës sipas standarteve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të LPP.   |

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën 6684/4, datë 01.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot.,260/18 datë 03.06.2021 “Shkresë përcjellëse”, nga *Kryetari i Bashkisë S.F*, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

Ju saktësojmë se jo në të gjitha kontratat është vënë tarifa ditore 4/1000. Tarifa ditore është vënë në varësi të afatit konkret që ka patur kontrata . Pra nëse kontrata ka qënë me afat zbatimi deri në 6 muaj është vënë tarifa ditore 4/1000,në rast se kontrata ka qënë me afat zbatimi jo më shumë se 12 muaj tarifa ditore është vënë 2/1000 dhe për kontratat mbi 12 muaj është vënë tarifa 1/1000. Gjithashtu në të gjitha kontratat e lidhura (neni 1 pika 3 e kontratës) është specifikuar që dokumentat e tenderit janë pjesë e kontratës, rrjedhimisht edhe kushtet e pergjithshme te kontrates sipas DST-ve.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: Nga auditimi i kontratave të sipërpërmendura ju në asnjë rast nuk keni vendosur kushtin e plotë të nenit, "Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve".

Fakti argumentues se: “Gjithashtu në të gjitha kontratat e lidhura (neni 1 pika 3 e kontratës) është specifikuar që dokumentat e tenderit janë pjesë e kontratës, rrjedhimisht edhe kushtet e pergjithshme te kontrates sipas DST-ve.”, e konfirmon këtë fakt. Komenti juaj nuk ka paraqitur prova dhe fakte të reja e për rrjedhojë nuk merret në konsideratë.

**Viti 2018**

|  |                                |  |
|--|--------------------------------|--|
| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim, asfaltim në rrugët e qytetit (lagjet nr. 5 dhe 13)” |                                |  |
| <b>Urdhër Prokurimi</b><br>nr.34, datë 05.11.18  | <b>NJHDT:</b><br>1.M.S(Jurist) | <b>KVO:</b><br>nr.34/1 prot., datë 06.11.2018: |

|  |  |   |
|--|--|---|
| <b>2. Lloji i Procedurës:</b><br>“Procedurë e hapur” | 2.M.B(Ing. agrourshqimore)<br>3.B.M(Ing. ndërtimi)   | 1. B.TH<br>2. G.J.P<br>3. A.D<br>4. A.A<br>5. E.DH,               |
| <b>Burimi Financimit:</b><br>të ardhurat e Bashkisë  | <b>OE fitues:</b> “S” ShPK & “A II” ShPK në<br>shumën 38,341,395 lekë                              |   |
| <b>Fondi Limit</b> 41,666,663 lekë                   | <b>Diferenca me fondin limit:</b> 26,003,714<br>lekë   |   |
| <b>Data e hapjes së tenderit:</b><br>07.12.2018      | <b>Operatorët Ekonomike</b><br>Pjesëmarrës në tender: 14 OE<br>S’kualifikuar 9 OE<br>Kualifikuar 5 | <b>Ankimime në AK:</b> “V” ShPK<br><b>Ankimime në KPP:</b> - s’ka |

| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>i</b> | <b>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.</b>  |
|--------------------------|----------|--|
| <b>Situata</b>           |          | <p><b>Në hartimin e DT</b> në lidhje me kriteret rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:</p> <p>1- Seksioni II, “Informacione të veçanta për kontratat”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 7.</p> <p>2- Kreu VII, “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2.</p> <p><b>Si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:</b></p> <p><b>Në pikën 5 të kriterve të veçanta është kërkuar</b> “Disponimi i mjeteve”, për të cilat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Në lidhje me mjetet (kamion, autobot, auto betonierë, betonierë, nuk janë përcaktuar kapacitetet e tyre, në lidhje me objektin dhe nevojat e zbatimit të kontratës.</li> <li>➤ Nuk është përcaktuar lloji i ekskavatorit me goma apo zinxhirë.</li> <li>➤ Për “Nyje të thyerjes të materialeve inerte” dhe “Fabrika e asfalto betonit” është kërkuar që të paraqitet kontrata e furnizimit me prodhuesin, ndërkohë që Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT) duhej të kishte kërkuar kontratë paraprake furnizimi, pasi kërkesa për kontratë furnizimi e vendos operatorin ekonomik në rast të mos shpalljes fitues përpara kushteve kontraktuale.</li> <li>➤ Në lidhje me shënimin se: “Lidhur me fabrikën e asfalto betonit ofertuesit duhet të kenë ne pronësi, me qira apo te lidhin kontrate furnizimi me një fabrikë vendndodhja e së cilës garanton realizimin e objektit konform kushteve teknike të përcaktuara në VKM Nr.628 datë 15.07.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”.</li> </ul> <p><b>Sqarojmë se kjo kërkesë nuk qëndron:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Jemi në kushtet kur OE pjesëmarrës në procedurë ka lëshuar deklaratë për plotësimin e specifikimeve teknike;</li> <li>- Kërkesë në kundërshtim me UKM nr.3, datë 15.2.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 9, 10, 11 dhe 12.</li> <li>- Kërkesë në kundërshtim me VKM nr.628 datë 15.07.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”, pikat:</li> </ul> <p><b>a-</b> “Rregulli teknik për ndërtimin e rrugëve (RrTNRr-1), Vëllimi 1: “Të përgjithshme dhe punime përgatitore” pjesa nr. <b>“5 Kontrolli i Punës”, pika 5.2 Autoriteti i Inxhinierit Mbikëqyrës</b>”, ku janë përcaktuar veprimet e mbikëqyrësit</p> <p><b>b-</b> Rregulli teknik për ndërtimin e rrugëve (RrTNRr-8), Vëllimi 8: Kërkesa për pranimin e materialeve dhe të produkteve, vëllimi 8: kërkesa për pranimin e</p> |



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

materialeve dhe të produkteve, pika 4, “Plotësimi i Kërkesave nga Produkti dhe Vlerësimi i Përputhshmërisë”, në të cilën janë përcaktuar sipas pikës 1, “Qëllimi”,

***Sa u trajtua ngarkohen me përgjegjësi NJHDT, sipas pikave të përcaktimit të kritereve për kualifikim***

KVO gjate verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nga Operatorët pjesëmarrës për realizimin e objektit te tenderimit, disa nga shoqëritë dhe konkretisht:

1. Shoqëria “B” ShPK ka paraqitur një kontrate qiraje për fabrikën e asfaltit me shoqërinë “S” ShPK nga ku rezulton se vendi i prodhimit te asfaltit është “Drize, Qendër Fier”
2. Shoqëria “B. X” ShPK, disponon një impiant prodhimi asfalto betoni nga ku rezulton se vendi i prodhimit te asfaltit është: Qukës Librazhd”.
3. Shoqëria “B.B” ShPK, ka paraqitur një kontrate furnizimi me binder dhe asfalto beton me shoqërinë “AAC” ShPK nga ku rezulton se vendi i prodhimit te asfaltit është “Fshati Stan Karbunarë Lushnje”.
4. Shoqëria “S.2F” ShPK ka paraqitur një kontrate furnizimi me asfalt me shoqërinë “A.2014” ShPK nga ku rezulton se vendi i prodhimit te asfaltit është: Tirane, Vore, Marikaj, Zona kadastrale 2596, me nr. pasurie 25/28”.
5. Bashkimi i shoqërive A.K 2002ShPK, “A.A” ShPK ka paraqitur kontrate furnizimi me binder dhe asfalto beton me shoqërinë ”B.X” nga ku rezulton se vendi i prodhimit te asfaltit është “Qukës Librazhd”.

Ka vendosur t’i kërkoje sqarime shoqërive të mësipërme lidhur me fabrikën e asfalto betonit te deklaruar ne shtojcën mbi disponimin e makinerive me qellim qe te sigurohet lidhur me përdorimin e tyre për realizimin e objektit konform kushteve teknike te përcaktuara ne legjislacionin e fuqi.

Me shkresën nr. 9635 prot., datë 28.12.2018, i është kërkuar shoqërisë “S” ShPK, si përfaqësuese e bashkimit te shoqërive “S” ShPK dhe “A II” ShPK shpjegime lidhur me ofertën e tyre te paraqitur ne tender.

Kërkesa për argumentimin e ofertës është dërguar me shkresë nëpërmjet zyrës postare me nr.9635 prot., datë 28.12.2018 dhe njëkohësisht nëpërmjet sistemit të APP në rubrikën “kërkesat”.

Shoqëria “S” ShPK ka kthyer përgjigje me shkresë zyrtare datë 04.01.2019 me nr.9635/1 prot., duke dhënë një argumentim ne lidhje me ofertën për zërat e punimeve te kërkuara, bashkëngjitur dhe te dhënat teknike te tyre, shoqëruar dhe me fatura tatimore shitje.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur nga shoqëria “S” ShPK, rezultoi se: Informacioni i dërguar nga shoqëria “S” ShPK, për argumentimin e ofertës anomalish të ulët është bindës dhe justifikon çmimet e ofruara.

#### **Ankimimi në AK:**

Në lidhje me zhvillimin e procedurës është ankimuar OE “V” ShPK, e protokolluar në Bashki me nr. 290, datë 14.01.2019.

Arsyet e ankimimit janë:

- Referenca ligjore për s`kualifikim nuk qëndron sepse ky kusht nuk është parashikuar tek kushtet e tenderit në kriteret e përgjithshme për kualifikim. Pasi kontratat e lidhura të firmës tonë janë kontrata furnizimi, nuk janë pjesëmarrje në procedurë tenderimi ç`ka do të thotë që ne nuk kemi marrë pjesë në tre oferta njëra pas tjetrës. Ofertat janë të ndryshme dhe janë hedhur në mënyrë të pavarur

dhe diskrete nga secili ofertues. Kontrata furnizimit bëhet e vlefshme në rast kualifikimi ose shpallje fitues gjë që nuk përbën kusht për s`kualifikim. Referuar arsyetimit të mësipërm arsyeja e s`kualifikimit nuk qëndron.

- Kërkojmë nga AK për të bërë verifikimin e dokumenteve për firmën “S” ShPK, kryesisht:

- a- Nuk plotësojnë në raport me % e marrë përsipër të gjitha kriteret specifike;
- b- Si dhe kontratat e bashkëpunimit nuk kanë përcaktuar elementet konkretë që do të kryejë secili prej tyre;
- c- Pikën e licencës NS 18;
- d- “A II” ShPK nuk ka kontratë furnizimi me fabrikë asfalti.

Nga ana e Titullarit të AK ka dalë urdhri për pezullimin e procedurës ë prokurimit nr.17/1, datë 14.01.2019 “Për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e KSHA” të përbërë nga:

- 1- V.P
- 2- M.L
- 3- H.N.

KSHA me Vendimin nr. 290/2, datë 21.01.2019, arsyetuar se:

Ankimuesi ka paraqitur në procedurë fabrikën e asfalto betonit. Nga verifikimi i dokumentacionit ka rezultuar se edhe OE “R” ShPK dhe “K” ShPK, kanë paraqitur kontratë furnizimi me shoqërinë “V” ShPK, për të njëjtën fabrikë që ky i fundit e ka vene ne dispozicion në procedurë, veprim i cili bie ndesh me VKM nr. 914, neni 65 “Ndërhyrja në ofertë”, ku është përcaktuar se:

“Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën procedurë prokurimi. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se **një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër**, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi”.

Rrjedhimisht ka konkluduar KSHA se OE “V” ShPK, nëpërmjet kapaciteteve teknike ka marrë pjesë dhe në ofertat e paraqitura nga këto OE.

Në lidhje me pikën 2 të ankimimit KSHA nuk e ka marrë në konsideratë pasi OE mbetet i s`kualifikuar dhe në këto kushte nuk ka interes të ligjshëm në kuptim të pikës 1, neni 63 të LPP.

Kthim përgjigje është bërë me shkresën nr.290/3, datë 21.10.2029.

#### **Konluzion:**

➤ Në lidhje me konkluzionin e KVO se OE nuk kanë arritur të argumentojë se me anë të fabrikës të asfalto betonit me të cilën ka lidhur kontrate qiraje dhe që ka deklaruar se do t`i verë në dispozicion për realizimin e objektit, do të realizojë prodhimin transportin vendosjen dhe ngjeshjen e përzierjes konform kushteve teknike siç përcaktohet në VKM nr. 628, datë 15.07.2015. Në analizat e çmimit të paraqitura nuk rezulton që të jetë reflektuar në çmim largësia nga vendi i prodhimit deri në objekt, **sqarojmë se:**

- Në DST është kërkuar dhe paraqitur Shtojca nr. 5 “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik”.

- Në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar, dalë në zbatim të neneve 7,12 dhe 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave, në pikat 9 dhe 10, është përcaktuar saktë detyra e mbikqyrësit të punimeve në lidhje me çështjen sa më lart.

Në këto kushte gjykimi i KVO nuk është i drejtë.

➤ Vendimi i KVO dhe i KSHA se OE “V” ShPK, nëpërmjet kapaciteteve




## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

teknike ka marrë pjesë dhe në ofertat e paraqitura nga këto OE, nuk qëndron pasi subjekti “V” ShPK, e ka aktivitetet prodhimi fabrikën e asfaltit, është i lirë të lidhë kontrata për këtë aktivitet, njëkohësisht nga aktiviteti i ndërtimit është i lirë të marrë pjesë në procedurë dhe aq më tepër këtë procedurë do ta fitonte vetëm një OE i vlerësuar i rregullt.

#### Sa më sipër ngarkohet përgjegjësi KVO dhe Auditimi i ofertës fituese.

Nga auditimi i ofertës “S” ShPK & “A II” ShPK, vlerën më të ulët të ofruar procedurën e prokurimit 21,925,992 lekë, rezultoi



me  
**KSHA.**

fituese  
me  
në

se:

1- Bazuar në nenin 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, në të cilën është përcaktuar se:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës.

**Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.**

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit **dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.** Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokuruar duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale **dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.**

Rezultoni se BOE ka paraqitur deklaratën noteriale (kontratë partneriteti) nr.7606 rep., nr. 5560 kol., datë 05.12.2018, kanë përcaktuar ndarjen e punëve “S” ShPK 79% dhe “A II” ShPK 21%, duke mos përcaktuar punët konkrete, as në marrëveshjen e partneritetit as të përcaktuara në zërat e preventivit të ofertës së paraqitur, si foto sa vijon:

Sa më sipër BOE nuk e përmbush këtë kriter.

2- Nisur nga kërkesa e disponimit të kategorisë së licensës NS18, OE “A II” ShPK, nuk e ka, sipas dokumentit të paraqitur në spe të APP, kategori që i duhet sipas përshkrimit sipërfaqësor të ndarjes së % së bashkëpunimit.

3- Nisur nga përshkrimi sipërfaqësor i ndarjes së % së bashkëpunimit “A II” ShPK nuk ka kontratë furnizimi me fabrikë asfalti.

BOE nga sa u trajtua duhej të s`kualifikohej.

#### Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO.

Miratimi i procedurës është bërë nga Titullari i AK datë 04.02.2019.

Kontrata është lidhur me nr. Prot., 900/2, datë 27.02.2019, me vlerë 26,311,190.88 lekë, me afat 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

**Konkluzion:** Shpallja fitues dhe lidhja e kontratës me BOE “S” ShPK & “A II” ShPK, është bërë **në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën**

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | <b>21,925,992 lekë pa tvsh.</b>   |
| <b>Kriteri</b>        | Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.          |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën 21,925,992 lekë pa tvsh |
| <b>Shkaku</b>         | Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.                                 |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë   |
| <b>Rekomandimi</b>    | AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.          |

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën 6684/4, datë 01.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot.,260/18 datë 03.06.2021 “Shkresë përcjellëse”, nga *Kryetari i Bashkisë S.F.*, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

.1 Lidhur me pretendimin e audituesve per kapacitetin e mjeteve Nuk është vendosur kapaciteti me qëllim të thjeshtimit të kriterëve, stimulimin e pjesëmarrjes te ofertuesve, rritjen e konkurrencës dhe vlerësimit sa më të drejtë të ofertuesve.

.2 Lidhur me "Nyjen e materialeve inerte" dhe "Fabrikës të asfalto betonit".

.2.a.Nga audituesit është konstatuar se duhej të ishte kërkuar edhe kontratë paraprake furnizimi,pasi kërkesa për kontratë furnizimi e vendos operatorin ekonomik, në rast të mos shpalljes fitues, përpara kushteve kontraktuale.

Lidhur me sa më sipër sqarojmë se:

Së pari : Kriteri është vendosur në përputhje me Rekomandimin e APP Nr 8197 Prot datë 03.09.2018 "Për hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra punë shërbime", ku në pikën 9 është përcaktuar se:

*"...Rekomandojmë që autoritetet kontraktore,në rastet e punëve publike, që kanë nevojë për volume të konsiderueshme të materialeve të ndërtimit (beton apo asfalt) dhe në rastet kur ofertuesi nuk i ka në pronësi impiantet automatikë të prodhimit të materialeve të nevojshme për realizimin e punimeve të ndërtimit të objektit,të kërkojnë nga ofertuesit që ti disponojnë ato me qira apo të kenë kontrata furnizimi për materialet,me disponuesit e impinteve"*

Së dyti: Në kriterin e vendosur nuk është përjashtuar mundësia që ofertuesit të paraqesin kontrata paraprake. Gjithashtu edhe nga KVO janë vlerësuar të vlefshme në të gjitha rastet kur janë paraqitur.

Psh në rastin konkret shoqëria pjesëmarrëse "P.G" sh.p.k,e cila është kualifikuar nga KVO, ka paraqitur kontratë furnizimi me asfalt e cila do të ketë efekt në rast se shpallet fitues.

Më poshtë pjesë nga kontrata e furnizimit të paraqitur nga "P.G" sh.p.k.

Palët deklarojnë se ky furnizim do te behet per efekt të tenderit “Sistemim , asfaltim dhe kanalizim i rrugeve ne bllok banimi Lagjet 5 dhe 13”, me numër të referencës së procedurës REF- 93027-11-06-2018 dhe fond limit 41,666,663 (dyzet e nje milion e gjashteqind e gjashtedhjetë e gjashte mije e gjashteqind e gjashtedhjetë e tre)lek,pa tvsh, me Autoritet Kontraktor –Bashkia Korce, ne qofte se SHOQERIA “PEPA GROUP” sh.p.k do te shpallet fituese .

**KOHËZGJATJA E KONTRATËS:**

Kjo kontratë qiraje i fillon efektet nga dita e fillimit te punimeve ne objektin: “Sistemim , asfaltim dhe kanalizim i rrugeve ne bllok banimi Lagjet 5 dhe 13”, Bashkia Korce dhe perfundon me date kur te perfundojne punimet ne objektin:“Sistemim , asfaltim dhe kanalizim i rrugeve ne bllok banimi Lagjet 5 dhe 13”, ne qofte se shoqeria “Pepa Group” shpk shpallet fitues ne tenderin e sipercituar.

III.3.b.Nga audituesit është konstatuar se nuk qëndron shënimi i vendosur ne DST si vijon: “*Lidhur me fabriken e asfaltobetonit ofertuesit duhet te kene ne pronesi,me qera apo te lidhin kontrate furnizimi me nje fabrike vendndodhja e se ciles garanton realizimin e objektit konform kushteve teknike te percaktuara ne VKM Nr.628 date 15.07.2015 “Per miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe Ndertimit te Rrugeve”.*

Lidhur me sa më sipër sqarojmë se:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

Së pari: Kriteri është vendosur me qëllim që të vërtetohet disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e kontratës.

Ky kriter nuk është vendosur që të vërtetohet cilësia e materialeve, pasi sic është argumentuar edhe nga ana juaj, KVO nuk vlerëson cilësinë e materialeve.

Në nenin 26 pika 8.c VKM Nr 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar" përcaktohet se :

*"Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

*... c.dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."*

Pra është detyrim i autoritetit kontraktor që të kërkojë mjete dhe pajisje teknike të cilat janë të nevojshme për të përmbushur kontratën.

Nga ana tjetër ofertuesi ka detyrimin të vërë në dispozicion për realizimin e objektit makineri dhe pajisje funksionale dhe që mund ti vërë realisht në dispozicion për realizimin e objektit të kërkuar.

Në rast se fabrika e asfaltit ndodhet në një largësi që nuk mund të vihet në dispozicion të objektit atëherë rrjedhimisht ofertuesi nuk mund ta realizojë objektin.

Duke qënë se VKM Nr.628 date 15.07.2015 "Per miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe Ndertimit te Rrugeve " parashikohet detyrimi që:

- *Perzierja e prodhuar duhet zakonisht te transportohet menjehere ne kantierin e ndertimit.*
- *E gjithë procedura e prodhimit, transportit, vendosjes dhe ngjeshjes se perzierjes nuk lejohet te jete me shume se 2(dy) ore,*

atëherë rrjedhimisht operatorët duhet të disponojnë mjete/pajisje teknike që të përmbushin këtë detyrim.

Në përfundim mendojmë se nuk përbën shkelje fakti që operatorëve ju është vënë në dukje se duhet të disponojnë një fabrikë që respekton kërkesat e VKM 628 datë 15.07.2015.

Lidhur me vlerësimin e ofertave.

I. Nga audituesit është konstatuar se skualifikimi i operatorëve për shkak se nuk kanë mundur të vërtetojnë se fabrika e asfatobetonit që kanë deklaruar do të vihet në dispozicion të objektit , nuk është i drejtë, sqarojmë se:

-Bazuar nenin 53 te Ligjit Nr Nr.9643, datë 20.11.1996 "Për Prokurimin Publik" ku përcaktohet se "Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave.

-Bazuar ne nenin 46 të LPP, pika 1.b "1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;"

- Në shtojcën 10 "Mbi disponimin e makinerive" ofertuesit kanë deklaruar se zotërojnë mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën , ku ndër të tjera është deklaruar edhe fabrika e asfalto betonit. Gjithashtu është autorizuar autoriteti kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

-Bazuar në sa më sipër KVO ka kërkuar sqarime lidhur fabrikën e asfaltobetonit. Sqarimi që ka kërkuar KVO është në kuadrin e verifikimit të mjeteve/pajiseve/aseteve të vëna në dispozicion për zbatimin e kontratës.

-Mbështetur në sqarimet e sjella KVO ka arritur në përfundimin se disa prej operatorëve nuk përmbushin kriterin e vendosur ne DST,Shtojca 12,kriteret e vecanta te kualifikimit,kapaciteti

teknik,pika 5,disponimi i mjeteve. Këta operatorë nuk kanë argumentuar që fabrikat e deklaruara prej tyre do të vihen në dispozicion të realizimit të kontratës duke respektuar kërkesat e VKM Nr 628 date 15.07.2015 “Per miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe Ndertimit te Rrugeve. Për sa kohë që ata nuk respektojnë kërkesat e VKM Nr 628 ata nuk mund ti vënë në dispozicion të realizimit të objektit dhe rrjedhimisht nuk mund të vlerësohet i përmbushur kriteri për disponimin e mjeteve.

-Ju sqarojmë se KVO nuk ka patur në asnjë rast qëllim të vlerësojë cilësinë e materialeve që do të përdoren në objekt. KVO, në cdo rast, ka vlerësuar vetëm nëse operatorët ekonomikë zotërojnë makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

- Gjithashtu, pjesëmarrësve në këtë procedurë prokurimi ju është dhënë mundësia që brenda afatit ligjor të percaktuar në nenin 63 të ligjit 9643 dt.20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” indryshuar, të paraqesnin ankesat e tyre si për kriteret e kualifikimit ashtu edhe për vlerësimin e ofertave dhe nëse ato nuk do të merreshin parasysh nga Autoriteti Kontraktor mund të depozitonin ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik.

Theksojmë se nuk ka patur asnjë ankesë lidhur me kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit dhe as lidhur me vlerësimin e bërë nga KVO për fabrikën e asfalto betonit.

II. Lidhur me skualifikimin e shoqërisë V sh.p.k, R sh.p.k dhe K sh.p.k, ju sqarojmë se edhe nga KVO edhe nga KSHA është vlerësuar si ndërhyrje në oferte(sipas nenit 65 të VKM nr.914) me argumentimin si më poshtë:

Duke qenë se në kontratat e furnizimit me asfaltobeton të lidhura nga shoqëria V sh.p.k me shoqëritë R sh.p.k dhe K sh.p.k është cituar shprehimisht se furnizimi me asfalto beton do të bëhet për procedurën me objekt “Sistemi,asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi Lagjet 5 dhe 13” atëherë rrjedhimisht shoqëria “Vashtemia” sh.p.k nëpërmjet kapaciteteve të saj teknike ka marrë pjesë edhe në ofertën e paraqitur nga shoqëritë R sh.p.k dhe K sh.p.k, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 65 të VKM 914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Gjithashtu shoqërisë V i dhënë mundësia që brenda afatit ligjor të percaktuar në nenin 63 të ligjit 9643 dt.20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” indryshuar, të paraqesë ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik.

Pavarësisht sa më sipër kjo shoqëri nuk ka paraqitur ankesë në KPP.

III. Lidhur me kualifikimin e bashkimit të shoqërive "S sh.p.k dhe A II sh.p.k" nga audituesit konstatohet se shoqëria A II sh.p.k nuk plotësohet kriteri për disponimin e kategorisë të licencës NS 18 dhe gjithashtu nuk ka fabrikë asfalti.

Lidhur me sa më sipër ju sqarojmë se në kushtet kur shoqëria A II ka marrë përsipër 21 % të punimeve, kryesisht punime kanalizimi dhe një pjesë të vogël(në raport me totalin) të shtrimit me asfalt, gjithashtu nisur edhe nga oferta më e ulët e paraqitur dhe mirëpërdorimi i fondeve publike, ka vendosur të kualifikojë bashkimin e shoqërive "S sh.p.k dhe A II sh.p.k".

Gjithë pjesëmarrësve në këtë procedurë prokurimi ju është dhënë mundësia që brenda afatit ligjor të percaktuar në nenin 63 të ligjit 9643 dt.20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” indryshuar, të paraqesnin ankesat e tyre si për kriteret e kualifikimit ashtu edhe për vlerësimin e ofertave dhe nëse ato nuk do të merreshin parasysh nga Autoriteti Kontraktor mund të depozitonin ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik.

### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

- Në lidhje me kriterin e kontratave të ngjashme komenti juaj se “në asnjë rast nuk është kërkuar një vlerë më e madhe se 50% e vlerës të kontratës që prokurohet dhe as një vlerë më e madhe se dyfishi i vlerës limit”, merret në konsideratë.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

- Në lidhje me komentin se “Në kriterin e vendosur nuk është përjashtuar mundësia që ofertuesit të paraqesin kontrata paraprake. Gjithashtu edhe nga KVO janë vlerësuar të vlefshme në të gjitha rastet kur janë paraqitur”, ju sqarojmë se vlefshmëria e tyre kur nuk është kërkuar si e tillë tregon vlerësim jo në kushtet e kërkuara në DST.
- Në lidhje me komentin tuaj se “mendojmë se nuk përbën shkelje fakti që operatorëve ju është vënë në dukje se duhet të disponojnë një fabrikë që respekton kërkesat e VKM 628 datë 15.07.2015”, ju sqarojmë se nuk është detyrë e KVO detyrat e mbikqyrësit të punimeve, trajtuar më hollësisht në akt konstatimin përkatës.
- Në lidhje me pretendimin se: “Theksojmë se nuk ka patur asnjë ankese lidhur me kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit dhe as lidhur me vlerësimin e bërë nga KVO për fabrikën e asfalto betonit, ju sqarojmë se fakti që nuk ka patur ankese nuk do të thotë që nuk është kërkesë e gabuar.
- Lidhur me pretendimin se “Duke qene se ne kontratat e furnizimit me asfaltobeton te lidhura nga shoqëria V sh.p.k me shoqerite R sh.p.k dhe K sh.p.k eshte cituar shprehimisht se furnizimi me asfalto beton do te behet per proceduren me objekt “Sistemim,asfaltim dhe kanalizim i rrugëve ne bllok banimi Lagjet 5 dhe 13” atehere rrjedhimisht shoqeria “Vashtemia” sh.p.k nepermjet kapaciteve te saj teknike ka marre pjese edhe ne oferten e paraqitur nga shoqerite R sh.p.k dhe K sh.p.k, veprim ky qe eshte ne kundërshtim me nenin 65 te VKM 914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, sqarimet janë dhënë në aktkonstatimin përkatës dhe në këtë Projekt raport në gjetjen sa më lart.
- Në lidhje me komentin tuaj se: “Kriteri është vendosur në përputhje me Rekomandimin e APP Nr 8197 Prot datë 03.09.2018 "Për hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra punë shërbime", ku në pikën 9 është përcaktuar se: "...Rekomandojmë që autoritetet kontraktore,në rastet e punëve publike,që kanë nevojë për volume të konsiderueshme të materialeve të ndërtimit (beton apo asfalt) dhe në rastet kur ofertuesi nuk i ka në pronësi impiantet automatikë të prodhimit të materialeve të nevojshme për realizimin e punimeve të ndërtimit të objektit,të kërkojnë nga ofertuesit që ti disponojnë ato me qira apo të kenë kontrata furnizimi për materialet,me disponuesit e impinteve", ju sqarojmë se kontrata e furnizimit i vendos operatorët ekonomikë në rast të mos shpalljes fitues përpara detyrimeve kontraktuale.
- Lidhur me pretendimin: “Lidhur me kualifikimin e bashkimit të shoqërive "S sh.p.k dhe A II sh.p.k" nga audituesit konstatohet se shoqëria A II sh.p.k nuk plotësohet kriteri për disponimin e kategorisë të licencës NS 18 dhe gjithashtu nuk ka fabrikë asfalti. Lidhur me sa më sipër ju sqarojmë se në kushtet kur shoqëria A II ka marrë përsipër 21 % të punimeve, kryesisht punime kanalizimi dhe një pjesë të vogël(në raport me totalin) të shtrimit me asfalt, gjithashtu nisur edhe nga oferta më e ulët e paraqitur dhe mirëpërdorimi i fondeve publike, ka vendosur të kualifikojë bashkimin e shoqërive "S sh.p.k dhe A II sh.p.k".  
Ju sqarojmë se: Nisur nga kërkesa e disponimit të kategorisë së licensës NS18, OE “A II” ShPK, nuk e ka, sipas dokumentit të paraqitur në spe të APP, kategori që i duhet sipas përshkrimit sipërfaqësor të ndarjes së % së bashkëpunimit.  
Sa trajtuar komenti juaj nuk merret në konsideratë.

**Likuidim i objektit:** “Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi lagjet 5 dhe 13”

#### Titulli gjetjes

**Mbi penalitetet që lindin si pasojë e dorëzimit të faturave tatimore të mëvonshme nga data e përfundimit të kontratës - “Sistemim, asfaltim dhe**

|                        | kanalizim i rrugëve në bllok banimi lagjet 5 dhe 13”, kontraktues "S" shpk & "A" shpk  |                   |                   |                  |                   |                        |                   |                        |                   |           |     |            |           |         |           |     |          |           |         |        |         |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |      |          |                   |  |  |                   |                  |                   |  |  |           |     |                   |           |        |           |     |          |                   |  |  |                  |               |                  |  |  |                        |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |  |             |        |  |  |  |  |
|------------------------|--|-------------------|-------------------|------------------|-------------------|------------------------|-------------------|------------------------|-------------------|-----------|-----|------------|-----------|---------|-----------|-----|----------|-----------|---------|--------|---------|-----|----------|-----------|-----|------------|-----------|---------|-----------|-----|----------|-----------|-----|------------|-----------|---------|-----------|-----|----------|-----------|-----|------------|-----------|---------|-----------|------|----------|-------------------|--|--|-------------------|------------------|-------------------|--|--|-----------|-----|-------------------|-----------|--------|-----------|-----|----------|-------------------|--|--|------------------|---------------|------------------|--|--|------------------------|--|-------------------|-------------------|------------------|-------------------|--|--|--|--|----------|------------|--|--|--|--|--|--|-------------|--------|--|--|--|--|
| <b>Situata</b>         | <p>Nga auditimi i kampionit të urdhër shpenzimeve me objekt investimet kapitale të vitit 2018 dhe 2019 rezultoi se nga ana Bashkisë Korçë, nga likuidimi i shpenzimeve kapitale për investimet, fatura tatimore bashkëlidhur urdhër shpenzimeve kanë datë lëshimi të mëvonshme nga data e situacionit përfundimtar.</p> <p><b>Likuidim i objektit:</b> Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi, lagjet 5 dhe 13. Kontratë e lidhur më datën 27.02.2019, me Nr. Kontrate <u>900/2</u> prot., afati 6 muaj, kontraktues "S" shpk &amp; "A" shpk. Vlera totale e kontratës 26,311,191 lekë Kodi i projektit 1220552</p> <p>Amendament kontrate datë 02.09.2019 shtyrje 56 ditë</p> <p>Afati I përfundimit <b><u>22.10.2019</u></b></p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Emri I Furnitorit</th> <th>Nr.Fat</th> <th>Datë fature</th> <th>Sh.Totale</th> <th>G.Punimi</th> <th>Sh.Operatori</th> <th>Nr i urdher shpenzimit</th> <th>Data e Likuidimit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>"S" &amp; "A"</td> <td rowspan="2">755</td> <td rowspan="2">07.05.2019</td> <td>8,000,000</td> <td>400,000</td> <td>7,600,000</td> <td>542</td> <td>10.05.19</td> </tr> <tr> <td>"S" &amp; "A"</td> <td>591,923</td> <td>29,596</td> <td>562,327</td> <td>697</td> <td>17.06.19</td> </tr> <tr> <td>"S" &amp; "A"</td> <td>758</td> <td>24.06.2019</td> <td>3,287,207</td> <td>164,360</td> <td>3,122,847</td> <td>735</td> <td>25.06.19</td> </tr> <tr> <td>"S" &amp; "A"</td> <td>764</td> <td>26.07.2019</td> <td>4,136,725</td> <td>206,836</td> <td>3,929,889</td> <td>892</td> <td>30.07.19</td> </tr> <tr> <td>"S" &amp; "A"</td> <td>776</td> <td>17.10.2019</td> <td>8,577,178</td> <td>428,859</td> <td>8,148,319</td> <td>1239</td> <td>21.10.19</td> </tr> <tr> <td><b>Shuma 2019</b></td> <td></td> <td></td> <td><b>24,593,033</b></td> <td><b>1,229,652</b></td> <td><b>23,363,381</b></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>"S" &amp; "A"</td> <td>785</td> <td><b>16.11.2019</b></td> <td>1,690,818</td> <td>84,541</td> <td>1,606,277</td> <td>391</td> <td>29.04.20</td> </tr> <tr> <td><b>Shuma 2020</b></td> <td></td> <td></td> <td><b>1,690,818</b></td> <td><b>84,541</b></td> <td><b>1,606,277</b></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td><b>Shuma 2019-2020</b></td> <td></td> <td><b>Likujdimet</b></td> <td><b>26,283,851</b></td> <td><b>1,314,193</b></td> <td><b>24,969,658</b></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>kontrata</td> <td>26,311,191</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>palikujduar</td> <td>27,340</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p><b>Paraqitur fatura tej afatit të kontratës nga data 22.10.2019 në datën 16.11.2019, ose 24 ditë vonesë.</b></p> <p>Bazuar në nenin 27 të kontratës Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve, pika 27,1 referon;</p> <p>“Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve do të llogariten me tarifën ditore</p> <p>- tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës?</p> <p>Nisur nga vlera e mbetur e kontratës, e cila paraqitet 1,690,818 lekë dhe nga vlera minimale e mbi të cilën llogaritet kamatvonesa (25%*26,311,191=6,577,798 lekë), bazuar në nenin e kontratës do të zgjedhim për llogaritje vlerën 6,577,798 lekë, pra minimalisht 25% e saj.</p> <p>Përfundimisht kamatvonesa për fatura jashtë afatit të kontratës është;</p> <p><b><i>Kamatvonesa= 25%*26,311,191*4/1000= 26,312 lekë</i></b></p> | Emri I Furnitorit | Nr.Fat            | Datë fature      | Sh.Totale         | G.Punimi               | Sh.Operatori      | Nr i urdher shpenzimit | Data e Likuidimit | "S" & "A" | 755 | 07.05.2019 | 8,000,000 | 400,000 | 7,600,000 | 542 | 10.05.19 | "S" & "A" | 591,923 | 29,596 | 562,327 | 697 | 17.06.19 | "S" & "A" | 758 | 24.06.2019 | 3,287,207 | 164,360 | 3,122,847 | 735 | 25.06.19 | "S" & "A" | 764 | 26.07.2019 | 4,136,725 | 206,836 | 3,929,889 | 892 | 30.07.19 | "S" & "A" | 776 | 17.10.2019 | 8,577,178 | 428,859 | 8,148,319 | 1239 | 21.10.19 | <b>Shuma 2019</b> |  |  | <b>24,593,033</b> | <b>1,229,652</b> | <b>23,363,381</b> |  |  | "S" & "A" | 785 | <b>16.11.2019</b> | 1,690,818 | 84,541 | 1,606,277 | 391 | 29.04.20 | <b>Shuma 2020</b> |  |  | <b>1,690,818</b> | <b>84,541</b> | <b>1,606,277</b> |  |  | <b>Shuma 2019-2020</b> |  | <b>Likujdimet</b> | <b>26,283,851</b> | <b>1,314,193</b> | <b>24,969,658</b> |  |  |  |  | kontrata | 26,311,191 |  |  |  |  |  |  | palikujduar | 27,340 |  |  |  |  |
| Emri I Furnitorit      | Nr.Fat   | Datë fature       | Sh.Totale         | G.Punimi         | Sh.Operatori      | Nr i urdher shpenzimit | Data e Likuidimit |                        |                   |           |     |            |           |         |           |     |          |           |         |        |         |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |      |          |                   |  |  |                   |                  |                   |  |  |           |     |                   |           |        |           |     |          |                   |  |  |                  |               |                  |  |  |                        |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |  |             |        |  |  |  |  |
| "S" & "A"              | 755  | 07.05.2019        | 8,000,000         | 400,000          | 7,600,000         | 542                    | 10.05.19          |                        |                   |           |     |            |           |         |           |     |          |           |         |        |         |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |      |          |                   |  |  |                   |                  |                   |  |  |           |     |                   |           |        |           |     |          |                   |  |  |                  |               |                  |  |  |                        |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |  |             |        |  |  |  |  |
| "S" & "A"              |  |                   | 591,923           | 29,596           | 562,327           | 697                    | 17.06.19          |                        |                   |           |     |            |           |         |           |     |          |           |         |        |         |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |      |          |                   |  |  |                   |                  |                   |  |  |           |     |                   |           |        |           |     |          |                   |  |  |                  |               |                  |  |  |                        |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |  |             |        |  |  |  |  |
| "S" & "A"              | 758  | 24.06.2019        | 3,287,207         | 164,360          | 3,122,847         | 735                    | 25.06.19          |                        |                   |           |     |            |           |         |           |     |          |           |         |        |         |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |      |          |                   |  |  |                   |                  |                   |  |  |           |     |                   |           |        |           |     |          |                   |  |  |                  |               |                  |  |  |                        |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |  |             |        |  |  |  |  |
| "S" & "A"              | 764  | 26.07.2019        | 4,136,725         | 206,836          | 3,929,889         | 892                    | 30.07.19          |                        |                   |           |     |            |           |         |           |     |          |           |         |        |         |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |      |          |                   |  |  |                   |                  |                   |  |  |           |     |                   |           |        |           |     |          |                   |  |  |                  |               |                  |  |  |                        |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |  |             |        |  |  |  |  |
| "S" & "A"              | 776  | 17.10.2019        | 8,577,178         | 428,859          | 8,148,319         | 1239                   | 21.10.19          |                        |                   |           |     |            |           |         |           |     |          |           |         |        |         |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |      |          |                   |  |  |                   |                  |                   |  |  |           |     |                   |           |        |           |     |          |                   |  |  |                  |               |                  |  |  |                        |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |  |             |        |  |  |  |  |
| <b>Shuma 2019</b>      |  |                   | <b>24,593,033</b> | <b>1,229,652</b> | <b>23,363,381</b> |                        |                   |                        |                   |           |     |            |           |         |           |     |          |           |         |        |         |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |      |          |                   |  |  |                   |                  |                   |  |  |           |     |                   |           |        |           |     |          |                   |  |  |                  |               |                  |  |  |                        |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |  |             |        |  |  |  |  |
| "S" & "A"              | 785  | <b>16.11.2019</b> | 1,690,818         | 84,541           | 1,606,277         | 391                    | 29.04.20          |                        |                   |           |     |            |           |         |           |     |          |           |         |        |         |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |      |          |                   |  |  |                   |                  |                   |  |  |           |     |                   |           |        |           |     |          |                   |  |  |                  |               |                  |  |  |                        |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |  |             |        |  |  |  |  |
| <b>Shuma 2020</b>      |  |                   | <b>1,690,818</b>  | <b>84,541</b>    | <b>1,606,277</b>  |                        |                   |                        |                   |           |     |            |           |         |           |     |          |           |         |        |         |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |      |          |                   |  |  |                   |                  |                   |  |  |           |     |                   |           |        |           |     |          |                   |  |  |                  |               |                  |  |  |                        |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |  |             |        |  |  |  |  |
| <b>Shuma 2019-2020</b> |  | <b>Likujdimet</b> | <b>26,283,851</b> | <b>1,314,193</b> | <b>24,969,658</b> |                        |                   |                        |                   |           |     |            |           |         |           |     |          |           |         |        |         |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |      |          |                   |  |  |                   |                  |                   |  |  |           |     |                   |           |        |           |     |          |                   |  |  |                  |               |                  |  |  |                        |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |  |             |        |  |  |  |  |
|                        |  | kontrata          | 26,311,191        |                  |                   |                        |                   |                        |                   |           |     |            |           |         |           |     |          |           |         |        |         |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |      |          |                   |  |  |                   |                  |                   |  |  |           |     |                   |           |        |           |     |          |                   |  |  |                  |               |                  |  |  |                        |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |  |             |        |  |  |  |  |
|                        |  | palikujduar       | 27,340            |                  |                   |                        |                   |                        |                   |           |     |            |           |         |           |     |          |           |         |        |         |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |      |          |                   |  |  |                   |                  |                   |  |  |           |     |                   |           |        |           |     |          |                   |  |  |                  |               |                  |  |  |                        |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |  |             |        |  |  |  |  |
| <b>Kriteri</b>         | <p>KPK neni “Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve”;</p> <p>Ligji nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar neni 7,12, dhe 18</p> <p>UKM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3 datë 15.02.2001 “ Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i</p>  |                   |                   |                  |                   |                        |                   |                        |                   |           |     |            |           |         |           |     |          |           |         |        |         |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |     |          |           |     |            |           |         |           |      |          |                   |  |  |                   |                  |                   |  |  |           |     |                   |           |        |           |     |          |                   |  |  |                  |               |                  |  |  |                        |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |  |             |        |  |  |  |  |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                       |  |
|-----------------------|--|
|                       | ndryshuar.” dhe i ngarkohet investitorëve përgjegjësia për këtë veprim. Pranimi i dokumentacionit vërtetues është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 6 e udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “pika 35 dhe 36, është përgjegjësi e nëpunësit zbatues siç shprehet edhe neni 12 pika 3 germa dh) dhe e) e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Pranimi i dokumentacionit të paplotë, përbën risk për sa i përket vërtetësisë së shpenzimit kapital. Gjithashtu vlera totale e penaltetit ku faturat janë paraqitur shumë më vonë se sa koha e situacionit në shumën <b>26,312 lekë</b> përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit  |
| <b>Shkaku</b>         | Mos zbatim i akteve ligjore  |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë  |
| <b>Rekomandimi</b>    | Nga Bashkia Korçë, të merren masa që likuidimi i shpenzimeve të kryhet bazuar në dokumentacion të plotë, autorizues dhe vërtetues të shpenzimit kapital.<br>Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik <b>në shumën 26,312 lekë</b> , si pasojë e mosmbajtjes së kamatvonesave.  |

**Viti 2019**

|  |  |  |
|--|--|--|
| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <b>“Investime në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit: Loti I- “Rikonstruksion i veprave ujitëse (Ura Polenë)”</b> |  |  |
| <b>Urdhër Prokurimi</b><br>nr. 889, datë 15.10.2019  | <b>NJHDT:</b><br>Njësia e Prokurimit<br>1.M.S(Jurist)<br>2.M.B(Ing. agroushqimore)<br>3.B.M(Ing. ndërtimi) | <b>4.KVO:</b><br>Urdhër <b>Nr.889/1prot, datë 15.10.2019</b> , dhe i përberë nga:<br>1.B.TH kryetare<br>2. A.D<br>3.M.B anëtare<br>4.K.P anëtare<br>5.H.N anëtar |
| Lloji “Kërkese propozim”   |  |  |
| <b>Fondi Limit:</b><br>903,147 lekë  | <b>OE Fitues i procedurës:</b><br>“N” ShPK   |  |
| <b>Data e hapjes së tenderit:</b> 04.11.2019   |  |  |
| <b>Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e Bashkisë   | <b>Vlera e fituar</b> 716,299 lekë   | <b>Operatorët Ekonomike</b><br>Pjesëmarrës në tender: 3 OE<br>S’kualifikuar 2 OE,<br>Kualifikuar 1 OE  |
| <b>Ankimime në AK:</b> s`ka<br><b>Ankimime në KPP:</b> - s`ka  | <b>Diferenca me fondin limit</b><br>186,848 lekë   |  |

|                        |   |
|------------------------|---|
| <b>Titulli gjetjes</b> | <b>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.</b>   |
| <b>Situata</b>         | Nga ana e KVO pas shqyrtimit të ofertave ekonomike ka rezultuar se nga ofertat e kualifikuara oferta e OE “AV” ShPK është <b>me çmim anomalisht të ulët. Nga ana e KVO është kërkuar</b> me shkresën nr.10668 prot., datë 12.11.2019 dhe njëkohësisht nëpërmjet sistemit të APP në rubrikën “kërkesat” <b>argumentimi i çmimit për zërat kryesorë (13 zëra)</b><br>OE “AV” ShPK ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 10668/1 prot., datë 14.11.2019, duke dhënë dhe justifikimin e vet për ofertën e paraqitur të shoqëruar me analiza çmimi për zërat e kërkuar si dhe fatura tatimore shitje.<br>KVO nga argumentimi i paraqitur ka konkluduar se ofertuesi nuk ka parashikuar |

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | <p>në çmim transportin e materialeve nga Vlora në Korçë me arsyetimin se bëhet fjale për një distance të konsiderueshme dhe kostoja e transportit duhej të ishte reflektuar dhe argumentuar në sqarimet e paraqitura. Gjithashtu edhe për sqarimet e paraqitura në analizat e çmimeve nuk është parashikuar diferenca e transportit të materialeve inerte çimentos dhe hekurit.</p> <p>Për sa me sipër KVO ka vendosur të s'kualifikoje ofertën e paraqitur nga shoqëria "AV" s ShPK, per Lotin 1, "Rikonstruksioni i veprave ujitëse (ura në Polenë)", pasi argumentimi i ofertës së shoqërisë në fjalë, nuk ishte bindës dhe nuk justifikonte çmimet e ofruara.</p> <p>Nga auditimi rezulton se s'kualifikimi për këtë arsye nuk qëndron pasi nuk është detyrë e KVO të vlerësojë cilësinë e mallit që do të vendoset në kantier por është përgjegjësi e subjektit, i cili ka lëshuar deklaratën e plotësimit të specifikimeve teknike dhe e mbikëqyrësit të punimeve i cili vlerëson cilësinë, bazuar në analizat dhe vendosjen në kantier, bazuar në Udhëzim nr. 3, datë 15.02.2001 për "Mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". Për rrjedhojë KVO nuk duhej ta s'kualifikonte këtë OE.</p> <p><b>Paligjshmëria në përdorimin e fondeve nga kjo procedurë është 49,160 lekë. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO.</b></p> |
| <b>Kriteri</b>        | Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.  |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën <b>49,160</b> lekë pa tvsh  |
| <b>Shkaku</b>         | Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.   |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë   |
| <b>Rekomandimi</b>    | AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.  |

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën 6684/4, datë 01.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot.,260/18 datë 03.06.2021 "Shkresë përcjellëse", nga *Kryetari i Bashkisë S.F*, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

**Prendimi i subjektit:**

Ju sqarojmë se KVO nuk ka bërë vlerësimin e cilësisë të mallit që do të vendoset në kantier por vlerësimin e rregullshmerisë dhe besueshmërisë të dokumentacionit të paraqitur. Në rast se analiza e cmimit nuk është e rregullt apo bindëse në një apo disa elementë përbëers atëherë KVO ka të drejtë ta refuzojë .

Konkretisht ofertuesi nuk ka pasqyruar në cmim transportin e materialeve, te cilat sipas dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi ndodheshin ne Vlorë. Duke qënë se kostoja e transportit është pjesë e koston të përgjithshme, mosreflektimi i saj në analizën e cmimit përbën mangësi në argumentimin e cmimit të paraqitur.

Për sa më sipër mendojmë se skualifikimi i shoqërisë AV sh.p. është bërë bazuar ne nenin 56 pika 2 të LPP ku përcaktohet se "...Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj."

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: nuk është detyrë e KVO të vlerësojë cilësinë e mallit që do të vendoset në kantier por është përgjegjësi e subjektit, i cili ka lëshuar deklaratën e plotësimit të specifikimeve teknike dhe e mbikëqyrësit të punimeve i cili vlerëson cilësinë, bazuar në analizat dhe vendosjen në kantier, bazuar në Udhëzim nr. 3, datë 15.02.2001 për "Mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". Për rrjedhojë KVO nuk duhej ta s'kualifikonte këtë OE.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

Sa më sipër komentuar ju sqarojmë se ju nuk keni paraqitur prova dhe fakte të reja e për rrjedhojë komenti juaj nuk merret në konsideratë.

Procedura e prokurimit publik me objekt: **“Rikonstruksion i veprave ujitëse”:**

|   |   |  |
|---|---|--|
| <b>Urdhër prokurimi</b><br>Nr, 248 datë 02.04.2019, | <b>NJHDT:</b><br>1.M.S(Jurist)                    | <b>KVO:</b> nr.248/1prot, datë 02.04.2019  |
| <b>Lloji i procedurës</b> “kërkesë për propozim”    | 2.M.B(Ing.agro ushqimore)<br>3.B.M(Ing. ndërtimi) | 1.B.TH Kryetare<br>2. M.BAnetare<br>3. O.PAnetar<br>4 A.DAnetar<br>5.H.NAnetar                   |
| <b>Fondi Limit</b> 4,353,420 lekë.                  | <b>fituese:</b> A.K 2002 shpk                     |  |
| <b>Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e Bashkisë    |   |  |
| <b>Data e hapjes së tenderit:</b> 15.04.2019        | <b>Vlera e fituar:</b> 2,597,700 lekë             | <b>Operatorët Ekonomike</b><br>Pjesëmarrës në tender: 7 OE<br>S’kualifikuar 1 OE,<br>Kualifikuar |
| <b>Ankimime në AK:</b> s`ka                         | <b>Diferenca me fondin limit</b>                  |  |
| <b>Ankimime në KPP:-</b> s`ka                       | 1,755,720 lekë                                    |  |

| <b>Titulli gjetjes</b> | <b>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.</b>   |
|------------------------|---|
| <b>Situata</b>         | <p><b>Hartimi i dokumenteve të tenderit:</b><br/> <b>DT</b> për hartimin e kriterëve teknike të veçanta për kualifikim janë sipas procesverbalit datë 03.04.2019, të hartuar nga B.M, bazuar në të dhënat teknike nga ing. P.P.<br/> Në këtë procesverbal është përcaktuar kërkesa për një punësim mesatar për 35 punonjës (+ tre inxhinierë).<br/> Nisur nga vlera e fondit limit dhe preventivi i objektit prej 4,353,420 lekë, <b>ky numër nuk është i argumentuar.</b><br/> <b>Procesverbali nr.1 i hartimit të DT</b> mban datën 03.04.2019.<br/> <b>Në hartimin e DT</b> në lidhje me kriteret rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:<br/> <b>1-</b> Seksioni II, “Informacione të veçanta për kontratat”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 7.<br/> <b>2-</b> Kreu VII, “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2.<br/> <b>Si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:</b><br/> <b>Në pikën 4.1.</b> është kërkuar: Një punësim mesatar i të paktën 38 (tridhjetë e tete) personash, per periudhen Dhjetor 2018 - Shkurt 2019 dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi .<br/> ➤ Ky numër nuk është i argumentuar me volum dhe grafik punimesh.<br/> <b>Në pikën 5</b> është kërkuar <b>“Disponimi i mjeteve”</b><br/> ➤ Në lidhje me mjetet (kamion, betonierë, nuk janë përcaktuar kapacitetet e tyre, në lidhje me objektin dhe nevojat e zbatimit të kontratës.<br/> <b>Sa më sipër sipas pikave të kriterëve për kualifikim ngarkohet me përgjegjësi NJHD.</b></p> |
| <b>Kriteri</b>         | Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.  |
| <b>Ndikimi/efekti</b>  | Përcaktim i kriterëve jo në lidhje me objektin e prokurimit dhe mosargumentim i tyre.   |
| <b>Shkaku</b>          | Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.   |
| <b>Rendesia</b>        | E lartë   |
| <b>Rekomandimi</b>     | AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.  |

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën 6684/4, datë 01.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot.,260/18 datë 03.06.2021 “Shkresë përcjellëse”, nga Kryetari i Bashkisë S.F, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

#### **Pretendimi i subjektit:**

Lidhur me hartimin e dokumentave të tenderit.

I.Në procesverbalin datë 03.04.2019 " Per hartimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit për objektin e prokurimit “Rikonstruksion i veprave ujitesë”, të mbajtur nga specialisti i fushës në njësinë e prokurimit lidhur me numrin e punonjësve,në pikën 2.1 është kërkuar si më poshtë:

"2.1. Një punësim mesatar i të paktën 38 (tridhjetë e tete) personash, për periudhën Dhjetor 2018 - Shkurt 2019 dokumentuar kjo me vertetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi .

#### Argumentimi i kriterit

*“Numri i punetoreve u vendos referuar llogaritjes të bërë nga preventivuesi,ing.\_P.P. Kriteri i mesiperm u vendos bazuar në nenin 46 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Per prokurimin publik”,i ndryshuar, neni 26 pika 8.b VKM Nr 914 date 29.12.2014 ”Per miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar.*

*Ky kriter u vendos me qëllim që të vertetohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë fuqinë punetore të nevojshme për realizimin e kësaj kontrate.*

*Llogaritja e numrit të punonjësve është bërë bazuar në VKM Nr 629 date 15.07.2015 ”Per miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre” dhe në Ligjin Nr 7961 date 12.07.1995”Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”i ndryshuar dhe në afatin e zbatimit të punimeve, sipas tabelës bashkelidhur procesverbalit. ”*

2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të përfshirë në listpagesa për periudhën Dhjetor 2018 – Shkurt 2019 nga një Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Topograf

Inxhinier Hidroteknik, per te cilet duhet te paraqiten: I.diploma ,II- kontrata e punës

#### Argumentimi i kriterit

*“Inxhinierët e kërkuar u vendosen referuar llogaritjes të punonjësve të bërë nga preventivuesi,ing.Pavli Petri. Kriteri i mesiperm u vendos bazuar në nenin 46 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Per prokurimin publik”,i ndryshuar, neni 26 pika 8.b VKM Nr 914 date 29.12.2014 ”Per miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar ,VKM Nr 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.*

*Ky kriter u vendos duke patur parasysh punimet e parashikuara në preventiv dhe me qëllim që të vertetohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë specialistet e nevojshëm për realizimin me sukses të kësaj kontrate. ”*

-Sic është argumentuar në procesverbalin e mbajtur nga specialisti, llogaritja e numrit të punonjësve është bërë bazuar në VKM Nr 629 date 15.07.2015 ”Per miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”dhe në Ligjin Nr 7961 date 12.07.1995”Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”i ndryshuar dhe në afatin e zbatimit të punimeve. Bashkelidhur do të gjëni tabelën e detajuar të llogaritjes të numrit të punonjësve bazuar në orët e punës, volumet e punës dhe kohëzgjatjen e punimeve.

II. Në procesverbalin Nr 1 datë 03.04.2019 "Për hartimin e dokumentave të tenderit" të mbajtur nga njësi e prokurimit,lidhur me përvojën e mëparshme është kërkuar:

*"Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme ,ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit është sa*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

*dyfishi i vlerës limit të kontratës, që prokurohet."*

Kriteri i mësipërm është vendosur bazuar në nenin 26 pika 6 të VKM 914 datë 29.12.2014 është përcaktuar se:

*"Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet."*

Mbështetur në sa më sipër autoriteti kontraktor lejohet të kërkojë një vlerë 0-50%. Në rastin konkret njësia e prokurimit ka përcaktuar vlerat për punët e ngjashme sa maksimalja e lejuar nga VKM. Pra në asnjë rast nuk është kërkuar një vlerë më e madhe se 50% e vlerës të kontratës që prokurohet dhe as një vlerë më e madhe se dyfishi i vlerës limit.

Për sa më sipër njësia e prokurimit gjykon se kriteri i mësipërm është në përputhje me legjislacionin e prokurimeve.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

Në lidhje me kriterin e kontratave të ngjashme komenti juaj se "në asnjë rast nuk është kërkuar një vlerë më e madhe se 50% e vlerës të kontratës që prokurohet dhe as një vlerë më e madhe se dyfishi i vlerës limit", merret në konsideratë dhe nuk do të trajtohet.

Nga ana e NJHDT nuk është argumentuar me zberthimin e zërave të punës së preventivit, ashtu sikurse është trajtuar në akt konstatim dhe në gjetjen e mësipërme.

Në lidhje me argumentimin e kriterëve ju sqarojmë se në asnjë rast në dosje nuk disponohej zberthimi i zërave të punës sipas manualeve dhe volumeve të punës për të argumentuar përcaktimet e kriterëve teknike për kualifikim.

Likuidimi i kontratës me objekt "**Rikonstruksion i veprave ujitëse**" "**A.K 2002**" shpk

**Titulli gjetjes** Mbi penalitetet që lindin si pasojë e dorëzimit të faturave tatimore të mëvonshme nga data e përfundimtar të kontratës - "**Rikonstruksion i veprave ujitëse**", kontraktor "**A.K 2002**" shpk

**Situata** Nga auditimi i kampionit të urdhër shpenzimeve me objekt investimet kapitale të vitit 2018 dhe 2019 rezultoi se nga ana Bashkisë Korçë, nga likuidimi i shpenzimeve kapitale për investimet, fatura tatimore bashkëlidhur urdhër shpenzimeve kanë datë lëshimi të mëvonshme nga data e situacionit përfundimtar.

**Likuidimi** i kontratës nr. 3961/2, datë 20.05.2019, me vlerë 3,117,240 lekë dhe afat punimesh 1 muaj nga data e lidhjes së kontratës ose 20.06.2019.

| Nr | Nr. Fat. | Datë fature       | Sh.Totale        | G. Punimi      | Sh. Operatori    | USH  | Data e Likuidimit |
|----|----------|-------------------|------------------|----------------|------------------|------|-------------------|
| 1  | 220      | 25.10.2019        | 3,117,240        | 155,862        | 2,961,378        | 1499 | 11.12.2019        |
|    |          | <b>Likuidimet</b> | <b>3,117,240</b> | <b>155,862</b> | <b>2,961,378</b> |      |                   |
|    |          | kontrata          | 3,117,240        |                |                  |      |                   |

Nga auditimi rezulton se fatura tatimore është paraqitur më datë 25.10.2019 nga 22.06.2019, ose 125 ditë më vonë.

Bazuar në nenin 27 të kontratës Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve, pika 27,1 referon;

|                       |  |
|-----------------------|--|
|                       | <p>“Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve do të llogariten me tarifat ditore</p> <p>- tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”</p> <p>Përfundimisht kamatvonesa për fatura jasht afatit të kontratës është;</p> <p><b><i>Kamatvonesa= 125 ditë *3,117,240 lekë *4/1000 *25% = 389,655 lekë.</i></b></p>   |
| <b>Kriteri</b>        | <p>KPK neni “Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve”;</p> <p>Ligji nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar neni 7,12, dhe 18</p> <p>UKM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3 datë 15.02.2001 “ Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.” dhe i ngarkohet investitorëve përgjegjësia për këtë veprim.</p> <p>Pranimi i dokumentacionit vërtetues është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, nenit 6 e udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “pika 35 dhe 36, është përgjegjësi e nëpunësit zbatues siç shprehet edhe neni 12 pika 3 germa dh) dhe e) e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.</p> |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | <p>Pranimi i dokumentacionit të paplotë, përbën risk për sa i përket vërtetësisë së shpenzimit kapital. Gjithashtu vlera totale e penalitetit ku faturat janë paraqitur shumë më vonë se sa koha e situacionit në shumën <b>389,655 lekë</b> përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit</p>   |
| <b>Shkaku</b>         | Mos zbatim i akteve ligjore  |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë  |
| <b>Rekomandimi</b>    | <p>Nga Bashkia Korçë, të merren masa që likuidimi i shpenzimeve të kryhet bazuar në dokumentacion të plotë, autorizues dhe vërtetues të shpenzimit kapital.</p> <p>Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik në shumën <b>389,655 lekë</b>, si pasojë e mosmbajtjes së kamatvonesave.</p>  |

**Procedura e prokurimit publik me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale – Rikonstruksion në bllokun informal rruga “QANI QYTEZA”:**

|   |   |  |
|---|---|--|
| <b>Urdhër prokurimi</b><br>nr. 450, datë 29.05.2019 | <b>NJHDT:</b> nr. 450, datë 29.05.2019<br>1.M.S(Jurist) | <b>KVO</b> nr. 450/1, datë 29.05.2019<br>1.B.TH Kryetare   |
| <b>Lloji i procedurës</b> “kërkesë për propozim”    | 2.M.B(Ing.agro ushqimore)<br>3.B.M(Ing. ndërtimi)       | 2. V.P, anëtar juriste,<br>Drejtoria Juridike              |
| <b>Fondi Limit</b> 7,081,774 lekë.                  |   | 3 A.D, specialist  |
| <b>Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e Bashkisë    | <b>fituese:</b> A.K 2002 ShPK                           | Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave                       |
| <b>Data e hapjes së tenderit:</b><br>13.06.2019     | <b>Vlera e fituar:</b> 3,700,181 lekë                   | <b>Operatorët Ekonomike</b><br>Pjesëmarrës në tender: 4 OE |
| <b>Ankimime në AK:</b> s`ka                         | <b>Diferenca me fondin limit</b>                        | S`kualifikuar 0 OE,  |
| <b>Ankimime në KPP:-</b> s`ka                       | 3,381,593 lekë  | Kualifikuar 4 OE   |

**Titulli gjetjes | Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.**





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

**Situata**

**Mbi përlogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike, dhe dokumentacionit teknik.**

**Nuk ka urdhër për ngritje grupi pune për hartimin e specifikimeve teknike** por nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, datë 27.05.2019, i është dërguar NJHDT dokumentacioni teknik për fillimin e procedurave të prokurimit: projekti, specifikimet teknike, preventivi i punimeve, grafiku i punimeve

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

**DT** - kriteret teknike të veçanta për kualifikim janë sipas procesverbalit datë 29.05.2019, të hartuar nga B.M.

**Procesverbali nr.1 i hartimit të DT** mban datën 29.05.2019.

Bazuar në rekomandimet e APP, nga ana e NJHDT me shtojcën e DT datë 05.06.2019, është hequr kategoria NP 4B

**Në hartimin e DT** në lidhje me kriteret rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:

**1-** Seksioni II, “Informacione të veçanta për kontratat”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 7.

**2-** Kreu VII, “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2.

**Si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:**

**Në pikën 5 është kërkuar “Disponimi i mjeteve”**

**Sa më sipër:**

➤ Në lidhje me mjetet (kamion, autobot, auto betonierë, betonierë, nuk janë përcaktuar kapacitetet e tyre, në lidhje me objektin dhe nevojat e zbatimit të kontratës.

➤ Nuk është përcaktuar lloji i ekskavatorit me goma apo zinxhirë.

➤ Për “Nyje të thyerjes të materialeve inerte” dhe “Fabrika e asfalto betonit” është kërkuar që të paraqitet kontrata e furnizimit me prodhuesin, ndërkohë që Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT) duhej të kishte kërkuar kontratë paraprake furnizimi, pasi kërkesa për kontratë furnizimi e vendos operatorin ekonomik në rast të mos shpalljes fitues përpara kushteve kontraktuale.

➤ Në lidhje me shënimin se: “Lidhur me fabrikën e asfalto betonit ofertuesit duhet të kenë ne pronësi, me qira apo te lidhin kontrate furnizimi me një fabrikë vendndodhja e së cilës garanton realizimin e objektit konform kushteve teknike të përcaktuara në VKM Nr.628 datë 15.07.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”.

**Sa më sipër kjo kërkesë nuk qëndron. Sqarojmë se:**

- Jemi në kushtet kur OE pjesëmarrës në procedurë ka lëshuar deklaratë për plotësimin e specifikimeve teknike;

- Kërkesë në kundërshtim me UKM nr.3, datë 15.2.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pikat 9, 10, 11 dhe 12.

- Kërkesë në kundërshtim me VKM nr.628 datë 15.07.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”, pikat L

**a-** “Rregulli teknik për ndërtimin e rrugëve (RrTNRr-1), Vëllimi 1: “Të përgjithshme dhe punime përgatitore” pjesa nr. “**5 Kontrolli i Punës**”, pika **5.2 Autoriteti i Inxhinierit Mbikëqyrës**”, ku janë përcaktuar veprimet e mbikëqyrësit

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | <p><b>b-</b> Rregulli teknik për ndërtimin e rrugëve (RrTNRr-8), Vëllimi 8: Kërkesa për pranimin e materialeve dhe të produkteve, vëllimi 8: kërkesa për pranimin e materialeve dhe të produkteve, pika 4, “Plotësimi i Kërkesave nga Produkti dhe Vlerësimi i Përputhshmërisë”, në të cilën janë përcaktuar sipas pikës 1, “Qëllimi”.</p> <p><b>Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi NJHDT</b></p> |
| <b>Kriteri</b>        | Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.  |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Përcaktim i kriterëve jo në lidhje me objektin e prokurimit dhe mosargumentim i tyre.   |
| <b>Shkaku</b>         | Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.   |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë   |
| <b>Rekomandimi</b>    | AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.  |

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën 6684/4, datë 01.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot.,260/18 datë 03.06.2021 “Shkresë përcjellëse”, nga *Kryetari i Bashkisë S.F.*, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

Lidhur me konstatimin se nuk ka urdhër për ngritje grupi pune për specifikimet teknike ju sqarojmë se:

Pjesë e strukturës të Bashkisë Korçë është edhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Teritorit një nga detyrat funksionale të së cilës sipas rregullores të organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Korçë është edhe hartimi i dokumentacionit teknik të investimeve, për këtë arsye nuk ka një urdhër të veçantë për caktimin e këtyre detyrave.

Lidhur me pretendimin e audituesve për kapacitetin e mjeteve kamion, autobot, autobetoniere dhe betoniere sqarojmë se janë kërkuar mjetet minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës. Nuk është vendosur kapaciteti me qëllim të thjeshtimit të kriterëve, stimulimin e pjesëmarrjes të ofertuesve, rritjen e konkurrencës dhe vlerësimit sa më të drejtë të ofertuesve.

II.2 Lidhur me mjetin "eskavator" është përcaktuar "Eskavator me goma" .

II.3 Lidhur me "Nyjen e materialeve inerte" dhe "Fabrikës të asfalto betonit".

II.3.a.Nga audituesit është konstatuar se nuk qëndron shënimi i vendosur në DST si vijon: " Lidhur me fabrikën e asfaltobetonit ofertuesit duhet të kenë në pronësi, me qera apo të lidhin kontratë furnizimi me një fabrikë vendndodhja e së cilës garanton realizimin e objektit konform kushteve teknike të përcaktuara në VKM Nr.628 datë 15.07.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”.

Në përfundim mendojmë se nuk përbën shkelje fakti që operatorëve ju është vënë në dukje se duhet të disponojnë një fabrikë që respekton kërkesat e VKM 628 datë 15.07.2015.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se nga APP është bërë monitorimi i kësaj procedure, konkretisht i dokumentave të tenderit dhe nëpërmjet emailit të datës 03.06.2019 janë bërë rekomandime të cilat janë zbatuar nga ana jonë dhe nëpërmjet shtojcës datë 05.06.2019 janë bërë të gjitha ndryshimet e rekomanduara nga APP. Bashkëlidhur do të gjeni emailin e datës 03.06.2019 dhe Procesverbalin e Njësisë të Prokurimit datë 05.06.2019 "Për një shtojcë në dokumentat e tenderit" .

Për sa më sipër, as nga APP dhe as nga operatorët ekonomikë, nuk ka patur ankesa dhe pretendime lidhur me kriteret e kontestuara nga ana juaj.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

- Në lidhje me kriterin e kontratave të ngjashme komenti juaj se “në asnjë rast nuk është kërkuar një vlerë më e madhe se 50% e vlerës të kontratës që prokurohet dhe as një vlerë më e madhe se dyfishi i vlerës limit”, merret në konsideratë.
- Në lidhje me komentin tuaj se “mendojmë se nuk përbën shkelje fakti që operatorëve ju është vënë në dukje se duhet të disponojnë një fabrikë që respekton kërkesat e VKM 628 datë 15.07.2015”, ju sqarojmë se nuk është detyrë e KVO detyrat e mbikqyrësit të punimeve, trajtuar më hollësisht në akt konstatimin përkatës.
- Në lidhje me pretendimin se: “Theksojmë se nuk ka patur asnjë anekse lidhur me kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit dhe as lidhur me vlerësimin e bërë nga KVO për fabrikën e asfalto betonit, ju sqarojmë se fakti që nuk ka patur anekse nuk do të thotë që nuk është kërkesë e gabuar.
- Në lidhje me mjetet (kamion, autobot, auto betonierë, betonierë, nuk janë përcaktuar kapacitetet e tyre, në lidhje me objektin dhe nevojat e zbatimit të kontratës.

**Likuidimi i kontratës me objekt:** “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale – Rikonstruksion në bllokun informal rruga “QANI QYTEZA”.

**Titulli gjetjes** Mbi penalitetet që lindin si pasojë e dorëzimit të faturave tatimore të mëvonshme nga data e përfundimtar të kontratës - Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale – Rikonstruksion në bllokun informal rruga “QANI QYTEZA”, me kontraktor "A.K 2002" shpk

**Situata** Nga auditimi i kampionit të urdher shpenzimeve me objekt investimet kapitale të vitit 2019 rezultoi se nga ana Bashkisë Korçë, nga likuidimi i shpenzimeve kapitale për investimet, fatura tatimore bashkëlidhur urdher shpenzimeve kanë datë lëshimi të mëvonshme nga data e situacionit përfundimtar.  
**Likuidim i objektit:** Kontratë e lidhur më datën 16.07.2019, me nr. 5894/2 prot, me afat 2 muaj ose data 16.09.2019 .

| Nr. Fat | Datë fature | Sh. Totale | G. Punimi | Sh. Operatori | urdher shpenzimi | Likuidimit |
|---------|-------------|------------|-----------|---------------|------------------|------------|
| 226     | 02.12.2019  | 4,440,218  | 222,011   | 4,218,207     | 1498             | 11.12.2019 |
|         | Likujdimet  | 4,440,218  | 222,011   | 4,218,207     |                  |            |
|         | kontrata    | 4,440,218  |           |               |                  |            |

Nga auditimi rezulton se fatura tatimore është paraqitur më datë 02.12.2019 nga 16.09.2019, ose 67 ditë më vonë.

Bazuar në nenin 27 të kontratës Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve, pika 27,1 referon;

“Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve do të llogariten me tarifën ditore

- tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”

Përfundimisht kamatvonesa për fatura jasht afatit të kontratës është;

**Kamatvonesa= 67 ditë \*4,440,218 lekë \*4/1000 \*25% = 297,465 lekë.**

**Kriteri** KPK neni “Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve”; Ligji nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar neni 7,12, dhe 18  
UKM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3 datë 15.02.2001 “ Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.” dhe i

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | ngarkohet investitorëve përgjegjësia për këtë veprim.<br>Pranimi i dokumentacionit vërtetues është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 6 e udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “pika 35 dhe 36, është përgjegjësi e nëpunësit zbatues siç shprehet edhe neni 12 pika 3 germa dh) dhe e) e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Pranimi i dokumentacionit të paplotë, përbën risk për sa i përket vërtetësisë së shpenzimit kapital. Gjithashtu vlera totale e penaltetit ku faturat janë paraqitur shumë më vonë se sa koha e situacionit në shumën <b>297,465 lekë</b> përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit  |
| <b>Shkaku</b>         | Mos zbatim i akteve ligjore   |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë   |
| <b>Rekomandimi</b>    | Nga Bashkia Korçë, të merren masa që likuidimi i shpenzimeve të kryhet bazuar në dokumentacion të plotë, autorizues dhe vërtetues të shpenzimit kapital.<br>Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik në shumën <b>297,465 lekë</b> , si pasojë e mosmbajtjes së kamatvonesave.   |

#### 4.Procedura e prokurimit publik me objekt: “Sistemime malore”:

|  |  |   |
|--|--|---|
| <b>Urdhër prokurimi</b><br>nr. 227, datë 26.03.2019          | <b>NJHDT:</b> nr. 227, datë 26.03.2019<br>1. M.S(Jurist)   | <b>KVO</b> nr. 922/4, datë 26.03.2019<br>1. B.TH Kryetare   |
| <b>Lloji i procedurës</b> “e hapur”                          | 2. M.B(Ing.agro ushqimore)<br>3. B.M(Ing. ndërtimi)  | 2. V.P, anëtar juriste, Drejtoria Juridike<br>3. A.D, specialist Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave |
| <b>Fondi Limit</b> 16,940,000 lekë.                          |  | 4. E.V, specialiste DPKZHT<br>5. K.P, specialiste Drejtoria e Financës                                |
| <b>Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e Bashkisë             | <b>OE fitues:</b> “G” ShPK<br><b>Vlera e fituar:</b> 8,589,403 lekë                                    |   |
| <b>Data e hapjes së tenderit:</b> 30.04.2019                 | <b>Diferenca me fondin limit</b><br>8,350,597 lekë   |   |
| <b>Ankimime në AK:</b> s`ka<br><b>Ankimime në KPP:-</b> s`ka | <b>Operatorët Ekonomike</b><br>Pjesëmarrës në tender: 11 OE<br>S`kualifikuar 3 OE,<br>Kualifikuar 8 OE |   |

|                        |   |
|------------------------|---|
| <b>Titulli gjetjes</b> | <b>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.</b>   |
| <b>Situata</b>         | <b>Hartimi i dokumenteve të tenderit:</b><br><b>Në hartimin e DT</b> në lidhje me kriteret rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:<br><b>1-</b> Seksioni II, “Informacione të veçanta për kontratat”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 7.<br><b>2-</b> Kreu VII, “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2.<br><b>Si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:</b> |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                       |  |
|-----------------------|--|
|                       | <p><b>DT</b> - kritereve teknike të veçanta për kualifikim janë sipas procesverbalit datë 27.03.2019, të hartuar nga B.M.</p> <p>➤ Në licencat për ekzekutimin e punimeve është vendosur kategoria NP12A- Punime të inxhinierisë së mjedisit, ndërkohë që në preventivin bashkëlidhur nuk ka punime të tilla.</p> <p>Në zbatim të VKM nr.42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, përshkrimi i punimeve të kësaj kategorie përmban:</p> <p>“N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitetet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte”.</p> <p>➤ Në lidhje me stafin është kërkuar 1 inxhinier mjedisi –për të cilin duhet të paraqitet diploma, kontrata e punës dhe certifikata për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe Auditimin mjedisor lëshuar nga Ministria e Mjedisit. Kjo kërkesë është e tejkualuar me kërkesat e LPP, pasi në preventiv nuk ka punime mjedisore sipas kuptimit të VKM nr.42, datë 16.01.2008.</p> <p>➤ Gjithashtu është kërkuar disponimi i mjeteve të domosdoshme për të cilat në lidhje me mjetet (kamion, betonierë, nuk janë përcaktuar kapacitetet e tyre, në lidhje me objektin dhe nevojat e zbatimit të kontratës.</p> <p><b>Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi anëtari i NJHDT</b></p> |
| <b>Kriteri</b>        | Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.   |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Përcaktim i kritereve jo në lidhje me objektin e prokurimit dhe mosargumentim i tyre.  |
| <b>Shkaku</b>         | Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.  |
| <b>Rendesia</b>       | Ë lartë  |
| <b>Rekomandimi</b>    | AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.   |

**5.Procedura e prokurimit publik me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale, (rikonstruksion rruge fshati Barç”:**

|   |   |   |
|---|---|---|
| <b>Urdhër prokurimi</b><br>nr. 184, datë 18.03.2019 | <b>NJHDT:</b> nr. 184, datë 18.03.2019<br>M.S(Jurist)               | <b>KVO</b> nr. 194/1, datë 28.03.2019<br>B.TH Kryetare  |
| <b>Lloji i procedurës</b> “e hapur”                 | M.B(Ing.agro ushqimore)<br>B.M(Ing. ndërtimi)                       | K. J, jurist, Drejtoria Juridike;<br>A.D, specialist, Drejtoria e menaxhimit te kontratave;<br>H.N, specialist, DPKZHT<br>K.P, specialiste, Drejtoria e Financës. |
| <b>Fondi Limit</b> 18,367,463 lekë.                 |   |   |
| <b>Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e Bashkisë    | <b>OE fitues:</b> “V” ShPK<br><b>Vlera e fituar:</b> 9,741,044 lekë |   |
| <b>Data e hapjes së tenderit:</b>                   | <b>Diferenca me fondin limit</b>                                    |   |

|  |  |  |
|--|--|--|
| 23.04.2019                                     | 8,626,419 lekë   |  |
| Ankimime në AK: s`ka<br>Ankimime në KPP:- s`ka | <b>Operatorët Ekonomike</b><br>Pjesëmarrës në tender: 11 OE<br>S`kualifikuar 2 OE,<br>Kualifikuar 8 OE |  |

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.</b>  |
| <b>Situata</b>           | <p><b>Mbi përlogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike, dhe dokumentacionit teknik.</b></p> <p>Nuk ka grup pune të ngritur për këtë qëllim nga ana e Titullarit të AK, por nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, më datë 13.03.2019, janë dërguar Drejtorisë së Prokurimeve Projekti, specifikimet teknike, preventivi i punimeve, grafiku i punimeve dhe analizat e çmimeve.</p> <p><b>Në hartimin e DT</b> në lidhje me kriteret rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:</p> <p><b>1-</b> Seksioni II, “Informacione të veçanta për kontratat”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 7.</p> <p><b>2-</b> Kreu VII, “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2.</p> <p><b>Si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:</b></p> <p>Nga ana e anëtarit të NJHDT B.M, është mbajtur procesverbali datë 20.03.2019, për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për objektin në fjalë.</p> <p>Në këto kriterë në lidhje me disponimin e mjeteve me kapacitet bartës nuk është kërkuar kapaciteti i tyre në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit.</p> <p><b>Gjithashtu në kriteret për kualifikim është vënë shënimi se:</b></p> <p><b>Shënim:</b> Lidhur me fabrikën e asfalto betonit ofertuesit duhet të kenë në pronësi, më qira apo të lidhin kontrate furnizimi me një fabrike vendndodhja e se cilës cila garanton realizimin e objektit konform kushteve teknike të përcaktuara në VKM nr.628 datë 15.07.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”</p> <p><b>Sa më sipër kjo kërkesë nuk qëndron. Sqarojmë se:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Jemi në kushtet kur OE pjesëmarrës në procedurë ka lëshuar deklaratë për plotësimin e specifikimeve teknike;</li> <li>- Kërkesë në kundërshtim me UKM nr.3, datë 15.2.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pikat 9, 10, 11 dhe 12.</li> <li>- Kërkesë në kundërshtim me VKM nr.628, datë 15.07.2015, “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”, pikatL</li> </ul> <p><b>a-</b> “Rregulli teknik për ndërtimin e rrugëve (RrTNRr-1), Vëllimi 1: “Të përgjithshme dhe punime përgatitore” pjesa nr. “<b>5 Kontrolli i Punës</b>”, pika <b>5.2 Autoriteti i Inxhinierit Mbikëqyrës</b>”, ku janë përcaktuar veprimet e mbikëqyrësit</p> <p><b>b-</b> Rregulli teknik për ndërtimin e rrugëve (RrTNRr-8), Vëllimi 8: Kërkesa për pranimin e materialeve dhe të produkteve, vëllimi 8: kërkesa për pranimin e materialeve dhe të produkteve, pika 4, “Plotësimi i Kërkesave nga Produkti dhe Vlerësimi i Përputhshmërisë”, në të cilën janë përcaktuar sipas pikës 1, “Qëllimi”.</p> |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | <b>Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi NJHDT</b>                                     |
| <b>Kriteri</b>        | Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.                |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Përcaktim i kritereve jo në lidhje me objektin e prokurimit dhe mosargumentim i tyre. |
| <b>Shkaku</b>         | Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.                                       |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë   |
| <b>Rekomandimi</b>    | AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.                |

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën 6684/4, datë 01.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot.,260/18 datë 03.06.2021 “Shkresë përcjellëse”, nga *Kryetari i Bashkisë S.F.*, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

Lidhur me sa më sipër sqarojmë se:

Së pari: Kriteri është vendosur me qëllim që të vërtetohet disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e kontratës.

Ky kriter nuk është vendosur që të vërtetohet cilësia e materialeve, pasi sic është argumentuar edhe nga ana juaj , KVO nuk vlerëson cilësinë e materialeve.

Në nenin 26 pika 8.c VKM Nr 914 date 29.12.2014 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”i ndryshuar” përcaktohet se :

”Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

... c.dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Pra është detyrim i autoritetit kontraktor që të kërkojë mjete dhe pajisje teknike të cilat janë të nevojshme për të përmbushur kontratën.

Nga ana tjetër ofertuesi ka detyrimin të vërë në dispozicion për realizimin e objektit makineri dhe pajisje funksionale dhe që mund ti vërë realisht në dispozicion për realizimin e objektit të kërkuar.

Në rast se fabrika e asfaltit ndodhet në një largësi që nuk mund të vihet në dispozicion të objektit atëherë rrjedhimisht ofertuesi nuk mund ta realizojë objektin.

Duke qënë se VKM Nr.628 date 15.07.2015 “Per miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe Ndertimit te Rrugeve ” parashikohet detyrimi që:

- Perzierja e prodhuar duhet zakonisht te transportohet menjehere ne kantierin e ndertimit.

- E gjithë procedura e prodhimit, transportit, vendosjes dhe ngjeshjes se perzierjes nuk lejohet te jete me shume se 2(dy) ore ,

atëherë rrjedhimisht operatorët duhet të disponojnë mjete/pajisje teknike që të përmbushin këtë detyrim.

Në përfundim mendojmë se nuk përbën shkelje fakti që operatorëve ju është vënë në dukje se duhet të disponojnë një fabrikë qe respekton kërkesat e VKM 628 datë 15.07.2015.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

- Në lidhje me komentin tuaj se “mendojmë se nuk përbën shkelje fakti që operatorëve ju është vënë në dukje se duhet të disponojnë një fabrikë qe respekton kërkesat e VKM 628 datë 15.07.2015”, ju sqarojmë se nuk është detyrë e KVO detyrat e mbikqyrësit të punimeve, trajtuar më hollësisht në akt konstatimin përkatës.

- Në lidhje me mjetet (kamion, autobot, auto betonierë, betonierë, nuk janë përcaktuar kapacitetet e tyre, në lidhje me objektin dhe nevojat e zbatimit të kontratës.

**Likuidimi i kontratës: “Rikonstruksion rruge fshati Barç”.**

| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mbi penalitetet që lindin si pasojë e dorëzimit të faturave tatimore të mëvonshme nga data e përfundimit të kontratës -“Rikonstruksion rruge fshati Barç”, kontraktor "V" shpk.</b>  |                   |                |                   |                        |                   |                        |                   |   |            |            |         |            |      |            |  |                   |                   |                |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
|--------------------------|---|-------------------|----------------|-------------------|------------------------|-------------------|------------------------|-------------------|---|------------|------------|---------|------------|------|------------|--|-------------------|-------------------|----------------|-------------------|--|--|--|----------|------------|--|--|--|--|--|-------------|-----|--|--|--|--|
| <b>Situata</b>           | <p>Nga auditimi i kampionit të urdhër shpenzimeve me objekt investimet kapitale të vitit 2019 rezultoi se nga ana Bashkisë Korçë, nga likuidimi i shpenzimeve kapitale për investimet, fatura tatimore bashkëlidhur urdhër shpenzimeve kanë datë lëshimi të mëvonshme nga data e situacionit përfundimtar.</p> <p><b>Likuidim i objektit:</b> Kontratë e lidhur më datën 27.05.2019, me nr. Kontrate 4333/2 prot., me afat 2 muaj ose data 27.07.2019. Firma fituese "V" shpk. Vlera totale e kontratës 11,689,253 lekë. Kodi i projektit 1220281</p> <table border="1" data-bbox="470 705 1436 940"> <thead> <tr> <th>Nr.Fat.</th> <th>Datë fature</th> <th>Sh.Totale</th> <th>G.Punimi</th> <th>Sh.Operatori</th> <th>Nr i urdher shpenzimit</th> <th>Data e Likuidimit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>7</td> <td>27.08.2019</td> <td>11,688,816</td> <td>584,441</td> <td>11,104,375</td> <td>1194</td> <td>09.10.2019</td> </tr> <tr> <td></td> <td><b>Likujdimet</b></td> <td><b>11,688,816</b></td> <td><b>584,441</b></td> <td><b>11,104,375</b></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td>kontrata</td> <td>11,689,253</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td>palikujduar</td> <td>437</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga auditimi rezulton se fatura tatimore është paraqitur më datë 27.08.2019 nga 27.07.2019, ose 30 ditë më vonë.</p> <p>Bazuar në nenin 27 të kontratës Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve, pika 27,1 referon;</p> <p>“Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve do të llogariten me tarifën ditore</p> <p>- tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”</p> <p>Përfundimisht kamatvonesa për fatura jashtë afatit të kontratës është;</p> <p><b>Kamatvonesa= 30 ditë *11,689,253 lekë *4/1000 *25% = 350,677 lekë.</b></p> | Nr.Fat.           | Datë fature    | Sh.Totale         | G.Punimi               | Sh.Operatori      | Nr i urdher shpenzimit | Data e Likuidimit | 7 | 27.08.2019 | 11,688,816 | 584,441 | 11,104,375 | 1194 | 09.10.2019 |  | <b>Likujdimet</b> | <b>11,688,816</b> | <b>584,441</b> | <b>11,104,375</b> |  |  |  | kontrata | 11,689,253 |  |  |  |  |  | palikujduar | 437 |  |  |  |  |
| Nr.Fat.                  | Datë fature   | Sh.Totale         | G.Punimi       | Sh.Operatori      | Nr i urdher shpenzimit | Data e Likuidimit |                        |                   |   |            |            |         |            |      |            |  |                   |                   |                |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
| 7                        | 27.08.2019  | 11,688,816        | 584,441        | 11,104,375        | 1194                   | 09.10.2019        |                        |                   |   |            |            |         |            |      |            |  |                   |                   |                |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
|                          | <b>Likujdimet</b>   | <b>11,688,816</b> | <b>584,441</b> | <b>11,104,375</b> |                        |                   |                        |                   |   |            |            |         |            |      |            |  |                   |                   |                |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
|                          | kontrata  | 11,689,253        |                |                   |                        |                   |                        |                   |   |            |            |         |            |      |            |  |                   |                   |                |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
|                          | palikujduar   | 437               |                |                   |                        |                   |                        |                   |   |            |            |         |            |      |            |  |                   |                   |                |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
| <b>Kriteri</b>           | <p>KPK neni “Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve”;</p> <p>Ligji nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar neni 7,12, dhe 18</p> <p>UKM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3 datë 15.02.2001 “ Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.” dhe i ngarkohet investitorëve përgjegjësia për këtë veprim.</p> <p>Pranimi i dokumentacionit vërtetues është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 6 e udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “pika 35 dhe 36, është përgjegjësi e nëpunësit zbatues siç shprehet edhe neni 12 pika 3 germa dh) dhe e) e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.</p>   |                   |                |                   |                        |                   |                        |                   |   |            |            |         |            |      |            |  |                   |                   |                |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
| <b>Ndikimi/efekti</b>    | <p>Pranimi i dokumentacionit të paplotë, përbën risk për sa i përket vërtetësisë së shpenzimit kapital. Gjithashtu vlera totale e penalitetit ku faturat janë paraqitur shumë më vonë se sa koha e situacionit në shumën <b>350,677 lekë</b> përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit</p>  |                   |                |                   |                        |                   |                        |                   |   |            |            |         |            |      |            |  |                   |                   |                |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
| <b>Shkaku</b>            | Mos zbatim i akteve ligjore   |                   |                |                   |                        |                   |                        |                   |   |            |            |         |            |      |            |  |                   |                   |                |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                    |   |
|--------------------|---|
| <b>Rendesia</b>    | E lartë   |
| <b>Rekomandimi</b> | Nga Bashkia Korçë, të merren masa që likuidimi i shpenzimeve të kryhet bazuar në dokumentacion të plotë, autorizues dhe vërtetues të shpenzimit kapital.<br>Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik në shumën <b>350,677 lekë</b> , si pasojë e mosmbajtjes së kamatvonesave. |

**6.Procedura e prokurimit publik me objekt: “Blerje mobilje dhe paisje për qendrën e shërbimeve dhe kreativitetit (komponenti 1 dhe 3) - loti 4, mobilje dhe paisje të ndryshme”:**

|  |  |  |
|--|--|--|
| <b>Urdhër prokurimi</b><br>nr. 245, datë 01.04.2019          | <b>NJHDT:</b> nr. 245, datë 01.04.2019<br>M.S(Jurist)  | <b>KVO:</b><br>me nr. 245/1, datë 01.04.2019<br>B.TH Kryetare  |
| <b>Lloji i procedurës</b> “e hapur”                          | M.B(Ing.agro ushqimore)<br>B.M(Ing. ndërtimi)  | GJ.P, përgjegjëse, Drejtoria Juridike.<br>M.L, specialist Drejtoria e Financës.<br>A.D, specialiste MK |
| <b>Fondi Limit</b> 16,473,336 lekë.                          |  |  |
| <b>Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e Bashkisë             | <b>OE fitues: “Sh.”shpk</b><br><b>Vlera e fituar: 13,218,860 lekë</b>                                |  |
| <b>Data e hapjes së tenderit:</b> 25/04/2019                 | <b>Diferenca me fondin limit</b><br>3,254,476 lekë   | Kontrata nr. 4056/1, datë 20.05.2019   |
| <b>Ankimime në AK:</b> s`ka<br><b>Ankimime në KPP:-</b> s`ka | <b>Operatorët Ekonomike</b><br>Pjesëmarrës në tender: 3 OE<br>S`kualifikuar 0 OE<br>Kualifikuar 3 OE | Vlera e kontratës 14,757,912 lekë, pas amandamentit (ulur)   |

|                          |   |
|--------------------------|---|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.</b>   |
| <b>Situata</b>           | <b>Mbi përlogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike, dhe dokumentacionit teknik.</b><br>Për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe dokumentacioni teknik, ka dalë urdhri i Titullarit të AK nr.848, datë 31.12.2018, ku është ngarkuar me këtë detyrë grupi i punës i përbërë nga:<br>- ZH.B, Drejtore e DPKZHT<br>- B.M, specialist, inxhinier ndërtimi DPKZHT<br>- V.P, specialiste, inxhinier elektrike DMK<br>- S.D, specialist IT, DBNJPASHM<br>Nga ana e grupit të punës është mbajtur procesverbali datë 14.01.2019.<br><b>Ky grup nuk ka paraqitur se ku i ka marrë nevojat që duhen për objektin e kësaj procedure</b> prokurimi, veprim në kundërshtim me: VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pikat:<br><b>a-</b> Neni 57, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, nënpika 3, ku është përcaktuar se:3. Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme:<br>- <b>Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion</b> dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik; |

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | <b>b-</b> Neni 60 “Urdhri i prokurimit”, ku është përcaktuar se: “ <b>Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime</b> , pas përlogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i AK apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë ...”. |
| <b>Kriteri</b>        | Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.  |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Përcaktim i kriterëve jo në lidhje me objektin e prokurimit dhe mosargumentim i tyre.   |
| <b>Shkaku</b>         | Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.   |
| <b>Rendësia</b>       | E lartë   |
| <b>Rekomandimi</b>    | AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.  |

## TE AUDITUARA MË PARË.

Procedura e prokurimit publik me objekt: “**Rikonstruksion i pjesshëm i Degës Ventrok**”:

|  |   |   |
|--|---|---|
| <b>Urdhër prokurimi</b><br>nr. 346, datë 26.04.2019          | <b>NJHDT</b> nr. 346, datë 26.04.2019<br>M.S(Jurist)<br>M.B(Ing.agro ushqimore)<br>B.M(Ing. ndërtimi)                     | <b>KVO</b> nr. 346/1, datë 26.04.2019<br>B.TH Kryetare<br>M.B, juriste, Drejtoria e Burimeve Njerëzore;<br>H.N, specialist DPKZHT<br>A.D, specialist, menaxhimi i kontratave<br>K.P, specialiste Drejtoria e Financës |
| <b>Lloji i procedurës</b> “e hapur”                          |   |   |
| <b>Fondi Limit</b> 34,133,298 lekë.                          |   |   |
| <b>Burimi Financimit:</b> buxheti i shtetit                  | <b>OE fitues:</b> “N” shpk<br><b>Vlera e fituar:</b> 19,098,861 lekë  |   |
| <b>Data e hapjes së tenderit:</b> 03/06/2019                 | <b>Diferenca me fondin limit</b><br>15,034,437lekë  | <b>Ndryshim i KVO,</b> me urdhër 346/2, datë 29.05.19, V.P, zv me M.B.  |
| <b>Ankimime në AK:</b> s’ka<br><b>Ankimime në KPP:-</b> s’ka | <b>Operatorët Ekonomike</b><br>Pjesëmarrës në tender: 17 OE<br>S’kualifikuar 4 OE, (1 me ofertë 0 lekë) Kualifikuar 13 OE | <b>Kontrata nr.6149/2, datë 29.07.2019</b><br>Vlera e kontratës 22,918,633 lekë   |

|                          |   |
|--------------------------|---|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.</b>   |
| <b>Situata</b>           | <p><b>Mbi hartimin e Dokumenteve të Tenderit.</b> DT për kriteret teknike për kualifikim janë hartuar më datë 26.04.2019, nga anëtari i NHHDT, B.M. <b>Procesverbali i hartimit të DT</b> mban datën 26.04.2019.</p> <p><b>Në hartimin e DT</b> në lidhje me kriteret rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:</p> <p><b>1-</b> Seksioni II, “Informacione të veçanta për kontratat”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 7.</p> <p><b>2-</b> Kreu VII, “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2.</p> <p><b>Si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Në DT është kërkuar për tre vite xhiro mesatare vjetore dhe bilancet ndërkohë që vërtetimi i numrit të punonjësve është kërkuar vetëm për dy muaj, kërkesa jo në proporcion me njëra tjetrën dhe e pa argumentuar kjo e fundit për afatin 2 muaj.</li> </ul> <p><b>Në DT është kërkuar: Disponimi i mjeteve Sa më sipër:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Në lidhje me mjetet (kamion, betonierë, nuk janë përcaktuar kapacitetet e tyre, në lidhje me objektin dhe nevojat e zbatimit të kontratës.</li> </ul> |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                       |  |
|-----------------------|--|
|                       | ➤ Nuk është përcaktuar lloji i ekskavatorit me goma apo zinxhirë. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi anëtari i grupit të NJHDT, B.M. |
| <b>Kriteri</b>        | Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.   |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Përcaktim i kriterëve jo në lidhje me objektin e prokurimit dhe mosargumentim i tyre.  |
| <b>Shkaku</b>         | Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.  |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë  |
| <b>Rekomandimi</b>    | AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.   |

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën 6684/4, datë 01.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot.,260/18 datë 03.06.2021 “Shkresë përcjellëse”, nga *Kryetari i Bashkisë S.F.*, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

**Në nenin 26 pika 5 të VKM 914 datë 29.12.2014 është përcaktuar se "Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës."**

**Në nenin 26 pika 7 VKM 914 datë 29.12.2014 është përcaktuar se "Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjene gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës."**

**Për sa më sipër mendojmë se nuk është kusht ligjor që kriteret të jenë në proporcion me njëra tjetrën por duhet të jenë në proporcion me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës.**

Lidhur me afatin 2 mujor të vendosur për numrin e punonjësve sqarojmë se ky afat është vendosur bazuar **në nenin 26 pika 8.b VKM 914 datë 29.12.2014 është përcaktuar se "Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktorkërkon: b. dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit" dhe gjithashtu bazuar në rekomadimet e vazhdueshme të APP për të mos vendosur periudha të gjata lidhur me numrin e punonjësve.** (Rekomandimi Nr 8197 Prot datë 03.09.2018 " Rekomandimi Nr 6732 datë 21.10.2020)

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

- Në lidhje me kriterin e kontratave të ngjashme komenti juaj se “në asnjë rast nuk është kërkuar një vlerë më e madhe se 50% e vlerës të kontratës që prokurohet dhe as një vlerë më e madhe se dyfishi i vlerës limit”, merret në konsideratë.
- Në lidhje me numrin e punonjësve ju sqarojmë se periudha dy mujore nuk korrespondon jo vetëm me xhiron dhe bilancet e kërkura por as me vlerën e kontratës. Ju kujtojmë se në procedura të tjera me lerë më të ulët se procedura në fjalë, kjo periudhë nuk ka qenë 2 mujore.

**2.Procedura e prokurimit publik me objekt: “Rehabilitimi urban i rrugëve të lagjeve të qytetit”:**

|  |  |  |
|--|--|--|
| <b>Urdhër prokurimi</b><br>nr. 246 datë 02.04.2019 | <b>NJHDT</b> nr. 246 datë 02.04.2019<br>M.S(Jurist)<br>M.B(Ing.agro ushqimore)<br>B.M(Ing. ndërtimi) | <b>KVO</b> nr. 246/1, datë 02.04.2019<br>B.TH Kryetare<br>V.P, juriste, Drejtoria e Burimeve<br>Njerëzore;<br>A.D, specialist DPKZHT |
| <b>Lloji i procedurës</b> “e hapur”                |  |  |
| <b>Fondi Limit</b> 36,395,655                      |  |  |

|  |  |  |
|--|--|--|
| lekë.  |  | E.DH, specialiste Drejtoria e Financës.                                  |
| <b>Burimi Financimit:</b> të ardhurat e Bashkisë             | <b>OE fitues:</b> A.K 2002 shpk & “A.A” shpk<br><b>Vlera e fituar:</b> 18,227,086 lekë                 |  |
| <b>Data e hapjes së tenderit:</b> 03/05/2019                 | <b>Diferenca me fondin limit</b> 18,168,569 lekë   |  |
| <b>Ankimime në AK:</b> s`ka<br><b>Ankimime në KPP:-</b> s`ka | <b>Operatorët Ekonomike</b><br>Pjesëmarrës në tender: 10 OE<br>S`kualifikuar 5 OE,<br>Kualifikuar 5 OE | Kontrata nr.4710/2, datë 12.06.2019<br>Vlera e kontratës 21,872,503 lekë |

| Titulli i gjetjes | i | Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.  |
|-------------------|---|---|
| Situata           |   | <p><b>Mbi hartimin e Dokumenteve të Tenderit.</b> DT për kriteret teknike për kualifikim janë hartuar më datë 02.04.2019, nga anëtari i NJHDT, B.M. <b>Procesverbali i hartimit të DT</b> mban datën 02.04.2019.</p> <p><b>Në hartimin e DT</b> në lidhje me kriteret teknike rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:</p> <p><b>1-</b> Seksioni II, “Informacione të veçanta për kontratat”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 7.</p> <p><b>2-</b> Kreu VII, “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2.</p> <p><b>Si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:</b></p> <p><b>Në DT është kërkuar:</b> 2.1.Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:<br/>Xhiroja mesatare vjetore gjatë tre viteve te fundit (2016,2017,2018) duhet të ketë një vlerë jo me te vogël se <b>50 % të vlerës limit</b> të kontratës që prokurohet.</p> <p><b>Në DT është kërkuar:</b> 1.Punët e ngjashme<br/>Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit <u>ose</u> punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit është sa dyfishi i vlerës limit të kontratës, që prokurohet.</p> <p>➤ Sa me sipër është në kundërshtim me VKM nr. <b>914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar neni 26 “Kontratat për punë publike”, pikat 6 dhe 7/a.</b></p> <p><b>Në DT është kërkuar:</b> “Disponimi i mjeteve” si dhe <b>Shenim:</b> Lidhur me fabrikën e asfaltobetonit ofertuesit duhet të kenë në pronësi, me qera apo të lidhin kontratë furnizimi me një fabrikë vendndodhja e së cilës cila garanton realizimin e objektit konform kushteve teknike të përcaktuara në VKM Nr.628 datë 15.07.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”.</p> <p>➤ Në lidhje me mjetet (kamion, betonierë, nuk janë përcaktuar kapacitetet e tyre, në lidhje me objektin dhe nevojat e zbatimit të kontratës.</p> <p>➤ Nuk është përcaktuar lloji i ekskavatorit me goma apo zinxhirë.</p> <p><b>Sa më sipër kjo kërkesë nuk qëndron. Sqarojmë se:</b></p> <p>- Jemi në kushtet kur OE pjesëmarrës në procedurë ka lëshuar deklaratë për plotësimin e specifikimeve teknike;</p> <p>- Kërkesë në kundërshtim me UKM nr.3, datë 15.2.2001, “Për mbikëqytjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pikat 9, 10, 11 dhe 12.</p> <p>- Kërkesë në kundërshtim me VKM nr.628 datë 15.07.2015 “Për miratimin</p> |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”, pikatL  
c- “Rregulli teknik për ndërtimin e rrugëve (RrTNRr-1), Vëllimi 1: “Të përgjithshme dhe punime përgatitore” pjesa nr. “**5 Kontrolli i Punës**”, **pika 5.2 Autoriteti i Inxhinierit Mbikëqyrës**”, ku janë përcaktuar veprimet e mbikëqyrësit

d- Rregulli teknik për ndërtimin e rrugëve (RrTNRr-8), Vëllimi 8: Kërkesa për pranimin e materialeve dhe të produkteve, vëllimi 8: kërkesa për pranimin e materialeve dhe të produkteve, pika 4, “Plotësimi i Kërkesave nga Produkti dhe Vlerësimi i Përputhshmërisë”, në të cilën janë përcaktuar sipas pikës 1, “Qëllimi”.

**Sa më sipër ngarkohet më përgjegjësi sipas pikave NJHDT**  
**Auditimi i ofertës të shpallur fituese:**

1- Nga auditimi rezulton se BOE ka lidhur kontratë bashkëpunimi nr.1745 rep., 1703 kol., datë 02.05.2019, sipas së cilës OE “A.A” shpk ka 51% dhe “A. K.” shpk ka 49%.

Në këtë akt marrëveshje nuk janë përcaktuar punët konkrete por janë ndarë në total 49% dhe 51%.

Alb Korca 2002 do te kryej 49% te punimeve si me poshte:

| Nr | PERSHKRIMI I PUNIMEVE                              |
|----|--|
| 1  | RR. Parashqevi Qirjazi (ish SMT)                   |
| 2  | RR. Pandi Raidhi (Lagja e Re nën Mborje)           |
| 3  | RR. Nexhip Vinçani (ish kundra ajrori)             |
| 4  | RR. Ark. Mehmet Musaj, Veli Korça dhe Kristo Floqi |

Al Asfalt do te kryej 51% te punimeve si me poshte:

| Nr | PERSHKRIMI I PUNIMEVE                              |
|----|--|
| 1  | RR. Parashqevi Qirjazi (ish SMT)                   |
| 2  | RR. Pandi Raidhi (Lagja e Re nën Mborje)           |
| 3  | RR. Nexhip Vinçani (ish kundra ajrori)             |
| 4  | RR. Ark. Mehmet Musaj, Veli Korça dhe Kristo Floqi |

Veprim në kundërshtim me VKM nr.914, datë “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”.

**Sa më sipër BOE nuk e plotëson kriterin, dhe duhej të s`kualifikohej. Paligjshmeria në përdorimin e fondeve është në shumën 18,227,086 lekë.**

|                       |  |
|-----------------------|--|
| <b>Kriteri</b>        | Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.                 |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën <b>18,227,086 lekë</b> pa tvsh |
| <b>Shkaku</b>         | Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.  |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë  |
| <b>Rekomandimi</b>    | AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.                 |

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën 6684/4, datë 01.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot.,260/18 datë 03.06.2021 “Shkresë përcjellëse”, nga *Kryetari i Bashkisë S.F.*, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

I.c Lidhur me kriterin e vendosur per disponimin e mjeteve:

-Lidhur me pretendimin e audituesve per kapacitetin e mjeteve kamion, autobot, autobetoniere dhe betoniere sqarojmë se janë kërkuar mjetet minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës. Nuk është vendosur kapaciteti me qëllim të thjeshtimit të kriterëve, stimulimin e pjesëmarrjes te ofertuesve, rritjen e konkurrencës dhe vlerësimit sa më të drejtë të ofertuesve.

I-Lidhur me "Fabrikën e asfalto betonit".

Nga audituesit është konstatuar se nuk qëndron shënimi i vendosur ne DST si vijon: " Lidhur me fabriken e asfaltobetonit ofertuesit duhet te kene ne pronesi,me qera apo te lidhin kontrate furnizimi me nje fabrike vendndodhja e se ciles garanton realizimin e objektit konform kushteve teknike te percaktuara ne VKM Nr.628 date 15.07.2015 "Per miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe Ndertimit te Rrugeve".

Për sa më sipër sqarojmë se:

Së pari: Kriteri është vendosur me qëllim që të vërtetohet disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e kontratës.

Ky kriter nuk është vendosur që të vërtetohet cilësia e materialeve, pasi sic është argumentuar edhe nga ana juaj , KVO nuk vlerëson cilësinë e materialeve.

Në përfundim mendojmë se nuk përbën shkelje fakti që operatorëve ju është vënë në dukje se duhet të disponojnë një fabrikë qe respekton kërkesat e VKM 628 datë 15.07.2015.

II.Lidhur me kualifikimin e bashkimit të operatorëve "A.K" sh.p.k dhe "A.A" sh.p.k nga audituesit është konstatuar se në aktmarreveshjen e bashkëpunimit nuk janë përcaktuar punët konkrete por janë ndarë në total 49% dhe 51%.

Lidhur me konstatimin tuaj ju sqarojmë se Bashkimi i shoqërive A.K 2002 sh.p.k dhe A.A sh.p.k kanë paraqitur kontratën e bashkëpunimit Nr 1745 rep,Nr 1703 Kol.

Pavarësisht se në marrëveshje janë cituar vetëm emrat e rrugëve, në preventiv janë të detajuar zërat e punimeve qe ka cdo rrugë.

Preventivi,si pjesë e dokumentave të paraqitura nga BOE shqyrtohet në mënyrë të pandarë nga dokumentacioni në tërësi dhe sic paraqitet edhe më sipër preventivi sqaron shumë qartësisht zerat e punëve sipas rrugëve,për të cilat BOE ka deklaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit. Duke konkluduar se shoqëria A.K 2002 do te kryejë 49% të totalit të punimeve duke përfshirë të gjitha zerat e punimeve dhe shoqëria A.A sh.p.k të kryejë 51% të të gjitha zërave të përfshira në preventiv. Në asnjë dispozitë ligjore nuk ndalohet një ndarje e tille e punëve ndërmjet operatorëve që formojnë BOE.

Për rrjedhojë nëse KVO në këtë rast do të procedonte me skualifikimin e BOE,jo vetëm që do të vepronte në mënyrë të padrejtë ndaj tyre,pasi BOE qartësisht plotëson kriterin e vendosur ne DST,por duke shpallur fitues operatorin vijues që ka ofertë më të lartë do të kryente përdorim të paligjshëm të fondeve publike duke shkaktuar një dëm ekonomik dhe duke shkelur kështu LPP neni nenit 1 gërma "b" "Objekti dhe qëllimi" i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

Nisur nga sa më sipër,KVO ka konkluduar se BOE ka vendosur që shoqëria A.A sh.p.k të kryejë 51% të të gjitha zërave të përfshira në preventiv dhe shoqëria A.K të kryejë 49% të të gjitha zërave të përfshira në preventiv.

Nisur nga kjo është bërë edhe vlerësimi i përmbushjes të kriterëve nga secili operator.

### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

- Për çështjet e tjera të trajtuara ju nuk keni paraqitur argumente dhe fakte të reja, për sa kundërshtoni jeni në kundërshtim me aktet ligjore të cituara në akt konstatim dhe në gjetjen përkatëse.

**Likuidimi i kontratës me objekt: “Rehabilitimi urban i rrugëve të lagjeve të qytetit”:**

| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>i</b>          | <p><b>Mbi penalitetet që lindin si pasojë e dorëzimit të faturave tatimore të mëvonshme nga data e përfundimtar të kontratës - “Rehabilitimi urban i rrugëve të lagjeve të qytetit”, me kontraktor "A.K 2002" &amp; "A.A"</b></p>   |                  |                   |                        |                   |              |                        |                   |     |            |           |         |           |      |            |  |  |                  |                |                  |  |  |     |          |           |         |           |     |            |           |         |           |     |            |           |        |           |     |            |  |  |                   |                |                   |  |  |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
|--------------------------|-------------------|---|------------------|-------------------|------------------------|-------------------|--------------|------------------------|-------------------|-----|------------|-----------|---------|-----------|------|------------|--|--|------------------|----------------|------------------|--|--|-----|----------|-----------|---------|-----------|-----|------------|-----------|---------|-----------|-----|------------|-----------|--------|-----------|-----|------------|--|--|-------------------|----------------|-------------------|--|--|--|-------------------|-------------------|------------------|-------------------|--|--|--|----------|------------|--|--|--|--|--|-------------|-----|--|--|--|--|
| <b>Situata</b>           |                   | <p>Nga auditimi i kampionit të urdhër shpenzimeve me objekt investimet kapitale të vitit 2019 rezultoi se nga ana Bashkisë Korçë, nga likuidimi i shpenzimeve kapitale për investimet, fatura tatimore bashkëlidhur urdhër shpenzimeve kanë datë lëshimi të mëvonshme nga data e situacionit përfundimtar.</p> <p><b>Likuidim i objektit:</b> Kontratë e lidhur më datën 12.06.2019, me Nr. Kontrate 4701/2 prot. Ose data 12,09.2019<br/>Firma fituese "A.K 2002" &amp; "A.A"<br/>Vlera totale e kontratës <b>21,872,503</b> lekë<br/>Viti 2019 në shumën 8,734,958 lekë me tvsh<br/>Viti 2020 në shumën 13,137,545 lekë me tvsh<br/>Kodi i projektit 1220626<br/>Amendament kontrate datë 28.08.2019 për 45 ditë, <b>mbyllja e punimeve data 27.10.2019.</b></p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th>Nr. Fat.</th> <th>Datë fature</th> <th>Sh.Totale</th> <th>G.Punimi</th> <th>Sh.Operatori</th> <th>Nr i urdher shpenzimit</th> <th>Data e Likuidimit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>217</td> <td>10.09.2019</td> <td>8,734,958</td> <td>436,748</td> <td>8,298,210</td> <td>1053</td> <td>11.09.2019</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td><b>8,734,958</b></td> <td><b>436,748</b></td> <td><b>8,298,210</b></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td rowspan="3">228</td> <td rowspan="3">23.12.19</td> <td>6,820,531</td> <td>341,027</td> <td>6,479,504</td> <td>767</td> <td>17.07.2020</td> </tr> <tr> <td>5,000,000</td> <td>250,000</td> <td>4,750,000</td> <td>872</td> <td>11.08.2020</td> </tr> <tr> <td>1,316,816</td> <td>65,841</td> <td>1,250,975</td> <td>988</td> <td>09.09.2020</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td><b>13,137,347</b></td> <td><b>656,867</b></td> <td><b>12,480,480</b></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td><b>Likuidimet</b></td> <td><b>21,872,305</b></td> <td><b>1,093,615</b></td> <td><b>20,778,690</b></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td>kontrata</td> <td>21,872,503</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td>palikujduar</td> <td>198</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga auditimi rezulton se fatura tatimore është paraqitur më datë 23.12.2019 nga 27.10.2019, ose 30 ditë më vonë.<br/>Bazuar në nenin 27 të kontratës Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve, pika 27,1 referon;<br/>“Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve do të llogariten me tarifën ditore<br/>- tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”<br/>Përfundimisht kamatvonesa për fatura jashtë afatit të kontratës është;<br/><b>Kamatvonesa= 57 ditë *21,872,503 lekë *4/1000 *25% = 1,246,732 lekë.</b></p> | Nr. Fat.         | Datë fature       | Sh.Totale              | G.Punimi          | Sh.Operatori | Nr i urdher shpenzimit | Data e Likuidimit | 217 | 10.09.2019 | 8,734,958 | 436,748 | 8,298,210 | 1053 | 11.09.2019 |  |  | <b>8,734,958</b> | <b>436,748</b> | <b>8,298,210</b> |  |  | 228 | 23.12.19 | 6,820,531 | 341,027 | 6,479,504 | 767 | 17.07.2020 | 5,000,000 | 250,000 | 4,750,000 | 872 | 11.08.2020 | 1,316,816 | 65,841 | 1,250,975 | 988 | 09.09.2020 |  |  | <b>13,137,347</b> | <b>656,867</b> | <b>12,480,480</b> |  |  |  | <b>Likuidimet</b> | <b>21,872,305</b> | <b>1,093,615</b> | <b>20,778,690</b> |  |  |  | kontrata | 21,872,503 |  |  |  |  |  | palikujduar | 198 |  |  |  |  |
| Nr. Fat.                 | Datë fature       | Sh.Totale   | G.Punimi         | Sh.Operatori      | Nr i urdher shpenzimit | Data e Likuidimit |              |                        |                   |     |            |           |         |           |      |            |  |  |                  |                |                  |  |  |     |          |           |         |           |     |            |           |         |           |     |            |           |        |           |     |            |  |  |                   |                |                   |  |  |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
| 217                      | 10.09.2019        | 8,734,958   | 436,748          | 8,298,210         | 1053                   | 11.09.2019        |              |                        |                   |     |            |           |         |           |      |            |  |  |                  |                |                  |  |  |     |          |           |         |           |     |            |           |         |           |     |            |           |        |           |     |            |  |  |                   |                |                   |  |  |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
|                          |                   | <b>8,734,958</b>  | <b>436,748</b>   | <b>8,298,210</b>  |                        |                   |              |                        |                   |     |            |           |         |           |      |            |  |  |                  |                |                  |  |  |     |          |           |         |           |     |            |           |         |           |     |            |           |        |           |     |            |  |  |                   |                |                   |  |  |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
| 228                      | 23.12.19          | 6,820,531   | 341,027          | 6,479,504         | 767                    | 17.07.2020        |              |                        |                   |     |            |           |         |           |      |            |  |  |                  |                |                  |  |  |     |          |           |         |           |     |            |           |         |           |     |            |           |        |           |     |            |  |  |                   |                |                   |  |  |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
|                          |                   | 5,000,000   | 250,000          | 4,750,000         | 872                    | 11.08.2020        |              |                        |                   |     |            |           |         |           |      |            |  |  |                  |                |                  |  |  |     |          |           |         |           |     |            |           |         |           |     |            |           |        |           |     |            |  |  |                   |                |                   |  |  |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
|                          |                   | 1,316,816   | 65,841           | 1,250,975         | 988                    | 09.09.2020        |              |                        |                   |     |            |           |         |           |      |            |  |  |                  |                |                  |  |  |     |          |           |         |           |     |            |           |         |           |     |            |           |        |           |     |            |  |  |                   |                |                   |  |  |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
|                          |                   | <b>13,137,347</b>   | <b>656,867</b>   | <b>12,480,480</b> |                        |                   |              |                        |                   |     |            |           |         |           |      |            |  |  |                  |                |                  |  |  |     |          |           |         |           |     |            |           |         |           |     |            |           |        |           |     |            |  |  |                   |                |                   |  |  |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
|                          | <b>Likuidimet</b> | <b>21,872,305</b>   | <b>1,093,615</b> | <b>20,778,690</b> |                        |                   |              |                        |                   |     |            |           |         |           |      |            |  |  |                  |                |                  |  |  |     |          |           |         |           |     |            |           |         |           |     |            |           |        |           |     |            |  |  |                   |                |                   |  |  |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
|                          | kontrata          | 21,872,503  |                  |                   |                        |                   |              |                        |                   |     |            |           |         |           |      |            |  |  |                  |                |                  |  |  |     |          |           |         |           |     |            |           |         |           |     |            |           |        |           |     |            |  |  |                   |                |                   |  |  |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
|                          | palikujduar       | 198   |                  |                   |                        |                   |              |                        |                   |     |            |           |         |           |      |            |  |  |                  |                |                  |  |  |     |          |           |         |           |     |            |           |         |           |     |            |           |        |           |     |            |  |  |                   |                |                   |  |  |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |
| <b>Kriteri</b>           |                   | <p>KPK neni “Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve”;<br/>Ligji nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar neni 7,12, dhe 18<br/>UKM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3 datë 15.02.2001 “ Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.” dhe i ngarkohet investitorëve përgjegjësia për këtë veprim.</p>   |                  |                   |                        |                   |              |                        |                   |     |            |           |         |           |      |            |  |  |                  |                |                  |  |  |     |          |           |         |           |     |            |           |         |           |     |            |           |        |           |     |            |  |  |                   |                |                   |  |  |  |                   |                   |                  |                   |  |  |  |          |            |  |  |  |  |  |             |     |  |  |  |  |

|                       |  |
|-----------------------|--|
|                       | Pranimi i dokumentacionit vërtetues është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 6 e udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “pika 35 dhe 36, është përgjegjësi e nëpunësit zbatues siç shprehet edhe neni 12 pika 3 germa dh) dhe e) e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Pranimi i dokumentacionit të paplotë, përbën risk për sa i përket vërtetësisë së shpenzimit kapital. Gjithashtu vlera totale e penalitetit ku faturat janë paraqitur shumë më vonë se sa koha e situacionit në shumën <b>1,246,732 lekë</b> përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit  |
| <b>Shkaku</b>         | Mos zbatim i akteve ligjore  |
| <b>Rendësia</b>       | E lartë  |
| <b>Rekomandimi</b>    | Nga Bashkia Korçë, të merren masa që likuidimi i shpenzimeve të kryhet bazuar në dokumentacion të plotë, autorizues dhe vërtetues të shpenzimit kapital.<br>Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik në shumën <b>1,246,732 lekë</b> , si pasojë e mosmbajtjes së kamatvonesave.  |

### 3.Procedura e prokurimit publik me objekt: “Rikonstrukcion rrugësh në njësitë administrative (faza e parë)”:

|  |  |  |
|--|--|--|
| <b>Urdhër prokurimi</b><br>nr. 215 datë 25.03.2019           | <b>NJHDT:</b> nr. 215 datë 25.03.2019<br>M.S(Jurist)   | <b>KVO</b> nr. 215/1, datë 25.03.2019<br>B.TH , ZV Kryetare e Bashkisë<br>E.DH, specialiste Drejtoria e Financës<br>K.J, jurist Drejtoria Juridike<br>H.N, specialist DPKZHT<br>A.D, specialist Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave |
| <b>Lloji i procedurës</b> “e hapur”                          | M.B(Ing.agro ushqimore)<br>B.M(Ing. ndërtimi)  |  |
| <b>Fondi Limit</b> 47,771,000 lekë.                          |  |  |
| <b>Burimi Financimit:</b> të ardhurat e Bashkisë             | <b>OE fitues</b> “G” shpk<br><b>Vlera e fituar:</b> 25,467,096 lekë                                    |  |
| <b>Data e hapjes së tenderit:</b> 25/04/2019                 | <b>Diferenca me fondin limit</b><br>22,303,904 lekë  |  |
| <b>Ankimime në AK:</b> s`ka<br><b>Ankimime në KPP:-</b> s`ka | <b>Operatorët Ekonomike</b><br>Pjesëmarrës në tender: 13 OE<br>S`kualifikuar 6 OE,<br>Kualifikuar 7 OE | Kontrata datë 31.05.2019   |

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.</b>  |
| <b>Situata</b>           | <b>Mbi hartimin e Dokumenteve të Tenderit.</b> DT për kriteret teknike për kualifikim janë hartuar më datë 25.03.2019, nga anëtari i NJHDT, B.M.<br><b>Procesverbali i hartimit të DT</b> mban datën 25.03.2019.<br><b>Në hartimin e DT</b> në lidhje me kriteret teknike rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:<br><b>1-</b> Seksioni II, “Informacione të veçanta për kontratat”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 7.<br><b>2-</b> Kreu VII, “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, parag.2.<br><b>Si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:</b> |





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

**Në DT është kërkuar:** “Disponimi i mjeteve” si dhe **Shënim:** Lidhur me fabrikën e asfalto betonit ofertuesit duhet të kenë në pronësi, me qira apo të lidhin kontrate furnizimi me një fabrikë vendndodhja e se cilës garanton realizimin e objektit konform kushteve teknike të përcaktuara në VKM nr.628 datë 15.07.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”

**Sqarojmë se në lidhje me:**

➤ mjetet (kamion, betonierë, autobot, autovinç, nuk janë përcaktuar kapacitetet e tyre, në lidhje me objektin dhe nevojat e zbatimit të kontratës.

➤ Nuk është përcaktuar lloji i ekskavatorit me goma apo zinxhirë.

**Sa më sipër kjo kërkesë nuk qëndron. Sqarojmë se:**

- Jemi në kushtet kur OE pjesëmarrës në procedurë ka lëshuar deklaratë për plotësimin e specifikimeve teknike;

- Kërkesë në kundërshtim me UKM nr.3, datë 15.2.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pikat 9, 10, 11 dhe 12.

- Kërkesë në kundërshtim me VKM nr.628 datë 15.07.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”, pikatL

e- “Rregulli teknik për ndërtimin e rrugëve (RrTNRr-1), Vëllimi 1: “Të përgjithshme dhe punime përgatitore” pjesa nr. **“5 Kontrolli i Punës”, pika 5.2 Autoriteti i Inxhinierit Mbikëqyrës**”, ku janë përcaktuar veprimet e mbikëqyrësit

f- Rregulli teknik për ndërtimin e rrugëve (RrTNRr-8), Vëllimi 8: Kërkesa për pranimin e materialeve dhe të produkteve, vëllimi 8: kërkesa për pranimin e materialeve dhe të produkteve, pika 4, “Plotësimi i Kërkesave nga Produkti dhe Vlerësimi i Përputhshmërisë”, në të cilën janë përcaktuar sipas pikës 1, “Qëllimi”.

**Sa më sipër ngarkohet më përgjegjësi sipas pikave NJHDT**

**Nga auditimi i kësaj procedure është shpallur fitues OE me vlerë më të ulët, nga auditimi i të cilit rezultoi se:**

Nga auditimi i kërkesës për një inxhinier hidroteknik nuk figuron në rubrikën në spe “Glavenca licenca dhe stafi drejtues”.

Sa u trajtua ky OE nuk i plotëson kriteret për kualifikim dhe si i tillë duhej të s`kualifikohej nga procedura.

**Paligjshmëria në përdorimin e fondeve është në shumën 25,467,096 lekë.**

**Sa më sipër mban përgjegjësi KVO.**

|                       |   |
|-----------------------|---|
| <b>Kriteri</b>        | Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.          |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën 25.467.096 lekë pa tvsh |
| <b>Shkaku</b>         | Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.                                 |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë   |
| <b>Rekomandimi</b>    | AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.          |

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën 6684/4, datë 01.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot.,260/18 datë 03.06.2021 “Shkresë përcjellëse”, nga *Kryetari i Bashkisë S.F.*, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

Lidhur me kriterin e vendosur per disponimin e mjeteve:  
 -Lidhur me pretendimin e audituesve per kapacitetin e mjeteve kamion, autobot, autovinc dhe betoniere sqarojmë se janë kërkuar mjetet minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës. Nuk është vendosur kapaciteti me qëllim të thjeshtimit të kriterëve, stimulimin e pjesëmarrjes te ofertuesve, rritjen e konkurrencës dhe vlerësimit sa më të drejtë të ofertuesve.  
-Lidhur me "Fabrikën e asfalto betonit".  
 Së pari: Kriteri është vendosur me qëllim që të vërtetohet disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e kontratës.  
 Ky kriter nuk është vendosur që të vërtetohet cilësia e materialeve, pasi sic është argumentuar edhe nga ana juaj , KVO nuk vlerëson cilësinë e materialeve.  
 Në përfundim mendojmë se nuk përbën shkelje fakti që operatorëve ju është vënë në dukje se duhet të disponojnë një fabrikë qe respekton kërkesat e VKM 628 datë 15.07.2015.  
 Lidhur me vlerësimin e ofertës të paraqitur nga shoqëria G sh.p.k,e cila është oferta me e ulët e paraqitur dhe e e shpallur fituese,nga audituesit është konstatuar se nuk është paraqitur dokumentacioni per një inxhinier hidroteknik.  
 Për sa më sipër sqarojmë se shoqëria G sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin per ing. Vladimir Nase i cili ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në Degen e Ndërtimit dhe ka mar titullin Inxhinier Ndertimi me specialitet Ndertime Hidroteknike,Rruga, Ura .  
 Gjithashtu referuar Licencës Profesionale Z.3197/2 ky ing është i licencuar edhe për kategoria 8.a Ndertim ujesjelles-kanalizime-kanale impiante vaditje.  
 Referuar sa më sipër KVO e ka konsideruar të plotësuar kërkesën për ing hidroteknik.

#### Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

- Për çështjet e tjera të trajtuara ju nuk keni paraqitur argumente dhe fakte të reja, për sa kundërshtoni jeni në kundërshtim me aktet ligjore të cituara në akt konstatim dhe në gjetjen përkatëse.

#### 4.Procedura e prokurimit publik me objekt: “Skemat ujitëse ”:

|  |   |  |
|--|---|--|
| <b>Urdhër prokurimi</b><br>nr. 249 datë 02.04.2019           | <b>NJHDT:</b> nr. 249 datë 02.04.2019<br>M.S(Jurist)  | <b>KVO</b> nr. 249/1 datë 02.04.2019<br>B.TH , ZV Kryetare e Bashkisë                  |
| <b>Lloji i procedurës</b> “e hapur”                          | M.B(Ing.agro ushqimore)<br>B.M(Ing. ndërtimi)   | M.B, juriste burimet njerëzore<br>A.D, specialist Drejtoria e Menaxhimit te Kontratave |
| <b>Fondi limit</b> 17,238,211 lekë.                          |   | O.L, specialist DPKZHT<br>K.P, specialiste Drejtoria e Financës.                       |
| <b>Burimi Financimit:</b> të ardhurat e Bashkisë             | <b>OE fitues</b> A.K 2002 shpk & “A.A” shpk<br><b>Vlera e fituar:</b> 9,813,689 lekë                  |  |
| <b>Data e hapjes së tenderit:</b> 25/04/2019                 | <b>Diferenca me fondin limit</b><br>7,424,522 lekë  |  |
| <b>Ankimime në AK:</b> s`ka<br><b>Ankimime në KPP:-</b> s`ka | <b>Operatorët Ekonomike</b><br>Pjesëmarrës në tender: 10 OE<br>S`kualifikuar 3 OE<br>Kualifikuar 7 OE |  |

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mos zbatim i akteve ligjore e nënljgore të LPP.</b>   |
| <b>Situata</b>           | <b>Mbi hartimin e Dokumenteve të Tenderit.</b> DT për kriteret teknike për kualifikim janë hartuar më datë 03.04.2019, nga anëtari i NJHDT, B.M.<br><b>Procesverbali i hartimit të DT</b> mban datën 03.04.2019.<br><b>Në hartimin e DT</b> në lidhje me kriteret teknike rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | <p>prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:<br/> <b>1-</b> Seksioni II, “Informacione të veçanta për kontratat”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 7.<br/> <b>2-</b> Kreu VII, “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2.<br/> <b>Si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:</b><br/> <b>Në DT është kërkuar sa vijon: <u>Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:</u></b><br/> N.P. 7 A, Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje<br/> N.P - 9 A, Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.<br/> Në kuptim të VKM nr.42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, <b>kuptimi i këtyre kategorive të licensave është:</b></p> <p><i>N.P. 7: Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pishëm, ujësjiellësat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.</i></p> <p><i>N.P. 9 Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemin dhe vendosjen e rregjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafrangmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.</i></p> <p>Nga ku rezulton se nuk duhej të ishte kërkuar kategoria <b>N.P. 9 -Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.</b><br/> <b>Në DT është kërkuar: “Disponimi i mjeteve”</b><br/> <b>Sqarojmë se në lidhje me:</b><br/> ➤ mjetet (kamion, betonierë, nuk janë përcaktuar kapacitetet e tyre, në lidhje me objektin dhe nevojat e zbatimit të kontratës.<br/> <b>Sa më sipër ngarkohet më përgjegjësi sipas pikave NJHDT</b></p> |
| <b>Kriteri</b>        | Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.  |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Përcaktim i kriterëve jo në lidhje me objektin e prokurimit dhe mosargumentim i tyre.   |
| <b>Shkaku</b>         | Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.   |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë   |
| <b>Rekomandimi</b>    | AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.  |

Likuidimi i kontratës me objekt: “Skemat ujitëse ”:

|                          |   |
|--------------------------|---|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mbi penalitetet që lindin si pasojë e dorëzimit të faturave tatimore të mëvonshme nga data e përfundimit të kontratës - “Skemat ujitëse ”, me kontraktor "A.K 2002" shpk &amp; "A.A" shpk.</b>     |
| <b>Situata</b>           | Kontratë e lidhur më datën 18.06.2019, me Nr. Kontrate 4841/2 prot. Afati tre muaj ose data <b>18.09.2019</b> . Firma fituese "A.K 2002" shpk & "A.A" shpk. Vlera totale e kontratës 11,776,426 lekë. |

Kodi i projektit 1220607 *Financim nga Të Ardhurat e Bashkisë*

| Nr. Fat. | Datë fature       | Sh. Totale        | G. Punimi      | Sh. Operatori     | urdher shpenzim | Data e Likuidimit |
|----------|-------------------|-------------------|----------------|-------------------|-----------------|-------------------|
| 216      | 19.08.2019        | 2,864,280         | 143,214        | 2,721,066         | 1073            | 16.09.2019        |
| 218      | 20.09.2019        | 4,143,288         | 207,164        | 3,936,124         | 1120            | 24.09.2019        |
| 224      | 19.11.2019        | 4,768,858         | 238,443        | 4,530,415         | 1394            | 20.11.2019        |
|          | <b>Likuidimet</b> | <b>11,776,426</b> | <b>588,821</b> | <b>11,187,605</b> |                 |                   |
|          | kontrata          | 11,776,426        |                |                   |                 |                   |
|          | palikujduar       | 0                 |                |                   |                 |                   |

Nga auditimi rezulton se fatura tatimore është paraqitur më datë 19.11.2019 nga **18.09.2019**, ose 61 ditë më vonë.

Bazuar në nenin 27 të kontratës Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve, pika 27,1 referon;

“Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve do të llogariten me tarifën ditore

- tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës’

Përfundimisht kamatvonesa për fatura jashtë afatit të kontratës është;

**Kamatvonesa= 61 ditë \*11,776,426 lekë \*4/1000 \*25% = 718,362 lekë.**

|                       |  |
|-----------------------|--|
| <b>Kriteri</b>        | KPK neni “Dëmet e likujdushme për vonesat në mbarimin e punimeve”; Ligji nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar neni 7,12, dhe 18<br>UKM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3 datë 15.02.2001 “ Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.” dhe i ngarkohet investitorëve përgjegjësia për këtë veprim.<br>Pranimi i dokumentacionit vërtetues është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, nenit 6 e udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “pika 35 dhe 36, është përgjegjësi e nëpunësit zbatues siç shprehet edhe neni 12 pika 3 germa dh) dhe e) e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Pranimi i dokumentacionit të paplotë, përbën risk për sa i përket vërtetësisë së shpenzimit kapital. Gjithashtu vlera totale e penalitetit ku faturat janë paraqitur shumë më vonë se sa koha e situacionit në shumën <b>718,362 lekë</b> përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit  |
| <b>Shkaku</b>         | Mos zbatim i akteve ligjore  |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë  |
| <b>Rekomandimi</b>    | Nga Bashkia Korçë, të merren masa që likuidimi i shpenzimeve të kryhet bazuar në dokumentacion të plotë, autorizues dhe vërtetues të shpenzimit kapital.<br>Drejtorja e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik në shumën <b>718,362 lekë</b> , si pasojë e mosmbajtjes së kamatvonesave.  |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

**5.Procedura e prokurimit publik me objekt: “Për projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pa favorizuara (rehabilitim përforcim banesash ekzistuese”:**

|  |   |   |
|--|---|---|
| <b>Urdhër prokurimi</b><br>nr. 712, datë 19.08.2019                  | <b>NJHDT</b> nr. 712, datë 19.08.2019<br>M.S(Jurist)  | <b>KVO:</b><br>me nr. 712, datë 19.08.2019<br>B.TH , ZV Kryetare e Bashkisë<br>A.D, specialist Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave<br>K.J. Jurist Drejtoria Juridike;<br>E.V, specialiste, DPKZHT;<br>E.DH, specialste Drejtoria e Financës.<br><br>Kontrata nr.8339/2, datë 27.09.2019<br>Vlera e kontratës 8,817,730 lekë<br>Afati 2 muaj. |
| <b>Lloji i procedurës</b> “kërkesë për propozim”                     | M.B(Ing.agro ushqimore)<br>B.M(Ing. ndërtimi)   |   |
| <b>Fondi limit</b> 9,505,055 lekë.                                   |   |   |
| <b>Burimi Financimit:</b> Buxheti i shtetit + Te ardhurat e bashkisë | <b>OE fitues</b> “N” sh.p.k<br><b>Vlera e fituar:</b> 7,348,108 lekë                                  |   |
| <b>Data e hapjes së tenderit:</b> 02.09.2019                         | <b>Diferenca me fondin limit</b><br>2,156,947 lekë  |   |
| <b>Ankimime në AK:</b> s’ka<br><b>Ankimime në KPP:-</b> s’ka         | <b>Operatorët Ekonomike</b><br>Pjesëmarrës në tender: 8 OE<br>S’kualifikuar 4 OE,<br>Kualifikuar 4 OE |   |

| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>i</b>   |                  |       |        |        |           |        |          |        |
|--------------------------|--|------------------|-------|--------|--------|-----------|--------|----------|--------|
| <b>Situata</b>           | <p><b>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.</b></p> <p><b>Hartimi i dokumenteve të procedurës:</b><br/>Procesverbali për hartimin e kriterëve të veçanta teknike për kualifikim, është mbajtur më datë 19.08.2018, nga B.M.<br/>Procesverbali “Për hartimin e dokumenteve të tenderit”, është hartuar më datë 19.08.19.</p> <p><b>Mbi hartimin e Dokumenteve të Tenderit.</b> DT për kriteret teknike për kualifikim janë hartuar më datë 03.04.2019, nga anëtari i NJHDT, B.M.<br/><b>Procesverbali i hartimit të DT</b> mban datën 03.04.2019.</p> <p><b>Në hartimin e DT</b> në lidhje me kriteret teknike rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:<br/> <b>1- Seksioni II, “Informacione të veçanta për kontratat”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 7.</b><br/> <b>Në DT është kërkuar: “Disponimi i mjeteve të mëposhtme:</b></p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th>Lloji Makinerive</th> <th>Sasia</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Kamion</td> <td>Cope 3</td> </tr> <tr> <td>Betoniere</td> <td>Cope 4</td> </tr> <tr> <td>Autovinc</td> <td>Cope 2</td> </tr> </tbody> </table> <p><b>Sqarojmë se në lidhje me:</b><br/> ➤ mjetet (kamion, betonierë, autovinç), nuk janë përcaktuar kapacitetet e tyre, në lidhje me objektin dhe nevojat e zbatimit të kontratës.<br/> <b>Sa më sipër ngarkohet më përgjegjësi sipas pikave NJHDT</b></p> | Lloji Makinerive | Sasia | Kamion | Cope 3 | Betoniere | Cope 4 | Autovinc | Cope 2 |
| Lloji Makinerive         | Sasia  |                  |       |        |        |           |        |          |        |
| Kamion                   | Cope 3   |                  |       |        |        |           |        |          |        |
| Betoniere                | Cope 4   |                  |       |        |        |           |        |          |        |
| Autovinc                 | Cope 2   |                  |       |        |        |           |        |          |        |
| <b>Kriteri</b>           | Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.   |                  |       |        |        |           |        |          |        |
| <b>Ndikimi/efekti</b>    | Përcaktim i kriterëve jo në lidhje me objektin e prokurimit dhe mosargumentim i tyre.  |                  |       |        |        |           |        |          |        |
| <b>Shkaku</b>            | Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.  |                  |       |        |        |           |        |          |        |
| <b>Rendesia</b>          | E lartë  |                  |       |        |        |           |        |          |        |
| <b>Rekomandimi</b>       | AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.   |                  |       |        |        |           |        |          |        |

**6.Procedura e prokurimit publik me objekt: “Rikonstrukcion i Shkollës 9 vjecare “Nuçi Naçi – 3 kate shtesë për palestër”:**

|  |  |   |
|--|--|---|
| <b>Urdhër prokurimi</b><br>nr. 345, datë 26.04.2019                    | <b>NJHDT</b> nr. 345, datë 26.04.2019<br>M.S(Jurist) | <b>KVO</b> nr. 345/1, datë 26.04.2019<br>B.TH , ZV Kryetare e Bashkisë<br>K.J. Jurist Drejtoria Juridike;<br>E.V, specialiste, DPKZHT;<br>E.DH, specialiste Drejtoria e Financës.<br>E.M, specialiste drejtoria e financës. |
| <b>Lloji i procedurës</b> “i hapur”                                    | M.B(Ing.agro ushqimore)<br>B.M(Ing. ndërtimi)        |   |
| <b>Fondi limit</b> 41,666,666 lekë.                                    |  |   |
| <b>Burimi Financimit:</b> Buxheti i shtetit + Te ardhurat e bashkise   | <b>OE fitues</b> “N” sh.p.k                          |   |
|  | <b>Vlera e fituar:</b> 25,104,541 lekë               |   |
| <b>Data e hapjes së tenderit:</b> ishte 30/05/2019<br>Bëhet 05.06.2019 | <b>Diferenca me fondin limit</b><br>16,562,125 lekë  | <b>Operatorët Ekonomike</b><br>Pjesëmarrës në tender: 14 OE<br>S’kualifikuar 3 OE,<br>Kualifikuar 11 OE   |
| <b>Ankimime në AK:</b> s`ka<br><b>Ankimime në KPP:-</b> s`ka           |  |   |

| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.</b>  |
|--------------------------|--|
| <b>Situata</b>           | <p><b>Mbi përlogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike, dhe dokumentacionit teknik.</b><br/>Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, datë 24.04.2019, i është dërguar NJHDT dokumentacioni teknik për fillimin e procedurave të prokurimit: projekti, specifikimet teknike, preventivi i punimeve, grafiku i punimeve.<br/><b>Nga auditimi i çmimeve të preventivit rezultoi se janë zbatuar çmimet e manualit.</b><br/>Nga auditimi i preventivit të paraqitur rezultoi se kemi një rritje fiktive të preventivit. Konkretisht për makineritë dhe pajisjet është përlogaritur me fond rezervë si dhe t.v.sh duke i konsideruar punime ndërtimi punimet e furnizimit të makinerive dhe pajisjeve. Kjo lloj strukture e ndërtuar në këtë formë bie ndesh me legjislacionin në fuqi, konkretisht me: UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, germa “A”, paragrafi i fundit, pasi të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat në përfshirjen e punimeve të ndërtimit, ku përcaktohet se: “Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat”, e konkretisht rezulton se fondi limit është përlogaritur tepër në shumën 1,542,802 lekë dhe nga situacioni përfundimtar i punimeve <b>janë përfituar padrejtësisht nga OE shuma prej 255,414 lekë.</b><br/><b>Hartimi i dokumenteve të procedurës:</b><br/>Procesverbali për hartimin e kriterëve të veçanta teknike për kualifikim, është mbajtur më datë 26.04.2019, nga B.M.<br/>Procesverbali “Për hartimin e dokumenteve të tenderit”, është hartuar më datë 26.04.19.<br/><b>Mbi hartimin e Dokumenteve të Tenderit.</b> DT për kriteret teknike për kualifikim janë hartuar më datë 03.04.2019, nga anëtari i NJHDT, B.M.<br/><b>Procesverbali i hartimit të DT</b> mban datën 03.04.2019.<br/><b>Në hartimin e DT</b> në lidhje me kriteret rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon:<br/><b>1- Seksioni II, “Informacione të veçanta për kontratat”, neni 26 “Kontratat</b></p> |



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

për punë publike”, pika 7

2- Kreu VII, “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2.

**Si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:**

**Në Dt është kërkuar Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:** N.P – 4A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale, ndërkohë që objekt i prokurimit është ndërtim shkolle.

**Në DT** për disponimin e mjeteve nuk është kërkuar kapaciteti i tyre.

**Në DT është vënë shenim:** Lidhur me fabriken e asfaltobetonit ofertuesit duhet të kenë në pronësi, me qera apo të lidhin kontratë furnizimi me një fabrikë vendndodhja e së cilës cila garanton realizimin e objektit konform kushteve teknike të përcaktuara në VKM nr.628, datë 15.07.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”

**Sa më sipër kjo kërkesë nuk qëndron. Sqarojmë se:**

- Jemi në kushtet kur OE pjesëmarrës në procedurë ka lëshuar deklaratë për plotësimin e specifikimeve teknike;

- Kërkesë në kundërshtim me UKM nr.3, datë 15.2.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pikat 9, 10, 11 dhe 12.

- Kërkesë në kundërshtim me VKM nr.628 datë 15.07.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”, pikat L

**g-** “Rregulli teknik për ndërtimin e rrugëve (RrTNRr-1), Vëllimi 1: “Të përgjithshme dhe punime përgatitore” pjesa nr. “**5 Kontrolli i Punës**”, **pika 5.2 Autoriteti i Inxhinierit Mbikëqyrës**”, ku janë përcaktuar veprimet e mbikëqyrësit

**h-** Rregulli teknik për ndërtimin e rrugëve (RrTNRr-8), Vëllimi 8: Kërkesa për pranimin e materialeve dhe të produkteve, vëllimi 8: kërkesa për pranimin e materialeve dhe të produkteve, pika 4, “Plotësimi i Kërkesave nga Produkti dhe Vlerësimi i Përputhshmërisë”, në të cilën janë përcaktuar sipas pikës 1, “Qëllimi”.

**Sa më sipër ngarkohet më përgjegjësi sipas pikave NJHDT**

***Sa u trajtua ngarkohen me përgjegjësi NJHDT, sipas pikave të përcaktimit të kriterëve për kualifikim.***

Nga auditimi i ofertës fituese “N” shpk, rezulton se në plotësim të kriterëve për kualifikim sa vijon:

*“Në rast se nuk ka në pronësi apo me qera Nyje të thyerjes të materialeve inerte duhet të paraqitet **kontrata e furnizimit me prodhuesin**, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, planin e vendosjes të nyjes, dhe lejen mjedisore (duhet të paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B lëshuar nga QKL ose leja mjedisore e lëshuar nga Ministria e Mjedisit.)*

*Në rast se Fabrika e asfaltobetonit nuk është në pronësi apo me qera, duhet të paraqitet **kontrate furnizimi me prodhuesin e vlefshme** për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, planvendosjen e fabrikes dhe lejen mjedisore (duhet të paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B lëshuar nga QKL ose leja mjedisore e lëshuar nga Ministria e Mjedisit.)”*

OE ka paraqitur **dy kontrata furnizimi të lidhura midis palëve, dhe jo kontrata të noterizuara** që të japin besueshmërinë e lidhjes së tyre.

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | <b>Sa më sipër ky OE nuk e plotëson këtë kusht, duke sjellë paligjshmëri në përdorimin e fondeve në shumën 25,104,541 lekë.<br/>Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO.</b> |
| <b>Kriteri</b>        | Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.  |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën <b>25,104,541 lekë</b> pa tvsh  |
| <b>Shkaku</b>         | Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.   |
| <b>Rendesia</b>       | E lartë   |
| <b>Rekomandimi</b>    | AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.  |

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën 6684/4, datë 01.06.2021, e protokolluar në KLSH me numër prot.,260/18 datë 03.06.2021 “Shkresë përcjellëse”, nga *Kryetari i Bashkisë S.F.*, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

I.Lidhur me kriteret për licencat dhe mjetet e vendosura në DST ju sqarojmë se:  
Lidhur me kriterin e vendosur për disponimin e kategorise N.P – 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale ju sqarojmë se kjo kategori është kërkuar për shkak se në preventivin e punimeve janë parashikuar punime sistemimi të jashtëm (ku përfshihet edhe shtresa stabilizanti dhe binderi)

II-Lidhur me "Fabrikën e asfalto betonit".  
Së pari: Kriteri është vendosur me qëllim që të vërtetohet disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e kontratës.  
Ky kriter nuk është vendosur që të vërtetohet cilësia e materialeve, pasi sic është argumentuar edhe nga ana juaj , KVO nuk vlerëson cilësinë e materialeve, është detyrim i autoritetit kontraktor që të kërkojë mjete dhe pajisje teknike të cilat janë të nevojshme për të përmbushur kontratën.  
Nga ana tjetër ofertuesi ka detyrimin të vërë në dispozicion për realizimin e objektit makineri dhe pajisje funksionale dhe që mund ti vërë realisht në dispozicion për realizimin e objektit të kërkuar. Në rast se fabrika e asfaltit ndodhet në një largësi që nuk mund të vihet në dispozicion të objektit atëherë rrjedhimisht ofertuesi nuk mund ta realizojë objektin.  
Në përfundim mendojmë se nuk përbën shkelje fakti që operatorëve ju është vënë në dukje se duhet të disponojnë një fabrikë qe respekton kërkesat e VKM 628 datë 15.07.2015.

III Lidhur me vlerësimin e ofertave  
Nga audituesit është konstatuar se shoqëria N sh.p.k , e cila ka paraqitur ofertën më të ulët,nuk plotëson kriteret për kualifikim për arsye se nuk ka paraqitur kontrata furnizimi të notërizuara .  
Lidhur me sa më sipër ju sqarojmë se:  
-Në kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit është kërkuar:  
"Ne rast se nuk ka ne pronesi apo me qera Nyje te thyerjes te materialeve inerte duhet te paraqitet kontrata e furnizimit me prodhuesin, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, e shoqeruar me dokumente qe vertetojne pronesine e saj, planin e vendosjes te nyjes, dhe lejen mjedisore duhet te paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose leja mjedisore e leshuar nga Ministria e Mjedisit.)  
Ne rast se Fabrika e asfaltobetonit nuk eshte ne pronesi apo me qera, duhet te paraqitet kontrate furnizimi me prodhuesin e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, e shoqeruar me dokumente qe vertetojne pronesine e saj, planvendosjen e fabrikes dhe lejen mjedisore ( duhet te paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose leja mjedisore e leshuar nga Ministria e Mjedisit.)"  
Gjithashtu në Nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

*ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

Për sa më sipër rezulton se në kriteret e vendosura në DST nuk janë kërkuar kontrata të noterizuara. Gjithashtu edhe referuar Kodit Civil (neni 659 dhe në vijim) forma noteriale nuk parashikohet si kusht për vlefshëmrinë e kontratave të furnizimit .

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

**Në lidhje me kategorinë e licenes, ju sqarojmë se në VKM nr.42, datë 16.01.2008,** “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, kuptimi i kësaj kategorie është sa vijon:

“N.P. 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndërë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore”, për rrjedhojë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

- Për çështjet e tjera të trajtuara ju nuk keni paraqitur argumente dhe fakte të reja, për sa kundërshtoni jeni në kundërshtim me aktet ligjore të cituara në akt konstatim dhe në gjetjen përkatëse.

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

##### **a- Anëtarët e KVO dhe KSHA**

1. B.TH, me detyrë Zv/Kryetari i Bashkisë
2. A.A
3. A.D, me detyrë Specialist inxhinier ndërtimi, Sektori i Menaxhimit të Kontrateve;
4. E.V, me detyrë ish përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit të Territorit dhe projekteve
5. E.DH, me detyrë Specialist për kontabilitetin, në Drejtorinë e Financës;
6. E.M, me detyrë ish specialist për infrastrukturën mjedisore
7. GJ.P, me detyrë Përgjegjës i Sektorit, Sektori i Shqyrtimit të kërkesave për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi (AMTP);
8. H.N, me detyrë Specialist për Shqyrtimin e Lejeve, Sektori për Kontrollin e Zhvillimit;
9. K.J, me detyrë Specialist për menaxhimin e aseteve në pronësi të Bashkisë Korçë, Drejtoria Juridike;
10. K.P, me detyrë Specialist buxheti Sektori i buxhetit;
11. M.B me detyrë Specialist Jurist, Sektori i Burimeve Njerëzore;
12. V.P, me detyrë ish specialiste juriste në sektorin AMTP
13. M.L, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit;

**b- Antarët e NJHDT**

1. M.S, Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve
2. M.B, Specialist për Proçedurat, Sektori i Prokurimeve
3. B.M, Specialistë preventivues, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit Të Zhvillimit të Territorit.

**Viti 2020.**

*Nga auditimi i procedurave të mëposhtëme rezultoi se janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik, nga llogaritja e fondit limit deri në lidhjen e kontratës sa vijon:*

“Procedura e prokurimit publik me objekt: “Blerje pako ushqimore ne ndihme te familjeve ne nevoje per perballimin e gjendjes se fatkeqesise natyrore te shkaktuara nga COVID-19”

Procedura e prokurimit publik me objekt: “Blerje karburanti, Loti 1-Nafte”

Procedura e prokurimit publik me objekt: “Blerje karburanti, Loti 2-Benzine”

Procedura e prokurimit publik me objekt: “Blerje kancelari leter boje printeri dhe fotokopje” Loti 1 - kancelari dhe letër dhe Loti 2 Boje printeri dhe fotokopje

Procedura e prokurimit publik me objekt: “Blerje kancelari leter boje printeri dhe fotokopje



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

**2.5. Auditim mbi zbatimin e kushteve në realizimin e punimeve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera në kontratat e lidhura me operatorët ekonomike fitues.**

**Te dhënat për kontrata për punë publike të kryera nga Bashkia Korçë, paraqiten në Aneks 3-3.5, bashkëlidhur projekt raportit.**

Në Bashkinë Korçë për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 -3 0.06.2020, janë zbatuar 20 kontrata për punë civile, dhe nga këto janë audituar 15 (pesëmbëdhjetë) në shumën **328,967,861.58 lekë me TVSH** nga ku:

- **Për vitin 2018**, janë audituar 6 kontrata për punë publike me shumë 152,598,236.82 lekë me TVSH.

- **Për vitin 2019**, janë audituar 9 kontrata për punë publike me shumë 176,369,624.76 lekë me TVSH, pasqyruar në tabelën nr. 1.

**Tabela nr. 1. Kontrata për punë publike të audituara nga KLSH.**

| Nr.                         | Emërtimi i objektit   | Kontraktori               | Dt e lidhes së kontratës | Vlera e kontratës me TVSH | Vlera e dëmit ekonomik |                     |
|-----------------------------|---|---------------------------|--------------------------|---------------------------|------------------------|---------------------|
|                             |   |                           |                          |                           | pa TVSH                | me TVSH             |
| 1                           | 2   | 3                         | 4                        | 5                         | 6                      | 7                   |
| 1                           | Sistemim, asfaltim në rrugët e NJA (fshatrat Bulgarec, Porodine, Biranj, Goskova Poshtë dhe Moravë) | “A.K” shpk & “J” shpk.    | 04.09.2018               | 41,002,676.82             | 806,429.00             | 967,714.80          |
| 2                           | Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi Lagjet 5 dhe 13                          | “S” SHPK                  | 27.02.2019               | 34,168,897.35             | 1,078,892.00           | 1,294,670.40        |
| 3                           | Rehabilitimi urban i rrugëve në lagjet e qytetit  | A.K 2002SHPK              | 12.06.2019               | 21,872,503.00             | 918,454.00             | 1,102,144.80        |
| 4                           | Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale (Rikonstruksion rruge fshati Barç)                    | “V” ShPK                  | 27.05.2019               | 11,689,253.00             | 107,289 .00            | 128,746.00          |
| 5                           | Rikonstruksion shkollë 9-vjeçare “Naim Frashëri” + shtesë për palestër Korçë                        | “T” SHPK                  | 04.09.2018               | 26,233,536.00             | 1,184,877              | 1,421,852.40        |
| 6                           | Rindërtim i shkollës 9-vjeçare Voskopojë Bashkia Korçë.   | "N" SHPK                  | 31.12.2018               | 32,250,952.00             | 761,497.00             | 913,796.40          |
| 7                           | Rehabilitimi i rrjetit të kanaleve ujitëse  | A.K 2002SHPK              | 31.12.2018               | 5,048,470.00              | 21,250                 | 25,500.00           |
| 8                           | Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Nuçi Naçi”   | "N" SHPK                  | 29.07.2019               | 30,125,449.00             | 517,606                | 621,127.20          |
| 9                           | Rikonstruksion i pjesshëm i degës Ventrok   | "N" SHPK                  | 29.07.2019               | 22,918,633.41             | 95,500.00              | 114,600.00          |
| 10                          | Skema ujitëse, Bashkia Korçë  | A.K 2002SHPK & “A.A” SHPK | 18.06.2019               | 11,776,426.00             | 297,556.00             | 357,067.20          |
| 11                          | Rikonstruksion rrugësh në njësitë administrative (Faza I) Bashkia Korçë                             | “G” SHPK                  | 31.05.2019               | 30,560,515.00             | 634,555.00             | 761,466.00          |
| 12                          | Sistemim, asfaltim në rrugët e qytetit (lagjet nr. 4, 5, 6, 8, 13 dhe 18) Bashkia Korçë             | JV “S” & “J” SHPK         | 04.09.2018               | 46,009,674.00             | 939,368                | 1,127,241.60        |
| 13                          | Rikonstruksion në bllokun informal "Rr. QANI QYTEZA" Bashkia Korçë                                  | A.K 2002SHPK              | 16.07.2019               | 4,440,218.00              | 513,128.00             | 615,753.60          |
| 14                          | Për projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara, Bashkia Korçë  | "N" SHPK                  | 27.09.2019               | 8,817,730.00              | 177,205.00             | 212,646.00          |
| 15                          | Rikonstruksion i godinës së stacionit të M.Z.SH.-së   | “V - CO” SHPK             | 04.12.2018               | 2,052,928.00              | -                      | -                   |
| <b>SHUMA pa dhe me TVSH</b> |   |                           |                          | <b>328,967,861.58</b>     | <b>7,946,317</b>       | <b>9,535,580.40</b> |

**Burimi: Njësia e menaxhimit të kontratave për punë publike, në bashkinë Korçë.**

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor, mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit për kontratat për punë publike, në 14 raste u konstatuan problematika me pasojë dëm ekonomik në shumën **7,946,317 lekë pa TVSH ose 9,535,580.40 lekë me TVSH.**

Problematikat në mënyrë të përmbledhur janë argumentuar si vijon:

**1. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: “Sistemim, asfaltim në rrugët e NJA (fshatrat Bulgarec, Porodine, Biranj, Goskova Poshte dhe Moravë”), me të dhënat si vijon:**

| Të dhëna për :   |   |  |  |
|--|---|--|--|
| Kontratën e zbatimit   |   | Mbikëqyrjen  | Kolaudimin   |
| Kontratë Nr. 5196/3<br>Prot, datë 04.09.2018   | Afati zbatimit të<br>kontratës 3(tre) muaj  | kontrata nr. 5454/3 prot,<br>datë 04.09.2018<br>Mbikëqyrësi me “D.P” | kontrata pa nr. prot, datë<br>28.09.2018                         |
| Vlera e kontratës<br>41,002,676.82 lekë me<br>TVSH   | Periudha e garancisë së<br>difekteve - 24 muaj  | SHPK, me licence nr.<br>MK. 2837/5<br>Administrator:<br><b>S.K</b>   | “Personin fizik”<br>Z. P.S, me licence nr.<br>MK. 2632/1         |
| Financimi në dy vite<br>buxhetore (2018-2019).<br>Kontraktori “A.K” shpk<br>& “J” shpk.<br>Administrator: <b>A.B</b> | Punimet kanë filluar me<br>datë 17.09.2018<br>Punimet kanë<br>përfunduar, brenda afatit<br>12.11.2018 | Vlera e kontratës së<br>mbikëqyrjes është<br>742,362 lekë me TVSH.   | Vlera e kontratës së<br>kolaudimit është 40,000<br>lekë me TVSH. |

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <p><b>Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.</b></p> <p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi Lagjet 5 dhe 13” Bashkia Korçë, me vlerë 41,002,676.82 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Kontraktorëve të përkohshëm “A.K” SHPK &amp; “J” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe konkretisht, Shtresë çakëll 15 cm makadam (rruga), Nënshtrësë zhavorri, F.V. Tub të brinjëzuar HDPE SN8 D=315mm, Shtresë çakëll 10 cm, përhapur e ngjeshur me makineri, në objekt në vlerën <b>806,429 lekë pa TVSH</b>. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 5163 Prot, datë 04.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Bashkimit të Përkohshëm kontraktorëve “A.K” SHPK &amp; “J” SHPK.</p> |
| <b>Situata</b>           | <p><b>Situata:</b> Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në rikonstrukcionin e rrugës fshati Bulgarec, u konstatua diferencë volumi në realizimin e zërit të punimeve Zëri (An) Shtresë çakëll 15 cm makadam (rruga).</li> <li>- Në rikonstrukcionin e rrugës fshtai Porodinë, u konstatuan diferenca në volume në realizimn e zërave: “Tub të brinjëzuar HDPE SN8 D=315mm” dhe zërin “Shtresë çakëll 15 cm makadam”.</li> </ul> <p>Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punës të pasqyruara në situacionin përfundimtar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer në volumin e situacionuar, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 806,429 lekë pa TVSH.</p>   |
| <b>Kriteri</b>           | <p><b>Kriteri:</b> Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5454/3 prot, datë</li> </ul>   |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | 04.09.2018.   |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Korçë.  |
| <b>Shkaku</b>         | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej 806,429 lekë pa TVSH, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.  |
| <b>Rendesia</b>       | <i>E lartë</i>  |
| <b>Rekomandimi</b>    | Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>806,429</b> lekë pa TVSH nga Bashkimi i Kontraktorëve “A.K” SHPK & “J” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5163 prot, datë 04.09.2018 me objekt “Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi Lagjet 5 dhe 13”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara. |

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. S.K, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

**2. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: “Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi Lagjet 5 dhe 13”), me të dhënat si vijon:**

| Të dhëna për :   |   |  |  |
|--|---|--|--|
| Kontratën e zbatimit   |   | Mbikqyrjen   | Kolaudimin   |
| Nr. 900/2 , Prot, datë 27.02.2019  | Afati zbatimit 6 muaj                             | Nr. 1456/1 prot, datë 22.02.2019                       | Nr. 9952/2 prot, datë 25.10.2019                     |
| Vlera e kontratës 34,168,897.35 lekë me TVSH   | Periudha e garancisë së difekteve 24 muaj         | Mbikqyrësi “R” SHPK me Administratore: Znj. R.N        | Person fizik “P.P”, me licence MK. 1967/1.           |
| Amendament Kontrate datë 02.09.2019 -zgjatje e afatit kohor me 56 ditë.                    | Punimet kanë filluar me datë 4.3.2019             | Vlera e kontratës së mbikëqyrjes 742,362 lekë me TVSH. | Vlera e kontratës së kolaudit 40,365.6 lekë me TVSH. |
| Kontraktori “S” & “A” SHPK përfaqësuar nga Kontraktori “S” SHPK me administrator: Z. Th. S | Punimet kanë përfunduar, brenda afatit 22.10.2019 |  |  |

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.</b><br>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi Lagjet 5 dhe 13” Bashkia Korçë, me vlerë 34,168,897.35 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Kontraktorëve të përkohshëm “S” SHPK & “A” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe konkretisht, transport dhera auto 5 km, punime për trotuarin, punime për shtresat asfaltike dhe nënshtresat, punime kanalizimi, etj., në objekt në vlerën <b>1,078,892 lekë pa TVSH</b> . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 900/2 Prot, datë 27.02.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Bashkimit të Kontraktorëve “S” SHPK & “A” SHPK. |
| <b>Situata</b>           | Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:   |

- Në rikonstruksionin e rrugës në lagjet nr. 5 dhe nr. 13, u konstatua diferencë volumi në realizimin e zërave të punimeve transport dhera auto 5 km, punime për trotuarin, punime për shtresat asfaltike dhe nënshtresat, punime kanalizimi, etj. Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punës të pasqyruara në situacionin përfundimtar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer në volumin e situacionuar, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,078,892 lekë pa TVSH**.

| Nr An al                      | Zëri i punimeve                               | Një sia | Çmi mi i ofert ës | Situa cioni përfu ndim tar | Libri i masa ve | Fakti    | Diferenca në + |                         |  |
|-------------------------------|---|---------|-------------------|----------------------------|-----------------|----------|----------------|-------------------------|--|
|                               |   |         |                   |                            |                 |          | Vol.           | Vlera                   |  |
| 123/158/5a)                   | Transport dhera auto 5 km                     | M3      | 250               | 5,104.90                   | 5,104.90        | 4,254.92 | 849.98         | 212,495                 |  |
|                               | Rikonstruksion i rrugës Kiço Drenova          | M2      | -                 | -                          | -               | -        | 150            | 225,000                 |  |
|                               | Punime për trotuarin                          | M2      | -                 | -                          | -               | -        | -              | 13,371                  |  |
|                               | Punime për shtresat asfaltike dhe nënshtresat | M2      | -                 | -                          | -               | -        | -              | 67,842                  |  |
|                               | Punime kanalizimi lagjia 5 dhe nr. 13         | M3      | -                 | -                          | -               | -        | -              | 560,184                 |  |
| <b>Totali në lekë pa TVSH</b> |   |         |                   |                            |                 |          |                | <b><u>1,078,892</u></b> |  |

|                       |   |
|-----------------------|---|
| <b>Kriteri</b>        | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1456/1 prot, datë 22.02.2019.                 |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Korçë.  |
| <b>Shkaku</b>         | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej <b>1,078,892 lekë pa TVSH</b> , e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.  |
| <b>Rendesia</b>       | <i>I lartë</i>  |
| <b>Rekomandimi</b>    | Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës <b>1,078,892 lekë pa TVSH</b> nga Bashkimi i Kontraktorëve “S” SHPK & “A” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 900/2 prot, datë 27.02.2019 me objekt “Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi Lagjet 5 dhe 13”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara. |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. R.N, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

**3. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: “Rehabilitimi urban i rrugëve në lagjet e qytetit”, me të dhënat si vijon:**

| Kontratën e zbatimit   |  | Të dhëna për :                                   |   |
|--|--|--|---|
|  |  | Mbikëqyrjen                                      | Kolaudimin                                |
| Nr. 4701/2 Prot, datë 12/06/2019   | Afati zbatimit të kontratës 3 muaj         | Nr. 4361/2 prot 12.06.2019                       | Nr. 9953/2, datë 25.10.2019               |
| Vlera e kontratës 21,872,503 lekë me TVSH  | Periudha e garancisë së difekteve -24 muaj | Mbikëqyrës “A.M” SHPK, me nr. licence MK. 2892/3 | PF “P.P”, nr. licence MK. 1967/1.         |
| Amendament Kontrate datë 28.08.2019 për zgjatjen e afatit kohor me 45 ditë.                              | Punimet kanë filluar me datë 30.05.2019    | Administratori: Z. E.M                           |   |
| Kontraktori A.K 2002SHPK & “A.A” SHPK, përfaqësuar nga Kontraktori A.K 2002SHPK me Administrator: Z. A.M | Punimet kanë përfunduar, 25.10.2019        | Vlera e kontratës 336,379 lekë me TVSH.          | Vlera e kontratës 67,243.20 lekë me TVSH. |

|                          |   |
|--------------------------|---|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.</b><br>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitimi urban i rrugëve në lagjet e qytetit” Bashkia Korçë, me vlerë 21,872,305 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Kontraktorëve të përkohshëm A.K 2002SHPK & “A.A” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt në rikonstruksionin e rrugëve: “P.Q” (Ish SMT), “P.R”, “N.N”, “Ark M.M, V.K, dhe K.F” në vlerën <b>918,454 lekë pa TVSH</b> . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4701/2 prot datë 12/06/2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Bashkimit të Kontraktorëve A.K 2002SHPK & “A.A” SHPK. |
|--------------------------|---|

**Situata**

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: Në rikonstruksionin e rrugëve “P.Q” (Ish SMT), “P.R”, “N.N”, zërat e punimeve të ndërtimit janë realizuar në volume më të vogla se në situacionin përfundimtar, argumentuar si në tabelë.

| Nr Anal         | Zëri i punimeve   | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacio ni përfund imtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + |        |  |
|-----------------|---|--------|-----------------|---------------------------|----------------|-------|----------------|--------|--|
|                 |   |        |                 |                           |                |       | Vol.           | Vlera  |  |
|                 | <b>I. Rruga P.Q (Ish SMT).</b>  |        |                 |                           |                |       |                |        |  |
| Zëri 1(3.89 /b) | Gërmim dheu me sek 0.25 m <sup>3</sup> , tok zak kat III, me shkarkim në mjet | M3     | 150             | 800                       | 800            | 600   | 200            | 30,000 |  |
| Zëri (3/212 )   | Shtresë çakulli 15 cm + ngjeshje  |        |                 |                           |                |       |                |        |  |

|  |   |      |       |          |         |          |        |         |
|--|---|------|-------|----------|---------|----------|--------|---------|
|  | Punime ndërtimi në trotuar<br>Zëri 8(3.207) + zëri 10 (An) +<br>zëri 9(3.212/b) | -    | -     | -        | -       | -        | -      | 230,840 |
| <b>Rikonstruksion i rrugës P.R</b>                         |   |      |       |          |         |          |        |         |
| Zëri<br>10(3/1<br>58/5a                                    | ) Transport dhera auto 5 km   | M3   | 150   | 1,699.6  | 1,699.6 | 1,472    | 227.6  | 34,140  |
| <b>Punime kanalizimi</b>                                   |   |      |       |          |         |          |        |         |
| Zëri<br>8(3.47<br>/1b)                                     | Mbushje, rafshim, ngjeshje me<br>tokmat elektrik çdo 30 cm.                     | M3   | 150   | 205      | 205     | 113.88   | 91.20  | 13,680  |
| <b>3. Rikonstruksion i rrugës N.N (Ish kundra ajrori).</b> |   |      |       |          |         |          |        |         |
| Zëri<br>8(3/21<br>2)                                       | Shtresë çakulli 15 cm +<br>ngjeshje   | M2   | 140   | 500      | 500     | 371      | 129    | 18,060  |
| Zëri<br>9(3/21<br>2)                                       | Shtresë stabilizanti 10 cm.   | M2   | 120   | 371      | 371     | -        | 371    | 44,520  |
| Zëri<br>15(3/<br>An/pp<br>)                                | F.V. puseta plastike 40x40x40<br>cm me kapak të fortë RIC<br>1084+1086.         | copë | 5,500 | 15       | 15      | 7        | 8      | 44,000  |
| Zëri<br>18(<br>An/22<br>)                                  | Puseta shiu 40x40x40 cm me<br>kapak zgarë hekuri.                               | copë | 8,500 | 10       | 10      | 5        | 5      | 42,500  |
|  | 4. Rikonstruksion i rrugës Ark.<br>M.M, V.K dhe K.F.                            | M2   | 980   | 1,840.50 | 1,840.5 | 1,463.25 | 377.25 | 369,705 |
| Zëri<br>15<br>(3/An/<br>pp)                                | F.V. puseta plastike 40x40x40<br>cm me kapak të fortë RIC<br>1084+1086.         | copë | 5,500 | 15       | 15      | -        | 15     | 82,500  |
|  | Punime kanalizimi Ark M.M   | M3   | 150   | 243      | 243     | 186.27   | 56.73  | 8,509   |

|                       |  |
|-----------------------|--|
| <b>Kriteri</b>        | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4361/2 prot 12.06.2019. |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Korçë.   |
| <b>Shkaku</b>         | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej <b>918,454 lekë pa TVSH</b> , e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.   |
| <b>Rendesia</b>       | <i>E lartë</i>   |
| <b>Rekomandimi</b>    | Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>918,454 lekë pa TVSH</b> nga Bashkimi i Kontraktorëve A.K 2002SHPK & “A.A” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 4701/2 Prot datë 12/06/2019 me objekt “Rehabilitimi urban i rrugëve në lagjet e qytetit”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të          |





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

situacionuara.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.M, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

**4. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale (Rikonstruksion rruge fshati Barç), me të dhënat si vijon:**

| Kontratën e zbatimit                               |   | Të dhëna për :   |   |
|--|---|--|---|
|  |   | Mbikëqyrjen  | Kolaudimin  |
| Nr. 4266/2 Prot, datë 27/05/2019                   | Afati zbatimit të kontratës 2 muaj  | Kontrata nr. 4607/2 prot, datë 30.05.2019                                      | Kontrata nr. 7333/2 prot, datë 20.08.2019   |
| Vlera e kontratës 11,689,253 lekë me TVSH          | Periudha e garancisë së difekteve - 24 muaj                                     | Kontraktori “S. S.” “K.S” ShPK, licence MK. 2992/6<br>Administrator:<br>Z. K.S | Kontraktori “G & L Konstruksion” ShPK, nr. licence MK. 2829/7 përfaqësuar nga Z. G.S. |
| Kontraktori “V” SHPK<br>Administrator:<br>Z. G. A. | Punimet kanë filluar me datë 30.05.2019<br>Punimet kanë përfunduar, 29.07.2019. | Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është - lekë me TVSH.                         | Vlera e kontratës së kolauditimit është - lekë me TVSH.                               |

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <p><b>Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.</b></p> <p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale (Rikonstruksion rruge fshati Barç)” Bashkia Korçë, me vlerë 11,689,253 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori “V” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe konkretisht: Beton për themel bordure dhe Pusetë shkarkimi b/a, 1x1x1.5 m, me kapak gize, Puseta elektrike 40x40x40 cm, Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak elektrik çdo 30 cm, në vlerën <b>107,289 lekë pa TVSH</b>. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4266/2 prot datë 27.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “V” SHPK.</p> |
| <b>Situata</b>           | Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.   |

| Nr Anal          | Zëri i punimeve  | Njësia         | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti                           | Diferenca në + |        |
|------------------|--|----------------|-----------------|-------------------------|----------------|---------------------------------|----------------|--------|
|                  |  |                |                 |                         |                |                                 | Vol.           | Vlera  |
| (2/262 /3)       | Beton për themel bordure                                 | m <sup>3</sup> | 6000            | 27.3                    | 27.3           | 21.21                           | 6.09           | 36,540 |
| Zëri (3.An/ 57b) | Pusetë elektrike kontrolli PVC 40x40x40 cm               | Copë           | 200             | 9                       | 9              | Jo sipas specifi kimeve teknike | 9              | 18,000 |
| Zëri (an- 21)    | Pusetë shkarkimi b/a, 1x1x1.5 m, me kapak gize           | Copë           | 20,000          | 21                      | 21             | 20                              | 1              | 20,000 |
| Zëri (3.47/      | Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak elektrik çdo 30 cm | M3             | 100             | 842                     | 842            | 514.51                          | 327.49         | 32,749 |

|     |                      |  |  |  |  |  |  |                |
|-----|----------------------|--|--|--|--|--|--|----------------|
| 1b) |                      |  |  |  |  |  |  |                |
|     | <b>Shuma pa TVSH</b> |  |  |  |  |  |  | <b>107,289</b> |

|                       |  |
|-----------------------|--|
| <b>Kriteri</b>        | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4607/2 prot, datë 30.05.2019.   |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Korçë.   |
| <b>Shkaku</b>         | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej <b>107,289 lekë pa TVSH</b> , e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.   |
| <b>Rendesia</b>       | <i>E lartë</i>   |
| <b>Rekomandimi</b>    | Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>107,289 lekë</b> pa TVSH nga Kontraktori “V” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4266/2 prot datë 27.05.2019 me objekt “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale (Rikonstruksion rruge fshati Barç)”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara. |

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. K.S, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

### 5. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: “Rikonstruksioni shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri” + shtesë për palestër Korçë”, me të dhënat si vijon:

| Të dhëna për :  |   |   |  |
|---|---|---|--|
| Kontratën e zbatimit  |   | Mbikëqyrjen   | Kolaudimin   |
| Nr. 4975/5 Prot, datë 04.09.2018  | Afati zbatimit të kontratës 6 muaj  | Nr. 5177/1 prot, datë 04.09.2018                          | Kontrata pa nr. prot, datë 28.09.2018                |
| Vlera e kontratës 26,233,536 lekë me TVSH                                   | Periudha e garancisë së difekteve -24 muaj  | “D.P” ShPK, me licence nr. MK. 2837/5<br>Z. S.K           | “Personit fizik” Z.P.S, me licence nr. MK. 2632/1    |
| Amendament Kontrate datë 28.08.2019 për zgjatjen e afatit kohor me 45 ditë. | Punimet kanë filluar me datë 06.09.2018   | Vlera e kontratës së mbikëqyrjes 530,570.40 lekë me TVSH. | Vlera e kontratës së kolaudimit 34,000 lekë me TVSH. |
| Kontraktori “I” SHPK<br>Administrator :<br>Z. F.M                           | Punimet kanë përfunduar, 03.03.2019   |   |  |
| <b>Titulli i gjetjes</b>  | <b>Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.</b> |   |  |
|   | Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt                         |   |  |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                |  |
|----------------|--|
|                | <p>“Rikonstruksioni shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri” + shtesë për palestër Korçë” Bashkia Korçë, me vlerë 26,233,024 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori “I” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe realizim i disa zërave jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën <b>1,184,877 lekë pa TVSH</b>, nga e cila:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shuma <b>598,583</b> lekë pa TVSH përfaqëson punime të pa realizuara në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Korçë..</li> <li>- Shuma <b>586,294</b> lekë pa TVSH përfaqëson punime të realizuara me cilësi të dobët dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, projektin e zbatimit dhe kushtet e kontratës.</li> </ul> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4975/5 prot, datë 04.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “I ” SHPK.</p> |
| <b>Situata</b> | Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve si dhe realizim i disa zërave jo në përputhje me specifikimet teknike, argumentuar si në tabelë.   |

| Nr Anal          | Zëri i punimeve                               | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti   | Diferenca në + |                  |
|------------------|---|--------|-----------------|-------------------------|----------------|---|----------------|------------------|
|                  |   |        |                 |                         |                |   | Vol.           | Vlera            |
| Zëri 3 (2.383)   | F.V Dyer entiefi të brendshme.                | M2     | 8,200           | 58.75                   | 58.75          | Nuk është realizuar sipas specifikimeve teknike | -              | 481,750          |
| Zëri 4 (2.386/1) | F.V Dyer të blinduara të jashtme.             | M2     | 14,520          | 7.2                     | 7.2            | -   | -              | 104,544          |
| Zëri (2.335/b)   | F.V. Dritare duroplast dopio xham.            | M2     | 8,308           | 180.50                  | 180.5          | 173.30  | 7.2            | 59,817.60        |
| Zëri 3(2.181)    | Konstruksione metalike për shkallë emergjence | Ton    | 138,500         | 3.65                    | 3.65           | 1.63  | 2.02           | 279,770          |
| Zëri 1(2.181)    | Konstruksione metalike.                       | Ton    | 138,500         | 8.3                     | 8.3            | 6.43  | 1.87           | 258,995          |
|                  | <b>Shuma në lekë (Pa TVSH)</b>                |        |                 |                         |                |   |                | <b>1,184,877</b> |

|                       |  |
|-----------------------|--|
| <b>Kriteri</b>        | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5177/1 prot, datë 04.09.2018. |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Korçë.   |
| <b>Shkaku</b>         | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej <b>1,184,877 lekë pa TVSH</b> , e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.   |
| <b>Rendesia</b>       | <i>E lartë</i>   |

|                    |  |
|--------------------|--|
| <b>Rekomandimi</b> | <p>Nga Bashkia Korçë, të merren masa për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Arkëtimin e vlerës prej <b>598,583</b> lekë pa TVSH nga Kontraktori “T” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 4975/5 Prot datë 04.09.2018 me objekt “Rikonstruksioni shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri” + shtesë për palestër Korçë”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.</li> <li>- T’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Kontraktorit “T” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej <b>586,294</b> lekë pa TVSH, për punime të realizuara me cilësi të dobët dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, projektin e zbatimit dhe kushtet e kontratës, të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë me datë 19.03.2021 për të garantuar silësinë e materialeve dhe funksionalitetin e shkollës. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Korçë, Mbikëqyrësi i punimeve, Kolaudatori i punimeve të objektit si dhe grupi i marrjes në dorëzim, brenda periudhës së garancisë (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të kthehet nga sipërmarrësi i punimeve).</li> </ul> |
|--------------------|--|

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. S.K, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

Për sa më sipër është mbajtur në projektraportin e auditimit dhe për këtë çështje mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “D.P” SHPK me Administrator Ing. D.K. në observacionin e protokolluar në Bashkinë Korçë datë 11.05.2021, përcjellë nga subjekti i audituar Bashkia Korçë me shkresën nr. 6684/4 datë 01.06.2021 (protokolluar në KLSH me nr. 260/18 prot, datë 03.06.2021) ka bërë **komente dhe shpjegime dhe konkretisht:** Nga ana e mbikëqyrësit pretendohet se:

**1.** Për zërin “F.V Dyer entiefi të brendshme” sasia është quajtur nul e gjitha, ndërkohë që dyert janë të vendosura në objekt...sipas elementeve të analizës, dyert janë përcaktuar të vendosen me material dërrase, në të cilën futet dhe emtiefi dhe melamina dhe çfarëdo lloj materiali tjetër që është nënprodukt i drurit, fakt që rrëzon pretendimin e audituesëve edhe sikur dyert të ishin me melaminë. Dyert janë realizuar me material emtief, që ka karakteristika pothuajse të njëjta me melaminën dhe kjo ka krijuar keqkuptime tek grupi i auditimit për llojin e saj...

**2.** Zëri “ Konstruksione metalike për shkallë emergjence” dhe “Konstruksione metalike për ndërtim Palestre” nga ana jonë është parë e arsyeshme vendosja e elementeve HSE në vend të HEA, sepse garantojnë qëndrueshmëri më të lartë strukturore dhe kundër agjentëve atmosferikë të korrozionit. Një lapsus në projekt-preventivin e rishikuar është mos shënimi i procesit të galvanizimit...

**3.** I njëjti arsyetim vlen edhe për zëin nr. 1(2.181) ku pesha e elementëve të vendosur në objekt është më e lartë se pesha e paraqitur në librezë masash dhe situacionuar.

**4.** Lidhur me zërat e punëve:

- “Plinta b/a C 16/20” është realizuar sipas llogaritjeve të librezës së masave duke ju referuar faktit.

- Realizimi për zërin “F.V. panele sandëish (t=40 m/m)” është kryer për të gjithë sipërfaqen dhe më pas është bërë prerja për dyert dhe dritaret ku ato janë vendosura.

- Në lidhje me parmakët e inoksit ne kemi bërë ndryshimet e preventivit dhe kemi mbajtur procesverbal .



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

5. Zëri “Dyer të blinduara të jashtme” është realizuar dhe ndodhet e vendosur në objekt.

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

1. Lidhur mbi zërin “F.V Dyer entiefi të brendshme” nuk keni sjellë argumente të cilat vërtetojnë realizimin e këtij zëri sipas specifikimeve teknike, por thjesht keni interpretuar rreth zërit 2.383 të manualit sipas VKM nr. 629. Dyert në fakt janë realizuar me material melamin dhe jo emtief siç është përcaktuar në ST hartuar nga AK dhe, nuk është e vërtetë që materiali emtief ka karakteristika pothuajse të njëjta me melaminën. Sipërmarrësi i punimeve është i detyruar të zbatojë specifikimet teknike sipas formularit mbi përmbushjen e ST të përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) dhe Kushteve të Kontratës së sipërmarrjes. Pranimi dhe vendosja e dyerve në objekt jashtë specifikimeve teknike është përgjegjësi direkte e Mbikëqyrësit të punimeve. PZ rezultoi i shoqëruar me specifikime teknike të hartuara nga AK Bashkia Korçë. Sa më sipër trajtuar, observacioni juaj nuk merret në konsideratë deri në plotësimin e specifikimeve teknike mbi Dyert e brendshme. Sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve nuk mund t'i ndryshojnë punimet dhe specifikimet sipas dëshirës së tyre, natyrisht që kur ndodh ky ndryshim për shkak të gjetjes së materialit, ndryshimi duhet të miratohet nga Autoriteti Kontraktor.

2+3. Lidhur mbi zëri “Konstruksione metalike për shkallë emergjence” dhe “Konstruksione metalike për ndërtim Palestre” shpreheni se Ju e keni parë të arsyeshme zëvendësimin e elementeve HSE me HEA, sepse garantojnë qëndrueshmëri më të lartë strukturore dhe kundër agjentëve atmosferikë të korrozionit. Por, a mund të ndodhë kjo në ndërtim, që Projekti i Zbatimit të ndryshojnë dhe punimet apo zgjedhja e materialeve të behën sipas dëshirës ?? Flisni për galvanizim, ku në fakt nuk është e parashikuar fare në preventiv dhe nëse është realizuar duhet të ishte miratuar si zë pune që shtohen dhe/ose që zbritet, pra në preventivin e ndryshuar. Audituesi nuk shprehet mbi zëra punime dhe volume jashtë Projektit të Zbatimit.

Ju sqarojmë edhe një herë se dëmi ekonomik vjen nga diferenca e sasisë së konstruksioneve metalike të situacionuara me sasi të faktike të matura në objekt në prezencë të përfaqësuesit të Bashkisë Korçë, z. A.D, njëkohësisht edhe anëtar i grupit të marrjes në dorëzim të investimit. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

#### **4. Lidhur mbi realizimin e zërave:**

- “Plinta b/a C 16/20” në volumin 25.5 m<sup>3</sup> nisur nga fakti se është zë i maskuar, audituesi ka bërë llogaritje referuar PZ, megjithatë e marrim në konsideratë argumentin e parashtruar.

- Lidhur mbi realizimin e zërit F.V. panele sandëish (t=40 m/m) pranojmë argumentin se puna është kryer për të gjithë sipërfaqen dhe më pas është bërë prerja për dyert dhe dritaret ku ato janë vendosura. Sa më sipër pika 4, Ju risqarojmë se observacioni është marrë në konsideratë në Projektraportin e auditimit të përcjellë në Bashkinë Korçë.

- Lidhur me parmakët e inoksit, pranojmë argumentin se kemi bërë ndryshime në preventiv dhe se kemi mbajtur procesverbal. Observacioni merret në konsideratë.

5. Lidhur me zërin “Dyer të blinduara të jashtme” nga auditimi në objekt rezultoi se nuk është realizuar. Në observacion shpreheni se ky zë është realizuar dhe ndodhet e vendosur në objekt dhe jeni të hapur për verifikim. por si është e mundur që pretendimi Juaj mbi realizimin e këtij zë pune nuk është shoqëruar me asnjë fotografi për të krijuar bindje mbi realizimin faktik të tij. Pra, ju nuk argumentoni me fakt (Foto) realizimin e dyerve të blinduara dhe për rrjedhojë observacioni nuk merret në konsideratë.

**6. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: “Rindërtim i shkollës 9-vjeçare Voskopojë”, me të dhënat si vijon:**

| Kontratën e zbatimit                             |  | Të dhëna për :   |   |
|--|--|--|---|
|  |  | Mbikëqyrjen  | Kolaudimin  |
| Nr. 9586/2 Prot, datë 31.12.2018                 | Afati zbatimit të kontratës 6 muaj<br>Shtyrje afati 120 ditë                   | kontrata nr. 79 prot, datë 27.12.2019  | kontrata pa nr. ..prot, datë 04.12.2019           |
| Vlera e kontratës 32,250,952 lekë me TVSH        | Periodha e garancisë së difekteve - 24 muaj                                    | Kontraktori “L.C”<br>SHPK, nr. licence MK. 3336 & “MCE” SHPK me licencë MK. 3119/2 me administrator Z. A.K | “Personit fizik” Z.P.S, me licence nr. MK. 2632/1 |
| Kontraktori “N” SHPK me administrator Znj. SH.N. | Punimet kanë filluar me datë 31.12.2018<br>Punimet kanë përfunduar, 08.11.2019 | vlera e kontratës së mbikëqyrjes ... lekë me TVSH.   | Vlera e kontratës së kolaudimit ... lekë me TVSH. |

|                          |   |
|--------------------------|---|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <p><b>Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.</b></p> <p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rindërtim i shkollës 9-vjeçare Voskopojë” Bashkia Korçë, me vlerë 32,250,952 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori “N” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe realizim i disa zëra punime jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën <b>761,497 lekë pa TVSH, nga e cila:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shuma <b>426,605</b> lekë pa TVSH përfaqëson punime të pa realizuara në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik.</li> <li>- Shuma <b>334,892</b> lekë pa TVSH përfaqëson punime të realizuara me cilësi të dobët dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, projektin e zbatimit dhe kushtet e kontratës.</li> </ul> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 9586/25 prot datë 31.12.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “N” SHPK.</p> |
| <b>Situata</b>           | Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve si dhe realizim i disa zërave jo në përputhje me specifikimet teknike, pasqyruar në tabelë.   |

| Nr Anal         | Zëri i punimeve                               | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + |         |
|-----------------|---|--------|-----------------|-------------------------|----------------|-------|----------------|---------|
|                 |   |        |                 |                         |                |       | Vol.           | Vlera   |
| Zëri (2/328)    | Patinim muri me allçi stuko.                  | M2     | 134             | 2284                    | 2284           | -     | 2284           | 306,056 |
| Zëri 1(2.181)   | Konstruksione metalike.                       | Ton    | 111.250         | 9.1                     | 9.1            | 7.56  | 1.54           | 380,475 |
| Zëri 5(2.114/1) | Plinta b/a C – 16/20.                         | M3     | 5,518           | 16.63                   | 15.63          | 7.27  | 8.36           | 46,130  |
| Zëri (An)       | F.V. Rrjetë mbrojtëse për dritare (palestër). | M2     | 4005            | 7.2                     | 7.2            | 4005  | -              | 28,836  |

|                |  |
|----------------|--|
| <b>Kriteri</b> | <p>Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e</li> </ul> |
|----------------|--|



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 79 prot, datë 27.12.2019.   |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Korçë.  |
| <b>Shkaku</b>         | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej <b>761,497 lekë pa TVSH</b> , e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.  |
| <b>Rendesia</b>       | <i>E lartë</i>  |
| <b>Rekomandimi</b>    | Nga Bashkia Korçë, të merren masa për:<br>- Arkëtimin e vlerës prej <b>426,605 lekë pa TVSH</b> nga Kontraktori “N ” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 9586/2 prot datë 31.12.2018 me objekt “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Voskopojë”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.<br>- T’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Kontraktorit “N” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej <b>334,892 lekë pa TVSH</b> , për punime të realizuara me cilësi të dobët dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, projektin e zbatimit dhe kushtet e kontratës, të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë me datë 10.12.2021 për të garantuar silësinë e materialeve dhe funksionalitetin e shkollës. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Korçë, Mbikëqyrësi i punimeve, Kolaudatori i punimeve të objektit si dhe grupi i marrjes në dorëzim, brenda periudhës së garancisë (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të kthehet nga sipërmarrësi i punimeve). |

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A.K, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

**7. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: “Rehabilitimi i rrjetit të kanaleve ujtitëse” bashkia Korçë, me të dhënat si vijon:**

|  | Të dhëna për :   |  |  |
|--|--|--|--|
|  | Kontratën e zbatimit   | Mbikëqyrjen  | Kolaudimin   |
| Nr. 3632/2 Prot, datë 31.12.2018                   | Afati zbatimit të kontratës 2 muaj   | kontrata nr. 4054/2 prot, datë 14.05.2019                  | kontrata nr. 6788/2 datë 31.07.2019                  |
| Vlera e kontratës 5,048,470 lekë me TVSH           | Periudha e garancisë së difekteve - 12 muaj                                    | “A” SHPK, nr. licence MK. 1666/3 me Administrator: Z. LL.T | “Personit fizik” Z. P.P, me licence nr. MK. 1967/1   |
| Kontraktori A.K 2002 SHPK me Administrator: Z. A.M | Punimet kanë filluar me datë 22.05.2019<br>Punimet kanë përfunduar, 23.10.2019 | vlera e kontratës së mbikëqyrjes 108,614 lekë me TVSH.     | Vlera e kontratës së kolaudimit 16,292 lekë me TVSH. |

|                          |   |
|--------------------------|---|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.</b><br>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitimi i rrjetit të kanaleve ujitëse” Bashkia Korçë, me vlerë 5,048,470 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori A.K 2002 SHPK, rezultuan në objekt diferencë në volum pune të zërit të punimeve “Hidroizolim me dy duar bitum”, në vlerën <b>21,250 lekë pa TVSH.</b><br>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3632/2 prot datë 16.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “A.K 2002 ” SHPK. |
| <b>Situata</b>           | Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volum në zbatimin e zërit të punimeve “Hidroizolim me dy duar bitum”.  |
| <b>Kriteri</b>           | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4054/2 prot, datë 14.05.2019.   |
| <b>Ndikimi/efekti</b>    | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Korçë.  |
| <b>Shkaku</b>            | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej <b>21,250 lekë pa TVSH</b> , e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.   |
| <b>Rendesia</b>          | <i>E lartë</i>  |
| <b>Rekomandimi</b>       | Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>21,250 lekë pa TVSH</b> nga Kontraktori A.K 2002 SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3632/2 prot datë 16.05.2019 me objekt “Rehabilitimi i rrjetit të kanaleve ujitëse”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.  |

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. LL.T, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

## 8. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: “Rikonstrukcion i shkollës 9-vjeçare “Nuçi Naçi””, me të dhënat si vijon:

|   | Të dhëna për :                              |  |  |
|---|---|--|--|
|   | Kontratën                                   | Mbikëqyrjen  | Kolaudimin   |
| Nr. 6026/2 Prot, datë 29.07.2019            | Afati zbatimit të kontratës 6 muaj          | kontrata nr. 6676/2 prot, datë 29.07.2019                                  | kontrata nr. 3751/2 datë 05.06.2019  |
| Amendim kontrate datë 02.03.2020            | Shtyhet 2 herë: 73 ditë + 15 ditë           |  |  |
| Vlera e kontratës 30,125,449 lekë me TVSH   | Periudha e garancisë së difekteve - 24 muaj | Kontraktori “S.S K.S” SHPK, nr. licence MK. 2992/6 me Administrator Z. K.S | Kontraktori “N.S” shpk, me licence nr. MK. 1846/6/1 me Administrator Z.E.N |
| Kontraktori “N” SHPK me Administratore Znj. | Punimet kanë filluar me datë 29.07.2019     | vlera e kontratës së mbikëqyrjes 642,734.4                                 | Vlera e kontratës së kolaudimit 62,214 lekë                                |





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

SH.N

Punimet kanë lekë me TVSH.  
përfunduar, 24.03.2019

me TVSH.

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <p><b>Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.</b></p> <p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Nuçi Naçi”, Bashkia Korçë, me vlerë 30,125,449 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori “N” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe realizim i disa zërave jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën <b>517,606 lekë pa TVSH</b>, nga e cila:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shuma <b>445,716</b> lekë pa TVSH përfaqëson punime të pa realizuara në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik.</li> <li>- Shuma <b>71,890</b> lekë pa TVSH përfaqëson punime të realizuara me cilësi të dobët dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, projektin e zbatimit dhe kushtet e kontratës.</li> </ul> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6026/3 prot, datë 29.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “N” SHPK.</p> |
| <b>Situata</b>           | <p>Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve si dhe realizim i disa zërave jo në përputhje me specifikimet teknike, pasqyruar si në tabelë.</p>  |

| Nr Anal           | Zëri i punimeve                               | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni i përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + |         |
|-------------------|---|--------|-----------------|---------------------------|----------------|-------|----------------|---------|
|                   |   |        |                 |                           |                |       | Vol.           | Vlera   |
| Zëri 4(2.181)     | Konstruksione metalike për Shkallë Emergjence | ton    | 82,955          | 3.6                       | 3.6            | 1.61  | 1.99           | 165,080 |
| Zëri 22(An.14 /m) | Pjesë speciale oxhaku.                        | ml     | 3,270           | 15.5                      | 15.5           | 5.5   | 10             | 32,700  |
| Zëri 1(2.181)     | Konstruksione metalike.                       | ton    | 82,955          | 9.1                       | 9.1            | 5.68  | 3.42           | 283,706 |
| Zëri (An)         | F.V. Rrjetë mbrojtëse për dritare (palestër). | M2     | 300             | 14.4                      | 14.4           | -     | 14.4           | 4,320   |
| Zëri 9(An)        | F.V. Tabela basketbolli në mur.               | copë   | 9,000           | 2                         | 2              | -     | 2              | 18,000  |
| Zëri 10(An)       | F.V. Rrjetë volejboli.                        | copë   | 13,800          | 1                         | 1              | -     | 1              | 13,800  |

|                       |  |
|-----------------------|--|
| <b>Kriteri</b>        | <p>Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6676/2 prot, datë 29.07.2019.</li> </ul> |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | <p>Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Korçë.</p>  |
| <b>Shkaku</b>         | <p>Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej <b>517,6056 lekë pa TVSH</b>, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e</p>   |

|                    |   |
|--------------------|---|
|                    | situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.  |
| <b>Rendesia</b>    | <i>I lartë</i>  |
| <b>Rekomandimi</b> | <p>Nga Bashkia Korçë, të merren masa për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Arkëtimin e vlerës prej <b>481,486</b> lekë pa TVSH nga Kontraktori “N ” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 4975/5 Prot datë 04.09.2018 me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Nuçi Naçi”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.</li> <li>- T’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Kontraktorit “N” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej <b>71,890</b> lekë pa TVSH, për punime të realizuara me cilësi të dobët dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, projektin e zbatimit dhe kushtet e kontratës, të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë me datë 05.06.2022 për të garantuar silësinë e materialeve dhe funksionalitetin e shkollës. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Korçë, Mbikëqyrësi i punimeve, Kolaudatori i punimeve të objektit si dhe grupi i marrjes në dorëzim, brenda periudhës së garancisë (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të kthehet nga sipërmarrësi i punimeve).</li> </ul> |

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. K.S, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

### **9. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: “Rikonstruksion i pjesshëm i degës Ventrok”, me të dhënat si vijon:**

|   | Të dhëna për :   |   |  |
|---|--|---|--|
|   | Kontratën e zbatimit   | Mbikëqyrjen   | Kolaudimin                                       |
| Nr. 6149/2 Prot, datë 29.07.2019                  | Afati zbatimit të kontratës 6 muaj   | kontrata nr. 6737/2 prot, datë 30.07.2019                   | kontrata nr. - datë 04.12.2019                   |
| Vlera e kontratës 22,918,633.41 lekë me TVSH      | Periudha e garancisë së defekteve - 24 muaj                                    | “M.S” SHPK, nr. licence MK. 1811/7 me Administrator Z. T.S. | “Personi fizik”P.S, me licence nr. MK. 2632/6/1  |
| Kontraktori “N” SHPK me Administratore Znj. Sh.N. | Punimet kanë filluar me datë 22.07.2019<br>Punimet kanë përfunduar, 05.11.2019 | vlera e kontratës së mbikëqyrjes 868,777 lekë me TVSH.      | Vlera e kontratës së kolaudimit -- lekë me TVSH. |

|                          |   |
|--------------------------|---|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <p><b>Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.</b></p> <p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm i degës Ventrok”, Bashkia Korçë, me vlerë 22,918,633.41 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori “N” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, në vlerën <b>95,500 lekë pa TVSH</b>. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6149/2 prot, datë 29.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “N”. SHPK.</p> |
|--------------------------|---|



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

**Situata** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve si dhe realizim i disa zërave jo në përputhje me specifikimet teknike, pasqyruar si në tabelë.

| Nr Anal                                 | Zëri i punimeve                     | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + |        |
|---|-------------------------------------|--------|-----------------|-------------------------|----------------|-------|----------------|--------|
|   |                                     |        |                 |                         |                |       | Vol.           | Vlera  |
| <b>I. Punime ndërtimi në Portbarazh</b> |                                     |        |                 |                         |                |       |                |        |
| 16(2.2 58)                              | Shtresë zhavorri                    | M3     | 1,500           | 121                     | 121            | 104   | 17             | 25,500 |
| Zëri 9(4.3)                             | Konstruksione metalike të thjeshta. | Ton    | 100,000         | 0.7                     | 0.7            | -     | 0.7            | 70,000 |

|                       |  |
|-----------------------|--|
| <b>Kriteri</b>        | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6737/2 prot, datë 30.07.2019. |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Korçë.   |
| <b>Shkaku</b>         | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej <b>95,500 lekë pa TVSH</b> , e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.  |
| <b>Rendesia</b>       | <i>E lartë</i>   |
| <b>Rekomandimi</b>    | Nga Bashkia Korçë, të merren masa për:<br>- Arkëtimin e vlerës prej <b>95,500 lekë pa TVSH</b> nga Kontraktori “N” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 6149/2 Prot datë 29.07.2019 me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm i degës Ventrok”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.                                 |

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. T.S, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

**10. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: “Skemat ujitëse” Bashkia Korçë, me të dhënat si vijon:**

| Kontratën e zbatimit                      | Të dhëna për :                              |   |  |
|---|---|---|--|
|   | Mbikëqyrjen                                 | Kolaudimin  |  |
| Nr. 4841/2 Prot, datë 18.06.2019          | Afati zbatimit të kontratës 3 muaj          | kontrata nr. 5251/2 prot, datë 18.06.2019                   | kontrata nr. 9806/2 datë 22.10.2019                                    |
| Vlera e kontratës 11,776,426 lekë me TVSH | Periudha e garancisë së defekteve - 24 muaj | “MCE” SHPK, nr. licence MK. 3119/2 me Administrator Z. P.M. | “H.C.E-17” shpk, me licence nr. MK. 3094/1 me Administratore Znj. F.N. |
| Kontraktori A.K 2002                      | Punimet kanë filluar me                     | vlera e kontratës së  | Vlera e kontratës së   |

SHPK & "A.A" SHPK datë 18.06.2019 mbikëqyrjes 282,634.8 kolaudimit 74,470 lekë  
 përfaqësuar nga lekë me TVSH.  
 kontraktori A.K 2002 Punimet kanë me TVSH.  
 SHPK me Administrator përfunduar, 18.09.2019  
 Z. A.M.

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <p><b>Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.</b></p> <p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Skemat ujitëse", Bashkia Korçë, me vlerë 11,776,426 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Kontraktorëve të përkohshëm A.K 2002 SHPK &amp; "A.A" SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, në vlerën <b>297,556 lekë pa TVSH, për</b> punime të pa realizuara në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4841/2 prot, datë 18.06.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Bashkimit të Kontraktori të përkohshëm A.K 2002 SHPK &amp; "A.A" SHPK.</p> |
| <b>Situata</b>           | Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, pasqyruar si në tabelë.   |

| Nr Anal         | Zëri i punimeve                                     | Njësia         | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + |         |
|-----------------|---|----------------|-----------------|-------------------------|----------------|-------|----------------|---------|
|                 |   |                |                 |                         |                |       | Vol.           | Vlera   |
| Zëri 2(3/24 0)  | Beton C 12-15 për kanal dhe vepra arti              | m <sup>3</sup> | 7,000           | 705.79                  | 699.85         | 668   | 37.80          | 264,600 |
| Zëri 12 (3.644) | Konstruksion metalike të thjeshta (portë metalike). | ton            | 154,000         | 0.75                    | 0.75           | 0.536 | 0.214          | 32,956  |

|                       |  |
|-----------------------|--|
| <b>Kriteri</b>        | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5251/2 prot, datë 18.06.2019. |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Korçë.   |
| <b>Shkaku</b>         | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej <b>297,553 lekë pa TVSH</b> , e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.   |
| <b>Rendesia</b>       | <i>E lartë</i>   |
| <b>Rekomandimi</b>    | Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>297,556 lekë pa TVSH</b> nga Bashkimit të Kontraktori të përkohshëm A.K 2002 SHPK & "A.A" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 4841/2 Prot datë 18.06.2019 me objekt "Skemat ujitëse", Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.                    |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. P.M, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

**11. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në njësitë administrative (Faza I)” Bashkia Korçë, me të dhënat si vijon:**

| Kontratën e zbatimit                           |  | Të dhëna për :   |   |
|--|--|--|---|
|  |  | Mbikëqyrjen  | Kolaudimin  |
| Nr. 4333/2 Prot, datë 31.05.2019               | Afati zbatimit të kontratës 3 muaj   | kontrata nr. 4636/2 prot, datë 31.05.2019                                | kontrata nr. 8321/2 datë 18.09.2019   |
| Vlera e kontratës 30,560,515 lekë me TVSH      | Periudha e garancisë së defekteve - 24 muaj                                    | Kontraktor “G.B.E” SHPK, nr. licence MK. 2812/3 me Administrator Z. G.B. | Kontraktor “H.C.E-17” shpk, me licence nr. MK. 3094/1 me Administratore Znj. F.N. |
| Kontraktori “G” SHPK me Administrator Z. A. B. | Punimet kanë filluar me datë 03.06.2019<br>Punimet kanë përfunduar, 30.08.2019 | vlera e kontratës së mbikëqyrjes 431,053.20 lekë me TVSH.                | Vlera e kontratës së kolaudimit --- lekë me TVSH.                                 |

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <p><b>Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.</b></p> <p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion rrugësh në njësitë administrative (Faza I)”, Bashkia Korçë, me vlerë 30,560,515 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori “G” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe disa zëra punime të realizuar jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën <b>634,555 lekë pa TVSH</b>, nga e cila:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shuma <b>508,555</b> lekë pa TVSH përfaqëson punime të pa realizuara në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik.</li> <li>Shuma <b>126,000</b> lekë pa TVSH përfaqëson realizim zërash jo në përputhje me specifikimet teknike, dhe konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.</li> </ul> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4333/2 prot, datë 31.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “G” SHPK.</p> |
| <b>Situata</b>           | Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, pasqyruar si në tabelë.   |

| Nr Anal  | Zëri i punimeve   | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti                             | Diferenca në + |           |
|--|---|--------|-----------------|-------------------------|----------------|-----------------------------------|----------------|-----------|
|  |   |        |                 |                         |                |                                   | Vol.           | Vlera     |
| <b>Rikonstruksion i rrugëve fshati Mborje</b>  |   |        |                 |                         |                |                                   |                |           |
| Zëri (3/An/pp)                                 | FV puseta plastike 40x40x40 cm me kapak të fortë RIC              | copë   | 3,000           | 16                      | 16             | 16 në kundërshtim me specifikimet | -              | 48,000    |
| <b>Rikonstruksion i rrugëve fshati Biranjë</b> |   |        |                 |                         |                |                                   |                |           |
| Zëri (3/89/b)                                  | Gërmim dheu me esk 0.25 m3, tok zak kat III, me shkarkim në mjet. | M3     | 160             | 1,035.73                | 1,035.73       | 923.99                            | 111.74         | 17,878.40 |

|  |   |     |       |          |          |                                    |        |               |
|--|---|-----|-------|----------|----------|------------------------------------|--------|---------------|
| Zëri (3/158/5)                                     | Transport dheu me auto deri 5 km.                                 | M3  | 170   | 1,035.73 | 1,035.73 | 923.99                             | 111.74 | 18,995        |
| Zëri (2/522)                                       | F.V. tub p.v.c DN 300.  | M1  | 800   | 246      | 246      | 100                                | 146    | 116,800       |
| <b>Rikonstruksion i rrugëve fshati Moravë</b>      |   |     |       |          |          |                                    |        |               |
| Zëri (2/263/3)                                     | Beton për themel bordure.   | M3  | 5,700 | 41       | 41       | 32.91                              | 8.09   | 46,113        |
| Zëri (An)  | F.V. Pllaka vetë shtrënguese p.p C 20/25.                         | M2  | 800   | 528      | 528      | 471                                | 57     | 45,600        |
| Zëri (3.An/1t)                                     | Furnizim vendosje <b>tub</b> korrugato SN8 DN 315                 | M1  | 1,300 | 372      | 372      | 296                                | 76     | 98,800        |
| Zëri (3/89/b)                                      | Gërmim dheu kanal me makineri                                     | M3  | 160   | 1,197    | 1,197    | 1,015                              | 182    | 29,120        |
| Punime për shtresat asfaltike dhe nënshtresat      |   |     |       |          |          |                                    |        | <b>48,982</b> |
| <b>Rikonstruksion i rrugëve fshati Kuç Belorta</b> |   |     |       |          |          |                                    |        |               |
| Zëri (3/89/b)                                      | Gërmim dheu kanal me makineri.                                    | M3  | 160   | 816      | 816      | 714                                | 102    | 16,320        |
| <b>Rikonstruksion i rrugëve fshati Bulgarec</b>    |   |     |       |          |          |                                    |        |               |
| Zëri (3/An/pp)                                     | F.V. puseta plastike 40x40x40 cm me kapak të fortë RIC 1084+1086. | Cop | 26    | 3000     | 26       | 26 jo në përputhje me specifikimet | -      | 78,000        |
| <b>Rikonstruksion i rrugëve fshati Bulgarec</b>    |   |     |       |          |          |                                    |        |               |
| Zëri (AN)  | F.V. pllaka vetë shtrënguese p.p C 20/25 6 cm.                    | M2  | 800   | 137.2    | 137.2    | 58.2                               | 79     | 63,000        |

|                       |  |
|-----------------------|--|
| <b>Kriteri</b>        | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4636/2 prot, datë 31.05.2019.  |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Korçë.   |
| <b>Shkaku</b>         | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej <b>634,555 lekë pa TVSH</b> , e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.   |
| <b>Rendesia</b>       | <i>E lartë</i>   |
| <b>Rekomandimi</b>    | Nga Bashkia Korçë, të merren masa për:<br>- Arkëtimin e vlerës prej <b>508,555 lekë pa TVSH</b> nga Kontraktori “G” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 4333/2 Prot datë 31.05.2019 me objekt “Rikonstruksion rrugësh në njësinë administrative (Faza I)”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.<br>- T’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Kontraktorit “G” SHPK, realizimin |



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

e zërave të punimeve sipas specifikimeve teknik në vlerën **126,000** lekë pa TVSH, brenda periudhës së garancisë me datë 04.10.2021 (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe Specifikimeve Teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të kthehet nga sipërmarrësi i punimeve).

#### **Disa problematika të konstatuara nga auditimi:**

1. Projekti “Rikonstruksion rrugësh në njësitë administrative (Faza I)” Bashkia Korçë është zbatuar në mungesë të lejes së ndërtimit, veprim ky në kundërshtim me nenin 39 të Ligjit nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, i cili thotë: “ *Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligj*”.

2. Sipërmarrësi i punimeve “G” sh.p.k gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier nuk ka hartuar rilevimin topografik si dhe profilet gjatësore dhe tërthore për rikonstruksionin e rrugëve në fshatrat: Mborje, Biranj, Moravë, Belorta, Bulgarec, Dishnicë dhe Turan. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu III dokumentacioni teknik i punimeve të ndërtimit, citohet se: “*Gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, i cili përmban:*

*a) Dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit e të rrjeteve të infrastrukturës, për lidhjen e themeleve e të bazamenteve me tabanin, për kontrollin në plan e lartësi të objektit, të strukturave mbajtëse etj*”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. G.B, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 18 datë 06.11.2020 dhe për këtë çështje sipërmarrësi i punimeve shoqëria “G” SHPK përfaqësuar nga Znj. J.B, në observacionin e protokolluar në Bashkinë Korçë me nr. 3865 prot, datë 12.05.2021, përcjellë nga subjekti i audituar Bashkia Korçë me shkresën nr. 6684/4 datë 01.06.2021 (protokolluar në KLSH me nr. 260/18 prot, datë 03.06.2021) ka bërë **komente dhe shpjegime dhe konkretisht:**

Nga ana e sipërmarrësit pretendohet se:

1. Zëri i punimeve “ (3/89/b) Gërmim dheu me esk 0.25 m<sup>3</sup>, tok zak kat III, me shkarkim në mjet dhe Transport dheu auto 5 km” është llogaritur gjerësia e gërmimeve totale duke përfshirë dhe trotualet me gjerësi 70 cm dhe 50 cm. Në anë të shtëpive ishin ujrat e zeza të cilat u zëvendësuan dhe u sistemuan me kanalet e reja dhe gjerësia e gërmimit ishte e detyruar në 4.7 m. Kështu që volumit të gërmimit i është shtuar dhe gërmimi i trotuarit dhe totali rezulton 557 m<sup>3</sup>.

2. Lidhur me zërin 3.158/5 Transport dheu auto 5 km, sasia totale e gërmimit është transportuar dhe sasia e transportuar deri në pikën e autorizuar nga AK është 557 m<sup>3</sup> dhe kjo sasi është e detajuar në librezën e masave.

3. Zëri i punimeve “F.V. puseta plastike 40x40x40 cm me kapak të fortë RIC 1084+1086 është vendosur kapaku 30x30x30 cm pasi nga eksperiencia jonë e gjatë në ndërtim kapakët 40x40x40 cm dëmtohen me shpejt.

4. Zëri (3/89/b) Gërmim dheu kanal me makineri është realizuar sipas librezës së masave në sasinë 522 m<sup>3</sup>.

5. Zëri “Zëri (2/522) FV tub p.v.c DN 160” është realizuar sipas librezës së masave në në gjatësinë 220 ml, pasi 20 ml janë vendosur nëpër shtëpi që nuk është llogaritur në gjatësinë e kanalit

#### **Rikonstruksion i rrugës fshati Biranj.**

1+2. Zërat e punimeve “Zëri (3/89/b) Gjermim dhe me esk 0.25 m<sup>3</sup>, tok zak kat III, me shkarkim në mjet” dhe “Zëri (3/158/5) Transport dhe me auto deri 5 km” janë realizuar në volumnin 1035.73 m<sup>3</sup> pasi rruga ekzistuese ka qenë e ngushtë dhe është hapur 4 m gjerësi mesatare dhe jo 2.8 m.

3. Sasia e tubit korrugato SN4 DN 300 mm prej 70.5 ml është e vendosur në terren për shkarkimin e ujërave të zeza deri në përrua.

4. Zëri (2/522) F.V. tub p.v.c DN 160, është realizuar në gjatësinë 246 ml pasi gjatësitë janë më të mëdha se 5 m.

#### **Rikonstruksion i rrugës Moravë.**

1. Zëri “Beton për themel bordure” fshati Moravë është librezuar sipas faktit me përmasat faktike të bordurave dhe kontrabordurave. Llogaritja e betonit për themel bordure është bërë sipas faktit me përmasat faktike të bordurave të vendosura dhe kontrabordurave...

2. Zbatuesi i punimeve ka shprehur kundërshti për zërat e punimeve “Pllaka vetë shtrënguese p.p C 20/25” me pretendimin se llogaritja është bërë me matjet faktike në terren dhe i detajuar në të njëjtën mënyrë në librezën e masave....

3. Lidhur me zërin “FV tub korrugato SN8 DN300” sipërmarrësi pretendon se në llogaritjen e gjatësisë së tubit janë dhe degëzimet nëpër rrugicat dhe gjatësitë e tubit për çdo degëzim janë të detajuara në librezë...

4. Lidhur me zërin “Gjermim dhe kanal me makineri” sipërmarrësi pretendon se gjermimi i kanalit është llogaritur për të gjitha gjatësitë e tubave të vendosura në vend dhe kjo sasi gjermimi përfshin edhe degëzimet e rrugicave për tubat 315 mm. Gjatësia totale e kanaleve të gjermuara për dimensionet e tubave është e detajuar për çdo gjatësi dhe dimension sipas zërit të tubacioneve të shtruara në fakt dhe volumni i gjermimit në total është 1197 m<sup>3</sup>...

#### **Rikonstruksion i rrugës Kuç Belorta.**

1. Volumni i gjermimit dhe me makineri është bërë mbi bazën e gjatësisë së rrugës dhe gjerësisë së rrugës 3 m dhe 50 cm bankina majtas dhe 50 cm bankina djathtas.

#### **Punime kanalizimi, fshati Bulgarec.**

1. Zëri i punimeve “F.V. puseta plastike 40x40x40 cm me kapak të fortë RIC 1084+1086 është vendosur kapaku 30x30x30 cm pasi nga eksperiencia jonë e gjatë në ndërtim kapakët 40x40x40 cm dëmtohen me shpejt.

#### **Rikonstruksioni i rrugës te Qendra shëndetësore Dishnicë.**

- Lidhur me zërin “FV Pllaka vetështrënguese p.p C-20/25 6 cm” me matjet në terren të figurave gjeometrike të çrregullta të trotuareve janë hedhur të dhënat faktike me llogaritje mesatare të gjerësisë së tyre.

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

1+2. Lidhur me pretendimin se volumnit të gjermimit në rrugën në fshatin Mborje në volumnin 557 m<sup>3</sup>, i është shtuar edhe gjermimi i trotuarit, e ka pranuar argumentin që fazën e Projektraporti, dhe është reflektuar në material, pra observacioni është marrë në konsideratë së bashku me pretendimin për zërin e transportit të dheut është marrë në konsideratë në Projektraportin e auditimit.

3. Lidhur mbi realizimin e zërit “F.V. puseta plastike 40x40x40 cm me kapak të fortë RIC 1084+1086” argumenti është në kundërshtim me specifikimet teknike dhe konsiderohet dëm ekonomik deri në realizimin e tij në përputhje kushtet e kontratës dhe specifikimeve teknike. Në ndërtim nuk mund të veprohet sipas dëshirës, së sipërmarrësit





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

dhe mbikëqyrësit të punimeve duke vendosur materiale (puseta plastike 30x30x30 cm) të pa miratuara më parë në preventivin e ndryshuar nga mbikëqyrësi dhe nga AK. Observacioni nuk merret në konsideratë.

4. Lidhur me zërin “Gërmim dhe kanal me makineri” nuk keni argumentuar asgjë, diferenca vjen nga llogaritja e bërë nga audituesi për të gjithë gjatësinë e tubacioneve. Lexoje me kujdes problematikën e konstatuar nga audituesi. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

5. Pretendimi për zërin “Zëri (2/522) FV tub p.v.c DN 160” është marrë në konsideratë nga audituesi dhe është reflektuar në Projektraport duke zbritur vlerën pre 16,000 lekë (20 ml x 800 lekë).

#### **Rikonstruksion i rrugës fshati Biranj.**

1+2. Lidhur me realizimin e zërave të punimeve “Zëri (3/89/b) Gërmim dhe me esk 0.25 m<sup>3</sup>, tok zak kat III, me shkarkim në mjet” fshati Biranj dhe “Zëri (3/158/5) Transport dhe me auto deri 5 km” argumenti nuk është bindës sepse referuar faktit rezulton se, gërmimi tek “Xhepi në piketat P1-P2” është realizuar në volumin 259 m<sup>3</sup> (37 ml x 2.8 m gjerësi x 2.5 m lartësia) dhe jo 370.74 m<sup>3</sup> (37 m x 4 m gjerësi x 2.5) siç është situacionuar. Gjerësia në k’ të xhep duhej të merrej 2.8 dhe jo 4 m, sepse po t’i referohemi piketës P1-P2 për distancën 50 ml gjatësia është marrë në llogaritje 6.2 m (3.5 m rruga + 2.8 m gjerësia e xhepit).

Pra, gërmimi është realizuar në volumin 923.99 m<sup>3</sup> gërmim dhe jo në volumin 1,035.73 m<sup>3</sup>, sa më sipër observacioni nuk merret parasysh.

3. Lidhur me diferencën prej 70 ml tub korrugato ju risqarojmë se argumentimi Juaj qëndron dhe është reflektuar në Projektraportin e auditimit duke bërë vlerën 91,000 lekë (70 ml x 1300 lekë). Mesa duket ju nuk jeni njohur me Projektraportin e auditimit të përcjellë në Bashkinë Korçë.

4. Argumenti për realizimin e zërit (2/522) F.V. tub p.v.c DN 160 në gjatësinë 246 ml, nuk qëndron, argumentuar si vijon:

- **Së pari:** Nga mbikëqyrësi i punimeve nuk na është paraqitur një planimetri ku të jenë pasqyruar lidhjet sipas familjeve dhe shkarkimi në 5 pusetat e shkarkimit 1x1x1.5 m.

- **Së dyti:** Nga disa familjarë ishte përdorur tub korrugato dhe jo tub p.v.c DN 160 mm, projekti nuk ka detaje të bashkimit të tubit korrugato SN4 DN 300 me tubin p.v.c DN 160. Sa më sipër observacioni Juaj nuk merret në konsideratë.

#### **Rikonstruksion i rrugës fshati Moravë.**

1. Lidhur mbi zërin “Beton për themel bordure” fshati Moravë nga auditimi në objekt në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve rezulton se bordurat janë vendosur me seksion 15 x 25 cm dhe jo me seksion 15 x 30 cm, gjithashtu kontrabordura është vendosur me seksion 15 x 12 cm. Pra fakti tregon ndryshe, sa më sipër argumenti juaj nuk merret në konsideratë.

2. Lidhur me diferencën prej 57 m<sup>2</sup> pllaka vetështrëguese, problematika është konstatuar nga pasqyrimi në librezën e masave, ku në disa segmente trotualet ishin më pak se sasia e situacionuar dhe librezuar. Pra diferenca vjen nga pasqyrimi i gabuar në librezë.

3. Furnizim vendosje tub korrugato SN8 DN 315. Zbatuesi i punimeve gjatë auditimit na vuri në dispozicion një planimetri mbi kanalizimet për të gjitha llojet e tubave të përdorur, dhe matjet që u bënë referuar kësaj planimetrie por dhe nga matjet në objekt u konstatua se janë realizuar 296 ml tub korrugato SN8 DN 315 dhe jo 372 ml. Në këtë konkluzion kemi dalë në objekt në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve. Për rastin konkret dhe jo vetëm, mbikëqyrësi nuk është shprehur me objektivitet sipas faktit edhe në prezencë të përfaqësuesit të bashkisë Korçë. Nuk është paraqitur argument që vërteton të kundërtën, seose fakti është siç është shprehur audituesi.

4. Lidhur mbi Gërmim dhe kanal me makineri, nga auditimi i pasqyrimin në librezën e masave konstatojmë se janë bërë gabime, sepse volumi i gërmimit është 1,015 m<sup>3</sup> gërmim (70.16 m<sup>3</sup> vëllimi i rërës + 0.01 m<sup>3</sup> vëllimi i tubit me Ø 200 mm + 28.99 m<sup>3</sup> vëllimi i tubit me Ø 315 mm + 3.77 m<sup>3</sup> vëllimi i tubit me Ø 400 mm + 4.83 m<sup>3</sup> vëllimi i tubit me Ø 160 mm + 907.22 m<sup>3</sup> vëllimi i mbushjes). Pra ky zë është realizuar në vëllimin 1015 m<sup>3</sup> dhe jo 1197 m<sup>3</sup>. Argumenti juaj nuk qëndron dhe observacioni nuk merret në konsideratë.

#### **Rikonstruksion i rrugës Kuç Belorta. Punime kanalizimi**

1. Lidhur mbi Gërmim dhe kanal me makineri, nga auditimi i pasqyrimin në librezën e masave konstatojmë se janë bërë gabime, sepse volumi i gërmimit është 714 m<sup>3</sup> gërmim (2,040 sipërfaqja maksimale e shtresës me çakëll x 0.35 m, thellësia e gërmimit sipas librezës). Pra ky zë është realizuar në vëllimin 714 m<sup>3</sup> dhe jo 816 m<sup>3</sup>. Thellësia e gërmimit sipas librezës është marrë 35 cm dhe jo 50 cm siç shpreheni ju në observacion.

#### **Punime kanalizime, fshati Bulgarec.**

1. Lidhur mbi realizimin e zërit "F.V. puseta plastike 40x40x40 cm me kapak të fortë RIC 1084+1086" argumenti është në kundërshtim me specifikimet teknike dhe konsiderohet dëm ekonomik deri në realizimin e tij në përputhje kushtet e kontratës dhe specifikimeve teknike. Në ndërtim nuk mund të veprohet sipas dëshirës, së sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit të punimeve duke vendosur materiale (puseta plastike 30x30x30 cm) të pa miratuara më parë në preventivin e ndryshuar nga mbikëqyrësi dhe nga AK. Observacioni nuk merret në konsideratë.

#### **Rikonstruksion i rrugës te Qendra shëndetësore Dishnicë.**

Lidhur mbi zërin F.V. pllaka vetë shtrënguese p.p C 20/25 6 cm, nga matjet faktike në objekt në prezencë të mbikëqyrësit dhe të përfaqësuesit të bashkisë Korçë u konstatua se janë realizuar 79 m<sup>2</sup> pllaka më pak, pra janë realizuar 58.2 m<sup>2</sup> pllaka dhe jo 137.2 m<sup>2</sup> pllaka. Mbikëqyrësi ka observuar pa fakte dhe jo në përputhje me matjet e kryera.

- Si përfundim nga shqyrtimi i argumenteve të paraqitura në observacion e sipërmarrësit të punimeve, grupi i auditimit nuk merr në konsideratë këtë observacion, ndërsa për problematikën e tjera të konstatuara nga audituesi nuk janë paraqitur argumente dhe fakte që grupi i auditimit të mendojë ndryshme, madje në disa raste sipërmarrësi i punimeve nuk ka shprehur të vërtetën e konstatuar nga matjet faktike në terren dhe në dy raste konsideron si të drejtë përdorimin dhe vendosjen e materialeve (p.sh. puseta plastike) të pa miratuara në preventivin e ndryshuar nga Autoriteti Kontraktor.

## **12. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: "Sistemim, asfaltim në rrugët e qytetit (lagjet nr. 4, 5, 6, 8, 13 dhe 18)" Bashkia Korçë, me të dhënat si vijon:**

| Kontratën e zbatimit  |  | Të dhëna për :   |  |
|---|--|--|--|
|   |  | Mbikëqyrjen  | Kolaudimin   |
| Nr. 5133/6/2 Prot, datë 04.09.2018  | Afati zbatimit të kontratës 6 muaj<br>Shtyrje afati 84 ditë  | kontrata nr. 5178/2 prot, datë 04.09.2018                                      | kontrata nr. - datë 28.09.2019                       |
| Vlera e kontratës 46,009,674 lekë me TVSH   | Periudha e garancisë së defekteve - 24 muaj  | JV "6D-Plan & HE & SK 11" SHPK, nr. licence MK. 2837/1 me Administrator Z. S.K | "Personi fizik" P.S, me licence nr. MK. 2632/6/1     |
| JV "S" & "J" SHPK përfaqësuar nga kontraktori "S" SHPK me Administrator Z. Th. S. | Punimet kanë filluar me datë 06.09.2018-<br>10.12.2018<br>Rifilluar 04.03.2019-<br>25.05.2019<br>Punimet kanë përfunduar, 25.05.2019 | vlera e kontratës së mbikëqyrjes 842,230.80 lekë me TVSH.                      | Vlera e kontratës së kolaudimit 40,000 lekë me TVSH. |



**KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.</b> Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim, asfaltim në rrugët e qytetit (lagjet nr. 4, 5, 6, 8, 13 dhe 18)”, Bashkia Korçë, me vlerë 46,009,674 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Kontraktorëve të përkohshëm “S” & “J” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, në vlerën <b>939,368 lekë pa TVSH</b> , e cila përfaqëson punime të pa realizuara në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5133/6 prot, datë 04.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Bashkimit të Kontraktorëve të përkohshëm “S” & “J” SHPK. |
| <b>Situata</b>           | Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, pasqyruar si në tabelë.   |

| Nr Anal                       | Zëri i punimeve   | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti    | Diferenca në + |         |                |
|-------------------------------|---|--------|-----------------|-------------------------|----------------|----------|----------------|---------|----------------|
|                               |   |        |                 |                         |                |          | Vol.           | Vlera   |                |
| Zëri 3/158/5a                 | Transport dhera auto 5km, për rrugët                            | M3     | 350             | 8,028.72                | 8,028.72       | 6,707.17 | 1,318.55       | 461,492 |                |
| Zëri 3/an/pp                  | . F.V puseta plastike 40x40x40 cm, kapak të fortë RIC 1084+1086 | copë   | 3,500           | 125                     | 125            | 113      | 12             | 42,000  |                |
| Zëri An-22                    | F.V puseta shiu b/a 40x40x40x100 cm me kapak zgarë hekuri.      | copë   | 10,000          | 36                      | 36             | 35       | 1              | 10,000  |                |
| Zëri 2.575                    | F.V puseta shkarkimi b/a 1x1x1.5 m, me kapak gize.              | copë   | 22,500          | 7                       | 7              | 3        | 4              | 88,000  |                |
|                               | Punime për ndërtimin e trotuarit                                | -      | -               | -                       | -              | -        | -              | 24,643  |                |
|                               | Punime për shtresat asfaltike dhe nënshtresat e rrugëve         | -      | -               | -                       | -              | -        | -              | 40,376  |                |
|                               | Punime kanalizimi në rrugën loni grazhdani.                     | -      | -               | -                       | -              | -        | -              | 120,239 |                |
|                               | Punime kanalizimi në rrugën vaskë pendavinji.                   | -      | -               | -                       | -              | -        | -              | 152,618 |                |
| <b>Totali në lekë pa TVSH</b> |   |        |                 |                         |                |          |                |         | <b>939,368</b> |

|                       |  |
|-----------------------|--|
| <b>Kriteri</b>        | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5178/2 prot, datë 04.09.2018. |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Korçë.   |

|                    |  |
|--------------------|--|
| <b>Shkaku</b>      | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej <b>939,368 lekë pa TVSH</b> , e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.   |
| <b>Rendesia</b>    | <i>E lartë</i>   |
| <b>Rekomandimi</b> | Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>939,368 lekë pa TVSH</b> nga Bashkimi i Kontraktorëve të përkohshëm “S” & “J” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 5133/6 Prot datë 04.09.2018 me objekt “Sistemim, asfaltim në rrugët e qytetit (lagjet nr. 4, 5, 6, 8, 13 dhe 18)”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara. |

Disa problematika të konstatuara nga auditimi:

1. Projekti i zbatimit me objekt “Sistemim, asfaltim në rrugët e qytetit (lagjet nr. 4, 5, 6, 8, 13 dhe 18)” Bashkia Korçë është zbatuar pa leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 39 të Ligjit nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, i cili thotë: “ *Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligj*”.

2. Sipërmarrësi i punimeve JV “S” SHPK & “J” SHPK gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier nuk ka hartuar rilevimin topografik si dhe profilet gjatësore dhe tërthore për rikonstruksionin në rrugët e qytetit (lagjet 4, 5, 6, 8, 13 dhe 18). Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu III dokumentacioni teknik i punimeve të ndërtimit, citohet se: “Gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, i cili përmban: a) Dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit e të rrjeteve të infrastrukturës, për lidhjen e themeleve e të bazamenteve me tabanin, për kontrollin në plan e lartësi të objektit, të strukturave mbajtëse etj”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. S.K, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 19 datë 06.11.2020 dhe për këtë çështje zbatuesi i punimeve shoqëria “S” SHPK, në observacionin e protokolluar në Bashkinë Korçë me nr. -- prot, datë 14.05.2021, përcjellë nga subjekti i audituar Bashkia Korçë me shkresën nr. 6684/4 datë 01.06.2021 (protokolluar në KLSH me nr. 260/18 prot, datë 03.06.2021) ka bërë **komente dhe shpjegime dhe konkretisht:**

Nga ana e sipërmarrësit të punimeve pretendohet se:

1. Diferencat në zërin volum gjermimi dhe volum transporti për të njëjtën njësi matëse për zërin e punimit “ 3/158/5a Transport dhera auto 5km, për rrugët” kanë ndodhur si pasojë e koeficientit të shkrifërimit i cili në këtë rast është 1.2 herë (koeficienti) më i madh referuar preventivit fillestar.

2. Lidhur me zërin “3/an/pp” FV Puseta plastike 40x40x40x, kapak të fortë RIC 1084+1086, sipërmarrësi i punimeve pretendon se ka bërë verifikimet në terren dhe pasi ka krahasuar me të dhënat e dosjes së punës ka hartuar pasqyrën ku pasqyron mospërputhjen për:

a) Në numrin faktik të zërit nuk janë përfshirë pusetat e rrugës Ramadan Isak, që është përfshirë në këtë projekt, por është paraqitur bashku me volumet e rrugës Hamit Mane.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

Kjo për shkak të procedurave të kërkuara që nevojiteshin nga dalja prej planimetrisë të miratuar.

b) Nuk janë numëruar gjithashtu edhe pusetat e këndeve të rrugëve me emërimet: Tring dhe Abcom. Faktikisht këto puseta janë ndërtuar dhe montuar nga firma “S” SHPK. por meqenëse ata kishin leje ndërtimi në njëjtën gjurmë rrugë me rrjetin e tubave Øën në administrim pusetat, në trotualet ku gjerësia e tyre nuk lejonte ndërtimin e dy apo më shumë pusetave në qoshet e rrugëve....Kjo është kryer në dijeni të Bashkisë Korçë dhe ndërrimi i kapakëve është bërë me dijeni të bashkisë Korçë.

**3.** Lidhur me zërin “F.V puseta shiu b/a 40x40x100 cm me kapak zgarë hekuri” sipërmarrësi i punimeve pasi bëri verifikimet në terren dhe pasi u krahasuan me të dhënat e dosjes së punës, diferenca rezultoi 1 copë.

**4.** Zëri “puseta shkarkimi b/a 1x1x1.5 m, me kapak gize” pas verifikimeve rezultoi me diferencë 4 copë puseta dhe jo 5 copë. Diferenca ka ndodhur nga mospërdorimi i projektit të ndryshuar, i cili pësoi ndryshime mjaft të mëdha gjatë zbatimit.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

**1.** Lidhur mbi zërat e punimeve Audituesit sqarojnë se koeficienti i pretenduar të shkrifërimit nuk është i përfshirë në termat e referencës së kontratës si dhe nuk justifikon sasinë prej 1318.55 m<sup>3</sup> të transportuar më shumë se sa ë gërmuar.

**2.** Inspektimi i zbatimit të punimeve në terren është bërë në prezencë të përfaqësuesit të bashkisë Korçë z. A. D. dhe në secilin rast janë përcaktuar qartë se cilat puseta janë numëruar e cilat janë pjesë të projektit. Për sa më sipër argumentet e dhëna nga ana Juaj merren pjesërisht në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit për të gjitha tipet e pusetave, plastike, të shiut dhe pusetave të shkarkimit.

**3.** Me argumentin e paraqitur, observacioni merret në konsideratë.

**4.** Observacioni është pranuar qysh në fazën e projektraportit, pra rezultojnë puseta mangut 4 copë, por Ju nuk jeni informuar mbi Projektraportin e auditimit përcjelluar në Bashkinë Korçë.

Mbi punimet për shtresat asfaltike dhe nënshtresat e rrugëve, mbas shqyrtimit të observacioneve të pusetave të shiut (35 copë) dhe të shkarkimit të ujërave të zeza (14 copë), janë shkaktuar nga mos zbritja e tyre për të gjitha rrugët e qytetit diferenca në vlerë në vlerën 40,376 lekë.

**13. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale "Rikonstruksion në bllokun informal Rr. QANI QYTEZA"” Bashkia Korçë, me të dhënat si vijon:**

| Kontratën e zbatimit                              |   | Të dhëna për :  |  |
|---|---|---|--|
|   |   | Mbikëqyrjen   | Kolaudimin   |
| Nr. 4894/2 Prot, datë 16.07.2019                  | Afati zbatimit të kontratës 6 muaj  | kontrata nr. 6330/2 prot, datë 16.07.2019                               | kontrata nr. - datë 28.09.2019   |
| Vlera e kontratës 4,440,218 lekë me TVSH          | Periudha e garancisë së defekteve - 24 muaj   | “P.F. M. K & D” SHPK, nr. licence MK. 1200/4 me Administrator Znj. M.K. | Kontraktori “G & L. C” SHPK me licence nr. MK. 2927/7 me Administrator Z. L.H. |
| Kontraktori A.K 2002SHPK me Administrator Z. A.M. | Punimet kanë filluar me datë 06.09.2018-10.12.2018<br>Rifilluar 04.03.2019-25.05.2019<br>Punimet kanë | vlera e kontratës së mbikëqyrjes 98,656.80 lekë me TVSH.                | Vlera e kontratës së kolaudimit --- lekë me TVSH.                              |

|                          |   |
|--------------------------|---|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <p><b>Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.</b></p> <p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale ”Rikonstruksion në bllokun informal Rr. QANI QYTEZA””, Bashkia Korçë, me vlerë 4,440,218 lekë me TVSH, fituar nga kontraktorit A.K 2002 SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, në vlerën <b>513,128 lekë pa TVSH</b>, e cila përfaqëson punime të pa realizuara në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmartjes së punimeve nr. 5894/2 prot, datë 16.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe kontraktorit A.K 2002 SHPK.</p> |
| <b>Situata</b>           | Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, pasqyruar si në tabelë.  |

| Nr Anal  | Zëri i punimeve   | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti  | Diferenca në + |          |
|--|---|--------|-----------------|-------------------------|----------------|--------|----------------|----------|
|  |   |        |                 |                         |                |        | Vol.           | Vlera    |
| <b>Rikonstruksion në rrugën “QANI QYTEZA”.</b> |   |        |                 |                         |                |        |                |          |
| Zëri 1(3/89/b)                                 | Gërmim dhe me makineri.   | M3     | 150             | 610                     | 610.4          | 454.12 | 155.88         | 23,382   |
| Zëri 11(3/158/5a)                              | Transport dhe auto deri 5 km.                                   | M3     | 120             | 939                     | 939            | 551.72 | 387.28         | 46,473.6 |
| Zëri 5(3/222/2)                                | Shtresë binderi me makineri.                                    | M3     | 950             | 987.7                   | 987.7          | 796.66 | 191.04         | 181,488  |
| Zëri 3(3/617/1)                                | F.V Bordura betoni 30 x 15 cm.                                  | ml     | 820             | 435                     | 435            | 293.8  | 141.2          | 115,784  |
| Zëri 6(2/262/3)                                | Beton për themel bordure C 12/15.                               | M3     | 7,000           | 13.54                   | 13.54          | 9.04   | 4.5            | 31,500   |
| Zëri 15(3/An/pp)                               | F.V. Puseta plastike 40x40x40 cm, kapak të fortë RIC 1084+1086. | copë   | 5,500           | 20                      | 20             | 4      | 16             | 88,000   |
| <b>Punime kanalizimi</b>                       |   |        |                 |                         |                |        |                |          |
| Zëri 6(An-21)                                  | Puseta shkarkimi b/a 1x1x1.5 m, me kapak gize.                  | copë   | 500             | 5                       | 5              | 3      | 2              | 1,000    |
| Zëri 7(An-22)                                  | Puseta shiu b/a, 40 x40 100 cm, me kapak gize.                  | copë   | 8,500           | 12                      | 12             | 9      | 3              | 25,500   |

|                       |   |
|-----------------------|---|
| <b>Kriteri</b>        | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6330/2 prot datë 16.07.2019. |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Korçë.  |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

|                    |   |
|--------------------|---|
| <b>Shkaku</b>      | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej <b>513,128 lekë pa TVSH</b> , e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.  |
| <b>Rendesia</b>    | <i>E lartë</i>  |
| <b>Rekomandimi</b> | Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>513,128 lekë pa TVSH</b> nga kontraktori A.K 2002 SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 5894/2 Prot, datë 16.07.2019 me objekt “ <i>Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale "Rikonstruksion në bllokun informal Rr. QANI QYTEZA"</i> ”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara. |

**Disa problematika të konstatuara nga auditimi:**

Nga auditimi në terren, u konstatua se punimet e ndërtimit të trotuarit në pjesë të ndryshme të objektit kanë pësuar dëmtime të cilat mund të bëhen shkak për dëmtimin e pllakave vetë shtrënguese, prandaj nisur nga fakti se punimet janë brenda periudhës së garancisë, sipërmarrësi i punimeve dhe mbikëqyrësi i punimeve të marrin masa të menjëhershme për riparimin e tyre, në rast të kundërt, mosrealizimi i tyre do të llogaritet si dëm ekonomik.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. M.K, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

**14. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: “Për projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara, Bashkia Korçë”, me të dhënat si vijon:**

|  | Kontratën e zbatimit   | Të dhëna për :  |   |
|--|--|---|---|
|  |  | Mbikëqyrjen   | Kolaudimin  |
| Nr. 8330/2 Prot, datë 27.09.2019                 | Afati zbatimit të kontratës 2 muaj   | kontrata nr. 8755/2 prot, datë 27.09.2019                         | kontrata nr. - datë 04.12.2019                    |
| Vlera e kontratës 8,817,730 lekë me TVSH         | Periudha e garancisë së defekteve - 24 muaj                                    | “G B C E” SHPK, nr. licence MK. 2632/1 me Administrator e Z. G.B. | Kontraktori “PF”P.S me licence nr. MK. 2632/1     |
| Kontraktori “N” SHPK me Administrator Znj. SH.N. | Punimet kanë filluar me datë 02.10.2019<br>Punimet kanë përfunduar, 25.11.2019 | vlera e kontratës së mbikëqyrjes 164,241 lekë me TVSH.            | Vlera e kontratës së kolaudimit --- lekë me TVSH. |

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | <b>Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.</b> Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “ <i>Për projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara, Bashkia Korçë</i> ”, me vlerë 8,817,730 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori “N” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe disa zëra punime të pa realizuar fare, në vlerën <b>177,205 lekë pa TVSH</b> , me pasojë dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.<br>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 8330/2 prot, datë 27.09.2019 të lidhur mes Autoritetit |
|--------------------------|--|

|                |  |
|----------------|--|
|                | Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “N” SHPK .  |
| <b>Situata</b> | Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, pasqyruar si në tabelë. |

| Nr Anal   | Zëri i punimeve                             | Njësia         | Çmimi i ofertës   | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti   | Diferenca në +                    |         |
|---|---|----------------|---|-------------------------|----------------|---|-----------------------------------|---------|
|   |   |                |   |                         |                |   | Vol.                              | Vlera   |
| <b>Pronar: M.K, rruga “Riza Cerova”, lagjia nr. 6</b> |   |                |   |                         |                |   |                                   |         |
| Zëri 9(2/197)   | Hidroizolim tarrace 2kk                     | m <sup>2</sup> | 6120 lekë (sipas faktit është realizuar me çmim 696 lekë) | 31.20                   | 31.20          | 31.20 x 696 lekë (realizuar sipas zërit 2/196 me 1 kk dhe jo me 2 kk) | 31.20 m <sup>2</sup> x 5,424 lekë | 169,228 |
| Zëri 1(2/481/3)                                       | F.V përcjellës PV-500, 4 m/m <sup>2</sup>   | ml             | 51  | 43                      | 43             | -   | 43                                | 2,193   |
| Zëri 2(2/481/2)                                       | F.V përcjellës PV-500, 2.5 m/m <sup>2</sup> | ml             | 34  | 43                      | 43             | -   | 43                                | 1,462   |
| Zëri 3(2/184/1)                                       | F.V përcjellës PV-500, 1.5 m/m <sup>2</sup> | ml             | 21  | 43                      | 43             | -   | 43                                | 903     |
| Zëri 4(2/480/1)                                       | F.V tubo plasmasi 14-17 m/m                 | ml             | 19  | 86                      | 86             | -   | 86                                | 1,634   |
| Zëri 5 (2/483)  | F.V çelësa e proza                          | copë           | 425   | 3                       | 3              | -   | 3                                 | 1,275   |
| Zëri 6(2/487)   | F.V kuti derivacioni plastike               | copë           | 170   | 3                       | 3              | -   | 3                                 | 510     |

|                       |   |
|-----------------------|---|
| <b>Kriteri</b>        | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 8755/2 prot datë 27.09.2019.  |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Korçë.  |
| <b>Shkaku</b>         | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej <b>177,205 lekë pa TVSH</b> , e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.  |
| <b>Rendesia</b>       | <i>E lartë</i>  |
| <b>Rekomandimi</b>    | Nga Bashkia Korçë, të merren masa për:<br>- Arkëtimin e vlerës prej <b>169,228 lekë</b> pa TVSH nga Kontraktori “N” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 8330/2 Prot datë 27.09.2019 me objekt “Për projekte për përmirsimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara, Bashkia Korçë”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.<br>- T’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Kontraktorit “N” SHPK, realizimin e zërave të punimeve sipas specifikimeve teknik në vlerën <b>7,977 lekë</b> pa |





**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

TVSH, brenda periudhës së garancisë me datë 04.10.2021 (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të kthehet nga sipërmarrësi i punimeve).

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. G.B, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

**15. Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit për kontratën me objekt “Rikonstruksion i godinës së stacionit të M.Z.SH.-së ”.**

| Kontratën e zbatimit                           |   | Të dhëna për :  |   |
|--|---|---|---|
|  |   | Mbikëqyrjen   | Kolaudimin  |
| Nr. 8380/2 Prot, datë 04.12.2018               | Afati zbatimit të kontratës 25 ditë   | kontrata pa nr.-- prot, datë 26.11.2018                                 | kontrata nr. - datë 27.12.2018                    |
| Vlera e kontratës 2,052,928 lekë me TVSH       | Periudha e garancisë së defekteve - 12 muaj   | “M.A.K. Studio” SHPK, nr. licence MK. 1811/7 me Administrator e Z. T.S. | Kontraktori “PF”P.S me licence nr. MK. 2632/1     |
| Kontraktori “V - CO” SHPK me Administrator V.M | Punimet kanë filluar me datë 04.12.2018<br>Rifilluar: 26.03.2019<br>Punimet kanë përfunduar, 05.04.2019 | vlera e kontratës së mbikëqyrjes 30,165.60 lekë me TVSH.                | Vlera e kontratës së kolaudimit --- lekë me TVSH. |

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projekt - preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i zbatimit të punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk rezultuan diferenca në volume apo në zëra punime ndërtimi.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi:

- Objekti “Rikonstruksioni i godinës së stacionit të MZSH-së” është ristrukturuar sipas projektit të zbatimit, kushteve teknike të zbatimit si dhe specifikimeve teknike dhe kushteve dhe kërkesave të kontratës me nr. 8380/2 prot, datë 04.12.2018. kontrata e zbatimit të punimeve është realizuar në shumën 2,052,844 lekë.
- Projekti i rikonstruksionit është zbatuar dhe nuk ka shmangie në drejtimin funksional, të qëndrueshmërisë dhe të destinacionit, në formë, dimensione, sipërfaqe e vëllim.
- Zërat e punimeve janë realizuar sipas preventivit bazë dhe të ripunuar dhe korrespondojnë me volumet në situacionin përfundimtar.
- Gjatë zbatimit të punimeve është mbajtur dokumentacioni teknik si, Akte kontrolli, procesverbal për punimet e maskuara, ditari i punimeve.

Nga matjet në dimension projekt – fakt që u bënë në objekt, rezultoi se punimet faktike sipas zërave të preventivit bazë dhe të ripunuar të realizuara nga sipërmarrësi i punimeve përputhen me volumet në tabelat e llogaritjeve sasiore dhe me volumet e pasqyruara në situacionin përfundimtar.

### **G. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.**

**Në zbatim të pikës G. Vlerësim me zgjedhje i proceseve administrative në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në rubrikën të ndryshme në programin e auditimit u shqyrtuan:**

1- Miratim nga Kryetari i Bashkisë Korçë të lejes së zhvillimit nr. 1918, datë 20.04.2018 dhe lejes së ndërtimit nr. 4427, datë 14.08.2018 për “Banesë individuale (3 Kate + Podrum), pa plotësuar kushtin e ruajtjes së distancës midis objekteve, kufirit të pronës dhe distancën nga trupi i rrugës.

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | Nga auditimi i zbatimit të procedurës për leje zhvillimi nr. 1918, datë 20/04/2018 dhe leje ndërtimi nr. 4427 datë 14/08/2018 për objektin “Banesë individuale (3 kate + podrum) në adresën Lagje 1, Rr. “Dhori Lako” Bashkia Korçë” Bashkia Korçë, u konstatua se janë miratuar këto leje pa plotësuar kushtin e ruajtjes së distancës midis objekteve, kufirit të pronës dhe distancën nga trupi i rrugës. Ky veprim është bërë në kundërshtim me nenet 34, 35 dhe 36 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar si dhe në kundërshtim me nenin 58 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë.  |
| <b>Situata</b>           | Aplikanti dhe zhvilluesi “K. 93” SHPK, ka paraqitur kërkesën me nr. prot. 4427, datë 09.07.2018 pranë Bashkisë Korçë, për leje ndërtimi për objektin “Banesë individuale (3 kat + Podrum)” në adresën L. 1, Rr. “Dhori Lako” Korçë, me dokumentacionin si vijon: ( Prokurë për autorizimin e tokës; Marrëveshja me pronarin e tokës; Kopje e dokumentacionit të pronësisë; Deklaratë e projektuesit të licencuar, për përputhshmërinë e projektit me dokumentet e planifikimit dhe legjislacionin në fuqi, sipas sistemit online; Kopje e licencës; Polica e sigurimit; Projekti dhe relacioni arkitektonik; Projekti dhe relacioni konstruktiv; Projekti dhe relacioni elektrik; Projekti dhe relacioni hidrosanitar; Projekti dhe relacioni i instalimeve të ngrohje-ftohjes; Preventivi i punimeve; Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e azhurnuar të hartës së parcelës lëshuar me lejen e zhvillimit; Grafiku i punimeve; Leje e zhvillimit; Projekti dhe relacioni i mbrojtjes nga zjarri; Miratim për VNM paraprake, pëlqim mjedisor; Mandatpagesa e tarifës së aplikimit; Format i aplikimit, i nënshkruar elektronikisht). |




## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

#### PLANI I VENDOSJES SË STRUKTURËS

OBJEKTI: BANESE INDIVIDUALE (3 KATE+PODRUM)  
 ZHVILLUES: SHOQERIA "KONSTRUKSION 93" shpk  
 VENDNDODHJA: RR. "DHORI LAKO" KODI POSTAR 7002, KORÇE



#### Situata

Me datë 02.08.2018, struktura përgjegjëse e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit e përbërë nga znj. ZH.B, z. E.GJ dhe z. H.N, pas shqyrtimit teknik të dokumentacionit është shprehur me mendimin pozitiv mbi dhënien e lejes së ndërtimit dhe, në vijim kryetari i Bashkisë Korçë, ka vendosur:

Lëshimin e lejes së ndërtimit për zhvilluesin “K. 93”, NUIS/NID J.....B për ndërtimin e objektit “Banesë Individuale (3 kat + Podrum)” në pasurinë me nr. pasurie 1/199, ZK 8562, në pronësi të T.M, me kufij (V 1/200, J 1/650, L 1/566, P 1/565) sipërfaqe 89.17 m<sup>2</sup> dhe adresë L. 1. Rr. “Dhori Lako” Korçë; në pasurinë me nr. pasurie 1/650, ZK 8562, në pronësi të T.M, me kufij (V 1/199, J 1/651, L 1/566, P 1/565), sipërfaqe 158.50 m<sup>2</sup> dhe adresë L. 1, “Dhori Lako” Korçë, sipas kushteve të zhvillimit si vijon:

|  |           |                       |
|--|-----------|-----------------------|
| <b>Treguesit e përdorimit të propozuar:</b>        |           |                       |
| Sipërfaqe. e tokës që zhvillohet                   |           | 247.67 m <sup>2</sup> |
| Sipërfaqe. e tokës së zënë nga struktura           |           | 132 m <sup>2</sup>    |
| Koeficienti i shfrytëzimit të truallit (KSHT)      |           | 54 %                  |
| Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë      |           | 396 m <sup>2</sup>    |
| Intensiteti i ndërtimit (I)                        |           | 1.6                   |
| Lartësia maksimale e strukturës nga niveli I tokës |           | 12.00 m               |
| Numri kateve mbi tokë                              |           | 3 kat                 |
| Numri i kateve nën tokë                            |           | 1 kat                 |
| Numri i vend parkimeve të mjeteve                  |           | 5 vende               |
| <b>Treguesit e përdorimit të propozuar:</b>        |           |                       |
| Nga kufijtë e pronës                               | V: 0.40 M | L: 1.00 M – 2.30 M    |
|  | J: 0.70 M | P: 2.10 M – 2.90 M    |
| Nga strukturat e tjera                             | V: 0.40 M | L:                    |
|  | J: 0.95 M | P:                    |
| Nga rrjeti rrugor                                  | V:        | L: 1.00 M – 2.30 M    |
|  | J:        | P: 2.10 M – 2.90 M    |
| Nga servitutet publike                             | V:        | L:                    |

Vlefshmëria e kësaj leje ndërtimit është për një periudhë 24 mujore nga data e fillimit të punimeve, referuar grafikut të punimeve.

Nga auditimi i zbatimit të procedurave mbi dhënien e lejes së ndërtimit, u konstatua se nga projektuesi i objektit si dhe nga DPKZHT nuk janë zbatuar distancat urbanistike dhe konkretisht:

|                       |  |                      |           |                    |  |           |                    |
|-----------------------|--|----------------------|-----------|--------------------|--|-----------|--------------------|
|                       | <p>- Distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës nuk është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimi plus 1 m. Pra, distanca minimale duhej të ishte 4 m dhe jo sipas distancave që jepen plan vendosje, si në tabelë.</p> <table border="1"> <tr> <td>Nga kufijtë e pronës</td> <td>V: 0.40 M</td> <td>L: 1.00 M – 2.30 M</td> </tr> <tr> <td></td> <td>J: 0.70 M</td> <td>P: 2.10 M – 2.90 M</td> </tr> </table> <p>- Distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga trupi i rrugës në lindje nuk është 2.5 por është marrë 1 m deri 2.3 m.</p> <p>- Distanca midis dy strukturave nga Veriu duhej të ishte 4.5 m (3 kt + 1.5 kt) dhe jo 0.4 m dhe Jugu distanca duhej të ishte 5m (3 kt + 2 kt) dhe 0.95 m.</p> <p>Sa më sipër, miratimi i leje zhvillimi nr. 1918, datë 20/04/2018 dhe leje ndërtimi nr. 4427 datë 14/08/2018 në njësinë strukturore KO/UB 140 për objektin “Banesë Individuale (3 kat + Podrum), nga Kryetari i Bashkisë Korçë Z. S.F dhe Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit znj. ZH.B pa plotësuar kushtin e ruajtjes së distancës midis objekteve, kufirit të pronës dhe distancën nga trupi i rrugës.</p> | Nga kufijtë e pronës | V: 0.40 M | L: 1.00 M – 2.30 M |  | J: 0.70 M | P: 2.10 M – 2.90 M |
| Nga kufijtë e pronës  | V: 0.40 M  | L: 1.00 M – 2.30 M   |           |                    |  |           |                    |
|                       | J: 0.70 M  | P: 2.10 M – 2.90 M   |           |                    |  |           |                    |
| <b>Kriteri</b>        | Sa më sipër është në kundërshtim me nenet 34, 35 dhe 36 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar si dhe në kundërshtim me nenin 58 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë.  |                      |           |                    |  |           |                    |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Miratimi i lejes së zhvillimit e ndërtimit të këtij objekti ka cenuar distancat midis objektit të ri dhe ekzistues, objektit të ri dhe kufirit të pronës dhe distancën së objektit të ri nga trupi i rrugës.   |                      |           |                    |  |           |                    |
| <b>Shkaku</b>         | Neglizhencë në respektimin e kondicioneve duke favorizim me të padrejtë aplikuesin dhe zhvilluesit e objektit.   |                      |           |                    |  |           |                    |
| <b>Rendesia</b>       | E Lartë  |                      |           |                    |  |           |                    |
| <b>Rekomandimi</b>    | Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojmë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit të zhvilluar plotësojnë qartazi treguesit e distancave ndërmjet objektit të ri dhe ekzistues, kufirit të pronës dh trupit të rrugës.   |                      |           |                    |  |           |                    |

2. Nga auditimi i zbatimit të procedurës për leje zhvillimi nr. 84, datë 16.01.2019 dhe leje ndërtimi nr. 710 datë 12.03.2019 për objektin “Banesë individuale (3 kate me podrum) në adresën Lagje. 1, Rruga "Lidhja e Prizrenit", Korçë, u konstatua se janë miratuar këto leje pa plotësuar kushtin e ruajtjes së distancës midis objekteve, kufirit të pronës dhe distancën nga trupi i rrugës. Ky veprim është bërë në kundërshtim me nenet 34, 35 dhe 36 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar si dhe në kundërshtim me nenin 58 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë.

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | Miratim nga Kryetari i Bashkisë Korçë të lejes së zhvillimit nr. 84, datë 16.01.2019 dhe lejes së ndërtimit nr. 710, datë 12.03.2019 për “Banesë individuale (3 Kate me Podrum), pa plotësuar kushtin e ruajtjes së distancës midis objekteve, kufirit të pronës dhe distancën nga trupi i rrugës.   |
| <b>Situata</b>           | Titullari i Autoriteti Kontraktor Bashkisë Korçë, pas shqyrtimit të kërkesës nr. Prot. 84 , datë 07/01/2019 , për leje zhvillimi për në pasurinë me nr. pasurie 8562-7/49, ZK 8562, në pronësi të V. K., me kufij (V 7/51, J 7/636, L 7/49, P 7/52), sipërfaqe 55.5 m <sup>2</sup> dhe adresë Korçë, Rruga Lidhja e Prizrenit; në pasurinë me nr. pasurie 8562-7/48, ZK 8562, në pronësi të E.K, me kufij (V 7/50, J 7/636, L 7/669, P 7/49), sipërfaqe 119.88 m <sup>2</sup> dhe adresë |



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë


L.1, Rruga "Lidhja e Prizrenit", Korçë, dhe dokumentacionit shoqërues të kërkesës si vijon: (Prokurë për autorizimin e aplikuesit, Kopje e dokumentit të pronësisë, Marrëveshja me pronarin e tokës, Mandatpagesa e tarifës së aplikimit Formati i aplikimit, i nënshkruar elektronikisht) ka miratuar lëshimin e Lejes së Zhvillimit **Nr. 84, datë 16.01.2019**, me kushtet zhvillimore, si vijon: (Kodi i njësisë strukturore, KO/UB 166; Tipologjia, M; Sipërfaqe maksimale e lejuar për ndërtim, (55.5 + 119.88 175.38 m<sup>2</sup>; Sipërfaqe e truallit të zënë nga struktura, 122.76 m<sup>2</sup>; Sipërfaqja e kateve mbi tokë, 350.7 m<sup>2</sup>; Koeficienti maksimal i shfrytëzimit të tokës KSHT (%), 70; Intensiteti maksimal i ndërtimit të pasurisë I, 2.00; Lartësia maksimale (m), 12; Lartësia maksimale në kate, 3; Kushtet për numrin e parkimeve, 31 (për të gjithë njësinë strukturore)).

Projekti i zbatimit është hartuar nga: F.K, me NIPT/NID K.....I, N.S me NIPT/NID H.....L, K.M me NIPT/NID L.....B, Y.H me NIPT/NID L.....P, N.U me NIPT/NID L.....S.

Zhvilluesi K.93sh.p.k, ka paraqitur kërkesën me nr. prot. 710 , datë 28.01.2019 pranë Bashkisë Korçë, për leje ndërtimi për objektin "Godinë banimi kolektive 3 kt me Podrum" në adresën Lagje. 1, Rruga "Lidhja e Prizrenit", Korçë, dhe dokumentacionit shoqërues të kërkesës si vijon: (Prokurë për autorizimin e aplikantit, Marrëveshje me pronarin e tokës, Kopje e dokumentit të pronësisë, Deklarata e projektuesit të licencuar, për përputhshmërinë e projektit me dokumentet e planifikimit dhe legjislacionin në fuqi, sipas sistemit online, Polica e sigurimit, Kopje e licencës, Mandatpagesa e tarifës së aplikimit, Leja e zhvillimit, Projekti dhe relacioni i mbrojtjes nga zjarri, Miratim për VKM paraprake, pëlqim mjedisor, Grafiku i punimeve, Preventivi i punimeve, Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e azhurnuar të hartës lëshuar me lejen e zhvillimit, Projekti dhe relacioni i instalimeve të ngrohje-ftohjes, Projekti dhe relacioni hidrosanitar, Projekti dhe relacioni elektrik, Projekti dhe relacioni konstruktiv, Projekti dhe relacioni arkitektonik, Formati i aplikimit, i nënshkruar elektronikisht si dhe pas marrjes zyrtarisht të mendimeve/pëlqimeve nga institucionet publike të parashikuara nga ligji, si vijon: OSHEE Korçë, Ujësjellës Kanalizime Korçë, ZVRPP Korçë).

Titullari i Bashkisë ka miratuar Leje Ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>, me **nr. 710, datë 12.03.2019**, ndërtimi i objektit "Godinë Banimi Kolektive 3 Kate me Podrum" , në pasurinë me nr. pasurie 8562-7/49, ZK 8562, në pronësi të V.K, me kufij (V 7/51, J 7/636, L 7/49, P 7/52), sipërfaqe 55.5 m<sup>2</sup> dhe adresë Korçë, Rruga Lidhja e Prizrenit; në pasurinë me nr. pasurie 8562-7/48, ZK 8562, në pronësi të E.K, me kufij (V 7/50, J 7/636, L 7/669, P 7/49), sipërfaqe 119.88 m<sup>2</sup> dhe adresë Korçë, Rruga Lidhja e Prizrenit me kushtet zhvillimore trajtuar më sipër:

Vlefshmëria e kësaj leje ndërtimit është për një periudhë 24 mujore nga data e fillimit të punimeve, referuar grafikut të punimeve.



*Plani i vendosjes së strukturave për lejen e ndërtimit nr. 710, datë 12.03.2019 dhe leje zhvillimi Nr. 84, datë 16.01.2019 ku paraqiten distancat nga objektet përreth dhe nga kufiri i pronës.*

#### Situata

- Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit e përbërë nga znj. ZH.B, z. E.Gj dhe z. H.N, ka hartuar raport teknik me nr. 710 prot, datë 19.02.2019, pas shqyrtimit të kërkesës së aplikantit me nr. prot. 710 , datë 28.01.2019, për leje ndërtimi për zhvilluesin K.93, NUIS/NID J.....B me të dhënat e mësipërme, struktura përgjegjëse e planifikimit ka marrë në shqyrtim kërkesën për leje ndërtimi e paraqitur në mënyrë elektronike për objektin: “Godinë banimi kolektive, 3 kate me podrum” në K.P 7002, L. 1, Rr. “Lidhja e Prizrenit”, Korçë, me pronar V. K., A. (E.) K. dhe zhvillues shoqëria “K. 93” sh.p.k. Objekti ndodhet në zonën M dhe ka këto parametra zhvillimi: ( Kategoria e përdorimit të tokës – M; - Nënkatëgoria e përdorimit të tokës – M.2; - Kodi i njësisë strukturore – KO/UB 166; - Përdorimi i lejuar – Banim, Konsolidim urban; - Përdorime të ndaluara – Përdorimet që janë në kundërshtim me Rregulloren e Planit; të Përgjithshëm Vendor të Territorit; - Statusi i zhvillimit – Leje ndërtimi

- Sipërfaqja e truallit që zhvillohet – 175.38 m<sup>2</sup>; - Sipërfaqja e strukturës në katin përdhe (gjurma) – 122.76 m<sup>2</sup>; - Sipërfaqja totale e ndërtimit – 350,60 m<sup>2</sup>; - Numri i kateve mbi tokën natyrale – 3; - Numri i kateve nën tokën natyrale – 1; - Lartësia e strukturës – 11.70 m; - Koeficienti i shfrytëzimit të



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

truallit – 70 %; - Intensiteti i ndërtimit – 2.00; Në përfundim, struktura përgjegjëse është shprehur me mendim pozitiv mbi lejen e ndërtimit).

- Nga auditimi i zbatimit të procedurave mbi dhënien e lejes së ndërtimit, u konstatua se nga projektuesi i objektit si dhe nga DPKZHT nuk janë zbatuar distancat urbanistike dhe konkretisht:

Treguesit e përdorimit të propozuar, paraqiten sipas tabelës së mëposhtme.

| <b>Treguesit e përdorimit të propozuar:</b> |                          |                |
|---|--------------------------|----------------|
| Nga kufijtë e pronës                        | V: 0.30/0.50/2.25/2.15 m | L: 2.09/1.71 m |
|   | J: 0.00/0.84/1.70 m      | P: 0.70/070 m  |
| Nga strukturat e tjera                      | V: -                     | L: -           |
|   | J: -                     | P: -           |
| Nga rrjeti rrugor                           | V: -                     | L: -           |
|   | J: 0.00/0.84/1.7 m       | P: -           |
| Nga servitutet publike                      | V: -                     | L: -           |

- Distancat e lejuara të objektit "Godinë Banimi Kolektive 3 Kate me Podrum" dhe kufirit të pronës nga Veriu, Jugu, Lindja dhe Perëndimi nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit 35 të VKM nr. 408, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*" të ndryshuar, pasi distanca e lejuar duhej të ishte e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m, pra duhej **4 m** dhe jo siç është lejuar me kondicionet sipas tabelës.

|                      |                          |                |
|----------------------|--------------------------|----------------|
| Nga kufijtë e pronës | V: 0.30/0.50/2.25/2.15 m | L: 2.09/1.71 m |
|                      | J: 0.00/0.84/1.70 m      | P: 0.70/070 m  |

- Distanca e objektit "Godinë Banimi Kolektive 3 Kate me Podrum" dhe trupit të rrugës, është dhënë vetëm nga Jugu me rrugën "Lidhja e Prizrenit" 0.00/0.84/1.7 m, ndërkohë që sipas nenit 36 "Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe trupit të rrugës" pika 3, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*" të ndryshuar, për gjerësi rruge, me ose pa trotuare, më të vogël se 7 metra, distanca minimale është 2.5 metra.

- E njëjta situatë paraqitet edhe për distancën e objektit "Godinë banimi 3 kate me podrum" me kufirin e pronës nga lindja me rrugën "Foqon Postoli" ku distanca minimale nuk është 2.5 m.

- Distanca minimale e objektit "Godinë banimi kolektive 3 kate me podrum" me objektin nga Veriu 3 kat nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*" të ndryshuar, pasi distanca e lejuar midis dy ndërtime (objekti i ri dhe objekti ekzistues nga veriu) duhej të ishte e barabartë me shumën e numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit që përballen plus 2 m, pra duhej që distanca të ishte 8 m (3 kat objekti i ri + 3 kat objekti ekzistues + 2 m) që në treguesit e përdorimit, në plan vendosje, në lejen zhvillimore dhe në lejen e ndërtimit nuk janë vendosur fare. Veprim ky në kundërshtim me nenin 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*" të ndryshuar.

Sa më sipër, miratimi i lejes së zhvillimi nr. 84, datë 16.01.2019 dhe leje ndërtimi nr. 710 datë 12.03.2019 në njësinë strukturore KO/UB 166 për objektin "Banesë Individuale (3 kat + Podrum), nga Kryetari i Bashkisë

|                       |   |
|-----------------------|---|
|                       | Korçë Z. S.F dhe Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit znj. ZH.B <i>pa plotësuar kushtin e ruajtjes së distancës midis objekteve, kufirit të pronës dhe distancën nga trupi i rrugës.</i>  |
| <b>Kriteri</b>        | Sa më sipër është në kundërshtim me nenet 34, 35 dhe 36 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar si dhe në kundërshtim me nenin 58 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë.   |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Miratimi i lejes së zhvillimit e ndërtimit të këtij objekti ka cenuar distancat midis objektit të ri dhe ekzistues, objektit të ri dhe kufirit të pronës dhe distancën së objektit të ri nga trupi i rrugës.  |
| <b>Shkaku</b>         | Neglizhencë në respektimin e kondicioneve duke favorizim me të padrejtë aplikuesin dhe zhvilluesit e objektit.  |
| <b>Rendesia</b>       | E Lartë   |
| <b>Rekomandimi</b>    | Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojmë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit të zhvilluar plotësojnë qartazi treguesit e distancave ndërmjet objektit të ri dhe ekzistues, kufirit të pronës dhe trupit të rrugës. |

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. S.F, në silësinë e Kryetarit të Bashkisë Korçë dhe znj. ZH.B në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

|   |
|---|
| <p>Për sa më sipër nga Bashkia Korçë është dërguar observacioni me nr. 6684/4 prot., datë 01.06.2020 (Protokolluar në KLSH me nr. 260/18 prot, daë 03.06.2021) ku pretendohet se:</p> <p>Për të dy rastet, si për lejen e ndërtimit nr. 4427, datë 14.08.2018 për objektin “Banesë individuale (3 kate + podrum)” në adresën L L. 1, Rr. “Dhori Leka” Bashkia Korçë dhe në lejen e ndërtimit nr. 710, datë 12.03.2019 për “Banesë individuale (3 kate me podrum)” sqarojmë se janë respektuar të gjitha distancat urbanistike sipas përkatësisë së rastit, bazuar në VKM-në 408, datë 13.05.2015. Edhe në vazhdim po jepen leje ndërtimi duke respektuar distancat ndërmjet objektit të ri dhe objekteve ekzistuese, kufirit të pronës dhe trupit të rrugës.</p> <p><b>Qëndrimi i Grupit të auditimit:</b></p> <p>Pas rishqyrtimit të dokumentacionit dhe kompetencave ligjore përkatëse për procesin e miratimit të lejeve të ndërtimit për objektin “Banesë individuale (3-kate + podrum)” në lagjen nr. 1, Rruga “Dhori Lako” Korçë dhe objekti “Godinë banimi kolektive 3-kate me podrum” në adresën lagje 1, Rruga “Lidhja e Prizrenit” Korçë, audituesit sqarojnë se argumentet e dhëna nga ana Juaj merren në konsideratë pjesërisht. Në asnjë rast në ligj apo në VKM 408, nuk parashikohet që, pavarësisht se si është ndërtuar të konsiderohet si faqe kallkan faqja e një objekti kur në fakt nuk është e tillë.</p> <p>Nga auditimi dhe rishqyrtimi i projekteve të lejeve të ndërtimit rezulton se faqet e objekteve të pretenduara nga ana juaj si faqe kallkan, në fakt nuk rezultojnë të tilla, kjo vërtetuar me dokumentacionin në sistemin e-lejet të projekteve përkatëse arkitektonike.</p> |
|---|

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes</b> | Nga auditimi me zgjedhje i procedurave për leje zhvillimi e ndërtimi të miratuara nga Bashkia Korçë, rezulton se kjo Bashki ka miratuar lejen e zhvillimit nr.1970/20, datë 09/03/2020 dhe lejen e ndërtimit nr.3845/20, |
|--------------------------|--|





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

*datë 28.07.2020 në kundërshtim me nenin 1, të ligjit nr.107, datë 31.07.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" të ndryshuar, nenet 34 dhe 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar si dhe në kundërshtim me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm vendor të Bashkisë Korçë.*

**Situata** Në përfundim të shqyrtimit teknik të dosjes, raportit teknik dhe pagesës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, është marrë vendimi dhe është bërë lajmërimi i aplikuesit për lejen e ndërtimit me nr. prot., 3845/2, datë 28.07.2020 dhe lejen e zhvillimit nr. 1970/20, datë 09.03.2020, në njësinë strukturore KO/UB573, për objektin "Godinë banimi me ambiente shërbimi me bodrum 8 kate për Godinën 5 dhe 6", në adresën 8561, Rr. "Midhi Kostani", Korçë, paraqitur nga zhvilluesi shoqëria "L" - Shpk, projektuar nga Arkitekti R.TH, nga Kryetari i Bashkisë Korçë S.F dhe Drejtore e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit zj. ZH.B. Të dhënat e Plan vendosjes, Lejes së Zhvillimit dhe Lejes së Ndërtimit me elementët përbërës, të krahasuar me Pasaportën e Njesisë Strukturore dhe Rregullores paraqiten si më poshtë


***Tabela 1. Krahasimi i Treguesve Parametrik ndërmjet Projektit të Zbatimit (Planit arkitektonik) dhe Pasaportës së Njesisë Strukturore***

| <i>Krahasimi Treguesve ndërmjet Projektit të Zbatimit (Planit arkitektonik) dhe Pasaportës së Njesisë Strukturore</i> | Sipas Projektit të Zbatimit            |  | Sipas Rregullores dhe Pasaportës së Njesisë Strukturore |                      |
|---|--|--|---|----------------------|
| Njësia Strukturore  | KO/UB573                               |  | KO/UB573  |                      |
| Nënkategoria  | A.Banim                                |  | A.1 Zona banimi në qendrën e qytetit                    |                      |
| Sipërfaqja e truallit që zhvillohet   | 2200m <sup>2</sup>                     |  |   |                      |
| Sipërfaqja e truallit të zënë nga struktura ( gjurma )  | 784m <sup>2</sup>                      |  |   |                      |
| Sipërfaqja totale e ndërtimit   | 6552.7m <sup>2</sup>                   |  |   |                      |
| Numri i kateve mbi tokën natyrale   | 8                                      |  | 8   |                      |
| Numri i kateve nën tokën natyrale   | 1                                      |  |   |                      |
| Vëllimi i strukturës  | 20902 m <sup>3</sup>                   |  |   |                      |
| Lartësia e Strukturës   | 21.1 m                                 |  | 27 m  |                      |
| Distancat e Strukturës nga trupi i rrugës   | 3-5.5 m                                |  |   |                      |
| Koeficienti i Shfrytëzimit (KSHT)   | 36%                                    |  | 70%   |                      |
| Intensiteti (sip totale e ndërtim/sip e truallit)   | 3                                      |  | 3.6   |                      |
| <b><i>Treguesit e përdorimit të propozuar</i></b>   |  |  |   |                      |
| Distancat e Strukturës nga kufijtë e pronës   | V: 1-2.2 m                             | L: 1.5m                                | <b>V: 9 m</b>   | <b>L: 9 m</b>        |
|   | J: 9m                                  | P: 9m                                  | J: 9m   | P: 9m                |
| Nga strukturat e tjera  | V: shesh i lire, prone e vet pronairit | L: shesh i lire, prone e vet pronairit |   |                      |
|   | J: 18.00 vet pronari                   | P: 18.00 vet pronari                   | J: 18.00 vet pronari                                    | P: 18.00 vet pronari |
| Nga trupi i rrugës  | V                                      | L: 3m                                  | V   | L: 3m                |
|   | J: 5.5m                                | P                                      | J: 3m   | P                    |
| Nga servitutet publike  | V                                      | L                                      | V   | L                    |
|   | J                                      | P                                      | J   | P                    |

Në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë, janë përcaktuar njësitë strukturore të qytetit të Korçës me treguesit parametrik (lartësia maksimale e ndërtimit, numri i kateve, KSHT, KSHP, KSHR, Intensiteti etj.) të aplikueshëm në secilën njësi. Në tabelën e mësipërme kemi hedhur të dhënat për njësinë strukturore KO/UB573. Gjithashtu pasi është bërë vlerësimi i plan-vendosjes dhe janë matur distancat në Autocad Map, janë hasur kundërshti ligjore në respektimin e distancës së gjurmës së ndërtimit nga kufiri i pronës. Më konkretisht po i trajtojmë më poshtë sipas orientimeve gjeografike;

***Plani i vendosjes së strukturave për leje zhvillimi nr. 1970/20 datë 09/03/2020 dhe leje***


ndërtimi nr., datë 06/12/2019, ku paraqiten distancat nga objektet përreth dhe nga kufiri i



pronës

a) Distanca e gjurmës së ndërtimit nga kufiri verior i pronës

Më poshtë po paraqesim pamjen e godinës 5 (në të djathtë) dhe 6 (në të majtë) të orientuar nga kufiri verior i pronës.



Sic mund të shihet dhe në Tabelën 1. të mësipërme, si dhe nga matjet në programin Autocad MAP 3D të distancave të dy objekteve nga kufiri i verior i pronës, ka rezultuar se kjo distancë ka qenë në fakt 2.2 metra për godinën 5 dhe 2.2 metra për godinën 6 nga kufiri verior i pronës. Distanca minimale sipas nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” dhe nenit 58 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë duhet të ishte :  $d = nr. k + 1m = 8 + 1 = 9$  metra

b) Distanca e gjurmës së ndërtimit nga kufiri lindor i pronës

Më poshtë po paraqesim pamjen e godinës 6 të orientuar nga kufiri lindor i pronës.

PAMJA NGA LINDJA SH. 1 : 150



Siç mund të shihet dhe në Tabelën 1. të mësipërme, si dhe nga majtjet në programin Autocad MAP 3D të distancave të godinës 6 nga kufiri i lindor i pronës, ka rezultuar se kjo distancë ka qenë në fakt 1.5 metra. Distanca minimale sipas nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” dhe nenit 58 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë duhet të ishte :  $d = nr. k + 1m = 8 + 1 = 9$  metra..

|                       |  |
|-----------------------|--|
| <b>Kriteri</b>        | Ligjin nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, nenet 34 dhe 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar si dhe në kundërshtim me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë   |
| <b>Ndikimi/efekti</b> | Miratimi i kësaj leje me qëllim përfitimin e padrejte të zhvilluesit “L” SHPK në kundërshtim me ligjin nr.107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, nenet 34 dhe 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar nga Kryetari i Bashkisë Korçë nuk ka siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, përdorimin racional të tokës dhe të burimeve natyrore, si dhe ka privuar mundësinë e drejtë të përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me dokumentet planifikuese duke mos krijuar kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale si dhe gëzim të të drejtave të pronësisë |
| <b>Shkaku</b>         | Mos respektimi i përcaktimeve të ligjit nr.107, datë 31.07.2014 “Për   |

|                    |  |
|--------------------|--|
|                    | <i>Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit</i> ” të ndryshuar, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “ <i>Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit</i> ” të ndryshuar si dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë me qëllim përfitim të padrejtë të zhvilluesve   |
| <b>Rendesia</b>    | <b>I lartë</b>   |
| <b>Rekomandimi</b> | Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit të zhvilluar plotësojnë qartazi treguesit e distancave në 3 nivele; distancë ndërmjet ndërtesave, ndërmjet ndërtesës dhe kufirit të pronës si dhe ndërmjet ndërtesës dhe trupit të rrugës. |

*(Gjerësisht problemet mbi lejet e ndërtimit, janë trajtuar në akt-konstatimi nr. 24, datë 06.11.2020)*

Komente dhe sqarime.

Nga subjekti Bashkia Korçë janë paraqitur observimet në lidhje me lejen e zhvillimit nr. 1970/20, datë 09/03/2020 dhe lejen e ndërtimit nr.3845/20 datë 28.07.2020 ., ku thuhet se:

a) Distanca e gjurmës së ndërtimit nga kufiri verior i pronës

Pretendimi se distanca e 2 objekteve 8 kate të cilëve i është miratuar leja, është 2.2 m nga kufiri i pronës dhe kjo distancë duhet të jetë 9 m nuk qëndron. Faqet e këtyre dy objekteve, janë pa hapje drite por me mur me tullë xhami. Neni 34, pika 4 të VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar, "Distanca minimale për faqet pa dritare dhe pa çarje fasade të çdo lloji tjetër, të cilat ndodhen përballë njëra-tjetrës dhe për të cilat nuk sigurohet deklaratë e të dyja palëve për kallkan, në kushtet e mos cenimit të sigurisë së secilit objekt duhet të jetë jo më pak 2 (dy) metra, ku secila ndërtesë mbart detyrimin për respektimin e distancës jo më pak se 1 (një) metër nga kufiri i pronës".

Në këto kushte të dy objektet 8 kate kanë respektuar distancën nga kufiri i pronës, jo 1 m secili, por nga 2.2 m secili nga kufiri i pronës.

b) Distanca e gjurmës së ndërtimit nga kufiri lindor i pronës

Siç mund të shihet dhe në Tabelën 1 (sipas Akt Konstatimit), si në veri edhe në lindje, prona është e vetë pronarit, i cili do të vazhdojë ta zhvillojë më tej. Ndërkohë që në veri është respektuar distanca nga kufiri i pronës (nga 1 m në 2.2 m, pa hapje dritaresh), në lindje ajo sipërfaqe nga pronari është lënë rrugë për të gjitha objektet që janë ndërtuar dhe do të ndërtohen në vazhdim. Prandaj, distanca prej 1.5 m është lënë për dy arsye: e para se është rrugë brenda bllokut të banimi dhe e dyta se është pronë e vetë pronarit ( e lënë vetëm për rrugë), që do të thotë se nuk ju cënon të drejtën e zhvillimit të pronës, pronarëve në kufi

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Për sa i përket pikës a) Distanca e gjurmës së ndërtimit nga kufiri verior i pronës, pretendimi juaj i cili bazohet në neni 34 të VKM Nr.408, datë 13.05.2015, nën ky që saktëson se nëse do të ishim në rastin e fasadës pa **çarje të çfarëdo lloji, duhet** respektuar distanca jo më pak se 1 (një) metër nga kufiri i pronës. Por në rastin tonë jo vetëm që kemi çarje fasade të mbuluar me tulla xhami, por kemi dhe dalje të ballkoneve (godina 6 në të majtë), pra absolutisht nuk mund të konsiderohet fasade pa asnjë çarje të strukturës. Po të nisemi dhe nga preventivi i punimeve i ngarkuar në sistemin e-leje, si preventivi i godinës 5 dhe ai i godinës 6, asnjëri prej tyre në fakt nuk parashikon punimet me tulla xhami, dhe kjo është një artificë e bërë nga projektuesi me synimin pikërisht për



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë**

të arritur, sipas tij, në një fasadë pa çarje dhe të ndërtohej në një distancë 2.2 metra dhe jo 9 metra nga kufiri i pronës, siç do duhej të ishte realisht.

Për sa i përket pikës b) Distanca e gjurmës së ndërtimit nga kufiri lindor i pronës, pretendimi juaj se prona në lindje është e vet zhvilluesit dhe kjo i jep të drejtën atij të zhvilloj objektin në një distancë 1.5 metra nga kufiri i pronës është absolutisht i pa konsiderueshëm. Kjo për faktin se ligji nuk lë hapësire interpretuese apo raste përjashtuese që zhvilluesi meqenëse ka në kufirin lindor prona të tij të cilat sipas pretendimit tuaj do të zhvilloj në të ardhmen ( dhe zhvillimi do të vij nëse do miratohet një leje zhvillimore, gjithmonë nëse, pra i përket së ardhmes), ti jepet e drejta të thyej distancat nga kufiri i pronës për të cilën ka marrë një leje zhvillimore dhe për të cilën është miratuar dhe leja e ndërtimit. Meqenëse zhvilluesi e ka pronën e vet dhe pasurinë në lindje të objektit që po zhvillohet, duhet ta kishte paraqitur në lejen zhvillimore nr.1970/20, datë 09/03/2020 ku koeficienti i shfrytëzimit të përcaktohej për një sipërfaqe truallë që zhvillohet më të madhe dhe të ruhej dhe distanca e gjurmës së ndërtimit nga kufiri i pronës.

**Për arsyet e sipërcituara, observimet tuaja nuk merren parasysh nga grupi i auditimit**

*Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi*

1) Kryetari i Bashkisë Korçë z. S.F nën cilësinë e miratuesit si dhe Drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit zj. ZH.B nën cilësinë e shqyrtuesit të lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit të dhëna në kundërshtim me ligjin, si më poshtë;

a. Lejes së zhvillimit nr.1970/20, datë 09/03/2020 dhe lejen e ndërtimit nr.3845/20 datë 28.07.2020

2) R.TH nën cilësinë e hartuesit të Projektit “Godina Banimi me ambiente shërbimi – 8 kate dhe bodrum nr.5, 6” me investitor “L” SHPK me licencë me n. A0153/3

*Komente dhe sqarime.*

Nga subjekti Bashkia Korçë janë paraqitur observimet me nr.prot 260/15 dtaë 31.05.2021 në lidhje me lejet e zhvillimit nr. 2439, 2347 dhe 2348, datë 08/04/2019 dhe lejet e ndërtimit nr. 5056, 5057 datë 09/07/2019, dhe nr.10726, datë 23/12/2019 ku thuhet se: Bazuar në VKM nr. 207, datë 15.03.2017, "Për shpalljen e Qendrës Historike të Qytetit të Korçës dhe miratimin e Rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth", neni 8 pika 3, si dhe në faktin që asnjë nga objektet nuk është shpallur monument kulture që të përfaqësojë vlerat historike të zonës ku bën pjesë studimi, si dhe bazuar në faktin që studimi është inicuar bazuar në njësinë strukturore KOK?UB 110 sipas PPV Korçë të miratuar në vitin 2015 (plan i cili ishte në fuqi përpara PPV të miratuar me Vendim të KKT nr.7 datë 08.02.2017), është dhënë leja për ndërtimin e objekteve, respektivisht si më sipër cituar.

Në lidhje me dhënien e lejeve nga Bashkia Korçë, sqarojmë se këto leje janë dhënë pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit (KKR) me vendim Nr. 443, datë 13.11.2019. Bazuar në neni 12 i VKM-së nr.207. Studimi i ka kaluar të gjitha instancat kompetente, deri në miratimin përfundimtar.

*Qëndrimi i grupit të auditimit*

Duke marrë parasysh faktet e reja të prezantuara nga subjekti Bashkia Korçë, në lidhje me dhënien e lejeve të ndërtimit nr. 5056, 5057 datë 09/07/2019, dhe nr.10726, datë 23/12/2019, si dhe duke konsideruar observimet e paraqitura nga Arkitekti A.P, **nga ana e KLSH do të reflektohen këto fakte si dhe do i kërkohet subjektit Bashkia Korçë që**

**të komunikohet në nivel institucional me Këshillin Kombëtar të Restaurimeve si dhe me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Korçë, për mbikqyrjen dhe kolaudimin e ndërhyrjeve që do të zhvillohen në funksion të zbatimit të lejeve të dhënë nga Bashkia Korçë në njësinë strukturore KO/UB 121, dhe të merren masa nga organet e sipërcituara në rastet e konstatimit të devijimeve të cilat do të dëmtonin vlerat arkitektonike të trashëgimisë kulturore të qytetit Korçë.**



### **III. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT**

#### **OPINIONI I AUDITIMIT**

***Opinion mbi pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara (I modifikuar /kualifikuar).***

Objektivi i audituesve në auditimin financiar është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionimi nëse këto pasqyra janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Korçë për vitin e fundit ushtrimor 2019, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

*Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit arrijmë në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë përmbledhëse vjetore të konsoliduara të vitit 2019, të cilat justifikojnë dhënien e opinionit të kualifikuar.*

***Baza për dhënien e opinionit (I modifikuar /kualifikuar).***

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të

Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kualifikuar të auditimit.

**Në vijim:**

- Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara formati nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, D. “Fondi i konsoliduar” nuk është pasqyruar llog. 12 “Rezultatet e mbartura” në vlerën 164,242,781 lekë, po kështu dhe llog. 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” duhej të pasqyrohej për vlerën (- 34,508,474) lekë.

- Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara Formati 2 “Pasqyra e performancës financiare” rezulton se Llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” me vlerën 373,377,950 lekë nuk është e barabartë me Llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” me vlerën 129,733,547 lekë në pasqyrën Formati 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” me një diferencë në vlerën 243,644,403 lekë.

- Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara, gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28) në formatin nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” kolona 11 “Gjendja në mbyllje të ushtrimit” është në vlerën 9,448,732,403 lekë kurse vlera e pasqyruara në formatin nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kolona 8 “Kosto historike” është 9,448,066,403 lekë (Me një diferencë prej 666,000 lekë). Ky ndryshim vjen nga zëri Mjete transporti 164,138,726 – 163,472,726 = 666,000 lekë.

- Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara vlera e detyrimeve të prapambetura të regjistruara në llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, është 191,211,054 lekë ku në listat analitike sipas njësive të vartësisë me vlerat e detyrimeve të prapambetura janë edhe vlerat e detyrimeve të cilat janë brenda 30 ditëve të datës së specifikuar për likuidim (Dhjetor 2019). Mbështetur në listat analitike sipas njësive llogaria e konsoliduar 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, duhej të ishte në vlerën 136,165,039 lekë.

- Pasqyra statistikore formati nr. 6 “Investimet dhe burimet e financimit” zëri “Burimet për investime”, llogaria nr. 105 “Grante të brendshme kapitale” në vlerën 377,180,547 lekë, llog. 1050 “Grante kapitale nga buxheti” e plotësuar për shumën 7,910,000 lekë, llogaria nr. 1051 “Grante kapitale nga nivele të tjera” në vlerën 301,478,696 lekë (në total 686,569,443 lekë) në analizë nuk rakordon me vlerën 904,561,097 lekë në pasqyrën “gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)” kolona e dytë “Blerjet e krijuara me pagesë” formati 7/a.

- Llog. 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” zënë shumën 53,421,313 lekë e cila në pasiv, në analizë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra, llogari të pagueshme, të cilat trashëgohen në vitin 2020 në vlerën 53,525,014 lekë (e cila nuk rakordon në shumën 103,701 lekë). Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe duhet të përfaqësojë detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit).

- Format 5 “Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore” për pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara nuk është plotësuar relacioni shpjegues ku të jenë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen duke mbajtur parasysh dhënien e shënimeve shpjeguese të bëra nga hartuesit e pasqyrave financiare vjetore individuale, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

#### ***Përgjegjësitë e drejtuesve të njësisë vendore .***

Drejtimi i njësisë vendore, Bashkia Korçë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” me ndryshime dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

#### ***Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare***

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi material apo anomalie që mund të ekzistojë.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

#### **Opinion i auditimit mbi përputhshmërinë:**

##### **Për drejtimin e Bashkisë Korçë.**

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nën ligjore (kriteret e vlerësimit), për procedurat e prokurimit publik të zhvilluara, si dhe zbatimin e kontratave të realizuara, gjatë periudhës objekt auditimi nga 01.01.2018-30.06.2020.

Auditimi, ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin kryerjen e procedurave të prokurimit dhe zbatimin e kontratave, si dhe çdo dokument të ndodhur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE). Në auditimin e prokurimeve me fonde publike, ne u mbështetëm në analizë risku, duke vlerësuar paraprakisht funksionimin e menaxhimit financiar dhe sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi, etj.

##### **Opinion i modifikuar, i kundërt<sup>1</sup>:**

Sipas mendimit tonë, ne kemi marrë siguri të arsyeshme, për të dhënë opinion se veprimtaria e subjektit të audituar, në këtë rast “Autoriteti Kontraktor” Bashkia Korçë, në prokurimin e fondeve publike, nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit (aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative të fushës së prokurimeve), si dhe gabimet dhe shkeljet e evidentuara, janë të përhapura dhe materiale (*përsa i përket materialitetit cilësor kryesisht*).

##### **Baza për opinion e modifikuar, të kundërt:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Korçë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e përputhshmërisë, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme<sup>2</sup> për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 400 & ISSAI 4000).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar Bashkia Korçë, nga 21 procedura të audituara 15 prej tyre dhe rezultuan mangësi dhe shkelje, si rezultat i veprimeve në kundërshtim me kriteret e vlerësimit (LPP, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, Udhëzime dhe Urdhra të APP-së), është shkaktuar paligjshmëri në përdorim pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet e fondeve publike në shumën **90,773,875 lekë**; nga auditimi i zbatimit të 15 kontratave për punë publike, është evidentuar dëm ekonomik, në shumën **8,053,606 lekë**. Sa më sipër, shkeljet dhe mangësitë e evidentuara përmbajnë gabime materiale dhe të përhapura (ISSAI 400 & ISSAI 4000). Për këto arsye kemi dhënë opinion të kundërt, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

##### **Përshkrimi i çështjeve:**

- Në pesë raste paligjshmëri në përdorimin e fondeve në prokurimin publik në shumën 90,773,875 lekë;
- Në 6 raste rezultuan mosmbajtje kamat vonesa në shumën 3,029,203 lekë.
- Të ardhurat e munguara lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në shumën 102,500 lekë.

<sup>1</sup> **Opinionin i modifikuar, i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, **janë materiale, dhe të përhapura.**

<sup>2</sup> ISA 500-ISSAI 1500, ku cilësohet se: “Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë evidence auditimi të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme”

- Nga auditimi i zbatimit të 15 kontratave për punë publike, është evidentuar dëm ekonomik, në shumën **8,053,606 lekë**
- Detyrimeve për tatim taksat vendore, në shumën totale 294,161,594 lekë
- Nga moszbatimi i saktë i cmimeve të karburantit dëm ekonomik në shumën 1,935,119
- Paligjshmëri në dhënien e lejeve të ndërtimit, etj

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Korçë:**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Korçë, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Korçë janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme<sup>3</sup>, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardevë ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

*Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:*

## **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1 Gjetje nga Auditimi:** Në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, gjatë periudhës objekt auditimi, u konstatua se edhe pse këto vendime gjyqësore kanë qenë të formës së prerë, të gjitha pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga Bashkia Korçë, por janë kryer nga përmbaruesit privat duke rënduar buxhetin e shtetit për tarifatat përmbarimore me kosto shtesë në shumën prej **256,181 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (14) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

#### **1/1 Rekomandimi:**

<sup>3</sup> ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

Bashkia Korçë, në çdo rast kur Vendimet Gjyqësore kanë marrë formë të prerë, për të shmangur kostot e tepërta buxhetore që vijnë për shkak të pagesave të shpenzimet e përmbarimore, duhet ti ekzekutojë ato në mënyrë vullnetare dhe të mos presë që, ekzekutimi të bëhet nëpërmjet urdhrave të përmbaruesit gjyqësor.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

#### **2 Gjetje nga auditimi:**

**a.** Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara, gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28) në formatin nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” kolona 11 “Gjendja në mbyllje të ushtrimit” është në vlerën 9,448,732,403 lekë kurse vlera e pasqyruara në formatin nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kolona 8 “Kosto historike” është 9,448,066,403 lekë (Me një diferencë prej 666,000 lekë). Ky ndryshim vjen nga zëri Mjete transporti  $164,138,726 - 163,472,726 = 666,000$  lekë.

**b.** Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara formati 7/b “Amortizimi i aktiveve afatgjata” në fund të vitit 2019 paraqitet në vlerën 1,348,441,615 leke. Krahasuar me vitin 2018 “Amortizimi i aktiveve afatgjata” paraqitet me shtese prej 338,786,204 lekë, e cila ka ardhur si rezultat i llogaritjes së amortizimit vjetor për aktivet afatgjata materiale për të gjithë vlerën por nuk është llogaritur amortizimi i aktiveve afatgjata jo materiale “studime e kërkime” bazuar në UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36, si dhe amortizimin e akumuluar.

**c.** Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara formati nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, D. “Fondi i konsoliduar” nuk është pasqyruar llog. 12 “Rezultatet e mbartura” në vlerën 164,242,781 lekë po kështu edhe në Formatin 6 “Pasqyra e investimeve dhe burimet e financimit”, nuk është pasqyruar vlera e llog. 12 “Rezultatet e mbartura” në vlerën 164,242,781 lekë dhe llog. 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” duhej të pasqyrohej për vlerën (- 34,508,474) lekë. Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara Formatin 2 “Pasqyra e performancës financiare” rezulton se llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” me vlerën 373,377,950 lekë nuk është e barabartë me llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” me vlerën 129,733,547 lekë në pasqyrën Formatin 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” me një diferencë në vlerën 243,644,403 lekë. Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur, i paraqitur në rubrikën C të pasqyrës së performancës financiare, duhet të jetë detyrimisht i barabartë me zërin rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85), që evidentohet në rubrikën C, të aktiveve neto/fondeve neto në pasqyrën e pozicionit financiar.

Kjo llogari në pozicionin financiar dhe atë të performancës financiare nuk përfaqëson saktë, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten, për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës. Ndërsa edhe si tepricë debitore, kjo llogari nuk përfaqëson saktë rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin nuk jepen sqarime në shënimet shpjeguese. Sa më lart nuk është në përputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 57, 71.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (19-39) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

#### **2.1 Rekomandimi:**

- Nga Bashkia Korçë, Sektori i Financës të merren masat për të saktësuar gjendjen në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28 Mjete transporti) pasqyruar në formatin nr. 7/a

“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe formatin nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”.

- Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, sipas procedurës kontabile, llogaria 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” si tepriçë debitore, duhet të përfaqësojë rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënime shpjeguese.

- Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” nga viti i mëparshëm në llogarinë 12 “Rezultate të mbartura”, e cila është e përdorshme dhe funksionale për njësitë e vetëqeverisjes vendore që, në kuadrin e decentralizimit të tyre, trashëgojnë në vitet e mëpasshme grantet buxhetore dhe të ardhurat e papërdorura të vitit ushtrimor. Rezultati i mbartur duhet të vijë nga rezultati i viteve respektive dhe mbetet i papërdorur, me të drejtë të pa parashkrueshme për ta përdorur në vijim. Ky rezultat duhet të jetë i argumentuar me të ardhurat në likuiditete në llogaritë financiare e të disponibiliteteve, si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuar në periudhat përkatëse ushtrimore.

## **Menjëherë**

### **3. Gjetje nga auditimi:**

**a.** Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara vlere e detyrimeve të prapambetura të regjistruara në llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, është 191,211,054 lekë ku në listat analitike sipas njësive të vartësisë me vlerat e detyrimeve të prapambetura janë edhe vlerat e detyrimeve të cilat janë brenda 30 ditëve të datës së specifikuar për likuidim (Dhjetor 2019). Mbështetur në listat analitike sipas njësive llogaria e konsoliduar 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, duhej të ishte në vlerën 136,165,039 lekë. Sa më lart është në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimt” dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 42.

**b.** Pasqyra statistikore formati nr. 6 “Investimet dhe burimet e financimit” zëri “Burimet për investime”, llogaria nr. 105 “Grante të brendshme kapitale” në vlerën 377,180,547 lekë, llog. 1050 “Grante kapitale nga buxheti” e plotësuar për shumën 7,910,000 lekë, llogaria nr. 1051 “Grante kapitale nga nivele të tjera” në vlerën 301,478,696 lekë (në total 686,569,443 lekë) në analizë nuk rakordon me vlerën 904,561,097 lekë në pasqyrën “gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)” kolona e dytë “Blerjet e krijuara me pagesë” formati 7/a.

**c.** Llog. 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” zënë shumën 53,421,313 lekë e cila në pasiv, në analizë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra, llogari të pagueshme, të cilat trashëgohen në vitin 2020 në vlerën 53,525,014 lekë (e cila nuk rakordon në shumën 103,701 lekë) si “Detyrime ndaj personelit” (llog. 421-423) për 38,830,081 lekë, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” (llog. 431) për 1,975,245 lekë, për “Sigurime shoqërore” (llog. 435) në vlerën 11,182,369, “Sigurime shëndetësore” (llog. 436) në vlerën 1,537,319 lekë.

Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe duhet të përfaqësojë detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Sa më lart është në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin”.

**d.** Format 5 “Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore” për pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara nuk është plotësuar relacioni shpjegues ku të jenë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen duke mbajtur parasysh dhënien e shënimeve shpjeguese të bëra nga hartuesit e pasqyrave financiare vjetore individuale, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 110, 111.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (19-39) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

#### **3.1 Rekomandimi:**

- Bashkia Korçë, Sektori i Financës të marrë masat për të saktësuar vlerën e llogarisë 486, “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura”, kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara vlerën e drejtë të aktiveve afat shkurtra; njëkohësisht duke përcaktuar rregullat që forcojnë kontrollin e brendshme lidhur me rakordimin dhe raportimin e detyrimeve për faturat e papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë rigoroze mbi baza mujore e vjetore, sipas përkatësisë së vitit buxhetor kur ato krijohen dhe likuidohen.

- Drejtuesit e Bashkisë Korçë, sektori i financës në miratimin e pasqyrave financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara, duhet të pasqyrojnë rakordimet e bëra nga hartuesit e pasqyrave financiare vjetore individuale me të tretët me informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër me qëllim, rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohet se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohet nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

- Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara për vitin 2021 të Bashkisë Korçë, për llogaritë e arkëtueshme 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” dhe llogaritë e tjera aktive afatshkurtra 486, “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura”.

**Menjëherë**

#### **4. Gjetje nga auditimi:**

**a.** Në pasqyrat financiare individuale Bashkia Korçë formati nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, D. “Fondi i konsoliduar” nuk është pasqyruar llog. 12 “Rezultatet e mbartura” në vlerën 132,696,192 lekë po kështu edhe në Formatin 6 “Pasqyra e investimeve dhe burimet e financimit”, nuk është pasqyruar vlera e llog. 12 “Rezultatet e mbartura” në vlerën 132,696,192 lekë dhe llog. 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” duhej të pasqyrohej për vlerën (-31,442,819) lekë. Në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara Format 2 “Pasqyra e performancës financiare” rezulton se Llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” me vlerën 293,548,389 lekë nuk është e

barabartë me Llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” me vlerën 101,253,373 lekë në pasqyrën Format 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” me një diferencë në vlerën 192,295,026 lekë. Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur, i paraqitur në rubrikën C të pasqyrës së performancës financiare, duhet të jetë detyrimisht i barabartë me zërin rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85), që evidentohet në rubrikën C, të aktiveve neto/fondeve neto në pasqyrën e pozicionit financiar.

Kjo llogari në pozicionin financiar dhe atë të performancës financiare nuk përfaqëson saktë, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten, për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës. Ndërsa edhe si tepricë debitore, kjo llogari nuk përfaqëson saktë rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese. Sa më lart nuk është në përputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 57, 71.

**b.** Llog. 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” zënë shumën 14,470,877 lekë e cila në pasiv, në analizë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra, llogari të pagueshme, të cilat trashëgohen në vitin 2020 në vlerën 14,762,317 lekë (e cila nuk rakordon në shumën 291,500 lekë) si “Detyrime ndaj personelit” (llog. 421- 423) për 10,549,391 lekë, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” (llog. 431) për 668,834 lekë, për “Sigurime shoqërore” (llog. 435) në vlerën 3,122,406, “Sigurime shëndetësore” (llog. 436) në vlerën 421,748 lekë.

Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” në pasqyrat financiare individuale të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe duhet të përfaqësojë detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Sa më lart është në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin”.

**c.** Në pasqyrat financiare individuale Bashkia Korçë vlera e detyrimeve të prapambetura të regjistruara në llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, është 124,905,128 lekë

ku në listën me vlerat e detyrimeve të prapambetura janë edhe vlerat e detyrimeve të cilat janë brenda 30 ditëve të datës së specifikuar për likuidim (Dhjetor 2019). Mbështetur në listën e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” kjo vlerë është **90,999,528** lekë. Sa më lart është në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimt” dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 42.

**d.** Konstatohet se faturat e pa likuiduara brenda një viti buxhetor, edhe pse kanë qenë të mbuluara me vlerën e të ardhurave të trashëguara për vitin pasues buxhetor, këto fatura nuk janë likuiduar të gjitha në vitin e ardhshëm, pasi disponibilitetet në thesar në fund të vitit buxhetor, nuk janë përdorur të gjitha në funksion të likuidimit të faturave të prapambetura vjetore, por një pjesë e tyre janë përdorur për buxhetin e ri vjetor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (19-39) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**4.1 Rekomandimi:** Bashkia Korçë, Sektori i Financës të marrë masat për të saktësuar vlerën e llogarisë 486, “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

*prapambetura*”, kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara vlerën e drejtë të aktiveve afat shkurtër; njëkohësisht duke përcaktuar rregullat që forcojnë kontrollet e brendshme lidhur me rakordimin dhe raportimin e detyrimeve për faturat e papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë rigorozë mbi baza mujore e vjetore, sipas përkatësisë së vitit buxhetor kur ato krijohen dhe likuidohen.

- Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes së pasqyrave financiare, sipas procedurës kontabile, llogaria 85, “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*” si tepricë debitorë, duhet të përfaqësojë dhe pasqyrojë rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese.

- Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*” nga viti i mëparshëm në llogarinë 12 “*Rezultate të mbartura*”, e cila është e përdorshme dhe funksionale për njësitë e vetëqeverisjes vendore që, në kuadrin e decentralizimit të tyre, trashëgojnë në vitet e mëpasshme grantet buxhetore dhe të ardhurat e papërdorura të vitit ushtrimor. Rezultati i mbartur duhet të vijë nga rezultati i viteve respektive dhe mbetet i papërdorur, me të drejtë të pa parashkrueshme për ta përdorur në vijim. Ky rezultat duhet të jetë i argumentuar me të ardhurat në likuiditete në llogaritë financiare e të disponibiliteteve, si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuar në periudhat përkatëse ushtrimore.

- Bashkia Korçë, Sektori i Financës të marrë masat për të saktësuar vlerën e llogarisë 486, “*Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura*”, kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare individuale të Bashkisë Korçë vlerën e drejtë të aktiveve afat shkurtër; njëkohësisht duke përcaktuar rregullat që forcojnë kontrollet e brendshme lidhur me rakordimin dhe raportimin e detyrimeve për faturat e papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë rigorozë mbi baza mujore e vjetore, sipas përkatësisë së vitit buxhetor kur ato krijohen dhe likuidohen.

- Drejtuesit e Bashkisë Korçë, sektori i financës në miratimin e pasqyrave financiare, duhet të konfirmojnë (Rakordojnë) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër me qëllim, rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohet se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohet nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

- Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare individuale për vitin 2021 të Bashkisë Korçë, për llogaritë e arkëtueshme 4342 “*Operacione me shtetin (Të drejta)*” dhe llogaritë e tjera aktive afatshkurtra 486, “*Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura*”.

**Menjëherë**

#### **5. Gjetje nga auditimi:**

Kontratat për blerjen e karburantit nuk janë hartuar mbështetur në çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, elementet fiskale, marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Neni 31 “*Kriteret për vlerësimin e ofertës*”. Gjithashtu sipas ekstraktit të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjekteve kontraktuese “*shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*” objekti i aktivitetit të tyre është *tregti me pakicë të karburanteve transport karburanti e mallrash etj*, kur objekti i aktivitetit duhej të ishte

*“import-eksport dhe tregti me shumicë e naftës, gazit, nënprodukteve të tyre, vajrave lubrifikantë, transporti kombëtar e ndërkombëtar i tyre...” të cilën e kanë vetëm shoqëritë aksionere, sipas VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto” pika 1.*

c. Autoriteti kontraktor për llogaritjen e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletinet e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment, sipas raporteve të analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e importuar, gjithashtu janë shtuar elementë fiskalë jo në përputhje me ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat Kombëtare”, të ndryshuar, pasi është shtuar dhe taksa e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës sipas VKM nr. 498, datë 30.05.2013, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, 6.

Konstatohet se për zbatimin e kontratave me subjektet, nga autoriteti kontraktor janë ngritur komisionet për marrjen në dorëzim dhe ka procesverbale të “marrjes e materialeve në dorëzim të mallit sipas kontratës” por komisionet nuk shprehen për cilësinë dhe plotësimin e specifikimeve teknike të shoqëruara me raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial duke vepruar në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42, pika 54.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (39 - 59) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

### **5.1 Rekomandimi:**

- Urdhër shpenzimet për vlerat e likuiduara nga autoriteti kontraktor për karburante, të shoqërohen me faturat tatimore, raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar për të vërtetuar cilësinë dhe standardet e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri dhe kushteve të kontratës.

- Autoriteti kontraktor, në llogaritjen e çmimit të karburanteve, duhet të mbështetet në buletinet e APP, me çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës, sipas kushtit CIF-Shqipëri, raporteve të analizave sipas datës respektive të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar, referuar elementëve fiskalë të përcaktuara me ligj.

*Menjëherë*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se në Bashkinë Korçë janë shpallur fitues së procedurës së prokurimit dhe janë përfutur kontrata nga një subjekti të vetëm, në të njëjtën periudhë kohore në vende të ndryshme të zbatimit, kjo në 9 raste me fond limit 215,085,079 lekë për sa më poshtë vijon:

- OE “G” shpk, ka kontraktuar 2 kontrata të lidhura më datë 31.05.2019;
- OE “N” shpk, ka kontraktuar tre kontrata 2 më datë 29.07.19 dhe datë 27.09.19;
- OE A.K 2002 shpk, ka kontraktuar 4 kontrata me datat 18.06.2019, 12.06.2019, 20.05.2019 dhe 16.07.2019.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit sipas procedurave të prokurimit rezulton se këta OE kanë paraqitur për procedura të ndryshme të shpallura dhe të lidhura kontrata për punë publike në të njëjtën kohë, në dy ose më shumë kontrata për objekte të ndryshëm për punë civile për të cilat kanë paraqitur të njëjtin numër punonjësish, të njëjtin staf teknik, të njëjtat makineri si dhe të njëjtin drejtues teknik (në kushtet kur vepra është mbi 30 milion lekë) si dhe njëkohësisht kanë deklaruar kontrata në proces të lidhura me autoritete të tjera kontraktore duke mos përmbushur kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit për procedurën pasardhëse. Këto veprime janë në kundërshtim me





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 47, “S’kualifikimi i ofertuesve”, neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 1, neni 58, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 1, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 69, “Njoftimi i fituesit”, neni 70 “Lidhja e kontratës”,  
(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (60-65) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**6.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa për shpalljen e fituesit, duke pasur në konsideratë rrethanant e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me qëllim që OE/kontraktori të plotësojë kriteret për realizimin e objektit të prokurimit pasardhës.

*Menjëherë*

**7 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik, rezultoi se në 6 raste, me vlerë të kontratave 105,938,192 lekë, sa vijon:

- “Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi lagjet 5 dhe 13” me datë kontrate 27.02.2019, me vlerë 26,311,191 lekë me tvsh dhe kontraktor "S" shpk & "A" shpk;
- “Rikonstruksion i veprave ujitëse”, me datë kontrate 20.05.2019, me vlerë 3,117,240 lekë me tvsh dhe kontraktor A.K 2002 shpk;
- “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale “Rikonstruksion rruge fshati Barç”, me datë kontrate 27.05.2019, me vlerë 11,689,253 lekë me tvsh dhe kontraktor “V” shpk;
- “Rikonstruksion i pjesshëm i Degës Ventrok”, me datë kontrate 29.07.2019, me vlerë 22,918,633 lekë me tvsh dhe kontraktor "N" shpk
- “Skemat ujitëse”, me datë kontrate 18.06.2019, me vlerë 11,776,426 lekë me tvsh dhe kontraktor "A.K 2002" & "A.A" shpk
- “Rikonstruksion i Shkollës 9 vjeçare “Nuci Naçi”– 3 kate shtesë për palestër”, me datë kontrate 29.07.2019, me vlerë 30,125,449 lekë me tvsh dhe kontraktor " N " shpk,

Gjatë zbatimit të kontratës për punë publike nuk është mbikëqyrur veprimtaria e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit, për t`u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është lidhur kontrata, duke shkelur kushtet e kontratës, të cilat duhet të ishin sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Kjo e vërtetuar sipas ditarit të objektit, për stafin teknik, makineritë dhe fuqinë punëtore të cilat duhen sipas kërkesave të veçanta për kualifikim (teknike) të procedurës për realizimin e objektit të prokurimit. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, ndryshuar, neni 60, “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu IX, “Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, Neni 77, “Mbikëqyrja e kontratës”, pikat 1, 2, 3 dhe 4, ligjin nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 7, UKM, nr.3, datë 15.2.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pjesa I, “Mbi mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit” si dhe me “Rregulloren për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë së Korçës”, pika 37. Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës, nën-pika 37.1 “Detyra të përgjithshme”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (60 -126) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**7.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që gjatë zbatimit të kontratës së punëve publike të mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi për tu siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, duke monitoruar zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara të zbatojë penaltitetet e parashikuara në kontratë.

*Menjëherë*

## **8. Gjetje nga auditimi:**

- a.** Nga auditimi i dosjeve të procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi, marrë nga sektori i Njësisë së Prokurimeve Bashkia Korçë, konstatohet se 16 objekte të prokuruar me fond limit 241,901,203 lekë, **pa miratimin për leje zhvillimi (ndërtimi) ose pa deklaratë të fillimit të punimeve të ndërtimit, të miratuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit** dhe Kryetari i Bashkisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 13, 22, 29, 38, 39 pika 1, 41 pika 1, 2, 3, neni 43, 51 dhe neni 52 dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit. Mos referimi në dispozitat ligjore të sipërcituara ka bërë që të mos gjej zbatim duke mos u aplikuar neni 52 “Kundërvajtjet administrative”, pika “e”.
- b.** Në asnjë rast nuk ka Urdhër të Kryetarit të Bashkisë drejtuar Drejtorisë së planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit (e cila është marrë me projektimet dhe preventivat duke i hartuar vetë) **për hartimin e detyrës së projektimit dhe miratimin e saj.** Nga auditimi në bilanc i llogarisë 202 “Studime dhe projekte”, vihet re se studimi dhe projektimi”, për sa trajtuar më sipër, janë në vlerën zero lekë.
- c.** Nga auditimi rezultoi se nuk ka urdhër nga Titullari i Njësisë Vendore, **për ngritjen e grupit të punës me specialistë të fushave** sipas zërave të punimeve parashikuar në preventivin e punimeve për kontrollin dhe marrjen në dorëzim të projekt preventivave të punimeve,”. Mos nxjerrja e urdhrave është në kundërshtim me pikën 35.a, 36 dhe 42 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,
- d.** Nga auditimi rezulton se projektet nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Grupi i projektimit duhet jetë i përberë minimumi nga: inxhinieri gjeodet për plan rilevimin dhe azhurnimin topografik, projektuesi arkitekt, projektuesi konstruktor, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi i instalimeve hidro sanitare, projektuesi i instalimeve ngrohje ftohje ventilim, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri, inxhinieri sizmolog, inxhinieri gjeolog, eksperti mjedisor
- e.** Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashki, bazuar në Rregulloren Brendshme neni 36, pikat 36.1 “Misioni”, 36.2 “Objektivat e drejtorisë”, 36.3 “Detyra të përgjithshme”, 36.4 “Drejtori i drejtorisë”, 36.5 “Sektori për Planifikimin e Territorit dhe Projektimin – Përgjegjësi”, ka të përcaktuara detyrat bazuar në nenin 14 “**Kontributet profesionale në planifikim**”, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ndërsa në pikën 36.6 “Detyrat dhe Përgjegjësitë”, në kundërshtim me misionin e kësaj drejtorie bazuar në ligjin nr. 107/2014, janë përcaktuar: “Organizon punën **për realizimin e projekt-ideve të kërkuara dhe projekteve të zbatimit** në kohën e duhur me cilësinë e kërkuar dhe duke plotësuar dokumentacionin e nevojshëm teknik dhe ekonomik”. **Në një kohë që kjo Drejtori nuk është e licencuar për hartimin e projekteve të zbatimit.**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 5, VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, e cila ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, neni 16 “Licenca – kategoritë e punimeve”, pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (62 -100) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

#### **8.1 Rekomandimi:**

- Bashkia Korçë për të gjitha punimet, për të cilat është detyrim paisja me leje ndërtimi (zhvillimi) të aplikojë për leje para se të nisë procedurën e prokurimit të punimeve.

- Autoriteti Kontraktor të marrë masa për hartimin e detyrës së projektimit dhe miratimin e saj si dhe për kontrollin dhe marrjen në dorëzim të projekt preventivave të punimeve.

- Bashkia Korçë të marrë masa për të operuar vetëm me projekte të zbatimit të hartuara nga projektues, të pajisur me licencat përkatëse.

*Menjëherë*

**9 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit në Bashkinë Korçë, rezulton se në njësinë e prokurimit është anëtare M.Bme profesion Ing. Agroushqimore, profesioni i të cilës nuk ka lidhje me objektet e prokurimit ku ka marrë pjesë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 57, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 1, duke moskrijuar kushtet për menaxhimin e saktë të procedurës së prokurimit sipas specifikave përkatëse.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (62 -65) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**9.1 Rekomandimi:** Bashkia Korçë të marrë masa që në NJHDT të vendosë punonjës në varësi të specifikës së objektit të prokurimit.

*Menjëherë*

**10 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave të lidhura në Bashkinë Korçë rezultoi se në të gjitha kontratat e lidhura, neni i kushteve të përgjithshme të kontratës (KPK), “Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve”, është vendosur sa vijon:

“Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:

- Muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës. Si dhe është shtuar: pika 27.2. “Investitori do të zbrisë dëmshpërblimin për vonesat nga pagesa e fundit e Sipërmarrësit”, e cila nuk është pjesë e KPK për kontratat për punë publike pjesë e DST të miratuara.

Ky përcaktim është në kundërshtim me KPK, të DST, të miratuara, Neni 34, “Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve”, pika 34.1, me efekt në

përllogaritjen jo të saktë të kamat vonesave në rastet e shtyrjes së afatit të punimeve mbi 6 muaj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2,3) faqe 62 -156) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**10.1 Rekomandimi:** AK të marrë masa për hartimin e kushteve të kontratës sipas standarteve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të LPP.

*Menjëherë*

**11 Gjetje nga auditimi:** Në 7 procedura prokurimi me fond limit lekë, një pjesë e kritereve të veçanta të DST që lidhen me kapacitetin teknik, nuk janë të lidhura me aftësinë zbatuese dhe llojit të punimeve apo shërbimeve, vlerën dhe natyrën e kontratës, të shërbimeve dhe blerjes së mallrave, veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", dhe ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 6.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (62 -156) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**11.1 Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kritereve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter me procesverbal, i cili të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**12 Gjetje nga auditimi:** Në 2 (dy) raste nga auditimi i zbatimit të procedurës për leje zhvillimi nr. 1918, datë 20/04/2018 dhe leje ndërtimi nr. 4427 datë 14/08/2018 për objektin "Banesë individuale (3 kate + podrum) në adresën Lagje 1, Rr. "Dhori Lako" Bashkia Korçë" dhe të lejes së zhvillimit nr. 84, datë 16.01.2019 dhe lejes së ndërtimit nr. 710, datë 12.03.2019 për "Banesë individuale (3 Kate me Podrum) Bashkia Korçë, u konstatua se janë miratuar këto leje pa plotësuar kushtin e ruajtjes së distancës midis objekteve, kufirit të pronës dhe distancën nga trupi i rrugës. Ky veprim është bërë në kundërshtim me nenet 34, 35 dhe 36 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar si dhe në kundërshtim me nenin 58 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 4 faqe 156 -169 të Raportit të Auditimit).

**12.1 Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit në zhvilluar plotësojnë qartazi treguesit e distancave ndërmjet objektit të ri dhe ekzistues, kufirit të pronës dhe trupit të rrugës.

*Në vazhdimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të procedurës për leje ndërtimi u konstatua se leja e zhvillimit nr. 1970/20, datë 09/03/2020 dhe leja e ndërtimit nr. 3845/20 datë 28.07.2020 për objektin "Godinë banimi me ambiente shërbimi me bodrum 8 kate për Godinën 5 dhe 6", në adresën 8561, Rr. "Midhi Kostani", Korçë, paraqitur nga zhvilluesi shoqëria "L" SHPK, është miratuar pa plotësuar kushtin e ruajtjes së distancës midis objekteve nga kufiri verior dhe lindor i pronës. Ky veprim është bërë në



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

kundërshtim me nenet 34, 35 dhe 36 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar si dhe në kundërshtim me nenin 58 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (171) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit).

**13.1 Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit të zhvilluar plotësojnë qartazi treguesit e distancave në 3 nivele; distancë ndërmjet ndërtesave, ndërmjet ndërtesës dhe kufirit të pronës si dhe ndërmjet ndërtesës dhe trupit të rrugë..

*Në vazhdimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.07.2017 – 30.06.2020, u konstatua se nga **21** procedura prokurimi të vlerësuara për auditim me vlerë kontrate **411,515,478** lekë, janë konstatuar me shkelje të aktive ligjore/nënligjore të LPP në **5** procedura me vlerë kontrate 90,773,875 lekë ose 22% e vlerës së kontratave të audituar, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (60-127) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**14.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Korçë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të miratuara në DST, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/ mallit dhe shërbimit dhe pasi të analizojë procedurat me shkelje, të marrë masa ndaje personave përgjegjës shkaktar të kësaj situate dhe eliminimin e tyre në të ardhmen.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Korçë), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi zbatues të ndiqet procesi me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **13,017,928** lekë si më poshtë:

**1. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratave të blerjes së karburantit rezultoi se në likuidimin e sasisë së karburantit gazoil dhe benzol nga Bashkia Korçë, nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën e furniturës *lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment*, gjithashtu si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit, si rrjedhojë janë kryer pagesa të tepërta për gazoilin dhe benzolin e likuiduar në vlerën **1,935,119** lekë me tvsh e cila duhet të arkëtohet nga subjektet “J.D” sh.p.k.. në vlerën 269,746 lekë, “A.C” sh.p.k. në vlerën 364,715 lekë, “A&T” sh.a.. në vlerën 14,717 lekë, “O.” sh.p.k. në vlerën 936,219 lekë, “M.O”sh.p.k. në vlerën 349,722 lekë me t.v.sh. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 77, pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (55) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**1.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, sektori i financës të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **1,935,119** lekë me tvsh e cila duhet të arkëtohet nga subjektet “J.D” sh.p.k.. në vlerën 269,746 lekë, “A.C” sh.p.k. në vlerën 364,715 lekë, “A&T” sh.a.. në vlerën 14,717 lekë, “O.” sh.p.k. në vlerën 936,219 lekë, “M.O”sh.p.k. në vlerën 349,722 lekë me t.v.sh. përfituar padrejtësisht si rezultat i mos respektimit të çmimit të miratuar sipas kontratave për furniturat bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datat përkatëse të furniturave, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.

## *Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e kryerjes së shpenzimeve, me objekt investimet kapitale të vitit 2019 rezultoi se, në përgjithësi faturat tatimore bashkëlidhur urdhër shpenzimeve, kanë datë lëshimi të mëvonshme nga data e situacionit përfundimtar, duke u paraqitura fatura tatimore tej afateve kontraktuale duke shkaktuar dëm ekonomik në shumën 3,029,203 lekë Paraqitja e faturave tatimore, në data të mëvonshme nga datat e situacioneve të punimeve, është në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, Udhëzim i MF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neni i kushteve të përgjithshme të kontratës “Dëmet e likuidueshme për vonesat në mbarimin e punimeve”, pjesë e DST në 6 raste.

Nga auditimi i transaksioneve lidhur me shpenzimet e investimeve për periudhën objekt auditimi, janë evidentuar raste, me dokumentacion të pa plotë, pasi janë paraqitur nga investitorët dhe janë pranuar nga AK situacione pa data, në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar neni 7, 12, dhe 18 si dhe UKM nr. 1, datë 16.06.2011, “Për disa ndryshime në UKM nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar”.

Pranimi i dokumentacionit vërtetues i parregullt është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, me neni 6 të udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 35 dhe 36, është përgjegjësi e nepunësit zbatues.

Nga auditimi i likuidimit të kontratave rezultoi se nuk ka gjetur zbatim neni i kushteve të përgjithshme të kontratës “Dëmet e likuidueshme për vonesat në mbarimin e punimeve”,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

duke u paraqitura fatura tatimore tej afateve kontraktuale duke shkaktuar dëm ekonomik në shumën 3,029,203 lekë, për rastet sa më poshtë vijon:

- Kontrata nr. 900/2 prot., datë 27.02.2019, me objekt “Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi lagjet 5 dhe 13”, me vlerë 26,311,191 lekë, kontraktuar me "S" shpk & "A" shpk, **në shumën 26,312 lekë;**

- Kontrata nr. 3961/2 prot., datë 20.05.2019, me objekt “Rikonstruksion i veprave ujitëse”, me vlerë 3,117,240 lekë, kontraktuar me A.K 2002 shpk, **në shumën 389,655 lekë;**

- Kontrata nr. 3961/2 prot., datë 20.05.2019, me objekt “Rikonstruksion në bllokun in formal rruga “QANI QYTEZA”, me vlerë 4,440,218 lekë, kontraktuar me A.K 2002shpk, **në shumën 297,465 lekë;**

- Kontrata nr. 4333/2 prot., datë 27.05.2019, me objekt “Rikonstruksion rruge fshati Barç”, me vlerë 11,689,253 lekë, kontraktuar me "V" shpk, **në shumën 350,677 lekë;**

- Kontrata nr. 4701/2 prot., datë 12.06.2019, me objekt “Rehabilitimi urban i rrugëve të lagjeve të qytetit”, me vlerë 21,872,503 lekë, kontraktuar me "A.K 2002" shpk & "A.A" shpk, në shumën **1,246,732 lekë;**

- Kontrata nr. 4841/2 prot., datë 18.06.2019, me objekt “Skemat ujitëse”, me vlerë 11,776,426 lekë, kontraktuar me "A.K 2002" shpk, në shumën **718,362 lekë.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (62 - 156) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik **në shumën 3,029,203 lekë**, si pasojë e mos mbajtjes së kamatëvonesave.

Nga Bashkia Korçë, të merren masa që likuidimi i shpenzimeve të kryhet bazuar në dokumentacion të plotë, autorizues dhe vërtetues të shpenzimit kapital.

*Menjëherë*

**3 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Sistemim, asfaltim në rrugët e NJA (fshatrat Bulgarec, Porodine, Biranj, Goskova Poshte dhe Moravë” Bashkia Korçë, me vlerë 41,002,676.82 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Kontraktorëve “A.K” SHPK & “J” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe konkretisht, shtresë çakëll 15 cm makadam (rruga), nënshtresë zhavorri, F.V. Tub të brinjëzuar HDPE SN8 D=315mm, shtresë çakëll 10 cm, përhapur e ngjeshur me makineri, etj., në vlerën **806,429 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 5163 Prot, datë 04.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Bashkimit të Përkoshëm kontraktorëve “A.K” SHPK & “J” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (129) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**3.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **806,429 lekë pa TVSH** nga Bashkimi i Kontraktorëve “A.K” SHPK & “J” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5163 prot, datë 04.09.2018 me objekt “Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi Lagjet 5 dhe 13”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

*Menjëherë*

**4 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi Lagjet 5 dhe 13” Bashkia Korçë, me vlerë 34,168,897.35 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Kontraktorëve të përkohshëm “S” SHPK & “A” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe konkretisht, transport dhera auto 5 km, punime për trotuarin, punime për shtresat asfaltike dhe nënshtresat, punime kanalizimi, etj., në vlerën **1,078,892 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 900/2 Prot, datë 27.02.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Bashkimit të Kontraktorëve “S” SHPK & “A” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (132) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**4.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës **1,078,892** lekë pa TVSH nga Bashkimi i Kontraktorëve të Përkohshëm “S” SHPK & “A” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 900/2 prot, datë 27.02.2019 me objekt “Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi Lagjet 5 dhe 13”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

*Menjëherë*

**5 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitimi urban i rrugëve në lagjet e qytetit” Bashkia Korçë, me vlerë 21,872,305 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Kontraktorëve të Përkohshëm A.K 2002 SHPK & “A.A” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt në rikonstruksionin e rrugëve: “Parashqevi Qirjazi” (Ish SMT), “P.R”, “Nexhio Ninçani”, “Ark Mehmet Musaj, Veli Korça, dhe Kristo Floqi” në vlerën **918,454 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4701/2 prot datë 12/06/2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Bashkimit të Kontraktorëve A.K 2002 SHPK & “A.A” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (134) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**5.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **918,454** lekë pa TVSH nga Bashkimi i Kontraktorëve A.K 2002 SHPK & “A.A” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 4701/2 Prot datë 12/06/2019 me objekt “Rehabilitimi urban i rrugëve në lagjet e qytetit”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

*Menjëherë*

**6 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale (Rikonstruksion rruge fshati Barç)” Bashkia Korçë, me vlerë 11,689,253 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori “V” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe konkretisht: Beton për themel bordure, dhe Pusëtë shkarkimi b/a, 1x1x1.5 m, me kapak gize, Puseta elektrike 40x40x40 cm, Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak elektrik çdo 30 cm, në vlerën **107,289 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4266/2 prot datë 27.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “V” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (136) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**6.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **107,289** lekë pa TVSH nga Kontraktori “V” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4266/2 prot datë 27.05.2019 me objekt “Rikonstruksion i rrugëve rurale





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

dhe informale (Rikonstruksion rruge fshati Barç)”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

*Menjëherë*

**7 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri” + shtesë për palestër Korçë” Bashkia Korçë, me vlerë 26,233,024 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori “I” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe realizim i disa zërave jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën **1,184,877 lekë pa TVSH**, respektivisht:

- Shuma **598,583** lekë pa TVSH përfaqëson punime të pa realizuara në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik.
- Shuma **586,294** lekë pa TVSH përfaqëson punime të realizuara me cilësi të dobët dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, projektin e zbatimit dhe kushtet e kontratës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4975/5 prot, datë 04.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “I” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (138) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**7.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të merren masa për:

- Arkëtimin e vlerës prej **598,583** lekë pa TVSH nga Kontraktori “I” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 4975/5 Prot datë 04.09.2018 me objekt “Rikonstruksioni shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri” + shtesë për palestër Korçë”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.
- T’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Kontraktorit “I” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **586,294** lekë pa TVSH, për punime të realizuara me cilësi të dobët dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, projektin e zbatimit dhe kushtet e kontratës, të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë me datë 19.03.2021 për të garantuar cilësinë e materialeve dhe funksionalitetin e shkollës. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Korçë, Mbikëqyrësi i punimeve, Kolaudatori i punimeve të objektit si dhe grupi i marrjes në dorëzim, brenda periudhës së garancisë (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të kthehet nga sipërmarrësi i punimeve).

*Menjëherë*

**8 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rindërtim i shkollës 9-vjeçare Voskopojë” Bashkia Korçë, me vlerë 32,250,952 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori “N” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe realizim i disa zëra punime jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën **761,497 lekë pa TVSH, nga e cila:**

- Shuma **426,605** lekë pa TVSH përfaqëson punime të pa realizuara në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik.
- Shuma **334,892** lekë pa TVSH përfaqëson punime të realizuara me cilësi të dobët dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, projektin e zbatimit dhe kushtet e kontratës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 9586/25 prot datë 31.12.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “N” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (141) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**8.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të merren masa për:

- Arkëtimin e vlerës prej **426,605** lekë pa TVSH nga Kontraktori “N” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 9586/2 prot datë 31.12.2018 me objekt “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Voskopojë”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

- T’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Kontraktorit “N” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **334,892** lekë pa TVSH, për punime të realizuara me cilësi të dobët dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, projektin e zbatimit dhe kushtet e kontratës, të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë me datë 10.12.2021 për të garantuar silësinë e materialeve dhe funksionalitetin e shkollës. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Korçë, Mbikëqyrësi i punimeve, Kolaudatori i punimeve të objektit si dhe grupi i marrjes në dorëzim, brenda periudhës së garancisë (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të kthehet nga sipërmarrësi i punimeve).

*Menjëherë*

**9 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitimi i rrjetit të kanaleve ujitëse” Bashkia Korçë, me vlerë 5,048,470 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori A.K 2002 SHPK, rezultuan në objekt diferencë në volum pune të zërit të punimeve “Hidroizolim me dy duar bitum” në vlerën **21,250 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3632/2 prot datë 16.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “A.K 2002” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (143) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**9.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **21,250** lekë pa TVSH nga Kontraktori A.K 2002 SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3632/2 prot datë 16.05.2019 me objekt “Rehabilitimi i rrjetit të kanaleve ujitëse”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

*Menjëherë*

**10 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Nuçi Naçi”, Bashkia Korçë, me vlerë 30,125,449 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori “N” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe realizim i disa zërave jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën **517,606 lekë pa TVSH**, nga e cila:

- Shuma **445,716** lekë pa TVSH përfaqëson punime të pa realizuara në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik.

- Shuma **71,890** lekë pa TVSH përfaqëson punime të realizuara me cilësi të dobët dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, projektin e zbatimit dhe kushtet e kontratës.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6026/3 prot, datë 29.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “N” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (145) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**10.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të merren masa për:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

- Arkëtimin e vlerës prej **445,716** lekë pa TVSH nga Kontraktori “N” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 4975/5 Prot datë 04.09.2018 me objekt “**Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Nuçi Naçi”**, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

- T’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Kontraktorit “N” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **71,890** lekë pa TVSH, për punime të realizuara me cilësi të dobët dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, projektin e zbatimit dhe kushtet e kontratës, të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë me datë 05.06.2022 për të garantuar cilësinë e materialeve dhe funksionalitetin e shkollës. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Korçë, Mbikëqyrësi i punimeve, Kolaudatori i punimeve të objektit si dhe grupi i marrjes në dorëzim, brenda periudhës së garancisë (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të kthehet nga sipërmarrësi i punimeve).

*Menjëherë*

**11 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm i degës Ventrok”, Bashkia Korçë, me vlerë 22,918,633.41 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori “N” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, në vlerën **95,500 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6149/2 prot, datë 29.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “N” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (147) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**11.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **95,500** lekë pa TVSH nga Kontraktori “N” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 6149/2 Prot datë 29.07.2019 me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm i degës Ventrok”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

*Menjëherë*

**12 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “**Skemat ujitëse**”, Bashkia Korçë, me vlerë 11,776,426 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Kontraktorëve të përkohshëm A.K 2002 SHPK & “A.A” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, në vlerën **297,556 lekë pa TVSH, për** punime të pa realizuara në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4841/2 prot, datë 18.06.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Bashkimit të Kontraktori të përkohshëm A.K 2002 SHPK & “A.A” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (149) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**12.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **297,556** lekë pa TVSH nga Bashkimit të Kontraktori të përkohshëm A.K 2002 SHPK & “A.A” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 4841/2 Prot datë 18.06.2019 me objekt “Skemat ujitëse”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

## *Menjëherë*

**13 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion rrugësh në njësitë administrative (Faza I)”, Bashkia Korçë, me vlerë 30,560,515 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori “G” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe disa zëra punime janë realizuar jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën **634,555 lekë pa TVSH**, nga e cila:

- Shuma **508,555** lekë pa TVSH përfaqëson punime të pa realizuara në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik.
- Shuma **126,000** lekë pa TVSH përfaqëson realizim zërash jo në përputhje me specifikimet teknike, dhe konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4333/2 prot, datë 31.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktorit “G” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (151) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**13.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të merren masa për:

- Arkëtimin e vlerës prej **508,555** lekë pa TVSH nga Kontraktori “G” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 4333/2 Prot datë 31.05.2019 me objekt “Rikonstruksion rrugësh në njësinë administrative (Faza I)”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.
- T’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Kontraktorit “G” SHPK, realizimin e zërave të punimeve sipas specifikimeve teknik në vlerën **126,000** lekë pa TVSH, brenda periudhës së garancisë me datë 04.10.2021 (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të kthehet nga sipërmarrësi i punimeve).

## *Menjëherë*

**14 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim, asfaltim në rrugët e qytetit (lagjet nr. 4, 5, 6, 8, 13 dhe 18)”, Bashkia Korçë, me vlerë 46,009,674 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Kontraktorëve të përkohshëm “S” & “J” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, në vlerën **939,368 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson punime të pa realizuara në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5133/6 prot, datë 04.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Bashkimit të Kontraktorëve të përkohshëm “S” & “J” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (155) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**14.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **939,368** lekë pa TVSH nga Bashkimi i Kontraktorëve të përkohshëm “S” & “J” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 5133/6 Prot datë 04.09.2018 me objekt “Sistemim, asfaltim në rrugët e qytetit (lagjet nr. 4, 5, 6, 8, 13 dhe 18)”, Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

## *Menjëherë*

**15 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale ”Rikonstruksion në bllokun



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

*informal Rr. QANI QYTEZA*", Bashkia Korçë, me vlerë 4,440,218 lekë me TVSH, fituar nga kontraktori A.K 2002 SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, në vlerën **513,128 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson punime të pa realizuara në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5894/2 prot, datë 16.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe kontraktori A.K 2002 SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (158) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**15.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **513,128** lekë pa TVSH nga kontraktori A.K 2002 SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 5894/2 Prot, datë 16.07.2019 me objekt "*Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale "Rikonstruksion në bllokun informal Rr. QANI QYTEZA"*", Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

*Menjëherë*

**16 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Për projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara, Bashkia Korçë", me vlerë 8,817,730 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori "N" SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe disa zëra punime të pa realizuar fare, në vlerën **177,205 lekë pa TVSH**, me pasojë dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Korçë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 8330/2 prot, datë 27.09.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe Kontraktori "N" SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (162) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit)

**16.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të merren masa për:

- Arkëtimin e vlerës prej **169,228** lekë pa TVSH nga Kontraktori "N" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 8330/2 Prot datë 27.09.2019 me objekt "Për projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara, Bashkia Korçë", Bashkia Korçë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

- T'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Kontraktori "N" SHPK, realizimin e zërave të punimeve sipas specifikimeve teknik në vlerën **7,977** lekë pa TVSH, brenda periudhës së garancisë me datë 04.10.2021 (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të kthehet nga sipërmarrësi i punimeve).

*Menjëherë*

## **B.1 MASAT E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE ME EFEKTE NË TË ARDHURAT E MUNGUARA NË BASHKINË KORÇË.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga ana e Bashkisë Korçë nuk janë marrë masa për realizimin e të ardhurave nga arkëtimi i tarifave vendore të subjekteve të ndërtimit që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në prokurimet e fondeve publike nga Bashkia Korçë. Nga auditimi i dokumentacionit ku u kryqëzuan të dhënat e marra nga Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave në lidhje me subjektet që kishin lidhur kontratë publike me bashkinë, dhe të dhënave të marra nga Drejtorinë e Taksave për pagimin e tarifave në lidhje me pagesën e tarifave përkatëse të këtyre subjekteve, u konstatuan dy fenomene;

1- Operatorë ekonomike të cilët e kishin mbyllur NIPTI<sup>n</sup> sekondar përpara mbarimit të kontratës duke mos ju llogaritur në këtë mënyrë edhe tarifa e pastrim, gjelbërim dhe ndriçimit për kantierin e ndërtimit. Pasi u llogarit pjesa e kontratës e cila vazhdonte edhe pas mbylljes së NIPTI<sup>n</sup> sekondar, rezultoi vlera e papaguar prej **52,500 lekësh**.

2- Operatorë ekonomike të cilët kanë lidhur kontrata gjatë vitit 2020 dhe nuk kanë hapur NIPT sekondar, duke mos ju llogaritur në këtë mënyrë edhe tarifa e pastrim, gjelbërim dhe ndriçimit për kantierin e ndërtimit. Pasi u llogarit pjesa e kontratës e cila është ekzekutuar pa NIPT sekondar, rezultoi vlera e papaguar prej **50,000 lekësh**. *Këto veprime janë bërë në kundërshtim me* ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe 14-16) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Korçë të marrë masa për arkëtimin e shumës prej **102,500 lekë** si rezultat i mos aplikimit të tarifave vendore për pastrim, gjelbërim dhe ndriçim për 4 subjektet që kanë kryer investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Korçë.

*Menjëherë*

## **B.2. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 30.06.2020 vlera e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore për subjektet e biznesit dhe familjarët në shkallë bashkie, për Bashkinë Korçë janë në vlerën **294,161,594 lekë** analizuar si më poshtë;

-Biznesi i madh dhe i vogël janë në vlerën **183,615,110 lekë** ose përbëjnë 62% të vlerës totale të borxhit

- Taksat dhe tarifave e familjes janë në vlerën **110,546,484 lekë** ose përbëjnë 38% të vlerës totale të borxhit. Sektori i Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Korçë, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, ka zbatuar vetëm procedurën e bllokimit të llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe nuk ka vazhduar me procedurat e tjera. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara”, të neneve 89 dhe 93.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe 14-16) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Taksave të Bashkisë Korçë, të merren masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/ juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për **3962** subjekte biznesi i madh dhe i vogël për vlerën **183,615,110 lekë** dhe **31,677** familje për vlerën gjithsej **110,546,484 lekë**, bazuar në neni 70, pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor” ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

- T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime në llogarit bankare.
- T'i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit kërkesa për vendosje barrë sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

- Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori Taksa e Tarifa, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite Sektori Taksa e Tarifa dhe Sektori Juridik të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

*Menjëherë*

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në Bashkinë Korçë për vitet 2018, 2019 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2020, për vjeljen dhe grumbullimin e taksës së ndikimit në infrastrukture bazuar ne ligjin nr .9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 23 dhe sipas pikës 2, të nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar dhe VKM nr.860, datë 10.12.2014, janë pajisur me leje legalizimi nga zyra e ALUIZN-it dhe janë debitorë të mbetur familjarë dhe subjekte në vlerën **21,717,084** lekë. Nga ana e këtij institucioni nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-it (ASHK). Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2016, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës se mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim"

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe 14-18) të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Korçë, bazuar në nenin 70, pika 3, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, të marrë masat për arkëtimin e tarifës për TNI, nga subjektet në proces legalizimi, duke bërë njoftim vlerësimet tatimore për subjektet sipas aneksit nr. **2.1 (1.4 dhe 1.5** bashkëlidhur projekt raportit), në vlerën totale të pa arkëtuar prej **21,717,084** lekë, e ardhur e munguar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore të legalizuara.

*Menjëherë*

## E. MASA ADMINISTRATIVE

### I. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Qendror (IMTQ)

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe UKM nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, **i rekomandojmë** Titullarit të Bashkisë Korçë, t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Qendror, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative "Dënimin me gjobë", në vlerën 50,000 lekë për mbikëqyrësit**, si më poshtë:

**1. Z. S.K,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në kontratat:

- Kontratës nr. 5454/3 prot., datë 04.09.2018, lidhur ndërmjet Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Z. S.F dhe kontraktorit “D.P” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2837/5 me Administratori Z. S.K, për shkeljet e konstatuara si vijon:

Vlera **806,429** lekë pa TVSH ose **967,714 lekë me TVSH**, përbën dëm ekonomik si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në zbatimin e kontratës me nr. 5196/3 prot, datë 04.09.2018 me objekt “Sistemim, asfaltim në rrugët e NJA (fshatrat Bulgarec, Porodine, Biranj, Goskova Poshte dhe Moravë)”, me sipërmarrës punimesh BOE “A.K” shpk & “J” shpk” SHPK.

- Kontratës nr. 5177/1 prot., datë 04.09.2018, lidhur ndërmjet Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Z. S.F dhe kontraktorit “D.P” SHPK, regjistruar me NIPT. L.....M dhe me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2837/5 me Administratori Z. S.K, për shkeljet e konstatuara si vijon:

Vlera **1,184,877** lekë pa TVSH ose **1,421,852 lekë me TVSH**, përbën dëm ekonomik si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në zbatimin e kontratës me nr. 4975/5 prot, datë 04.09.2018 me objekt “Rikonstruksioni shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri” + shtesë për palestër Korçë”, me sipërmarrës punimesh OE “I” SHPK.

- Kontratës nr. 5178/2 prot., datë 04.09.2018, lidhur ndërmjet Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Z. S.F dhe kontraktorit “D.P” SHPK & “SK 11” SHPK, regjistruar me NIPT. L.....M dhe me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2837/1 me Administratori Z. S.K, për shkeljet e konstatuara si vijon:

Vlera **939,368** lekë pa TVSH ose **1,127,241 lekë me TVSH**, përbën dëm ekonomik si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në zbatimin e kontratës me nr. 5133/6 prot, datë 04.09.2018 me objekt “Sistemim, asfaltim në rrugët e qytetit (lagjet nr. 4, 5, 6, 8, 13 dhe 18)”, me sipërmarrës punimesh BOE JV “S” & “J” SHPK përfaqësuar nga kontraktori “S” SHPK.

**2. Znj. R.N,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve sipas kontratës nr. 1456/1 prot., datë 22.02.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Z. S.F dhe kontraktorit “R” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1506/8 me Administratori Znj. R.N, për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Vlera **1,078,892** lekë pa TVSH ose **1,294,670 lekë me TVSH**, përbën dëm ekonomik si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në zbatimin e kontratës me nr. 900/2 prot, datë 27.02.2019 me objekt “Sistemim, asfaltim dhe kanalizim i rrugëve në bllok banimi Lagjet 5 dhe 13”, me sipërmarrës punimesh BO.K“S” & “A” SHPK përfaqësuar nga Kontraktori “S”.

**3. Z. E.M,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve sipas kontratës nr. 4361/2 prot., datë 22.02.2019 , lidhur ndërmjet Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Z. S.F dhe kontraktorit “A.M” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2892/3 me Administratori Z. E.M, për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Vlera **918,454** lekë pa TVSH ose **1,102,144 lekë me TVSH**, përbën dëm ekonomik si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në zbatimin e kontratës me nr. 900/2 prot, datë 27.02.2019 me objekt “Rehabilitimi urban i rrugëve





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

në lagjet e qytetit”, me sipërmarrës punimesh BOE fitues “A.K 2002” SHPK & “A.A” SHPK.

**4. Z. A.K.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve sipas kontratës nr. 79 prot., datë 27.12.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Z. S.F dhe kontraktorit “L.C” SHPK & “MCE” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3119/2 me Administratori Z. A.K, për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Vlera **761,497** lekë pa TVSH ose **913,796 lekë me TVSH**, përbën dëm ekonomik si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në zbatimin e kontratës me nr. 9586/2 prot, datë 31.12.2018 me objekt “**Rindërtim i shkollës 9-vjeçare Voskopoje**”, me sipërmarrës punimesh O.K“N” SHPK.

**5. Z. K.S.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve sipas kontratës nr. 6676/2 prot., datë 29.07.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Z. S.F dhe kontraktorit “S.S K.S” SHPK, regjistruar me NIPT. L.....M dhe me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2992/6 me Administratori Z. K.S, për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Vlera **517,606** lekë pa TVSH ose **621,127 lekë me TVSH**, përbën dëm ekonomik si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në zbatimin e kontratës me nr. 6026/2 prot, datë 29.07.2019 me objekt “**Rindërtim i shkollës 9-vjeçare Nuçi Nuçi**”, me sipërmarrës punimesh O.K “N” SHPK.

**6. Z. G.B.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve sipas kontratës nr. 4636/2 prot., datë 31.05.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Z. S.F dhe kontraktorit “G B C E.” SHPK, regjistruar me NIPT. L.....M dhe me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2812/3/6 me Administratori Z. G.B, për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Vlera **634,555** lekë pa TVSH ose **761,466 lekë me TVSH**, përbën dëm ekonomik si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në zbatimin e kontratës me nr. 4333/2 prot, datë 31.05.2019 me objekt “Rikonstruksion rrugësh në njësitë administrative (Faza I)”, me sipërmarrës punimesh O.K“G” SHPK.

**7. Znj. M.K.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve sipas kontratës nr. 6330/2 prot., datë 16.07.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Z. S.F dhe kontraktorit “P.F. M.K & D” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1200/4 me Administratori Znj. M.K, për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Vlera **513,128** lekë pa TVSH ose **615,753 lekë me TVSH**, përbën dëm ekonomik si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në zbatimin e kontratës me nr. 4894/2 prot, datë 16.07.2019 me objekt “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale "Rikonstruksion në bllokun informal Rr. QANI QYTEZA", me sipërmarrës punimesh O.K“A.K” SHPK.

#### **E/1 Për procedurat e prokurimit publik.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në dokumentet e auditimit, vërejtjeve dhe komentet e subjektit të audituar trajtuar në kapitullin 2/3 të Raportit Përfundimtar të Ri Auditimit, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenet 15 shkronja (c, ç) dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe shkresës së APP drejtuar KLSH me nr.2624, datë 13.04.2021, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë, të vlerësojë

shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë), apo marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara.

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**